



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

TRANSCRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 17 dhe 20 KORRIK 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
17. i 20. JULIA 2009. GODINE

KORRIK – JULIA  
2009

## Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritarë,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t’ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ju njoftoj se para seancës, deputeti Arsim Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

**ARSIM REXHEPI:** I nderuar shumë, zoti Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi,  
I nderuar zoti Kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Kolege dhe kolegë deputetë,

Procesi i privatizimit në komuna e Vushtrrisë ka rezultuar si një proces krejtësisht i dështuar. Duke qenë se Vushtrria kishte së paku tri fabrika të mëdha, popullsia e atjeshme ishte e angazhuar në to. Në Fabrikën e Tekstilit “Vushteks”, në Fabrikën e Llaqeve dhe Ngjyrave “Ekstra” dhe në Fabrikën e Llamarinës “Llamkos” ishin të punësuar rreth 4000 punëtorë. Gjatë dhe pas procesit të privatizimit këto fabrika, dikur krenaria e këtij qyteti, ndërruan natyrën e funksionimit dhe dedikimin e tyre, e gjithë punëtoria mbeti pa punë dhe sot Vushtrria rangohet ndër regjionet më të varfra në Kosovë. “Vushteksi”, po e zëmë, është shndërruar në deponi mallrash gjithfarë dhe tjetërsimi i natyrës së tij do të duhej të ishte edhe në fokus të punës së këtij Kuvendi, sepse edhe aty gjatë procesit të privatizimit janë kultivuar praktika të dyshimta.

Janë 3000 vende të punës veç në këtë fabrikë, të cilat janë humbur gjatë procesit të privatizimit. Por, sot, këtu para jush kam dalë për një problematikë tjetër, kam dalë që të shpreh indinjatën time të thellë për zhvillimet më të reja në Fabrikën e “Llamkosit” në Vushtrri. Rreth 500 punëtorë të kësaj fabrike ka disa muaj që nuk kanë marrë pagat e tyre. Për më shumë, ata janë krejtësisht të pa sigurt për të ardhmen e fabrikës. Siç dihet, kjo fabrikë është privatizuar me spin-off special nga një afaristë bullgar, për të cilin, gjatë procesit të konkurrimit, Agjencioni i atëhershëm Kosovar i Mirëbesimit ka qenë në dijeni se ky afarist para organeve përkatëse bullgare veç kishte paraqitur kërkësen për insolvencë, për likuidim. Pra, ishte një operator ekonomik në shuarje, gjë kjo që do të duhej ta përjashtonte automatikisht këtë operator nga procesi i konkurrimit. Ky fakt do të duhej të merrej parasysh atëbotë nga AKM-ja, por me gjithë vërejtjet që janë bërë në këtë drejtim, ky Agjencion atëbotë i administruar nga ndërkombëtarët dhe vendorët ka ...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni kohën edhe gjysmë minute apo një minutë!

**ARSIM REXHEPI:** ...ky Agjencion atëbotë ka injoruar, do të thotë, kërkësat e sindikatës. Megjithatë, ky operator ka privatizuar “Llamkosit”. Investimet e këtij operatori kanë qenë nën nivel dhe vendet e lira të punës është dashur t’i krijojë ky operator, që e ka obliguar kontrata, që kanë qenë po ashtu në numrin e caktuar. Që nga ngushti i vitit 2008, punëtorët e “Llamkosit” do të thotë nuk kanë marrë pagat e tyre. Ata kanë protestuar para

Qeverisë dhe para organeve të komunës, por kanë hasur në vesh të shurdhër. Tani ata po bëhen gati që të futen në një grevë urie, një grevë e tillë nuk do t'i bënte mirë as gjendjes së gjithmbarshme dhe as imazhit të Kosovës dhe sidomos nuk do t'i bënte mirë imazhit të Qeverisë.

Andaj, ju kisha lutar, zoti Kryeministër dhe zoti ministër i Ekonomisë dhe Financave, Shala, që këtë problematikë të këtyre punëtorëve ta keni nën fokus dhe t'u jepni një përgjigje definitive sepse ...

**KRYETARI:** Faleminderit!  
Gani Buçina e ka kërkuar fjalën.

**GANI BUÇINCA:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!  
Edhe pse është një deklaratë e shkurtër, unë e mora fjalën dhe dola këtu para jush, të nderuar kolegë deputetë.

Jemi të gjithë dëshmitarë të një rasti të shëmtuar, dje, të një akti vandal të dhunës, i cili është shprehur ndaj institucioneve të Kosovës dhe për këtë besoj se të gjithë jeni të shqetësuar këtu.

Unë kërkoj që sot ky Kuvend të fus në rend të ditës dhe të nxjerrë një deklaratë dhe të gjithë ju që jeni këtu prezentë, të dënoni politikën e dhunës dhe terrorit, të dënoni atë akt i cili ndodhi dje edhe i cili eskaloi në një manifestim të një vullneti që ishte shumë shqetësues, jo vetëm përfat e qytetarëve, por edhe të institucioneve dhe përfat e demokracisë në Kosovës.

Pra së gjithash, besoj që këtë akt vandal, këtë dhunë, politikë terrori dhe të dhunës do të dënojnë edhe Aleanca përf Ardhmërinë e Kosovës, në vend që të shtrojë dolli dhe gosti përf vandalistët, falangistët, të cilët dëshironin të dhunonin institucionet dhe vullnetin e qytetarëve dhe besoj se është dashur ndoshta të ngrihet nga vetë kjo parti, të ngrihet ky problem.

Unë ju kisha lutar që sot, ju kolegë deputetë, duhet të distancoheni të gjithë nga politika e falangave, por dëshiroj të theksoj, unë solidarizohem me të gjitha ato kërkesa të arsyeshme të veteranëve të luftës, të invalidëve të luftës, të familjeve të dëshmoriëve dhe unë besoj që duhet të gjithë të përpinqemi që problemet e tyre në rrugë institucionale dhe në kuadër të mundësive që i ka Kosova ....

**KRYETARI:** Ju njoftoj që përf fjalë, para se të fillojë seanca, kanë qenë të lajmëruar Arsim Rexhepi, Gani Buçinca dhe Driton Tali. Të tjerët që janë lajmëruar, janë lajmëruar pa u konsultuar me mua. Driton Tali, e ka fjalën.

**DRITON TALI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,  
Të nderuar qytetarë,

Tashmë ne të gjithë jemi të informuar se Qeveria ka marrë vendimin përf ndërtimin e Termocentralit “Kosova C” apo “Kosova e Re” me kapacitet 2000 megavatesh. Këtë vendim shumë të rëndësishëm, i cili prek drejtpërsëdrejti edhe shumë gjenerata të ardhshme, Qeveria e mori pa debat publik, përf kundër shumë insistimeve edhe nga deputetët e Kuvendit. Siç e dini, personalisht, që nga shkurti i vitit të kaluar prej vitit 2008 kam kërkuar që të futet kjo pikë përf diskutim në Kuvend, sepse është çështja më e rëndësishme ekonomike dhe shoqërore përf Kosovën. Mirëpo, Qeveria gjithmonë i ka

anashkaluar këto iniciativa, duke zhvilluar një proces jashtë opinionit kosovar dhe kundër sugjerimeve të ekspertëve tanë dhe merr një vendim, i cili shkel strategjinë e zhvillimit të energjisë 2005 -2015, të cilën ky Kuvend i nderuar e miratoi në tetor të vitit 2005, sipas propozimit të Qeverisë, gjegjësisht Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, e cila thotë se kapacitetet e reja energetike duhet të ndërtohen me kapacitet deri më 1000 megavat dhe në bashkëpronësi me Qeverinë e Kosovës, do me thanë, Kosova në partneritet me investuesit privatë, pra jo domosdoshmërisht që investuesit të janë të jashtëm. Andaj, të nderuar kolegë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projekti dhe ngjarjet e fundit, kërkoi që urgjentisht të futet në rendin e ditës kjo pikë për diskutim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Po, pasi Gani Buçinca vërtet konsideroj që ka gabuar dhe të ka dhënë rast, përjashtim bëj nga të lajmëruarit, që Ardiq Gjini ta marrë fjalën.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë vetëm mund t'ju them ju, t'i lus edhe kolegët e Partisë Demokratike të Kosovës, edhe Kryeministrin që po qesh, të distancohen prej Gani Buçincës. Kryeministër, nëse je duke qeshur, e ke shti vetë t'i thotë ato fjalë. Jeni duke e prishur demokracinë, jujeni duke e prishur demokracinë, zoti Gani Buçinca, që punon me trekmandë, është duke e prishur demokracinë, pa pikë të lidhjes e fut në kontekst Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës përdicë që është e dënueshme. Mendoj se ky Kuvend njëherë e përgjithmonë, nëse e ka minimumin e drejtësisë dhe të njerëzisë, duhet të distancohet prej njerëzve që nuk e kanë asnjë fije nder në fytyrën e vet. Sot e ka fyer Kuvendin, ju ka fyer juve, na ka fyer të gjithë neve dhe kushdo që qesh sot, është duke e shkatërruar sensin demokratik të këtij vendi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryeministri e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** E para, desha që t'ju falënderoj të gjithëve, i nderuar zoti Kryetar, në këtë periudhë tash kur e kemi edhe një javë për rishikimin e buxhetit.

E dyta, desha të..., që pasi u përmend edhe Kryeministri në raport që e ngriti zoti Arsim për çështjen e "Llamkosit" në Vushtrri. E para, në atë periudhë kur është privatizuar, ju e dini, unë nuk kam qenë as kryeministër, as në Qeveri, jeni të informuar shumë mirë. E dyta, më vjen tepër mirë që e ngriti këtë çështje, me të cilën jam duke u marrë personalisht dhe drejtpërdrejt, por kjo çështje irregullohet përmes procedurave dhe çështjeve shumë transparente dhe jo politike apo përmes frysë elektorale, po përmes procedurave plotësisht transparente. Dhe, dobësitë, lëshimet dhe papërgjegjësitë e së kaluarës, natyrisht se Qeveria aktuale nuk mund t'i marrë, por është e obliguar t'i përmirësojë dhe jemi duke punuar për t'i përmirësuar, gjë që një ditë besoj se do të janë të mirëpritura edhe bashkëpunimi do të jetë i ngushtë dhe shumë i mirëpritur për të gjitha çështjet që mund të ngrihen, të debatohen edhe të sugjerojen.

Sa i përket projektit të Termocentralit "Kosova e Re", i gjithë projekti ka shkuar në një procedurë krejt transparente, me një qëndrim unanim të Komitetit drejtues, nëse deputeti nuk i njeh procedurat se si shkon e gjithë ai proces. Në një proces mbështetës të plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në një proces transparent mbështetës të plotë të Bankës Botërore, të Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të ICO, të Komisionit Evropian dhe të gjithë faktorëve relevantë ndërkombëtarë. Ndërsa, mendimet tuaja që pretendon t'i prezantosh 2015, nuk dallojnë nga mentaliteti i vitit 1974. Faleminderit!

(Reagim i deputetit Tali)

KRYETARI: Fjalën Kryeministrit!

KRYEMINISTRI HASHIM THACI: Po ju njoftoj që këto projekte madhore për interes të vendit, janë projekte që duhet të na bashkojnë të gjithëve, jo dikush të nervozohet pa asnje arsy, jo dikush të reagojë pa asnje arsy, përkundrazi duhet të jenë projekte që nuk datojnë me mua, nuk i kam shpikur unë, edhe këtë duhet ta kemi të qartë, por është një projekt i cili nuk mund të ndalet dhe duhet të ecë përpara.

Në anën tjetër, dua të theksoj se edhe për autostradën, që do të fillojë së shpejti, e di që keni për të reaguar, por mos u bëni reagues të punëve të mira. Ju ftoj, gëzojuni edhe dritës dhe distancimit nga terri edhe gëzojuni rrugëve të reja dhe distancimit nga balta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Vazhdojmë. Gani Buçinca, nuk ke të drejtë për replikë, se ke gabuar!

Vazhdojmë me rendin e ditës:

**- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 25 qershori 2009**

Ju njoftoj se në sallë janë 87 deputetë.

Kemi hyrë në rend të ditës. Faleminderit!

Konsideroj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 25 qershori.

Pika e dytë e rendit të ditës:

**- Pyetje parlamentare**

Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq. Deputete, mund ta lexoni pyetjen.

NERXHIVANE DAUTI: E kam parashtruar në seancën e kaluar dhe kam marrë përgjigje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë pyetjen nuk e kam me veti me qenë se javën e kaluar më është thënë që s'kam të drejtë, por megjithatë e kam mbajtur në mend.

E dimë, këtë vit të gjithë jemi dëshmitarë se të reshurat atmosferike u kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme bujqve tanë në pjesë të ndryshme të Kosovës, dëme të cilat e kanë shumë vështirë bujqit tanë t'i kompensojnë. Me qenë se ndikime të tillë nga të reshurat atmosferike mund të ndodhin edhe në të ardhmen, zoti ministër, a keni menduar për krijimin e ndonjë fondi për t'ju ndihmuar bujqve në raste të tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër Vehapi, e ke fjalën.

**MINISTRI IDRIZ VEHAPI:** I nderuar zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,  
Të nderuar deputetë,  
E nderuara deputete Pantina,

Është e vërtetë se në vazhdimësi, por edhe këtë vit ka pasur të reshura të cilat kanë bërë dëme në kultura bujqësore dhe ne si ministri kemi reaguar menjëherë, kemi dalë në terren dhe i kemi mbledhur të gjitha të dhënat për dëmet e krijuara, të shkaktuara nga breshëri dhe të reshorat në këtë vit dhe të gjitha këto do t'i prezantojmë dhe, në veçanti, ne kemi krijuar një komision të përbashkët me komunën e Gjilanit, me Ministrinë e Pushtetit Lokal, edhe Ministria jonë dhe në momentin kur t'i kemi të dhënat për dëmet e shkaktuara, sigurisht se si Qeveri do të reagojmë.

Por, mos harroni se në të gjitha shtetet, mendoj se edhe këtu te ne, kulturat bujqësore, por edhe sektorë të tjera, sigurohen përmes kompanive të sigurimeve dhe sigurisht këtu ndikimin e vetë duhet ta ketë edhe shteti, por buqit në të ardhmen duhet të mendojnë për sigurimin e prodhimeve të tyre dhe pastaj atëherë ata të jenë të sigurt në rast të dëmeve eventuale.

Si Ministri, ne nuk mund të parashohim fonde të tilla, sepse i tërë buxheti jonë nuk do t'i mbulonte dëmet të cilat mund të shkaktohen në një vit të caktuar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër!  
Deputete, ke pyetje shtesë. Faleminderit!  
Pyetja e radhës, deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati, deputetja nuk është. Vazhdojmë, deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Mund ta lexoni pyetjen, deputet.

**NAIM RRUSTEMI:** Çështja: Të dhënat tregojnë se ka raste ku punonjës, shërbyes civilë ose zyrtarë të një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejnë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik dhe për këtë shërbim pranojnë kompensim shtesë. Pyetja: Pse nuk e respektoni Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në Ministrinë që ju e drejtoni dhe a mund të tregoni si e bëni ndarjen e parave?

**KRYETARI:** Zoti ministër, e ke fjalën.

**MINISTRI AHMET SHALA:** I nderuar zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,  
Të nderuar deputetë,

Kolegët e mi më thonë, a dal unë t'i jap përgjigjen, sepse thotë që kjo nuk ndodh, kështu që unë megjithatë po të lexoj ligjin. Neni 80 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ndalim kompensim shtesë, thotë: Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbej në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë dhe nuk do të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyes civil ose zyrtar i sipër cekur. Prandaj, nëse Qeveria e Republikës së Kosovës cakton me akt ndonjë zyrtar, shërbyes civil ose një zyrtar i autoritetit publik për të shërbyer në komision, borde apo ndonjë funksion tjetër, ne nuk bëjmë kompensim. Dhe, nga 1 janari i vitit 2009 asnjë zyrtar,

përkatësish shërbyes civil, në qoftë se ka marrë pjesë në ndonjë punë që i ka caktuar ministri apo udhëheqësi, nuk është paguar për punën shtesë. Singersisht t'ju them, në disa pozicione ka krijuar ky nen goxha telashe. Ne jemi duke shikuar mundësinë se si të rregullohen që disa nga bordet ligjore që janë të imponuara me Ligj të Kuvendit, të gjemë një zgjidhje dhe besoj se duhet ta iniciojmë një procedurë të klarifikimit dhe, nëse mund të them, të relaksimit të këtij ligji, i cili ka krijuar goxha shtrëngim të fuqishëm dhe besoj se do ta gjemë një zgjedhje së shpejti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: I nderuar ministër,

Të dhënat nuk e thonë atë çka ju e thoni, por fjala publike sigurisht se mbetet në transkript. A ka mundësi që, mua personalisht, por edhe të tjerëve që janë të interesuar, t'i shohim të dhënat përmuanin dhjetor 2008 dhe përmuanin prill 2009 dhe t'i vërtetojmë në fjalët që ju i keni thënë këtu publikisht. Unë e di, e dinë edhe ata që e kanë marrë, edhe deputetët që janë paguar përmjë çështje të tillë përmuanin dhjetor 2008 dhe përmuanin prill 2009?

KRYETARI: Ke përgjigje? Urdhëro!

MINISTRI AHMET SHALA: Nëse nuk isha i qartë, dua ta përsëris. Ky nen zbatohet nga 1 janari i vitit 2009. Në bazë të të gjitha të dhënavë që Ministria e Ekonomisë dhe të Financave i ka, unë nuk besoj që ndonjë institucion ose organizatë buxhetore ka bërë një pagesë të tillë. Në qoftë se ka bërë, atëherë duhet të sqarojë organizata buxhetore, por ligji është shumë i saktë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Vazhdojmë. Deputeti Driton Tali, Driton, po ta jap përparësinë, nuk po të dënoj. Pyetje përmestrin e Ekonomisë dhe Financa, zoti Ahmet Shala.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kjo pyetje ka të bëjë edhe përmty, zoti Kryetar, mirë që nuk ma ndalove!

Bordi i ri TPK-së, i Trustit të Kursimeve Pensionale, kohë më parë deklaroi se është marrë vendimi përmuljen e shpenzimeve të menaxhmentit apo të operimeve, por nuk na u dhanë sqarime të hollësishme.

Pjetje: Sa iu kushton menaxhmenti operues dhe ai mbikëqyrës kontribuuesve kosovarë, sa paguhën drejtoret dhe bordi i drejtoreve, duke pasur parasysh se sot na kanë pru një raport dhe kjo pyetje është bërë më 1 qershor.

KRYETARI: Ministri i Financave, pyetja është përmty.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Ju faleminderit, deputet!

Konsideroj se kjo pyetje është përmty organin i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, është Bordi i Trustit Pensional. i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe konsideroj që ata duhet ta jepin këtë përgjigje. Prandaj, komentimi im është që Qeveria e Kosovës do të mbështetë çdo iniciativë e cila është përmirësuar qytetarëve të Kosovës dhe që është në funksion të efikasitetit të funksionimit të këtij institucioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

**DRITON TALI:** T'ia rikujtoj, nuk e di për të satën herë, zotit ministër, se nuk po i lexon ligjet. Ligji e obligon këtë, ky është sipas Ligjit mbi pensionet ai i cili duhet t'i raportohet këtij edhe Bankës Qendrore, për më tepër, siç e kam pas potencuar disa herë se biznes partnerin e tij e ka bërë kryetar të bordit atje dhe ajo është dashur, është dashur t'i tregohet kështu shoqërisht. Badihava nuk thuhet: "Bë mirë n'desh me pa mirë". Po, shumë zyrtarisht është ky i obliguar të na tregojë, sipas Ligjit mbi pensionet. Le ta lexojë mirë dhe e sheh!

**KRYETARI:** Ministër, keni përgjigje? Jo. Ju faleminderit! Vazhdojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku. Deputet, mund ta lexoni pyetjen!

**RIZA SAMAKA:** Zotëri Kryetar,

Në marrëveshje me ministrin e nderuar, e lamë këtë çështje për javën e ardhshme për shkak të pajisjes me disa të dhëna, të cilat do të shkonin në favor të përgjigjes adekuate. Ju faleminderit!

**KRYTARI:** E keni edhe një pyetje. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, ose për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Këtu i kemi dy ministrat, mund ta parashtroni pyetjen, zoti deputet!

**RIZA SMAKA:** I nderuari zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër, ministra, deputetë,

Pyetje kuvendore e referuar aplikimit, përkatësisht joaplikimit të nenit 13 të Ligjit për ushqimin. Ushqimi që importohet, sipas kësaj, në Kosovë, për plasman në treg duhet t'i përbushë kërkesat ligjore për ushqimin. Rrjedhimisht me paragrafin 2 të po kësaj dispozite, është përcaktuar se ministri për Shëndetësi dhe ministri për Bujqësi, Pylltar dhe Zhvillim Rural, me akt nënligjor nga sferat respektive definojnë kushtet për importimin e ushqimit në vend. Me sa unë di, ky akt nënligjor nuk është miratuar, por nëse eventualisht është miratuar, nuk është relevante që unë nuk e di, po e zëmë, por e di këtë që është më relevante se...

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Zoti ministër, cili po e merrni fjalën? Ministri Alush Gashi.

**MINISTRI ALUSH GASHI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Falënderoj deputetin Riza Smaka për përkushtim, për cilësinë e ushqimit në vendin tonë. Fatmirësisht, në vitet e fundit në këtë lëmi, legjislationi ka ndërmarrë të gjitha hapat që ushqimi në vendin tonë të jetë nën kontroll juridik dhe ekzaminim të laboratorëve.

Ushqimi i importuar në Republikën e Kosovës kontrollohet në Dogana nga Agjacioni i Ushqimit dhe Veterinës, agjencion i cili sipas Ligjit të ri të votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në pranverë të këtij viti, përgjegjet në Kabinetin e Kryeministrat. Në Doganë, ushqimi kontrollohet nga Inspektorati Veterinar dhe Fitasanitar dhe jo nga Inspektorati Sanitar.

Në bazë të Udhëzimit administrativ 1205 për etiketimin e produkteve ushqimore, bën miratimin e etiketimeve, të cilat janë të parapara, ku prodhuesit e ushqimit janë të

obliguar ta bëjnë deklarimin e përbërjes së produktit ushqimor dhe kjo verifikohet në laboratorët përkatës. Lidhur me një pjesë të pyetjes suaj, për të cilën keni marrë përgjigje nga ministri i Bujqësisë edhe herën e kaluar, më lejoni të theksoj se Ligji për ushqim në Kuvendin e Republikës së Kosovës është miratuar në prill të këtij viti dhe në bazë të atij Ligji, ne jemi të obliguar që të hartojmë udhëzime administrative, të cilat janë duke u bërë këto ditë dhe besoj në një afat të paraparë ligjor, ne do ta kemi në funksion edhe këtë udhëzim administrativ. Pasi që me procedurat e Kuvendit tonë, udhëzimet administrative hartohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, ne konform ligjit jemi duke i ndërmarrë të gjitha masat. Ju mund të keni ndoshta ndonjë ide përvendet tjera, ku së bashku me ligj Kuvendit i vijnë edhe të gjitha udhëzimet administrative, në vendin tonë nuk është ai rast. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

**RIZA SMAKA:** Mjerisht, ushqimi importohet i pakontrolluar, ushqimi së paku shitet jashtë kritereve elementare e standardeve, rrezikohet shëndeti i konsumatorit në çdo vend. Natyrisht, jo absolutisht në çdo vend, apo jo. Ky është realiteti edhe pa udhëzime që nuk i paski pas përgatitur, por jo vetëm udhëzime, por pa sanksione, po jo vetëm pa sanksione, por edhe pa ndërmarrje masash të përditshme të rregullta, absolutisht është e pamundur që të bëhet kontrollimi i ushqimit, i cili importohet dhe i cili distribuohet dhe i cili konsumohet. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëro, zoti ministër, e ke fjalën!

**MINISTRI ALUSH GASHI:** I nderuari, zoti deputet,

Mund t'ju garantoj se konstatimet e juaja nuk qëndrojnë. Ushqimi në vendin tonë importohet në bazë të ligjit në fuqi, kontrollohet cilësia dhe në vendet ku pas deklarimit mund të ketë ndonjë pikëpyetje eventuale, ekzaminimet bëhen së paku në dy laboratore tjera. Ne jemi të ndërgjegjshëm se gjatë këtyre dy viteve të fundit, inspektimi i institucioneve që merren me shitje dhe distribuim është përvjetor herë më i madh se viteve të mëparshme dhe përkushtimi që laboratori të jetë nën kontroll dhe të jetë laboratori në vend, vetëm e rikonfirmon përcaktimin për cilësi të ushqimeve. Andaj, ne jemi të gatshëm t'ju ofrojmë të dhëna shtesë në, qoftë nga Ministria e Shëndetësisë apo e Bujqësisë dhe laboratoret përkatëse për numrin e ekzaminimeve të ushqimit që bëhen në baza ditore, andaj konstatimi i juaj nuk qëndron.

**KRYETARI:** Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Sanije Alijaj, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen.

**SANIJE ALIJAJ:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Ligjit për barazi gjinore, subjektet përgjegjëse për arritjen e barazisë gjinore dhe kompetencat e tyre, neni 4, pika 5, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të paraqet Projektrezolutën mbi Programin e Kosovës për barazi gjinore, që duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Zoti Kryeministër, pse deri me tani nuk është proceduar kjo Projektrezolutë, kur dihet që Ligji për barazi gjinore është miratuar në vitin 2004, për t'i mundësuar Agjencisë për

Barazi Gjinore jetësimin e programit dhe të strategjisë për barazi gjinore 2009-2015. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Përgjigjet zëvendëskryeministri, Kuçi, Urdhëro!

ZËVENDSKRYEMINISTRI HAJRDIN KUÇI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zonja Aliu,

Unë besoj që pyetja është bërë para datës 4 korrik të këtij viti, përndryshe me datën 4 korrik, Programin e Kosovës për barazi gjinore, Qeveria e ka proceduar në Kuvendin e Republikës, që besoj se shumë shpejtë do ta vejmë në rend dite. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete, a keni pyetje shtesë? Sanije Alijaj!

SANIJE ALIJAJ: Unë nuk e kisha këtë informatë. Shqetësimi im ka qenë pse nuk procedohet Programi për barazi gjinore dhe pse nuk miratohet Rezoluta për jetësimin e këtij programi dhe të strategjisë për barazi gjinore? Krahas kësaj, kërkoj nga Qeveria që të formojë Institutin për hulumtime për barazi gjinore, që është në kuadër të programit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Deputetja Fatmire Berisha, ka pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq. Fatmire Brisha!

FATMIRE BERIHA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër, në Mitrovicë më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, në prani të familjarëve u vranë dhjetëra qytetarë, fëmijë, gra dhe burra prej 13 vjeç deri në 62 vjeç, si dhe u plagosën shumë të tjerë. Për 9 vite, familjarët e të vrarëve, të dëbuar nga vendbanimet e tyre, ndihen të lënë pas dore, pa mbështetje institucionale. Pyetja ime për ju, ministër Rashiq, është kjo: Çfarë statusi do të kenë këta të vrarë dhe familjarët e tyre? Ju faleminderit!

KRYESUSI: Fjalën e ka, ministri Rashiq!

MINISTRI NENDAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Gospodjo,

Zakonom broj 02/L-2 za vrednosti rata, reguliše se status i prava na penzije i različite benificije za porodice palih, invalide, veterane, nesatale, kao i civilne žrtve rata.

U grupu - Civilne žrtve rata, ulaze osobe koji su umrle od poslednice rata od 27.02.1998 do 20.6.1999, kao i osobe koje se smatraju nestalim u toku ovog perioda. Na žalost, u ovom momentu osobe koje su van tog perioda bile umrle ili pale u ovom slučaju, što se same Mitrovice tiče, nisu predvidjeni u ovoj našoj šemi koju imamo. I na žalost, nijedan zakonski akt, ni zakonski podakt ne reguliše njihov status, tako da mi možemo da imamo na umu, i kada budemo imali mogučnosti da možda nešto uradimo povodom toga, ali u ovom momentu Zakon nije spremán da i ove ljude eventualno uključi u svoje sistemske šeme. Eventualno šta možemo mi da uradimo, šta mogu ja da vam ponudim

da možemo da uradimo, da ukoliko su porodice tih, na žalost umrlih ljudi, ukoliko su porodice u lošem materijalnom stanju, mi možemo da im ponudimo našu asistenciju naše socijalne, penzije i druge programe pomoći koje naše Ministarstvo ima pod kompetencijama. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!  
Zonja deputete, a ke pyetje shtesë? Fatmire!

FATMIRE BERISHA: Po, ju faleminderit, i nderuari kryesues!  
Ju faleminderit për sqarimet, zoti ministër! Besoj që me ardhjen e këtij ligji në Kuvend do të kihet parasysh edhe çështja e kësaj kategorie të qytetarëve tanë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Deputeti Naser Rugova, ka pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, zotëri Sadri Feratin.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Zoti ministër Ferati, pse nuk po funksionalizohet Tregu i gjelbër, i ashtuquajtur multietnik te ura lindore e Mitrovicës. A mos po pritet rezultati i procesit të decentralizimit në atë pjesë, kur dihet që janë investuar para të shumta nga taksapaguesit kosovarë lidhur me këtë projekt. Ky është një shqetësim dhe kam obligim për shumë qytetarë të asaj pjese të Mitrovicës, më kanë lultur që thjesht ta parashtoj si pyetje parlamentare në Kuvend dhe konsideroj që ju jeni ministri kompetent për këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, Ferati!

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
I nderuari deputet,  
Edhe pse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ç'është e vërteta, nuk është kompetente për bashkudhëheqjen e këtyre projekteve që financohen nga Komisioni Evropian dhe që lidhen me pjesën e zhvillimit, pra të tregtisë, është Ministria për Tregti dhe Industri, por meqë unë kam disa informacione, do t'i ndajë me juve bashkë. Ky është një projekt që ka filluar në vitin 2003, pra atëherë edhe kur nuk ka pasur Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal, por është bërë bashkërisht me Ministrinë për Tregti dhe Industri. Por, meqë kam qenë afér këtyre projekteve, kam disa informacione.

Për arsyet e praktikave që tani ne i njohim, jo për herë të parë ndodhë që mjetet që ndahen nga Komisioni Evropian, ato kanë një afat më të gjatë të implementimit. E di se është kontraktuar kompania, është një kompani me emrin "Kastrioti" dhe tek tash, në vitin 2008, ka intensifikuar punët e sajë dhe është afér përfundimit të fazës së parë të infrastrukturës dhe kjo është hera e parë, pra, që do të shpenzohen ato 500 mijë eurot e para. Por, do t'i ketë edhe dy fazë tjera dhe ju siguroj se nuk ka asnjë pritje me asnjë motiv tjetër dhe edhe ne insistojmë edhe tani, kemi insistuar edhe më herët, kur isha në një funksion tjetër, që kjo sa më shpejt të ndodhë dhe të jetë në dispozicion të interesit të qytetarëve.

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!  
Zoti deputet, a keni pyetje shtesë? Naser Rugova

NASER RUGOVA: Ju faleminderit!

Ministër, këto shqetësimë që ngrihen nga ana e qytetarëve, të një pjese shumë sensitive tani për sigurinë, qetësinë dhe progresin e shtetit të ri të Kosovës, duhet të insistohet që të jetësohen për arsyen se, e di që është në fazën e parë, i di edhe procedurat, por edhe Komisioni Evropian, edhe institucionet e vendit, vërtet kur ndahen mjetet, duhet t'i realizojnë ato, sidomos në ambientet e tillë që kanë rëndësi të madhe për progresin edhe të Mitrovicës, por edhe të sundimit të rendit dhe të ligjit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, a doni shtesë? Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Drita Maliqi, nuk është këtu, por unë do ta levoj se kjo ka pasur dëshirë të bëjë shumë pyetje, unë do t'ia levoj. Deputetja Maliqi, pyetje për ministrin Sadri Ferati.

Deputetja Maliqi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Enver Hoxhaj.

Deputetja Maliqi pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Valton Beqiri.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi, asnjëra nuk bëhet, se deputetja nuk është këtu.

Deputeti Emrush Xhemajli, mua më duket se nuk është ky. Ky deputet ka pasur paralajmëruar një pyetje për ministrin Idriz Vehapi.

Në fund, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi. Urdhëro, zoti deputet!

RIZA SMAKA: Zoti ministër, Rashiq,

Në vendin tonë, në kundërshtim me Kushtetutën praktikohen padrejtësi dhe inkonsekuenca të konsideruara në disfavorin e të paaftëve në punësim, në edukim, në kujdesin dhe mbrojtjen shëndetësore si dhe në qasjen e shërbimeve shtetërore e tjera. Po ashtu...

KRYESUESI: ... Zotëri, veç një moment. Ju pyetjen nuk e keni drejtuar për këtë njeri, të cilit po i drejtoheni. Ju keni bërë pyetje për Idriz Vehapin. Pse tash Rashiq? Të merremi vesh çka është duke ndodhur këtu. Qe, e kemi me numër, e kemi pyetjen që e keni bërë ju. Ndreqi letrat, mos ia ke bërë njérën tjetrit, të lutem!

RIZA SMAKA: Unë, atë pyetje, e kam konsideruar se janë pyetje të sodit, të datës 10. korrik dhe e kuptova se është fjala për zotëri Rashiqin, ndërsa ajo pyetje është konsumuar për shkak se ka skaduar afati apo...

KRYESUESI: A doni të bëni pyetjen tash për zotëri Vehapin, apo jo?

RIZA SMAKA: Nuk e kam me veti, prandaj e lë.

KRYESUESI: Atëherë, e le për tjeter herë. Faleminderit, zoti deputet!

Ne do të kalojmë në pikën tjeter të rendit të ditës.

Kolegë deputetë, sot kemi në rend dite një mori çështjesh që kërkojnë debat dhe që do të zhillojmë debat për 3 – 4 pika.

Unë, ju ofroj për fillim, kjo varet nga ju, a pajtoheni që në debate të kemi 10 minuta për përfaqësues të grupeve dhe 5 minuta për deputetët?

Kush është ”për”, le ta ngrit dorën? Faleminderit shumë!

Kush është” kundër”, le ta ngrit dorën? 1 ”kundër”.

Abstenim? Nuk ka.

Domethënë u morëm vesh që të gjitha pikat e debatit që i kemi në rend dite sot, të marrin 10 minutëshin përfaqësuesit e grupeve ose shefat e grupeve, ndërsa deputetët nga 5 minuta.

Kemi në rendi dite:

- **Shqyrtimi i Raportit të parë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008**

Komisioni për Integrime Evropiane, në koordinim me komisionet e tjera parlamentare ka hartuar dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e parë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Raporti u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ftoj kryetaren e Komisionit për Integrime Evropiane, zonjën Zylfije Hundozi, që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit të paraqes këtë raport. Zonja Hundozi!

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues,

Zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

Rritja e eksperiencës dhe kapaciteteve për tejkalimin e sfidave që sjell me vete procesi i integrimeve evropiane është prioritet kyç i shtetit të Kosovës. Edhe pse realitetin e ri, gjegjësish krijimin e një shteti të ri në Ballkanin Perëndimor nuk e kanë pranuar edhe pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, gjë që e vështirëson procesin formal të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, kjo nuk është arsy që ne mos të vazhdojmë punën drejt këtij procesi. Këtë e kemi vërtetuar me angazhimin e rritur edhe të Kuvendit të Kosovës në këtë drejtim.

Edhe rapporti i sotëm paraqet një angazhim shtesë të gjitha komisioneve parlamentare që të jatin kontributin e tyre në këtë proces. Edhe pse bashkëpunimi në mes të komisioneve të Kuvendit të Kosovës dhe Komisionit për Integrimeve Evropiane me temën e planit të veprimit ka filluar, megjithatë bashkëpunimi nuk ka qenë i mjaftueshëm. Disa prej komisioneve kanë ofruar informacione të mangëta ose informacione për aktivitete që do të përbushen në tremujorin e tretë, gjë që nuk mund të konsiderohet si përbushje e obligimit për këtë periudhë reportuese që e kanë marrë komisionet pas miratimit të planit të veprimit nga ana e seancës plenare të 26 shkurtit të vitit 2009. Arsy për këtë ka qenë me siguri që hartimi i rapportit për zbatimin e planit të veprimit nga ana e komisioneve të Kuvendit paraqet një proces të ri dhe si i tillë i ka sfidat e veta. Kuvendi i Kosovës e ka adresuar plotësisht ose pjesërisht 55 nga 110 sfida të planit të veprimit në kuadër të 141 mbledhjeve të mbajtura nga trupat e saj. Me këtë është e qartë se komisionet parlamentare nuk e kanë pasur në mbledhjet e veta të rregullta një pikë në agjendën e tyre – procesin e integrimeve evropiane. Dhënia e informacioneve të mangëta ose mosdhënia e tyre ka pasur si pasojë mos regjistrimin, prandaj edhe mosparaqitjen e të gjitha sukseseve në këtë raport. Por, edhe pse bashkëpunimi në mes të kryetarëve të komisioneve ka qenë në nivel, Komisioni për Integrime Evropiane nuk ka pasur përkrahje nga ana e Kryesisë dhe atë sa i përket diplomacisë parlamentare. Komisioni për

Integrime Evropiane e ka pasur agjendën e miratuar nga Parlamenti i Madridit dhe Barcelonës dhe disa deputetë të këtij komisioni kanë qenë të ftuar që ta vizitojnë Parlamentin e Spanjës me kërkesë të këtij komisioni – Kryesisë që i është parashtuar, janë refuzuar. Me këtë rast ka humbur një shans për lobim që Kosova të pranohet, që edhe një shtet i Bashkimit Evropian ta pranojë Kosovën edhe të na lehtësohet rruga për procesin e integrimeve evropiane. Megjithatë, Komisioni për Integrime Evropiane do të bëjë vlerësimin e praktikave më të mira të zbatuara nga komisionet të cilat e kanë përbushur detyrën e tyre më me përgjegjësi dhe në formë të rekomandimeve do t'ia shpërndajë edhe komisioneve të tjera që në tremujorin vijues, mbledhja dhe analiza e informacioneve të jetë sa më adekuate.

Një punë me përkushtim do të jetë kontribut për raportin e ardhshëm që ai të parqet saktë gjendjen reale në Kosovë.

Sa i përket sfidave të identikuara në Raportin e progresit të dhënë në nëntor të vitit 2008 nga ana e Komisionit Evropian, ka pasur të arritura dhe atë në veprimet e të gjitha institucioneve – Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura, por me mos përmirësim të vërejtjeve të dala nga ky raport dhe numri i këtyre të fundit paraqet 2/3 nga 110 sfida të identikuara. Në raportin që u është dhënë deputetëve hollësisht janë të përshkruara të gjitha të arriturat dhe sfidat që nuk janë tejkaluar.

Me këto të dhëna, gjegjësish faktë, të dala nga ky raport, Qeveria nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme që t'i përmirësojë vërejtjet e dala në Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe me këtë e rezikon këtë proces shumë të rëndësishëm për Kosovën. Qeveria e ka hisen kryesore në përbushjen e obligimeve të marra nga partneriteti evropian dhe nëse këtë gjë nuk e kupton seriozisht, ne do të mbësim vrimë e zezë në Ballkanin Perëndimor.

Besoj se një punë më e përkushtuar për realizimin e obligimeve të marra nga partneriteti evropian do t'i lehtësonë Komisionit Evropian që të na fusë në procesin e liberalizimit të vizave. Me përashtimin nga ky proces, neve po na vazhdohet dënim i të jetuarit në geto e me të stagnim dhe vetëm stagnim, derisa fqinjët tanë me hapa të shpejtuar ecin kah Bashkimi Evropian.

Mirëpo, nga të gjitha të dhënat në Raport, kuptohet se duhet bërë një punë v më intensive, jo vetëm nga ana e Qeverisë, por edhe nga ana e komisioneve parlamentare që me detyrën e vet të bëjnë presion në Qeverinë që t'i plotësojë obligimet e marra nga partneritetin evropian.

Pasi që na ka mbetur edhe një tremujor për raportim, Komisioni për Integrime Evropiane i jep këto rekomandime:

Rekomandime për Kuvendin e Kosovës:

- Komisionet parlamentare të fillojnë të zbatojnë vendimin e seancës plenare për përfshirjen në rend të ditës të secilës mbledhje - integrime evropiane ku do të shqyrtohet rregullisht plani i veprimit në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre.
- Komisioni parlamentar nëpërmjet zyrtarëve mbështet rregullisht të përçojnë informacione të mbledhura te Kryesia e Kuvendit dhe Komisioni parlamentar për Integrime Evropiane për çështjet e ngritura në planin e veprimit.
- Kërkohet nga Komisioni për Mandate dhe Imunitete që të përfshijë në rregullore të re të punës që për secilin projektligj të dorëzohet raporti për vlerësimet e

- ndikimit rregullativ krahas memorandumit shpjegues, deklaratës financiare dhe deklaratës për përafrim të legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.
- Pas shqyrtimit të raporteve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi të monitorohet zbatimi i rekomandimeve nga Qeveria.
  - Të gjitha institucionet publike dhe politike në Kosovë të respektojnë parimin e mos ndikimit politik në emërimet në pozitat kyçë në shërbimin civil, agjencitë e pavarura dhe bordet e ndërmarrjeve publike.
  - Në përputhje me Kushtetutën rekomandohet që institucionet publike dhe politike në Kosovë të garantojnë dhe mbrojnë lirinë e shprehjes dhe fjalës së lirë, si dhe të parandalojnë praktikat e ndërhyrjeve politike në media.
  - Plotësimi dhe shtimi i stafit me numër dhe ekspertizë të njësisë për përkrahje ligjore në shqyrtimin e legjislacionit evropian,
  - Më konkretisht urgjentisht të rekrutohet stafi në Njësinë e harmonizimit në kuadër të Divisionit për harmonizim dhe standardizim ligjor në këtë njësi.
  - Të sigurohet linjë buxhetore dhe mbështetje institucionale për Këshillin për trashëgimi kulturore.

Rekomandimet për Qeverinë:

- Qeveria për secilin projektligj të dorëzojë raportin për vlerësimin e ndikimit rregullativ, krahas memorandumit shpjegues, deklaratës financiare dhe deklaratës për përafrim të legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.
- Drejtori i Agjencisë për Koordinim e Zhvillim dhe Integrime Evropiane pranë Zyrës së Kryeministrit t'i paraqesë raporte Komisionit për Integrime Evropiane në baza mujore për zbatimin e planit të veprimit për partneritet evropian.
- Qeveria dhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial të përgatisin një plan- strategji për përbledhjen e vendimeve të gjykatave dhe një përbledhje të interpretimeve të ligjeve.

Rekomandime të Zyrës së Avokatit të Popullit:

- Të merren parasysh nga Qeveria pas shqyrtimit të raporteve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi, të monitorohet zbatimi i rekomandimeve nga Qeveria.
- Qeveria të marrë masa konkrete rreth hartimit të kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij në fushën e të drejtave autoriale dhe të drejtave të ngjashme.
- Të sigurohet linjë buxhetore dhe mbështetje institucionale për Këshillin për Trashëgimi Kulturore.
- Të gjitha institucionet publike dhe politike në Kosovë të respektojnë parimin e mos ndikimit politik në emërimet në pozita kyçë në shërbimin civil, agjencitë e pavarura dhe bordet e ndërmarrjeve publike.
- Qeveria të zbatojë reformën e administratës publike dhe planin e veprimit.
- Në përputhje me Kushtetutën, rekomandohet që institucionet publike dhe politike në Kosovë të garantojnë dhe mbrojnë lirinë e shprehjes dhe fjalës së lirë si dhe të parandalojnë praktikat e ndërhyrjeve politike në media.

Rekomandimet për institucionet e pavarura,:

- Qeveria dhe Këshilli gjyqësor dhe prokuroria të përgatisin një plan-strategji për përbledhjen e vendimeve të gjykatave dhe një përbledhje e interpretimeve të ligjeve.
- Pas shqyrtimeve të raporteve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi të monitorohet zbatimi i rekomandimeve nga Qeveria.
- Të sigurohet linjë buxhetore dhe mbështetje...
- Të gjitha institucionet publike dhe politike në Kosovë të respektojnë parimin e mos ndikimit politik për emërimet në pozitat kyçë në shërbimin civil, agjenci të pavarura dhe ndërmarrje publike. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Është mirë deputetë ta ekonomizoni kohën, për të mos ndodhur secilën herë për ta vazhduar, apo jo. E dini sa i keni, bëni idetë pak më të koncentruar. Kush flet në emër të PDK-së, këtu i kam disa emra. Deputeti Hydajet Hyseni, flet.

**HYDAJET HYSENI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,  
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron integrimin euro-atlantik të Republikës së Kosovës një prioritet me peshë të veçantë që meriton vëmendje dhe përkushtim të veçantë dhe në këtë kontekst e përshëndet raportin e prezantuar dhe rekomandimet e tij, i vlerëson ato si bazë solide për procesin vijues të integrimeve evropiane.

Sic është e njobur, po edhe për arsyen e njobura, Kosova ka hyrë në këtë proces me vonesë të madhe dhe me hendikepe të shumta, por Kosova ka edhe përparrësitë e saja evidente që duhet afirmuar dhe shfrytëzuar dhe nuk janë afirmuar e shfrytëzuar sa duhet.

Përcaktimi plebishitar i popullit të Kosovës, spektrit të saj politik dhe të qytetarëve të saj për t'u bërë pjesë e familjes evropiane është shprehje e aspiratës së kahershme të brezave të ndryshëm çlirimtarë, që nga Skënderbeu, Rilindja Kombëtare e këndej. Ky disponim premtues, por në një masë edhe euforik dhe semplist, i thjeshtëzuar dhe thjeshtëzues, do racionizuar, sistemuar dhe operacionalizuar.

Po dëshmohet fakti tashmë i verifikuar për vullnetin e jashtëzakonshëm për të qenë pjesë e familjes evropiane, duhet shoqëruar me dëshmi për zotësinë dhe kapacitetet institucionale e shoqërore për t'u ngritur në nivelin e kërkuar të standardeve dhe vlerave demokratike evropiane.

Raporti që po e shqyrtojmë sot ashtu si edhe Raporti i progresit i Komisionit Evropian janë rast i mirë për të parë veten, për të parë edhe të arriturat, por edhe mangësitë, dështimet dhe sfidat e shumta me të cilat përballet Kosova në këtë proces historik. Si i tillë rapporti do përshëndetur dhe duan përgëzuar gjithë ata që kanë punuar në të, duhet shquar për të mirë, veçanërisht praktika e qasjes së hapur, inkluzive dhe gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndërinstitucionale, veçmas në reportin Kuvend – Qeveri, por edhe në report me shoqërinë civile dhe me partnerët ndërkombëtar, si e vëtmja qasje e drejtë dhe efektive.

Duke qenë rapport i parë në këtë proces dhe duke qenë se është një ecje në një rrugë për ne të pashkelur, Raporti nuk pretendon dhe objektivisht nuk mund të ishte i plotë dhe i përkryer. Raportit mund t'i bëhen vërejtje, korrigjime, plotësimë dhe konsideroj se ky edhe ishte një nga synimet e këtij rapporti. Qasja aktive, kërkuese dhe kreative ndaj këtij rapporti, do të ndihmojë jo vetëm plotësimin e këtij rapporti, por do të jetë rrjedhimisht

edhe ndihmesë e rëndësishme në procesin e hartimit të raportit të progresit të Komisionit Evropian.

Pos sfidave të shumta, të determinuar nga fati historik dhe rrjedhimisht stadi objektivisht i ulët i këtij zhvillimi ekonomik e shoqëror dhe veçmas nga pasojat e rënda të robërisë shekullore, represionit dhe luftës, tablonë e realitetit kosovar e dëmon edhe fenomeni i prezantimit ende të deformuar të realitetit të ri kosovar, nga njëra anë, si pasojë e mos organizimit dhe mos koordinimit të duhur, vazhdon praktika e mos afirmimit dhe mos kapitalizimit në masë të duhur të të arriturave evidente në fusha të caktuara. Ndërkaq, në anën tjetër, si pasojë e luftës ende aktive speciale dhe po ashtu edhe të prirjeve spekulative të qarqeve të caktuara e rretheve profiteve në emër të shoqërisë civile, të cilat janë mësuar të fitojnë projekte me trillime, shpifje e mizevirllëqe, duke ekzagjeruar deri në absurd problemet ekzistuese ose duke i imputuar realitetit kosovar edhe fenomene që nuk ekzistojnë fare. Madje mund të thuhet se edhe në vetë raportin ka mangësi të tillë.

Formula e Raportit të progresit të Komisionit Evropian nuk ka progres të reportuar, është zëvendësuar me të drejtë me formulën pak a shumë më të përshtatshme, nuk ka raportim, sepse ishte një difekt i tillë, komisionet nuk kanë reportuar, ministritë nuk kanë reportuar edhe sukseset evidente. Por kjo nuk ka ndodhur në gjithë raportin. Prandaj, ka edhe pjesë në të cilat është bartur formula e mëparshme që objektivisht prejudikon një vlerësim negativ.

Megjithatë, duhet pranuar se nuk ka fajin gjithmonë pasqyra, sado që është e deformuar. Fajet megjithatë shpesh i ka fytyra dhe ne mendoj që duhet të ballafaqohemi seriozisht me sfidat e evidentuara.

Një fenomen tjetër, që mendoj duhet adresuar me një qasje më aktive, është fakti se ne vazhdojmë t'i qasemi këtij procesi me duar të lidhura. Në shumë raste institacioneve të Kosovës u vihet përgjegjësi edhe për kompetencat të cilat objektivisht nuk janë në duar të tyre. Për më tepër, në fusha të caktuara ne përballemi edhe me praktikën e kuteve dhe standardeve të ndryshme. Mendoj se duhet shtruar me të drejtë nevoja e standardizimit të standardeve në raport edhe me të tjerët përreth nesh.

Raporti ka sfida të shumta dhe është mirë që raporti ynë i ka ri aktualizuar ato, por është nevoja tani që të mos mbetemi vetëm në konstatime, por të bëhet diagnostikimi i duhur i tyre, adresimi, operacionalizimi, afatizimi dhe korrigjimi i tyre, duke siguruar llogaridhëni adekuate. Në funksion të kësaj, e konsiderojmë të nevojshme funksionalizimin më të mirë, ndoshta edhe rindërtimin e një trupi koordinues ndërinstitucional, me përfshirje edhe të shoqërisë civile, që këtë sfidë do ta adresonte në mënyrë më adekuate.

Raporti është një rast për shkundje dhe këndellje dhe mendoj se ai po funksionon i tillë. Është mirë që edhe Shoqëria Civile po ngre zërin dhe po angazhohet, siç ishte edhe këto ditë, sidomos pas asaj që ndodhi me liberalizimin e vizave. Është vërtet e pakuptueshme që vizat t'u hiqen vendeve që nuk kanë njojur edhe dokumentet e UNMIK-ut, që kanë refuzuar edhe Këshillin e Sigurimit dhe rezolutat e tij, që kanë falsifikuar dhjetëra-mijëra dokumente të udhëtimit, kurse me kute të tjera vlerësohen vende që absolutisht në shumë aspekte qëndrojnë më mirë se kjo.

Besoj se me procesin vijues, komisionet dhe ministritë do ta plotësojnë Raportin dhe në këtë mënyrë do të ndikohet që raporti i Komisionit Evropian i progresit për Kosovën për vitin 2009, të jetë më i plotë dhe më pozitiv.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet angazhimin e Qeverisë në procesin e integrimeve evropiane, veçanërisht të zëvendëskryeministrit dhe mendojmë se zgjidhja që është gjetur duke angazhuar zëvendëskryeministrin edhe për një çështje të tillë të ndjeshme, është e qëlluar, por, konsiderojmë se ka vend për të avancuar edhe më shumë këtu, ndoshta edhe duke menduar për formimin e një ministrie të veçantë siç kanë bërë edhe disa vende me tranzicion më të suksesshëm se ne.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike me këto dhe sugjerimet e tjera, e mbështet raportin dhe angazhohet për jetësimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Hyseni! Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, flet deputeti Bujar Bukoshi.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të paraqes aprovimin e Raportit të Komisionit për Integrime Evropiane.

Ky komision, ku unë jam nënkyetar, ka bërë dhe po bën një punë të mirë duke ngritur kualitetin e punës të Komisionit për çdo ditë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah Raportin e Komisionit për Integrime Evropiane dhe i fton të gjitha formacionet e tjera të punojnë me përkushtim edhe më të madh në këtë proces.

E di se kemi mjaft punë për të bërë në këtë drejtim, nuk them se jemi lule e drithë, mirëpo të gjitha institucionet e Kosovës, pa dallim, kanë treguar përkushtimin maksimal për integrime evropiane. Ne jemi koshient që Kosova nuk mund t'i përballojë problemet pa asistencën ndërkombëtare, sidomos në kontrollimin e kufijve të Kosovës, në sundimin e ligjit, në rikuperimin e ekonomisë kosovare dhe në shumë sfera të tjera.

Forma se si po i kthehet ky përkushtim Kosovës, e minon punën tonë, përkushtimet tona si dhe kompromiset e shtrenjta, që i kemi bërë në rrugën tonë drejt integrimeve në Bashkimin Evropian.

Nga ana tjetër, disa vendime të Brukselit, jo vetëm që rrezikojnë punën dhe investimin që shoqëria kosovare, me institucionet e saj, e ka bërë në rrugën drejt integrimeve, por ato rrezikojnë stabilitetin e shtetit të Kosovës, si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë.

Propozimi i Komisionit Evropian për heqjen e regjimit të vizave për disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe memorandumi shpjegues i Komisionit Evropian – The explanatory memorandum i famshëm la një shije të hidhur tek shqiptarët, përsëri Kosova harrohet dhe mbetet në listën e zezë, përsëri kasapët e Ballkanit shpërblehen. Ky është vendim i gabuar, me standarde të dyfishta. Serbia nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkua, por është favorizuar. Propozimi ka prapavijë politike. Arsyetimet për gjoja natyrën teknike të mos përfshirjes së Kosovës janë jo vetëm joserioze, por kur kihet parasysh se Serbia, jo plotësisht e denazifikuar, është në listë të bardhë, janë edhe hipokritët.

Më lejoni që me këtë rast t'i shpreh edhe brengat e mia si deputet, për të cilat mendoj, besoj dhe shpresoj se edhe shumica e kolegeve dhe kolegëve të mi do t'i përkrahin.

Zonja dhe zotërinj,

Nëse e përkthejmë brutalisht këtë vendim, del që të mbijetuarit e Reçakut, të Izbicës, të Krushës së Madhe e të shumë e shumë vendeve të tjera të Kosovës nuk mund të udhëtojnë për në Bashkimin Evropian pa viza, përderisa paramilitarët e "Tigrave" të Arkanit, të Frenkit dhe të gjithë paramilitarët e tjerë, që kanë vrarë e prerë nëpër Kosovë, mund të sorollaten pa asnjë therë në këmbë nëpër vendet e Bashkimit Evropian. Ky është me të vërtetë skandal dhe mohim i vlerave morale dhe përplaset me të gjitha parimet e Bashkimit Evropian dhe besueshmërisë së tij karshi Kosovës. Kjo është e papranueshme për Kosovën.

Ditëve të fundit ishim dëshmitarë të një vizite tejet formale të zotit Solana, në të cilën ky zotëri mes broçkullave të tjera, pa pikë marreje na tha që për "shkaqe teknike" Kosova nuk qenka në rend për liberalizim vizash. Kjo është qesharake, kur në Kosovë qëndrojnë dhe veprojnë me mijëra ndërkombëtarë që marrin rroga për ta ndihmuar Kosovën, që ajo të bëhet vend më i mirë. Këta ndërkombëtarë dhe një grumbull organizatash ku po punuan këta, përfshirë edhe ICO dhe EULEX-in, paskan dështuar të na këshillojnë për kushte teknike të liberalizimit të vizave. Kjo tregon se sa seriozisht merret prezanca ndërkombëtare në Kosovë nga ana e Brukselit. Së pari, ndarja e rajonit që vuan nga të njëjtat probleme ose probleme të ngjashme në shtetet që bëjnë për viza dhe në ato që s'bëjnë, domethënë lista të bardha dhe lista të zeza, vetëm se rrit hendekun në mes të vendeve fqinje. Së dyti, duket se disa burokratë në Bruksel vuajnë nga harresa kur lejojnë që Serbia, shkaktari i katër luftërave të fundit në ish-Jugosllavi, të hyjë në këtë listë të bardhë e që viktimat si Kosova, mos të hyjë.

Kjo politikë, zonja dhe zotërinj, do të ketë reperkusione të rrezikshme, sepse do të amnistojë dhe do të validojë dhunën e kaluar, sjelljen e Serbisë. Nuk jepen karotat kur nuk ka shenja të denazifikimit të plotë të një shteti. Mesazhet janë të mbrapshta, sepse inkurajojnë Serbinë të vazhdojë të mbetet faktor çrrregullues në rajon. Kjo do të trimërojë ministrin e Punëve të Brendshme të Millosheviqit që ta eskalojë dhunën ndaj elementeve jo serbe në Serbi dhe Beogradit do të rrissë presionin që ka mbi serbët e Kosovës dhe me metodat e njobura destruktive do ta pengojë konsolidimin e shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet, Bukoshi. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i kam disa emra, deputetja Gjylnaze Syla.

**GJYLNAZE SYLA:** Faleminderit!

Inderuar zoti kryesues,

Inderuar zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Sot për herë të parë po shqyrtojmë Raportin e progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës. Ne përgëzojmë Komisionin për Integrime Evropiane për punën që ka bërë dhe për rekomandimet që i ka sjellë për punën e mëtejshme që duhet të bëjnë institucionet e Kosovës.

Përbushja e këtyre kërkeseve dhe kushteve është e domosdoshme për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Megjithatë, është e qartë nga rapporti se pjesa më e madhe e obligimeve bie mbi vetë Qeverinë dhe se pjesa më e madhe e sfidave që duhet përbushur është pikërisht nga Qeveria. Nga 110 sfida sa u patën identifikuar, sipas këtij

raporti janë përmbushur 55 nga këto. Raporti, pra, shqyrton kapacitetin e Kosovës për të zbatuar standardet evropiane, që do të thotë atrimin gradual të legjislacionit dhe të politikave të Kosovës me aqcuis communataire në përputhje me prioritetet e partneritetit evropian. Nga Raporti shihet se institucionet kanë përmbushur një pjesë të obligimeve të veta, një pjesë të obligimeve ende janë sfiduese, një pjesë është për shkak të mosbashkëpunimit ose për shkak të mos raportimit.

Kuvendi, në këtë aspekt ka rritur rolin e tij mbikëqyrës, meqenëse ka mbikëqyrur diku afersisht 8 ligje, ndërsa komisionet në përgjithësi kanë pasur mungesë të mbështetjeve profesionale. Unë ftoj Kuvendin që sidomos Komisioni për Integrimë Evropiane ta ndihmojë që të ketë stafin mbështetës, por që edhe vetë Kuvendi të ketë stafin mbështetës ku ka të bëjë me standardizimin e parimeve të BE-së.

Sa i përket Qeverisë në sferën e demokracisë dhe sundimin e ligjit për vitin 2009, Strategjia legjislative e Qeverisë në këtë strategji nuk është përfshirë Kuvendi. Tash sfidë ngel racionalizimi i metodave punuese, do të thotë, ekziston një përzierje në mes të përgjegjësive, të cilat i ka Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Agjencia për Barazi Gjinore dhe Agjencia Kundër Korrupsionit.

Po kalojmë në një temë tjeter, që është administrata publike, të shohim se sa funksionon demokracia dhe sundimi i ligjit te ne. Edhe pse Kuvendi ka arritur një sukses duke përgjedhur Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, ende sfidë ngelë, shërbyesit civilë përballen me ndërhyrje politike, korruption dhe nepotizëm. Nuk është zbatuar strategjia për reformën publike dhe plani i veprimit dhe nuk janë të qarta masat se si do të maten këto.

Sistemi gjyqësor. Të arriturat në sistemin gjyqësor janë se është bërë zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, sfidë ende ngelin burimet e shumta të legjislacionit dhe janë diku më shumë se 50 rregullore të UNMIK-ut, të cilat duhet zëvendësuar me legjislacionin gjegjës, ndërsa nuk ekziston Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Do të ndalem pak te të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Progres është arritur në zgjedhjen, pas përpjekjeve për herë të katërt, në përgjedhjen e Avokatit të Popullit, megjithatë, nuk është bërë amendamentimi i Ligjit për Avokatin e Popullit dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut.

Një fakt shqetësues dëshiroj ta ngrë, për të satën herë, sidomos presionin politik mbi mediet. Ky presion mbi mediet duhet të pushojë.

Të drejtat e femrave nuk respektohen, nuk ka strategji dhe mekanizëm për mbrojtjen nga dhuna në familje, por edhe mekanizmat ekzistues nuk janë efikas.

Agjencia për Barazi Gjinore ka dyfishim sepse këtë punë e bën gjithashtu edhe Zyra për qeverisje të mirë. Qëllimi i parashtruar i Ligjit për barazi gjinore që të ketë 40% të përfaqësimit të femrave nuk është përmbushur.

Nuk ka plan për bashkëpunimin ndërkombëtar për të lehtësuar transferimin e të arrestuarve kosovarë nga vendet e BE-së në Kosovë. Gjithashtu nuk ka përparim në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Sa i përket çështjeve rajonale dhe detyrimeve ndërkombëtare, më vjen mirë që është zëvendëskryeministri këtu, mbase mund të ketë progres se sipas raportit nuk ka progres

sa i përket përfaqësimit të Kosovës në mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë, si në Këshillin për Bashkëpunimin Rajonal dhe CEFT-a. Ngel që UNMIK-u është prapë përfaqësues i Kosovës.

Sa i përket ekonomisë, mungesa e statistikave e bën të pamundur vlerësimin e situatës ekonomike. Punësimi dhe politikat e punësimit janë të varfра dhe sa i përket politikave sociale nuk ka gjykata të specializuara në Kosovë. Kosova nuk ka Fond për Sigurim Shëndetësor.

Më lejoni të fokusohem për një moment në energjinë, duke konsideruar si elementin kyç për zhvillimin tonë ekonomik.

Të nderuar kolegë,

Dëshiroj të theksoj dhe të tërheq vëmendjen tuaj se duhet ta merrni shumë me shqetësim projektin “Kosova e Re”, domethënë, vendimi ka mangësi, nuk është transparent, është bërë me nguti dhe është injorim i rekomandimit të ekspertëve. Po e fus këtu, duke sjellë vëmendjen tuaj për rëndësinë se sa është e nevojshme që të krijohet transparenca dhe të mbikëqyret ky projekt.

Sa i përket kontrollit të kufirit dhe menaxhimit të kufijve, gjithashtu është i mangët. Nuk ka progres në zbatimin në praktikë, kurse pikat kufitare 1 dhe 31 mbesin jashtë regjistrimit të pikave kufitare të kalimit. Pasaportat nuk i kanë karakteristikat biometrike.

Luftha kundër krimit të organizuar është një e arritur e pakt në krahasim me atë çfarë duhet të bëhet dhe atë kryesisht një progres për viktimat e torturës, por jo edhe të luftimit të mirëfilltë të krimit të organizuar.

Përveç rekomandimeve që i mbështes, të cilat i ka paraqitur Komisioni, unë kam edhe disa rekomandime shtesë në emër të Grupit Parlamentar. Kuvendi duhet të ketë një sistem autonom të IT, në nivelin administrativ duhet të sigurohet stafi i kualifikuar për standardizimin e BE-së. Kuvendi duhet të jetë i involvuar në projektin “Kosova e Re” dhe duhet të jetë autoriteti përfundimtar i marrjes së vendimeve për kushtet dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja energetike në Kosovë.

Sa i përket rekomandimit të Qeverisë, në këtë projekt, sidomos duhet të jetë transparente. Qeveria duhet të luftojë korrupcionin dhe krimin e organizuar me krijimin dhe zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit kundër korrupcionit dhe krijimin e infrastrukturës përkatëse ligjore. Qeveria duhet të ketë plan për bashkëpunim ndërkombëtar për të lehtësuar transferimin e të arrestuarve kosovarë nga vendet e BE-së. Gjithashtu, duhet t'i kushtojë shumë më tepër vëmendje sektorit të shëndetësisë.

Sa i përket sistemit gjyqësor, duhet të krijohet sistem operacional për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjykatat paralele në veri, që zbatojnë ligjet serbe nuk duhet të lejohen.

Dhe, fare në fund, sistemi i caktimit, shkarkimit dhe promovimit në karrierë për gjyqtarë dhe prokurorë duhet të bëhet sipas standardeve evropiane, pa ndërhyrje politike. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete! Për Aleancën Kosova e Re, Njomza Emini.

**NJOMZA EMINI:** I nderuari, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,  
Kolegë deputetë,

Sot po e shqyrtojmë Raportin e planit të veprimit që është dal nga rapporti i progresit të Komisionit Evropian. Këtu do të doja të shprehja shqetësimin që nuk janë prezent, i pari që është në Qeveri, Kryeministri, që cdoherë thirret në agjendën e tij që është prioritet integrimi evropian dhe këtu shihet qartë se sa jemi ne, sa është vullneti jonë që të ecim drejt Bashkimit Evropian. Mirëpo, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re e përshëndesim punën që e ka bërë Komisioni Evropian, rapportin që është bërë, që është shumë i rëndësishëm tanë që jemi në fazën e shtet ndërtimit të Kosovës dhe kuptohet që jemi ata të cilët dëshirojmë të hyjmë edhe ne që të mos jemi të izoluar nga vendet e Bashkimit Evropian dhe sa më shpejt të hyjmë në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, do të thotë, nga ana Grupit Parlamentar ne e përshëndesim edhe bashkëpunimin që ka pasur Komisioni për Integrime Evropiane me komisionet e tjera parlamentare dhe duke ditur se ka një rëndësi të veçantë ku dihet se në vjeshtë të këtij viti Komisioni Evropian do të publikojë studimin e fizibilitetit i cili do të përbajë propozime konkrete për rrugën drejt Bashkimit Evropian që do të dalë me disa rekomandime se çka ne duhet të plotësojmë standardet dhe kriteret drejt Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, rapporti paraqet disa progrese të rëndësishme që janë arritur, sidomos në fushën e sundimit të ligjit, emërimi i kryetarit, të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese, prandaj emërimi i Avokatit të Popullit, anëtarësimi i Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe progresi i arritur në intensifikimin e kontakteve me institucionet e Bashkimit Evropian dhe takimin në Prishtinë në mes të Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian.

Mirëpo, përveç të arriturave, pra rapporti paraqet edhe shumë sfida të cilat janë mbetur, do të thotë, pa u adresuar fare gjatë kësaj periudhe kohore, shkurt-qershori të vitit 2008. Meqenëse ka shumë sfida të cilat do të adresohen, unë i kisha përmendur disa prej tyre që Grupi Parlamentar i ka pas disa rekomandime që mosmiratimi do të thotë i Ligjit për këshillin prokurorial dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor, mosemërimi i Komisarit për media i paraparë në Ligjin për qasje të informatave zyrtare dhe mos aprovimi i strategjisë dhe planit kundër korruptionit që dihet se ende nuk ka ardhur plani dhe nuk është aprovuar plani, faktikisht, kundër korruptionit që do të duhej të plotësohet njëra ndër sfidat që është më se e nevojshme kur dihet se së shpejti do të dalë edhe rapporti i progresit të Komisionit Evropian.

Ka arsyet ë ndryshme për mos adresimin e këtyre sfidave, mirëpo unë kisha dashtë të ndalem në dy pika që ndërlidhen dhe janë të rëndësishme për adresimin e të gjitha sfidave në tërsësi. Me qëllim që të kemi një mishërim të agjendës evropiane me agjendën tonë nationale, çështjet të cilat komisionet parlamentare i adresojnë në takimet e tyre të rregullta, është me rëndësi që komisionet parlamentare sa më shpejtë të vendosen në kuadër të tyre në agjendë integrimin evropian.

E dyta. Siç e ceka edhe më lartë, në vjeshtë të këtij viti do të kemi publikimin nga Komisioni Evropian të gjeturat e studimit të fizibilitetit dhe adresimi i të gjitha sfidave të dala nga rapporti i progresit 2008.

Është e rëndësishme që të bëhet para publikimit të gjeturave andaj një bashkëpunim dhe diskutim më intensiv në mes të Qeverisë dhe komisioneve parlamentare në lidhje me çështjet e integrimit evropian do të ndihmonte në adresimin e tyre.

Ne jemi edhe të njoftuar që tani ka dalë vendimi nga Brukseli që Kosova nuk ka hyrë, do të thotë, nuk është në agjendë sa i përket liberalizimit të vizave dhe për këtë unë rekomandoj dhe sugjeroj që të jetë në prioritet sa i përket integrimeve evropiane dhe që të dalë raporti sa më i mirë sa i përket përbushjeve dhe kritereve që do të duhej, atëherë konsideroj se neve po qe se dëshirojmë të hyjmë në familjen evropiane nuk na ndal që të përbushim kriteret po qe se dëshirojmë që sa më shpejt, sepse kuptohet vullneti i të gjithëve, institucioneve dhe qytetarëve është që sa më shpejtë edhe ne të jemi pjesë e familjes evropiane. Faleminderit për durim.

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!  
Për Partinë LDD, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Integrimi në Bashkimin Evropian tanimë është objektiv nacional i Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Konform agjendës evropiane, me propozim të Komisionit për Integrime Evropiane të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kuvendi më 26 shkurt 2009, miratoi Planin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian. Po në seancën e 26 shkurtit 2009, Kuvendi mori vendim që komisionet parlamentare të vendosin në kuadër të agjendës së tyre të rregullt një pikë të rendit të ditës lidhur me procesin e integrimit evropian, si veprime konkrete të legjislativit të vendit ndaj sfidave të raportit të progresit të Komisionit Evropian, gjë që nuk është respektuar nga shumica e komisioneve funksionale të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe pse janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm takimesh, tryezash, dëgjimesh publike dhe parlamentare, jo të gjitha komisionet parlamentare kanë kryer punën e vet si duhet, duke mos dërguar informacione të nevojshme te Kryesia e Kuvendit, te Komisioni për Integrime Evropiane, ose raportet kanë qenë të mangëta dhe nuk kanë paraqitur gjendjen e saktë për veprimet konkrete ndaj sfidave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian.

Ka qenë e paraparë që çdo tre muaj të debatojmë për veprime të ndërmarrë si legjislativ ndaj sfidave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian dhe tani jemi në javën e tretë të muajit të shtatë dhe po debatohet për të parën herë, që është kryekëput neglizhencë e Kuvendit dhe të trupave të tij dhe punë jo e mjaftueshme e komisioneve funksionale të Kuvendit. Me të drejtë mund të parashtrohet pyetja se çfarë ka ndërmarrë Komisioni për Integrime

Evropiane si komision përgjegjës për këtë proces. Përkundër mungesës së ekspertizës së nevojshme, mbështetjes së nevojshme institucionale, si komision më i ri i Kuvendit, kemi bërë një punë të konsiderueshme dhe kemi hartuar dokumente strategjike të nevojshme, si: Rezolutën për prioritetet dhe strategjitet e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, Rezolutën për adoptimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe dokumentin Letra e Bardhë, sfidat e përfshirjes sociale në Kosovës, dokumente këto të rëndësishme që dalin nga agjenda evropiane për Kosovën.

Është hartuar edhe ky dokument që po shqyrtohet sot, si instrument mbikëqyrës i Kuvendit të Kosovës, në kuadër të një mekanizmi që synon ta masë progresin e arritur, si dhe të rekomandojë dhe të korrigojë vendimet e institucioneve publike, kërkesa këto të Raportit të fundit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Cilat janë veprimet konkrete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si përgjigje institucionale ndaj sfidave të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008?

Gjatë periudhës reportuese, komisionet parlamentare kanë vënë theksin e mbikëqyrjen e punës së ministrive dhe ligjeve të caktuara. Janë thirrur dhjetë herë ministrat të raportojnë për këto çështje të lidhura me planin e veprimit, por kemi pasur raste kur ministrat nuk iu kanë përgjigjur ftesave të komisioneve parlamentare, ose ka edhe ministra që kanë refuzuar të raportojnë për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian.

Kjo nuk do koment, është më tepër se papërgjegjësi. Si rrjedhojë nga 110 sfidat që janë ndërmarrë veprime, në 55 prej tyre, janë ndërmarrë veprime të pjerrëta që do të thotë që tregon një neglizhencë, joefiqencë institucionale sa i takon këtij procesi jetik për të ardhmen e vendit tonë.

Jemi në pritje të përfundimit të studimit të fizibilitetit për Kosovën nga Komisioni Evropian. Me këtë qasje dhe neglizhencë institucionale, rezultati i këtij studimi, frikësohem se nuk do të jetë lajm i mirë për qytetarët e vendit tonë.

Në këtë dokument që po e diskutojmë sot, janë paraqitur të arriturat, sfidat, por edhe rekomandimet e nevojshme për Kuvendin, Qeverinë dhe institucionet e pavarura. Në këtë kuptim, Grupi Parlamentar i LDD-së, jep mbështetje në parim punës së mirë të Komisionit dhe të gjithë aktorëve të tjera që ndihmuan në hartimin e këtij dokumenti. Por, Grupi Parlamentar i LDD-së, duke parë mungesën e vizionit të institacioneve të vendit për ta integruar vendin në Bashkimin Evropian, neglizhencat, mungesën e kapaciteteve, mos komunikimin dhe ndërveprimin institucional, politikat sektoriale të pakoordinuara dhe pa strategji e plane veprimi, rekomandojmë veprime të shpejta si vijon:

1. Duke pasur parasysh se Plani i veprimit të partneritetit evropian përban rreth 1600 veprime, të cilat duhet të përbushen nga institucionet tona, këto veprime të zbatohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Plani i veprimit të Partneritetit Evropian, të debatohet në Kuvendin e Kosovës dhe të plotësohet me rekomandimet e organit më të lartë legjislativ të vendit, sepse është cilësuar nga Komisioni Evropian si dokument shumë ambicioz dhe në shumë raste jo real.
3. Të bëhet një koordinim dhe bashkëpunim institucional i mirëfilltë, të nxirret bazë ligjore adekuate, sepse edhe 17 muaj të qenit shtet, Agjencioni për Koordinim, Zhvillim dhe Integrim Evropian, punon me Rregullore të UNMIK-ut dhe kjo nuk do koment.
4. Plani i veprimit të partneritetit Evropian, i hartuar nga Qeveria, të miratohet më së largu në fund të marsit të vitit pasues dhe jo si deri me tanë, jemi në muajin e shtatë dhe ende nuk është miratuar në kuvend ky dokument.
5. Të përkrahet Komisioni për Integrime Evropiane në të gjitha aspektet dhe të ketë mbikëqyrje adekuate të Planit të veprimit të partneritetit Evropian nga ana e këtij Komisioni dhe e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Të ngrihet përgjegjësia, cilësia dhe koordinimi i aktiviteteve të zyrave të ministrive të linjës për integrime evropiane, agjencioneve të pavarura dhe institucioneve të tjera dhe të bëhet një koordinim i mirëfilltë institucional me Agjencionin për Koordinim, Zhvillim dhe Integrime Evropiane.

7. Procesi i integrimit në BE-e të jetë vërtet prioritet i Qeverisë dhe jo vetëm prioritet deklarativ, si deri me tani.

8. Të shqyrtohet edhe mundësia e organizimit institucional në nivele të tjera, pse jo edhe një ministri e veçantë për këtë proces në ekzekutivin e vendit tonë, për koordinim më të mirë dhe drejtim kompetent të këtij procesi, sipas kriterieve të parapara nga Bashkimi Evropian.

9. Angazhim të shtuar të të gjitha institucioneve përgjegjëse, në veçanti të Qeverisë, si bartëse kryesore e këtij procesi të rëndësishëm, sepse ditët e fundit jemi dëshmitarë të vendimeve konkrete të Bashkimit Evropian, të cilat për Kosovën nuk ishin lajme edhe aq të mira, andaj nëse nuk i qasemi drejt dhe me përgjegjësi këtij procesi, vërtet rrezikojmë të mbesim geto e Ballkanit si deri me tani.

Apeloj te Kuvendi dhe institucionet e tjera të vendit që këtij procesi jetik për të ardhmen e Kosovës t'i qasemi seriozisht, sepse pa i përbushur kriteret e nevojshme, qoftë edhe ato elementare si shtet, po shihet që karotat po shkojnë në drejtimet e kundërta, kurse një popull i lashtë që ka dhënë kontribut të veçantë për paqen dhe stabilitetin në rajon, nuk po shikohet ashtu siç do të duhej. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, deputet!  
Për Grupin “7+”, deputeti Xhezair Murati.

**DŽEZAIR MURATI:** Hvala, gospodine predsedavajući!

Ja se ne bih ljutio kada bi bio u prilici da pozdaravim veçi broj ministara, ali eto možda je dosadna ova ematika. Ona je tako složena, tako znaçajna. Mi, kada stvari ovde rešavamo, kada govorimo o njihovoj složenosti, ponekada ne uvidjamo da ta složenost zavisi od mnogo većeg jedinstva, ne samo skupštinskog, ja bih rekao i Vladinog rada, saradnja je ne samo sa našim civilnim društвom, sa medjunarodnom misijom i tako dalje. Izveštaj koji smo dobili ovih dana, je veoma složen, obuhvata vrlo složenu problematiku, terbalо je mnogo rada na njemu.

Ja, kao predstavnik Parlamentarane grupe „7+“, istovremeno i kao član Komisije za evropske integracije, mogu reči da smo uložili dosta truda. Parlament može sa time da se složi ili ne, ali je činjenica da ovaj izveštaj, pečat mu je dala Komisija za evropske integracije, jednom vrlo ja bih rekao plodnom saradnjom sa svima onima koji su hteli da saradjuju. Sve komisije ne na jednak način, sve institucije ne na isti način, svi pojedinci i ministri takodje, ne na isti način, ali danas kada je moj kolega Naser govorio o tome kako je kosovska javnost prihvatile to što su Kosovo, Bosna i Hercegovina i Albanija dovedene u jedan plan, ja bih rekao „Š“, u odnosu na neke zemlje koje su koliko do juče bile uzrok svih nestabilnosti, da se ne vraćamo nazad, čega... još treba da razmišljamo, postoji li to ili nešto što vezuje Bosnu i Hercegovinu, Kosovo i Albaniju, ima tu neka veza, ne moram ja da je pominjem, ali je činjenica da smo taoci jedne takve politike i oni koji se suprostavljaju naparetku ovih zemalja, u ovom slučaju Kosova. Ja bih rekao da moja zajednica je taoc. Bošnjaci kao većinski narod Bosne su priznali Kosovo pre nego je ona dobila nezavisnost, ali nisu u prilici i zvanično to uradili jer su taoci jedne politike produžene ruke tamo u Bosni.

Sandjak, vi znate koliko vozila Kosovom saobraćaju i tako dalje. Ovakvom politikom dolaze u još težu situaciju. Imamo sada puštanje autostrade, jer tako? Ponovo je ona na jednom, malo područje, što kažu moje kolege, getoizirana i tako dalje. A da bi smo te „sumnje“ otklonili, zaista mora mnogo toga još da se radi. Zaista mora još mnogo toga još da se radi, zaista mnogo treba da se radi.

I pored toga kažem, svesni smo da smo na neki način podredjeni, izolovani da ne upotrebim neke druge teže reči i tako dalje, ali ja bih se ovde u ovoj prilici zadržao na odeljak 2, tačka 2. Izveštaja koji smo imali pripremljen svih ovih dana, a to su u pitanju prava manjinskih zajednica, ljudska prava i tako dalje. Tako da, ja bih se malo zadržao prvo na informisanje. Gospodo, manjinske zajednice joč uvek nemaju isti pristup informisanju sa svim gradjanima Kosova. Pojedine teritorije su i dalje van signala RTK, 10 godina o tome govirimo, dovedemo političke lidere broj 1, broj 2. konkretno osoba koja vam goviri, i šta imate tamo obećanja, obećanja koja idu u vazduh i nema pristupa informisanju. Kada su u pitanju pisani mediji, nema pisanih medija na manjinskim jezicima, nema. Sredstva koja treba da predvidimo, recimo za elektronske medije, ponekada odu u budžet, ne iskoriste se, ne dodju na prvu stranu da se makar koliko toliko oni mediji elektronski koji se slušaju, budu malo jači i tako dalje.

Znate kako je, plačati preplatu a ne koristiti njene usluge, zar to nije zakidanje, neču da upotrebim teži izraz. To je jedna vrsta diskriminacije, ne volim nikada da politizujem ove probleme, ali činjenica je da je to, to. Kada je u pitanju Zakon o vreskim slobodama, činjenica je da on ima neusaglašenosti sa Zakonom u edukaciji, što dovodi veoma često do žalbi mnogih roditelja ili do nekih distanci na relaciji škola-gradjani i verske slobode i tako dalje.

Svakako je prilika da kažem ovde da ima napretka na Kosovu. Moje su kolege govorili i koleginica Emini, o Ombudspersonu, o Ustavnom sudu, o svemu tome što smo uradili, ne treba danas mnogo da se bavimo, to je činjenica. Mi sada treba da stavimo u žihu našeg interesovanja ono što smo propustili, što propuštamo, što zavisi od nas i tako dalje, i tako dalje.

Ponekada gospodo, gledano iz ugla večinske zajednice, možda problemi manjina vam izgledaju minorni, mali, ali kada se postavite u ugao naš pa kada pogledate iznutra, videćete koliko su veliki. 10 godina iza rata mi nemamo udžbenike u osnovnim školama, 10. godina iza rata, mi imamo vrlo loše prevode za prirodne nauke, 10 godina iza rata, kako da govorimo o udržebenicima za srednje škole. 10. godina iza rata, albanski kao jezik sredine, koji smo velikodušno prihvatali, izučava se u našim školama na bosanskom, na turskom, o jeziku romi, neču govoriti, tu nismo odmakli negde, sa dva časa nedeljno bez udžbenika, bez kvalitetnih nastavnika. O kojoj integraciji da govorimo. Ovo je prilika da kažem da mora da bude veći broj časova, mislim u nastavi zajednica manjinskih, veći broj časova albanskog jezika, i ozbiljniji rad i ozbiljniji program. Pa ne možemo drugačije, nemamo obrazovanje adekvatno rešeno, nemamo informisanje adekvatno rešeno, hočemo da govorimo o napretku kada je u pitanju Izveštaj o progresu.

Mislim da moramo, mi nemamo, vrlo često nam se gradjani žale na pristup zvaničnim dokumentima. I to je otežano. Pa onda, gospodo, molim vas, govorimo stalno o Ministarstvu zajednica, govorimo o Komisiji za prava i interese zajednica i ne mičemo od nule, i tako dalje i tako dalje. O decentralizaciji govorimo uvek, decentralizacija krajeva u kojoj živi jedna zajednica manjinska, šta je sa drugima. Mi nismo prihvatali da o

ovom problemu govorimo u Beču. Nama je domovina Kosovo, želim ovde da govorim, ali ovde niko ne govorи. Mi pominjemo, pominjemo i to se zaboravlja i odugovlači se i tako dalje, i tako dalje.

Zbog toga, gospodo, mi ovaj izveštaj prihvatom. Ja sam veoma zadovoljan radom u Komisiji za evropske integracije, ali to nije dovoljno. Mi moramo vrlo ozbiljno, zajedno ovde da analiziramo svaki naš narpedak, svakih nekoliko meseci i tako dalje i tako dalje, da ono što zavisi od nas, da mi budemo kreatori toga, a da kasnije ne dobijamo packe koje dobijamo i tako dalje. U svakom slučaju, mi izveštaj podržavamo, ali moramo i primedbe koje treba da budu objektivne, koje treba da ovde iznesemo, da ih ugradimo kako ne bismo bili tamo gde jesmo. Hvala!

KRYESUESI: Në emër të SLS-së, fjalën e ka Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ja se zahvaljujem, ali ja sam se prijavila da govorim kao poslanica, a ne u ime SLS.

KRYESUESI: Gospodjo, ja sam vam dao reč. Izvolte, govorite, jer ste dobili reč!

VEZIRA EMRUŠ: Da, ja se zahvaljujem, ali dala sam do znanja da govorim u svoje ime, kao poslanica.

Danas imamo pred sobom Izveštaj Evropske komisije koji po prvi put razmatramo ovde u Skupštini.

Pozdravljam Kabinet,

Predsedništvo, i sve kolege,

Ovaj izveštaj za nas treba da bude jako ozbiljan izveštaj. Ja se nadam da je svako od nas požljivo pročitao ovaj izveštaj. Ja se ne bih mnogo zadržavala na tačke koje su ovde dodirnute, ali posebno ću se zadržati na pitnaje decentralizacija i poštovanje Ahtisarijevog plana.

Na ime decentralizacije, mi kao zajednice nismo dobili opštinu, imamo označenje u Ustavu, imamo zvezdicu, ima nas kao narod u Ustavu, a naša zajednica, kao što je Goranska zajednica, nije dobila, nije ispoštovana na ime Zakona o decentralizaciji, iako smo dali kao subjekat politički amandman na Zakon o opštinama, da to budu 3 nove opštine, gde bi Zajednica bošnjaka, Gorana i još jedna zajednica u Pečkoj regiji, dobile tri opštine.

Znači, jako važno pitanje decentralizacije. Ovde sam čula sve kolege da su bila pitanja o medjuinstitucionalnoj saradnji ovde na Kosovu, i oko toga hoću da kažem da medjuinstitucionalne saradnje nema na centralnom i lokalnom nivou, što je posledica gde naše zajednice, kao manjinske zajednice, trpe još veće posledice svih tih zbivanja na Kosovu, kao što je poštovanje službenog jezika, prevodi, prilazi dokumentaciji, otežano je za naše zajednice, koja nažalost ne zna jedan od zvaničnih jezika, znamo da je po Ustavu albanski i srpski, a ostali jezici su na lokalnom nivou, tako da su zajednice sputane u svim oblastima, u oblasti zdravstva, u oblasti javnih preduzeća, informacija, u oblasti institucija, kao što su opštine i lokalne samouprave, u oblasti gde treba jedan izvod rodjenih da im bude dostupan.

O oblasti kao što je prosveta, neću da govorim. Kada je u pitanju naša zajednica, koja se opredelila i koja ima pravo i ne treba da bude diskriminirana, da uči na jednom od službenih jezika, kao što je srpski jezik. Meni je jako žao što moram da kažem, zajednica

uči i živi u jednoj jako teškoj situaciji gde nema osnovnu platformu za učenje našeg učenika, zato što smo se opredelili da učimo na jednom od zvaničnih jezika po Ustavu Kosova, a to je srpski jezik. Naša zajednica je izložena još većoj platformi, da kažem, jedne diskriminacije i smatram da više toga institucije Kosova i Vlada Kosova treba da naprave i da medju komisija saradnja bude i da se obidju zajednice, kao što su naše, i da se napravi osnovna platforma o svim ovim sferama. Toliko. Ja ne bih zamarala mnogo ovu zajednicu, ali mi je jako žao što nas je Evropska komisija izuzela od ostalih načela. Čuli smo da smo imali 110 izazova, da nismo ostvarili ni 50 od toga, pola, i to traba da bude jaka simbolika i alarmantnost za sve nas ovde poslanike. Tiliko za danas. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!  
Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zot kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të jem shumë i shkurtër. Së pari dua të them se duhet të përkrahet Raporti në përgjithësi dhe ato disa rekomandime, por ajo që duhet të theksohet dhe t'i japim rëndësi më të madhe, është te pika 14, faqe 29. Është shqetësuese, ndoshta, sepse Kuvendi duhet ta shfrytëzojë ekspertizën ekzistuese të Komisionit Evropian, domethënë nëse nuk ka mundësi të ekspertëve të jashtëm, t'i dërgojë ligjet për shqyrtim apo në harmonizim me legjisacionet e BE-së. Kjo ndoshta merr më tepër kohë, por ashtu duhet të bëhen dhe të shkojë paralelisht me ngritjen e stafit të divizionit për harmonizim edhe siç ceket në raport. Prandaj, bashkëpunimi me Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe ndihma kërkuar nga ata duhet të shfrytëzohet nga Komisioni për Integrim Evropiane maksimalisht dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në këtë rast, ajo që unë shoh që nuk trajton raporti, është mos implementimi i aktiviteteve që dalin nga Plani i Qeverisë për Integrim për periudhën 2008 – 2010. Për shembull, në raportin e fundit të progresit nuk është paraqitur, sepse plani është miratuar në korrik 2008, mirëpo Kuvendi e ka për detyrë të mbikëqyrë punën e Qeverisë drejtëpërdrejt të përbushjes së agjendës evropiane dhe, në këtë rast, trysnia e Kuvendit edhe e komisioneve duhet të jetë më e madhe në përbushjen e kësaj agjende. Disa struktura janë themeluar dhe nuk zhvillojnë takime, për shembull, Komiteti i Punës për Integrim Evropian, Zyra e zëvendëskryeministrat dhe e sekretarit të përhershëm të ministrive është përmendur dhe duhet të cekën në raport a ka pasur takime dhe cilët hapa janë ndërmarrë.

Ndoshta si rekomandim është dashur të kërkohet shpjegim nga Qeveria, lidhur me mos zbatimin e planit dhe mos funksionalizimin e strukturave që do të ndihmonin në realizimin e agjendës evropiane për Kosovën. Kjo është detyrë edhe e Kuvendit, sepse Qeveria i përgjigjet Kuvendit edhe në këtë rast Komisionit për Integrim Evropiane.

Unë do të thosha që ka ngecje edhe te Kuvendi, nuk është vazduar sipas agjendës. Për shembull, po e marr vetëm një ligj, Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis është nxjerrë me datën 6.5.2009, ndërsa sipas planit është paraparë që ligji të nxjerrët gjatë vitit 2008. Pra, edhe këto ngecje do të duhej të dilnin si rekomandime.

Kuvendi dhe Qeveria duhet të bashkëpunojnë në planin e ri të veprimit për partneritet evropian, në mënyrë që të pajtohen lidhur me veprimet që janë të arritshme dhe bashkërisht të jalin afatin kohor për realizimin e veprimeve. Nëse kjo nuk arrihet, atëherë shumica e veprimeve mbesin të parealizuara dhe plani mbetet shumë ambicioz. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet!  
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

**IBRAHIM GASHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra prezantë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po bisedojmë për një dokument shumë të rëndësishëm, që në fakt nuk është vetëm yni, por gjeneron prej një dokumenti që është bërë për ne, për të cilin është diskutua në instanca tjera të shtetit të Kosovës, por në Kuvendin e Kosovës po diskutohet për herë të parë. Mendoj që puna që ka bërë Komisioni ynë për Integrime Evropiane për ta sjellë këtë dokument është për t'u përshëndetur, por puna që kemi bërë të gjithë si institucionë për të përbushur vërejtjet që vinë nga Komisioni Evropian, gjithsesi është për të diskutuar, për t'u debatuar dhe për t'u korriguar.

Ne po dëgjojmë në fakt nga zhvillimet e këtyre ditëve lidhur me Kosovën, përkatësisht lidhur me çështjen e liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, jemi ndarë pak të pakënaqur, të zhgënjer me qëndrimet që janë marrë karshi tri vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhur me, si të them, etapat nëpër të cilat do të vijnë në fazën e liberalizimit të vizave, pra nuk janë bërë pjesë e grupit të shteteve që përfituan nga këto lëshime të BE-së. Mendoj që ne nuk kemi shumë arsyë që të anko hemi dhe ta kritikojmë Brukselin, por të shohim një herë sa ne i kemi kryer detyrat e shtëpisë dhe të shohim sfidat formale që i ka Kosova, barrierat formale që i ka Kosova për t'u bërë pjesë e këtyre lehtësirave të Bashkimit Evropian.

Ne po harrojmë që edhe më tutje pesë vende të BE-së nuk e kanë njojur shtetin e Kosovës dhe po harrojmë se çdo vendim brenda BE-së merret me konsensus të plotë dhe, natyrisht, kjo është një barrierë e madhe formale para së cilës duhet të mendojmë se si të gjejmë zgjidhje për ta tejkular si shtet dhe jo të ndalemi dhe vetëm të kritikojmë dikë.

Natyrisht, edhe vendimi për ta përfshirë Serbinë në procesin e liberalizimit të vizave konsideroj se duhet parë si vendim politik i Brukselit, si favor që i bëhet një shteti, ndoshta me gjasë për ta joshur atë që të kuptojë dhe që të pranojë t'i akceptojë realitetet e reja politike që kanë ndodhur në Ballkan në dhjetë vjetët e fundit ku .... më i pa akceptueshëm për Beogradin ka qenë dhe mbetet shteti i Kosovës.

Nëse rikthehem i ky raport që e kemi në diskutim sot, edhe këtu duhet të vërejmë se kemi ende shumë punë të pabëra dhe nëse këto, si të them, projeksione kohore që i kemi ngritur ne në këtë raport rezulton që shumë pika, i keni vërejtur të gjithë, thuhet nuk ka progres. Dhe, kjo duhet hiq pa shikuar më larg, veç këtu nëse ndalemi, duhet parë se a mund të mobilizohemi ne që të kryejmë pjesën tonë si Kuvend? Ne kemi ngritur edhe në Kryesi, por edhe në komisione shpeshherë nevojën e mbështetjes me ekspertizë, e mbështetjes me logistikë për të përbushur, përkatësisht për të përfomuar në nivelin e duhur që të përbushim atë minimum të obligimeve që i kemi, të detyrimeve që i kemi për ta prezantuar punën e Kuvendit të Kosovës pranë mekanizmave të Bashkimit Evropian. Ne kemi një Komision, i cili është ankuar në vazhdimësi se nuk ka mbështetje të mjaftueshme me ekspertë, gjë e cila vlen edhe për komisionet e tjera, dhe nuk kemi gjetur shumë, si të them, mirëkuptim brenda vvetves, por edhe në raport me Qeverinë, përkatësisht Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave që të gjejmë rrugë për t'i tejkular këto probleme që janë ekskluzivisht tonat, nuk janë të tjetërkujt.

Në vazhdim, unë dëgjova edhe fjalën e përfaqësuesit të minoritetit boshnjak, kolegut deputet, që ngriti edhe në atë pjesë, ka vërejtje që ndoshta nuk jemi ndalur për ta analizuar, do të thotë, si institucione se kemi mund të bëjmë më shumë që t'i përbushim disa gjëra që nuk janë shumë të kushtueshme, por që kërkojnë më shumë angazhim dhe përkushtim, si të them, të resurseve humane për t'i përbushur edhe ato. Të mos harrojmë se minuset që mund t'i marrim në këtë dimension, janë mjaft të kushtueshme dhe janë një farë mënyre vërejtje që zënë vend shumë lehtë në çdo raport tjetër të ardhshëm.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Po tentoj t'jua kthej pak memorien në vitin e kaluar, në shtator kur kemi diskutua për Raportin e progresit për vitit e kaluar dhe disa deputetë këtu, duke më përfshirë edhe mua, e kemi tërhequr vërejtjen se ka shumë pika serioze të cilat duhet të merren parasysh në atë kohë. Po ju kujtoj se prej kësaj follore zyrtarët më të lartë të Qeverisë kanë thënë: "gëzojuni sukseseve të Kosovës, ju prej opozitës".

Çështja tjetër është se kemi ardhur në pozitë sot të jemi vendi më i izoluar në botë dhe ne si institucion nuk po tregojmë se po klithim prej pezmit, se nuk është e drejtë çka po na ndodh. A e dini pse? Se secili po shihet pak në pasqyrë dhe po i vjen turp edhe të klithë prej pezmit se çka kemi ditur t'i bëjmë vetit. Shihni, integrimet evropiane udhëhiqen nga Ekzekutivi, jo nga Parlamenti. Shikoni kush është këtu, zëvendëskryeministri po udhëheq integrimet evropiane. A është këtu? Nuk është këtu, edhe a doni t'ju tregoj ku janë, mund t'ju tregoj edhe restorantin ku janë në drekë, nuk kanë punë hiq. Në drekë janë, nuk janë këtu që të bisedojnë me ne. Në fund të fundit, po shihet edhe pse nuk ka kuorum, nuk ka kuorum pse 15 ministra, zëvendëskryeministra e kryeministra, që janë deputetë e s'janë këtu, do domethënë 20 i kemi mangu në fillim. Paramandoni të dalë opozita, tash prapë nuk ka kuorum për debat, opozita po e bën kuorumin.

Çështje tjetër, nja 100 herë Kryeministri i Kosovës e ka përmend fizibilitetin. Çfarë fizibiliteti, bre, është turp ta përmend dikush fizibilitetin. Çfarë fizibiliteti kur Kosova është i vetmi vend në kontinentin e Evropës që nuk ka as perspektivë të liberalizmit sot. Nuk është çështja se edhe Bosnja edhe Shqipëria nuk kanë liberalizim. Nuk kanë liberalizim se i kanë pas një numër kushteve të caktuara 1, 2, 3, 4, 5, për të cilat Unioni Evropian, Komisioni u ka thënë, nëse i plotësoni, keni liberalizim, nëse nuk i plotësoni, nuk keni liberalizim. Neve as këtë nuk na ka thënë. Dhe, a dini çka dëgjojmë ne, duam t'i plotësojmë kushtet unilateralisht, por nuk kemi dëgjuar klithje më herët, kur ka qenë dashur, prej zyrtarëve të Qeverisë, të cilët ka qenë dashur të thonë qartë, nuk është e drejtë çka po na bëni, nuk është e drejtë se nëse dikush, në fund të fundit, ta përdorë një metaforë, "nëse dikush ta shpëton jetën, nuk ka të drejtë të ta lypë dorën".

Mendoj se duhet përmendur edhe disa çështje që po dalin këtu. Ne jemi duke bërë analizë profesionale, nuk kemi nevojë të bëjmë analizë profesionale të krejt kësaj pune, ne duhet të bëjmë analizë politike. Cilat janë pasojat, çka po ndodh me njerëzit e Kosovës, qysh e ndejnë vetën ata? Përpos një gazetari të "Kohës Ditore" që ka shkruar për një gazetë jashtë Kosovës, ka qenë një klithje për të treguar se po na dhemb, se nuk është e drejtë, se duhet të punojmë edhe vetë. Por, po ju them edhe një herë, klithja kamuflohet për shkak se po na vjen turp ta akuzojmë në këtë fazë Unionin Evropian, që edhe ata kanë faj për, shkak se ne e kemi bastarduar totalisht jetën politike në Kosovë. Shihni ju,

përmendet fizibiliteti dhe liberalizimi, e në raport thuhet që kemi problem me shërbimin civil. Krejt sekretarët permanentë janë përjashtuar prej punës, krejt drejtoret janë përjashtuar prej punës, më kryesorët, është shpërlarë shërbimi civil prej njerëzve që dinë dhe janë futur njerëz krejt të rinj që nuk dinë kurrgjë. Kemi problem me shërbimin civil, kemi problem. Thotë, kemi problem me buxhet, qe tri herë po na thonë, na kanë thënë që rishikimi vitin e kaluar është shkelje e Kushtetutës, e kemi përmendur në këtë foltore, kurkush nuk është lodhur. Sivjet prapë na sillet buxheti, për të njëjtën ditë do të na sjellin, i pari dhe i dyti, shpejt e shpejt, prapë ka shkelje të Kushtetutës në buxhet edhe na thonë po i ka fajet Evropa, se nja 5 shtete s'na ka njohur. Këqyreni veten!

Kemi problem me korruption, 100 herë na kanë thënë që është duke u rritur korruptioni, korruptioni ka marrë përmasa sofistikimi, është i organizuar, nuk është më... njëri të bëjë, njëri të mos ta bëjë, është i organizuar korruptioni dhe kurkush nuk lodhet, thonë ato 5 vende që nuk na kanë njohtë, Spanja e Qipro.

Kemi problem me lirinë e medieve. Çka kanë lidhje Qipro, Spanja e Sllovakia me lirinë tonë të medieve këtu, dhe ne prapë e akuzojmë dikën tjetër.

Mendoj se nëse ne nuk tregojmë, si Kuvend, se nuk jemi indiferent me këtë që po ndodh, nëse ne tregojmë se ne prapëseprapë duam ta shikojmë veten, po duam ta shikojmë edhe Evropën, që vetëm Kosovën e ka lënë jashtë, do ta japim një mesazh që krejt në rregull është, se komod jemi ne, se neve deputetëve administrata po na i kryen vizat e nuk po na bie ndërmend që njerëzit presin me ditë vetëm të shkojnë për ta vizituar një të afërm, shembull ta marrim, dhe në fund të fundit edhe është fyerje, është fyerje për qytetarin e Kosovës, i cili sot nuk është qytetar i dorës së dytë të Evropës, jo çfarë, është i dorës së tretë në Ballkan, është qytetar ballkanas i dorës së tretë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Me ndër qofsh, faleminderit edhe ty! Fjalën e ka kërkuar deputetja Edita Tahiri.

**EDITA TAHIRI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Ministra të nderuar,

Pavarësia e Kosovës dhe njohjet nga pjesa më e fuqishme e botës hapën mundësi reale për ta qeverisur mirë vendin tonë, si dhe për ta bërë Evropën dhe botën të na pranojnë krahëhapur në familjet e tyre. Mirëpo, rezultatet që i kemi, nuk janë ato të pritshmet. Sa janë inkurajuese disa rezultate, si njohjet e reja, anëtarësimi në Bankën Botërore e në Fondin Monetar Ndërkombëtar, iritja e buxhetit shtetëror, vendimet e përparimet e rëndësishme në planet strategjike të infrastrukturës, të arsimit, të legjislacionit e të tjera, aq janë dekurajuese ngecjet, si në ekonomi, në punësim, në zgjidhjen e çështjeve sociale, në planin e politikës së jashtme e tjës.

Qeveria e Kosovës nuk ia doli ta shpejtojë hapin, u vonua, neglizhoi apo u hutua pas interesave dytësore dhe, si pasojë, Kosova mbeti jashtë regjimit të liberalizimit të vizave.

Kriteret teknike për këtë çështje, si pasaportat biometrike apo menaxhimi i integruar i kufijve, nuk arritën të plotësohen me kohë. Derisa pati përparime në kriterin e dytë, është dashur një qasje rationale rrëth pasaportave biometrike dhe jo të bëhet një punë e dyfishtë. Nga ana tjetër, po ashtu mendoj se edhe Bashkimi Evropian nuk mbajti qëndrim koherët ndaj Ballkanit Perëndimor, përkundër zotimeve të agjendës së Selanikut për një integrim global të kësaj pjese të rajonit. Ishte gabim politik i BE-së që ta favorizojë Serbinë, si agresore dhe autore e gjenocidit në këto hapësira, e cila më tej vazhdon të

mos i përbush obligimet ndaj Gjykatës së Hagës, ndërsa izoloi Kosovën, e cila si viktimi u dëmtua në masa marramendëse. Kosova u desh të ketë trajtim specifik dhe të ndihmohet nga BE-ja në mënyrë që të evitojë më shpejt pasojat e krizës shumëvjeçare.

Megjithatë, përgjegjësia më e madhe bie te ne. Qeveria e Kosovës duhet të zotërojë shumë më mirë qeverisjen e vendit dhe të jetë në shërbim të plotë të interesave të qytetarëve dhe të interesave nacionale. Si anëtare e Komisionit për Integrime Evropiane, mund të them se me shumë kujdes trajtuam arritjen dhe ngecjet e institucioneve të Kosovës në përbushjen e sfidave të dala nga Raporti i progresit 2008. Bëmë një punë të madhe për t'i vlerësuar me saktësi rezultatet, ishim të lumtur për arritjet, por mbetëm të dëshpëruar nga ngecjet dhe veçmas të pakënaqur me raportimet e zbehta dhe improvizuese të disa ministrike e komisioneve të Kuvendit që pamundësuan një vlerësim të plotë.

Nga ky vlerësim, më lejoni të veçoj disa nga standardet, ku kërkohet vërtet një angazhim serioz. Një standard parësor është forcimi i ligjit, i sundimit të tij në kuptimin cilësor e gjeografik. Ligji duhet të vlejë dhe të zbatohet për të gjithë, pa përjashtime. Shtrirja e pushtetit në veri është imanente. Kërkohet thellimi i reformave në gjyqësi, një luftë e pa kompromis kundër krimit e korruptionit dhe dukurive të tjera.

Kemi nevojë për një qasje dhe qeverisje më efektive dhe shumë më transparente, që i bën ballë zgjidhjes së problemeve të qytetarëve dhe sidomos shtresave më të goditura të shoqërisë, një qeverisje që menaxhon mirë dhe krijon imazhin e Kosovës si një shtet funksional.

Mjafton ta rikujtojmë skandalin në Policinë e Kosovës, me ç'rast u zhdukën mbi 40 kilogramë narkotikë, apo manifestimin e dhunshëm të pakënaqësive të një grupei të qytetarëve, që ndodhi dje, për të konstatuar se duhet një reflektim i thellë i institucioneve për të qenë proaktive ndaj shqetësimeve dhe kërkesave të qytetarëve.

Jemi zotuar për krijimin e një shteti demokratik dhe jo të një demokracie të kontrolluar, për një administratë publike vilsoniane të liruar nga ndërhyrjet politike, por raporti i progresit të KE-së, rapporti i Departamentit të Shtetit Amerikan e raporte të tjera ...

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYESUESI:** Po e di që je, Editë, po përbolle, pra! Po, 5 minuta kaluan, regjia ta ndali. Ia jepni kohën, se është anëtare e komisionit.

**EDITA TAHIRI:** Faleminderit, shumë!

Ndërhyrja e politikës në gjyqësi, në media, në organizata publike është e pa tolerueshme, pastaj mungesa e debatit në Parlament. Ne po synojmë integrime të shpejta evropiane, por ky proces ka pengesa serioze me faktin se ende 5 vende nuk na kanë njojur, ndërsa lobizimi ynë ka humbur busullën diplomatike. Kjo qasje në diplomaci nuk e di se në interesin e kujt është, të mos flasim se mungojnë trajtime strategjike në pozicionime gjeo - politike të Kosovës. Siç dihet, rivalitetet gjeo-politike të vendeve të Ballkanit janë me zhvillime të hovshme, por mbahen sekrete. Ku është Kosova në këto zhvillime, a jemi duke e humbur hapin dhe a po ia ngushtojmë vetes perspektivën? Pyetja ime fundamentele është, a mos vallë e kemi reduktuar debatin për politikën e jashtme në garën e aktorëve zyrtarë dhe jo zyrtarë për atë se kush po grumbullon më shumë merita, derisa vendet rrëth nesh po krijojnë avantazhe gjeo-politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!  
Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar kolegë,

Unë do të përpinqem që të jem shumë i shkurtër, sepse u thanë shumë çështje, por para se të filloj do të them vetëm se sa është vullneti ynë për të qenë pjesë ose për t'u integrua në familjen e gjerë evropiane, shihet edhe vetë përkushtimi i Qeverisë së Kosovës, të cilët sot këtu, në kohën kur po flasim për një nga çështjet më të rëndësishme për vendin, nuk e kanë gjetur kohën dhe mundësinë që të jenë me ne.

Megjithatë, konsideroj se vendimi që Kosova të mos jetë në hartën e liberalizimit të vizave është lajmi më i keq për qytetarët e Kosovës, është lajmi më i keq për Kosovën dhe dikush do të duhej të japë përgjigje se i kujt është fajti, çka është dashur të bëhet dhe pse nuk është bërë, kush duhet të japë llogari para qytetarit të vendit, a ka vullnet politik për t'i kryer detyrat tonë dhe a po i frikohet dikush integrimit të Kosovës?

Do të përqendrohem në tri fusha shumë të rëndësishme, të cilat konsideroj se nuk do të duhej të jenë vetëm kërkesa dhe standarde që kérkon familja e gjerë evropiane, por mbi të gjitha çështjet të cilat kérkojnë ligjet e Kosovës dhe i parashohim.

Të drejtat e njeriut, të cilat janë të paraqitura edhe në këtë raport, e gjithë ne mund të shkruajmë fjalë të mira, por gjithë ne e dimë se cila është gjendja të drejtave të njeriut sot në Kosovë, ku po thuaj se nuk ka institucion i cili nuk abuzon me të drejtat e njeriut qoftë me veprim, qoftë me pa veprim.

Çështja e dytë - sundimi i ligjit dhe ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa kemi sundim të ligjit në Kosovë dhe cila është gjendja edhe me sistemin e drejtësisë në Kosovë, edhe me sistemin e sigurisë, por edhe me shumë fusha që atakojnë drejtpërdrejtë jetën e përditshme dhe që janë një faktor shumë i rëndësishëm për t'u bërë pjesë e familjes së gjerë evropiane.

Çështja që po ashtu bie në sy edhe në rapport dhe që ka mangësi, është mbrojtja e pronës intelektuale dhe ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa i kushtohet rëndesi në vendet demokratike mbrojtjes së pronës intelektuale. Në Kosovë, kolegë, përkundër faktit se kemi ligj, prona intelektuale nuk mbrohet, ajo përdhoset për çdo ditë.

Po ashtu, një fakt shumë i rëndësishëm dhe një nga kriteret është administrata publike në Kosovë. Gjithë ne e dimë që, jo vetëm që janë të politizuara, por është edhe e partizuar Administrata Publike në Kosovë dhe shërbyesit, punonjësit e Administratës Publike në Kosovë janë nën një presion të vazhdueshëm edhe politik, por edhe nën presione të tjera.

Përmenden shumë, po ashtu, çështjet të cilat do të duhej t'i kryej Kuvendi i Kosovës. Unë po përmend vetëm një prej organizmave më të lartë, i cili merret me shqyrtimin e problemeve në Administratën Publike të Kosovës. Konkrektisht, po flas për vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që është autoritet i pavarur, vendimet e të cilit, kolegë, në 90% të rasteve nuk zbatohen nga ana e institucioneve të Kosovës, qoftë në nivelin qendror, qoftë nga niveli lokal. Kjo është gjendja reale në të cilën gjendemi ne.

Po ashtu, mungesa e funksionimit ose mosfunkcionimi i Këshillit për Emërimet të Larta Publike është edhe një nga problemet shumë të mëdha. A kemi improvizim në Kosovë? Unë besoj që jo vetëm në këtë institucion ku jemi ne, por po thuaj se gjithëjeta jonë

institucionale ka më shumë të bëjë më improvizime se sa me kryerje të detyrave. Edhe ky Kuvend, të cilit i takojmë ne, ka mbetur po në të njëjtën gjendje në kohën kur në Kosovë ka administruar Administrata e UNMIK-ut, ka qenë instrument për nevojat e saj dhe tash ky institucion nuk ka arritur dhe nuk po arrin që të bëjë tejkalime, që të kryejë detyrimet e veta kushtetuese çfarë i ka. Është një mentalitet i mbetur edhe në Kuvend, është një mentalitet i mbetur edhe në Qeveri në kohën kur ka qenë UNMIK-u.

Po ashtu, këtu hetohen edhe përplasje kompetencash dhe unë do të përmend vetëm një rast se sa jemi serioz. Shumica e vendeve të cilat insistojnë ose synojnë integrimin në familjen evropiane, kanë ministri të punëve të jashtme dhe integrime, ne në Kuvendin e Kosovës kemi tre organizma të cilët merren me marrëdhënet me jashtë e ku ka dualizëm, ku ka konflikt veprimi, e kemi Kryesinë e Kuvendit, që është përgjegjëse për marrëdhënie me jashtë, e kemi Komisionin për Marrëdhënie me Jashtë, dhe e kemi Komisionin për Integrimet brenda Kuvendit dhe ju të gjithë e dini se sa dhe çka...

**KRYESUESI:** A e kreve, po. Fjalën e ka Fatmir Rexhepi.

**FATMIR REXHEPI:** Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Kolegë deputetë,

Dokumenti i hartuar dhe i ofruar nga Komisioni në formën e Raportit mbi progresin, sfidat dhe planin e veprimit të Kuvendit, është me shumë rëndësi nëse vlerësimi ynë politik është objektiv për progresin, si dhe për detyrimet dhe aktivitetet që dalin për institucionet e vendit. Në mungesë të një strategjje nationale lidhur me perspektivën evropiane të vendit, atëherë në plotësimin e kriterieve politike, ekonomike dhe të standardeve tjera drejt integrimeve në Bashkësinë Evropiane, dokumentin e vlerësoj me shumë prioritet dhe me konsensus të plotë institucional, por i cili për shtetin e ri është me plotë sfida, i cili duhet të sigurojë dhe të garantojë në radhë të parë zbatimin e Kushtetutës, forcimin e demokracisë, sundimin dhe zbatimin e ligjit, për të cilin jemi në një test demokratik para opinionit vendor dhe ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, në radhë të parë, po ashtu, duhet të shohim funksionimin e Parlamentit dhe të Qeverisë, e cila duhet të përfaqësojë dhe a përfaqëson dhe a garanton prava sovranitetin dhe integritetin e vendit në funksionimin e tij deri më tash.

Një rol të veçantë, në kuadër të këtij dokumenti, i shoh edhe sfidat në ndërtimi e një sistemi gjyqësor, forcimi dhe funksionimi i të cilët do të jetë dhe do të matet shumë nga Bashkësia ndërkombëtare dhe nga ne, nga qytetarët në luftën kundër krimít të organizuar, i cili sot është i pranishëm në vendin tonë, si dhe krijimi i një stabiliteti makro ekonomik, pra, të ekonomisë së tregut, të një transparence të plotë para Kuvendit dhe qytetarëve, në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve të pasurisë publike, në të cilën mendoj se nuk jemi kah e kalojmë tekstin as si Qeveri, e as si institacione, sikur që i kemi me dy rastet e fundit, ajo që sot u tha, pra, në një informatë dhe në një përgjegjësi që ka Qeveria në këtë rast para Parlamentit lidhur me procesin e privatizimit të Kosovës së Re dhe të aseteve të tjera të pasurisë së thëngjillit, si dhe të një aksioni të mëhershëm apo dokumentit që e lëshoi Qeveria dhe nja 3 javë e bombardoi, do të thotë, apo i dha një diverzion ekonomik së tregut lidhur me një monopol që deshi ta vendos për importimin e mishit. Këto janë shenja jo të mira, të cilat duhet pra t'i japid një shkollë vetë Qeverisë dhe ne se si duhet të sillemi në një shtet demokratik.

Mendoj, që ky dokument përcjell edhe kërkësen tjetër për një performance tjetër të Qeverisë lidhur me politikat, strategjinë dhe veprimet në luftën kundër korrupzionit,

sepse të gjitha sondazhet e institucioneve më relevante na e përcjellin mesazhin se korrupzioni në Kosovë është shumë i lartë.

Pastaj, në politikat sektoriale, pra, lidhur me menaxhimin e fondeve publike, me investime, politikat zhvillimore, pra mos të jenë selektive në të gjitha fushat, qoftë ato të transportit, të energjetikës, të mjesdit dhe politikat tjera të cilat janë të pranishme, por unë mendoj që këto duhet të korrigohen dhe të forcojnë, do të thotë, përbushjen e këtyre standardeve.

Një vlerësim tjetër që kisha dashur për ta thënë këtu para Parlamentit, është edhe plani dhe strategjia lidhur me qarkullimin e lirë të personave, kur kemi të bëjmë me përgatitjen e dokumenteve. Mendoj se këtu avantazhin që e kemi pasur para një viti e gjysmë, e kemi kthyer në disavantazh në raport me vendet e tjera. Kjo ka të bëjë kryekëput me përgatitjen e dokumentacionit që ka të bëjë me pasaportat biometrike. Në sirtarët e Qeverisë aktuale, para një viti e gjysmë ka ekzistuar pra dokumenti që ka kushtuar përafërsisht i përgatitur nga kompania “Sazhen” dhe kompanitë e tjera, afér 18 milionë euro, mjete të cilat nuk i kanë munguar Qeverisë as atëherë për shkak suficiteve, me prioritet është dashur që para një viti e diçka të fillojë dhënia e dokumenteve apo pasaportave biometrike, në mënyrë që të mos vonohemi dhe ta kemi, sot çdo qytetar i Kosovës ka mundur ta ketë pasaportën biometrike dhe dokumentet tjera, me të cilat kishim pasur një avantazh të madh sa i përket vendeve tjera, si një kusht teknik apo një standard, të cilin kemi mundur ta plotësojmë, por ky është një gabim i madh.

Megjithatë, unë e përkrah raportin dhe iu bashkëngjitem të gjithë atyre deputetëve....

#### Drejtimin e seancës e rimerr Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, Besa Gaxherri e ka fjalën! Nuk është. Fjalën ia jap deputetit Enis Krvan.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit,zoti Kryetar!

Unë e përgëzoj komisionin dhe e përkrah për punën, por megjithatë do t'i them disa vërejtje.

Në kapitullin e dytë që na është sjellë ne nga komisioni, ekziston lista e ligjeve të miratuara gjatë legjislaturës së tretë, por mendoj se nuk ekziston një informatë e mjaftueshme se cilat ligje nuk zbatohen dhe mendoj që edhe kjo do të duhet të ceket. Për shembull:

- 1) Ligji për dokumentet e udhëtimit, i aprovuar në Kuvend me datën 20 shkurt 2008, nuk zbatohet kur është çështja e gjuhëve zyrtare të komunave.
- 2) Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, të aprovuar në Kuvend me datën 13 mars 2008, nuk zbatohet tërësisht.
- 3) Ligji për letërnjoftimin, i aprovuar në Kuvend më 3 tetor 2008, nuk zbatohet kur është çështja e gjuhës turke, ani që me ligj e obligon institucionin përkatës.
- 4) Ligji për Ansamblin kombëtar shtetëror të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera, të aprovuar në Kuvend me datën 6 nëntor 2008, nuk zbatohet kur është

çështja e ansambleve në nivele komunale dhe të komuniteteve jo shumicë, që i garantohet me ligj.

Dhe, çështja tjetër, ne kapitullin 2.2, në veprimet e propozuara thuhet që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim duhet të kërkoj themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore. Prandaj, ne e kemi diskutuar edhe nëpër komisione parlamentare këtë çështje. Ky Këshill është themeluar në vitin 2007 dhe jemi në të njëjtin mendim që për mbikëqyrjen e organizmit të këtij Këshilli, duhet jo Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, por Komisioni Parlamentar për Kulturë, i cili ka punuar Ligjin për trashëgimi kulturore të Kosovës, në vitin 2007, i cili është aprovuar dhe, në të njëjtën kohë, Komision i cili ka formuar Këshillin për Trashëgimi Kulturore dhe i cili është votuar në këtë Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Po e shfrytëzoj vendin që t'ia jap fjalën vetes. Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Respektoj mendimet e çdo deputeti të shprehur në debatin e sotëm. Më lejoni që edhe unë si deputet të shpreh disa qëndrime për çështjen e integrimeve evropiane.

Të nderuar,

Përgjegjësia jonë si deputetë është përgjegjësi e përfaqësuesve të popullit, është përgjegjësi politike dh institucionale. Ne nuk përfaqësojmë politika të grupeve atdhetare e as të OJQ-ve apo të medieve. Kërkoj nga ju, të nderuar deputetë, që politikën tonë në raport me Bashkimin Evropian dhe gjithë instrumentet e tjera të tij, si dhe Këshillin e Evropës, të mos i ngrehim mbi politikën e liberalizimit të vizave apo të lejimit të vizave për Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Sigurisht që nuk ndihemi mirë me këtë fakt por, ju lutem, të keni parasysh faktin se Kosova shtet është në vitin e dytë të saj. Mendoj që qëndrimi i Këshillit të Evropës për liberalizimin e vizave për vendet e caktuara nuk është ngritur krejt mbi parimet politike, por edhe mbi çështjet teknike dhe të tjerët, si shtete që funksionojnë ndoshta qe 100 e më shumë vite, kanë pasur mundësi të tjera shumë më të avancuara dhe më të lehta se Kosova. Kosova qe 10 vjet ka pasur mundësi që t'i ndërtojë institucionet dhe t'i plotësojë kushtet dhe këto shumica e viteve nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, e pak vite si shtet i pavarur dhe shtet sovran.

Ne nuk mundemi si qytetarë, por edhe si përfaqësues të popullit, nuk mund të anko hemi në politikat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës dhe popullit të saj. Mendoj që Bashkimi Evropian dhe shumë trupa tjerë të Bashkimit Evropian, gjatë këtyre viteve kanë qenë në mbështetje e Kosovës, në mbështetje të proceseve politike që janë zhvilluar në Kosovë dhe në mbështetje të qytetarëve të Kosovës dhe mendoj që, ne si institucion, duhet ta njohim këtë mirënjohje, këtë mbështetje, këtë përkrahje që e kemi pasur nga shtetet, nga Bashkimi Evropian.

Do të thotë, ne nuk mund të nisemi nga ajo fjala e popullit “njëqind pite të humbin për një përpinq”, do të thotë, ne duhet ta kemi parasysh se gjithë këto zhvillime që i kemi pasur në 10 vitet e fundit, i kemi pasur në saje të një bashkëpunimi të fortë, të një koordinimi të punëve që i kemi pasur me Bashkimin Evropian, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e ndryshme të demokracisë botërore që e kanë mbështetur në tejkalimin e vështirësive, të gjitha vështirësive që i ka pasur Kosova dhe populli i saj.

Ne deputetët, Qeveria dhe institucionet e pavarura, mediet dhe shoqëria civile, të gjithë duhet t'i ngrehim standardet dhe përgjegjësitë që dalin para ligjeve në Kosovë, dhe jo të

gjithë gjithherë jemi duke respektuar standartet që dalin nga Kushtetuta dhe ligjet që janë në fuqi në Kosovë.

Integrimi nuk është çështje vetëm e institucioneve, ndonëse këto kanë përgjegjësi kryesore, por përgjegjësi kanë edhe qytetarët në prezantimin e vlerave kombëtare, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj dhe gjithherë qytetarët e Kosovës prezantojnë vlerat kombëtare në Kosovë dhe jashtë saj. Nga ne kërkohet që si shtet t'i plotësojmë disa kërkesa teknike, e mbi të gjitha duhet të bindim, në rend të parë veten, por edhe të tjerët se në Republikën e Kosovës sundon ligji, sundon rendi dhe ende ka shumë hapësirë për të dëshiruar për një rend dhe për një sundim të ligjit në kuptimin më të mirë të fjalës.

Unë kam bindjen se perspektiva jonë për lehtësim në lëvizje për integrime evropiane, është në bashkëpunim dhe koordinim të plotë në Bashkimin Evropian, me Këshillin e Evropës dhe me të gjithë trupat tjerë dhe me gjithë mekanizmat e vendeve evro-atlantike dhe kurrsesi në konfrontim me këto vende.

Gazetat mund të shkruajnë, Shoqëria Civile mund të flet dhe ata bëjnë mirë që flasin, se edhe ata janë në shërbim të demokracisë, por ne si institucione, në këtë rast si Kuvend, fjala jonë ka peshë dhe përgjegjësi tjetër dhe pesha jonë më nuk është vetëm personale dhe nuk është as vetëm institucionale, është një peshë që buron edhe nga përgjegjësia e qytetarëve që e kemi marrë dhe nga përgjegjësia e qytetarëve që duhet t'u shërbejmë dhe ne duhet të punojmë që vërtet qytetarët të kenë së shpejti lehtësi për të lëvizur jo vetëm në Evropë, por edhe në gjithë pjesën tjetër.

Po e përfundoj, ne duhet t'i ngrehim standartet, në rend të parë për veten tonë dhe nuk mund të kënaqemi dhe të pajtohem me këto standarde që vet ne i kemi, duhet t'i ngrehim standartet e vlerave tona dhe kur i bëjmë këto, unë kam bindje të plotë se do të hasim në mirëkuptim edhe në Bashkimin Evropian, edhe në Këshillin e Evropës, edhe në mekanizmat tjerë evro-atlantik, gjithnjë duke pasur parasysh se Kosova është shteti më i ri në Evropë dhe në Botë, por ne po flasim më tepër tanit për Evropën dhe mendoj që gjatë kësaj kohe, si shteti më i ri në Evropë, kemi arritur rezultate të kënaqshme. Natyrisht, qëllimi dhe synimi ynë është që të bëhem sa më parë dhe sa më shpejtë pjesë integrale e Bashkimit Evropian. Ju faleminderit!

Radha është për deputeten Qamile Morina, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

**QAMILE MORINA:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ministër, deputetë të nderuar,

Unë besoj, kolegë të nderuar, se ne jemi të gjithë të vetëdijshëm për dimensionin dhe rëndësinë e proceseve integruese dhe të rrugës tonë për të arritur qëllimet tona. Duke vlerësuar se qëllimi parësor i Republikës së Kosovës për vitin 2009 është avancimi i proceseve të integrimeve evropiane, me theks të veçantë në arritjen e vlerësimeve pozitive të Raportit të fizibilitetit nga Komisioni Evropian.

Kuvendi ka përmbrushur disa nga obligimet e parapara dhe atë në fillim të këtij viti, duke miratuar Rezolutën për prioritet dhe strategjitet e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008. Mirëpo, barra kryesore për realizimin e këtyre synimeve bie mbi Qeverinë, por mosprezenca e Kabinetit qeveritar sot, neve na bën shumë të qartë që Qeveria nuk është serioze lidhur me këtë çështje.

Unë do të ndalesha tek përbushja e pikave të politikave sektoriale, siç përcaktohet në raportin e progresit të paraparë në Propozim-planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pika 71, 72 dhe 107. Sa i përket dialogut social, një progres shumë i kufizuar është arritur. Këshilli konsultativ tri palësh nuk funksionon me vite të tëra, por edhe ristrukturimi në Këshillin Ekonomik Social, që është krijuar në këtë vit, ende nuk ka filluar punën. Esencialisht konsideroj se përmirësimi i dialogut social është i kushtëzuar me procedimin dhe miratimin e Ligjit bazik të punës. Është frustruese për qytetarët tonë, por edhe për ne deputetët, që arsyetimet që jepen me vite, janë tejet kontradiktore për implikimet buxhetore për mosmiratimin e këtij ligji. Fitohet përshtypja se nuk ka një ekspertizë të mirëfilltë për implikimin buxhetor për miratimin e këtij ligji, sidomos duke pasur parasysh se pagesa e pushimit të lehonisë po zbatohet.

Natyrisht, mungesa e Ligjit të punës vështirëson procedimin e Ligjit për sindikata dhe greva. Kontrata kolektive e miratuar në vitin 2004 nuk ka arritur të zbatohet fare, përvèç aneks kontratës të nënshkruar në mes partnerëve socialë, që ka pasur të bëjë me pushimin e lehonisë. Andaj, sa i përket realizimit të dialogut social, Qeverinë e pret një rrugë e gjatë që kërkon përkushtim në realizimin e tij. Sa i përket rehabilitimit profesional dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ligji është miratuar në Kuvend, por ende nuk zbatohet. Sipas informatave të marra nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale, Qeveria këtë vit ka miratuar planin kombëtar të veprimit të personave me aftësi të kufizuara, por fatkeqësisht ende nuk implementohet. Qeveria, gjegjësisht Zyra për qeverisje të mirë duhet seriozisht të angazhohet në monitorimin e implementimit të këtij plani kombëtar. Gjithashtu, nevojitet një qasje e të gjitha agjencive dhe në bashkëpunim të aktorëve të ndryshëm shtetërorë për të luftuar me sukses trafikimin e qenieve njerëzore. Nga e gjithë kjo që u tha, mund të konkludojmë se Qeveria nuk është qasur me seriozitet të plotë duke mos përbushur as obligimin që të sjellë në Kuvend Planin e veprimit të partneritetit evropian. E tëra po mbetet në disa iniciativa që nuk po arrijnë të zbatohen dhe, ajo më e rëndësishmja, çdo ditë e më shumë po konsiderohemi si vrimë e zezë e Ballkanit, që seriozisht po e çon Kosovën drejt izolimit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputetët që janë në radhë, ta kenë parasysh se raporti është i Kuvendit, nuk është i Qeverisë. Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

**SANIJE ALIJAJ:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ministër dhe deputetë të nderuar,

Shqyrtimi i Raportit të parë të progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës ka rritur dinamikën e punës së komisioneve parlamentare, të Kryesisë së Kuvendit, të seancave plenare dhe qysh në fillim Raportin e Komisionit Evropian e përkrah në parim dhe rekomandimet që i janë ofruar kësaj seance plenare për ta miratuar, sepse prezantojnë sfidat dhe prezantojnë të arriturat dhe sfidat që na presin në të ardhmen për t'u realizuar, që janë parakushte për integrimet evropiane. Në muajt e fundit, komisionet parlamentare, ku unë jam anëtare, Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Komunitete kanë shtuar aktivitetin për hartimin dhe realizimin e planeve operative për të realizuar pikat e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës në fushën e bashkëpunimit me ministritë për të konstatuar sa zbatohen ligjet që garantojnë të drejtat e njeriut dhe ka konstatuar se mekanizmat të cilat mbikëqyrin dhe garantojnë e promovojnë të drejtat e njeriut, nuk janë të mjaftueshme, njëherësh edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut kërkon që të bëhet komision funksional për projektligjet që procedohen në Kuvendin e Kosovës e që garantojnë të drejtat e njeriut. Në kuadër të përgjegjësive që dalin për Komisionin për të Drejtat e Njeriut, ai ka organizuar takime me Zyrën për qeverisje të mirë, Agjencionin për

Barazi Gjinore dhe Agjencionin Kundër Korrupsionit dhe nga ky takim ka konstatuar se janë arritur shumë rezultate por, ndër të tjera, kanë dalë disa rekomandime që unë do t'i prezantoj veç e veç. Duhet të përshpejtohet Ligji kundër dhunës në familje, në mënyrë që të realizohet strategjia kundër dhunës në familje, duhet të zbatohet neni 4 pika 5 e Projektligjit për barazi gjinore, për të nxjerrë një rezolutë që mundëson realizimin e Programit dhe të Strategjisë për barazi gjinore 2009-2015, njëherësh edhe Agjencionit për Barazi Gjinore t'i jepet fuqi ligjore që personave të cilët janë të dyshuar t'u konfiskohen, në të vërtet t'u bllokohen llogaritë bankare, kompanive t'u konfiskohen asetet dhe keqvepruesve të cilët mundësojnë korrupsionin në Kosovë, t'u merren dokumentet e udhëtimit, në mënyrë që kjo të jetë qasje serioze që Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian në të ardhmen të dalë me raporte pozitive në këtë drejtim. Në Komisionin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve dhe Kthim, ku unë jam nënkyetare e parë, në kuadër të përgjegjësive që kanë dalë nga Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës, është formuar një nënkomision, që objektiv të punës ka t'i vizitojë institucionet publike dhe kompanitë publike për të konstatuar sa po zbatohen ligjet që garantojnë të drejtat e komuniteteve dhe sa janë të integruara komunitetet në institucionet qendrore dhe lokale.

Zoti Kryetar, në këtë drejtim kemi konstatuar se ka progres, por edhe ka institucione që edhe më tej duhet të punojnë me seriozitet për integrimin e komuniteteve. Me këtë rast, shpreh shqetësimin tim se edhe përkundër përkushtimit të madh të institucioneve të Kosovës që komunitetet të janë të lira dhe të trajtohen si qytetarë të barabartë, me kërkësen e Kuvendit të Kosovës, me kërkësen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, me datën 14 korrik, do të thotë, ditën e mërkurë, është proceduar Ligji për shitjen e banesave që të miratohet dhe që të bëhen vlerësimet e amendamenteve të komisionit funksional se a shkelin amendamentet të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Me këtë rast, shpreh shqetësimin tim se ekziston një opinion në kuadër të anëtarëve të këtij komisioni, të cilët me mos praninë e tyre më lënë përshtypjen që qëllimi nuk kanë qenë të pranishëm në komision vetëm e vetëm që ky projektligj të mos procedohet ...

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYETARI:** Faleminderit! Po vazhdojmë. Nait Hasani, le të përgatitet deputetja Muzejene Selmani. Rrumbullakojeni në 5 minuta!

**NAIT HASANI:** Ju faleminderit, Kryetar!

Mirë se erdhe, zëvendëskryeministër!

Unë, meqë jemi në raportin e progresit, çështja e liberalizimit të vizave është bërë si çështje shumë e ndjeshme dhe mund të them se po flitet shumë, edhe organizatat joqeveritare dhe shtypi ka folur për këtë dhe mendoj se nuk është çështja vetëm që Kosova nuk i ka plotësuar disa standarde apo disa politika, po është çështje politike e Bashkësisë Evropiane ndaj Kosovës dhe ndaj Ballkanit. Kur e them këtë, kam parasysh që pikërisht në Bruksel janë trajtuar këto çështje dhe çështja e Kosovës është lënë mbrapa pikërisht për shkak se një politikë e tillë është ndjekur në raport me Serbinë. Brukseli nuk e ka pasur një qasje të drejtë ndaj nesh, po mendoj që Serbia nuk është që i ka plotësuar standardet për liberalizim të vizave, po ka qenë më shumë politike dhe mendoj që është një çështje që mund të them se tashmë 100 vjet në Ballkan përcillet në mes besimeve dhe mes besimit mysliman dhe besimit të krishterë. Shtetet e krishtera vazhdimisht kanë kërkuar dhe kanë pasur mbështetjen nga Bashkësia Evropiane, ndërsa shtetet edhe më herët edhe pengesat që i kemi pasur, them edhe më 1912, pavarësia e Shqipërisë atëherë ka qenë si pengesë për shkak të besimit mysliman, edhe tan...

(Reagim)

Të lutem! Unë po e flas atë që i kemi mësuar prej historisë vazhdimisht, ju mund ta kundërshton si secili, i keni mendimet, gjykimet, secili mund të flas dhe të veprojë vetë, po unë them që pikërisht shtetet të cilat janë Bosnja, Kosova dhe Shqipëria janë me shumicë myslimanë dhe pikërisht Bashkimi Evropian ka bërë këtë veprim politik ose i ka vënë në geto këto tri shtete që mos të liberalizohen për viza, ndërsa vizat ia kanë dhënë Serbisë që ka bërë gjenocid, ua ka dhënë shteteve tjera, ia kanë dhënë edhe Maqedonisë, e tjera.

KRYETARI: Nait, të lutem, Raporti i Komisionit është dhe mendoj se nuk ka nevojë tash këtu të mbajmë orë historie. Me gjithë respektin, por jemi në rend dite.

NAIT HASANI: Faleminderit! Dhe, mendoj që këtu është çështja që politika jonë ka bërë përpjekje sa ka mund, por nuk ka mund ta thyej këtë politikën e Bashkësisë Evropiane. Mendoj që Ministria e Jashtme është dashur të jetë më aktive dhe Kuvendi dhe Qeveria duhet ta hartojnë mundësinë që ta trajtojnë dhe ta krijojnë edhe Ministrinë për Integrimë Evropiane, e cila do të jetë ndihmesë shumë e fuqishme edhe për Raportin e progresit, por edhe për të tjerat. Ministria e Drejtësisë te ne është ndoshta edhe pengesa kryesore, unë mendoj që në Raportin e progresit ka për t'u trajtuar dhe do të trajtohet, pikërisht sepse kemi shumë neglizhenca dhe shumë lëndë të pazgjidhura, shumë të paarsyeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Ju kisha lutur, deputetë të nderuar, e kemi Raportin e Komisionit dhe të përqendrohemë në këtë. Unë, përsëri po e them që as Kuvendit, as askujt në Kosovë nuk i konvenon të hyjë tash të shpalos se cilat janë qëllimet. Ne nuk i dimë qëllimet, ne duhet t'i përbushim kriteret dhe standardet njëherë për veti, pastaj edhe për të tjerët. Mendoj se kjo duhet të jetë një çështje që ne duhet ta ndiejmë, një përgjegjësi që duhet ta dimë.

Tani kemi edhe 6 deputetë të paraqitur për diskutim, nëse doni e marrim një pauzë deri në ora 14:30 dhe pastaj vazhdojmë. A jeni dakord për pauzë? Atëherë, pauzë deri në 14:30.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën, por para se të fillojmë me diskutimet e deputetëve, ju kisha njoftuar që, së pari, kemi shumë pika të rendit të ditës dhe, së dyti, duhet t'i shkurtojmë pak diskutimet, sepse mendoj që kjo temë është diskutuar mjaft nga grupet parlamentare. Dhe, çështja e tretë është, nëse nuk e kryejmë sot seancën, duhet ta vazhdojmë nesër.

Pra, nëse nuk doni ta vazhdoni nesër për pikat e rendit të ditës, grupet parlamentare le të përgatiten se kush duhet të flasë në Kuvend, sepse nëse vazhdojmë kështu, ne do të vazhdojmë deri vonë edhe nesër. Do të thotë, nëse çdo deputet do ta përsërisë tjetrin, ne duhet të vazhdojmë seancën edhe sot deri në 10 edhe nesër para dite, përndryshe s'mund ta përfundojmë. Pra, seancat duhet të vazhdohen, edhe të dielën, deputetët paguhen për atë.

Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar, do të thotë, me rend është, Muzejene Selmani, le të përgatitet Safete Hadërgjonaj ose Sala Berisha-Shala, me kartelën e Safetes.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin që është prezent këtu dhe për ministrin e Shëndetësisë,

Përshëndetje për të gjithë deputetët që janë prezent në këtë vazhdim të seancës.

Raporti i progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, pikësëpari duhet të përshëndes Komisionin për Integrime Evropiane, i cili e ka pru këtë plan të punës këtu sot në seancë plenare- këtë raport. Mirëpo, mund të them me një përgjegjësi shumë të madhe se në këtë raport ka mundësi të ketë edhe disa përmirësime duke marrë parasysh se në të gjitha komisionet parlamentare u cek se ndoshta nuk është përpiluar edhe prej komisioneve të tjera, në bashkëveprim me ministritë e linjës, por prapëseraprë raporti si raport mund të them se i plotëson konditat në nivel të përgjithshëm. Unë kisha për t' u ndalur në disa pika të raportit, pasi prezent këtu sot është zotëri zëvendëskryeministër, është çështja e marrëveshjes së lirë të mallrave, rasti i CEFTA-s, duke marrë parasysh se pas gjashtë muajve udhëheqësinë e CEFTA-s, zotëri zëvendëskryeministër e merr dikush tjetër dhe do të kemi shumë probleme. Dhe, ne si Kuvend do të bëjmë presion pak te Qeveria në këtë aspekt që të realizohet zbatueshmëria dhe e gjithë përgjegjësia që del nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Në faqen 11 thuhet se nuk ka progres apo nuk ka ardhur rapporti nga komisionet ekzistuese. Për çështjen e sigurimit të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike, mund t' ju them shumë sinqerisht se ne i kemi pasur të ftuar dy ministrat edhe ministrin e Tregtisë dhe Industrisë dhe ministren e Energjetikës dhe të Minierave, mirëpo në kapitullin IV – tregu i brendshëm, konkurenca, ceket se duhet të jetë edhe Projektligji për ndihmat shtetërore që do të shqyrtohet në Kuvend. Kjo më duket pak e tepërt në këtë kapitull.

Në përgjithësi mund të them se Raporti i progresit apo më mirë të themi rapporti të cilin duhet ta realizojë Kuvendi i Kosovës për sfidat e Komisionit Evropian, pikësëpari duhet të fillojë nga sundimi i ligjit dhe rendit në Kosovë, luftimi i krimtit të organizuar, zhvillimi ekonomik i Kosovës me gjithë këto sfida dhe njëkohësisht zvogëlimi i papunësisë në ato përmasa çfarë mund t'i bëjë Qeveria e Kosovës. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka Sala Berisha- Shala, me kartelën e Safete Hadërgjonajt, le të përgatitet, Gani Buçinca.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër dhe ministër i Shëndetësisë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm,

Pra, jemi duke shqyrtuar Raportin e parë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, andaj më duket se tingëllon joserioze të shfrytëzohet foltorja për të hedhur gurë mbi Qeverinë, sidomos paraqitja e disa deputetëve që vijnë nga pozita, sa për opozitën ata e kanë mision gjithçka të shohin errët. Gati se në secilin diskutim u përmend mospërfshirja e Kosovës në liberalizimin e vizave.

Të nderuar deputetë,

E dimë se me lehtësimin e vizave Bashkimi Evropian u mundëson vendeve të rajonit që për një periudhë tranzitore vizat të merren më lehtë për disa kategori të vizë-kërkuesve, ndërsa liberalizimi nënkupton lëvizje të lirë brenda zonës Shengen, ku bëjnë pjesë 25 shtete të Evropës.

Duke pasur parasysh këtë besoj që do të jetë obligim në vazhdim i BE-së, përkatësisht i 22 shteteve të saj, që për momentin e kanë njojur pavarsinë e Kosovës, që t'u ofrojë qytetarëve të Kosovës respekt dhe të drejtën themelore për liri të lëvizjes. Mos përfshirjen e Kosovës në liberalizimin e vizave disa këtu e quajtën si lajm i keq. Mendoj që nuk duhet ta mohojmë faktin se gjithmonë kur ka qenë e nevojshme, Komisioni Evropian ka

dal me një formulë dhe zgjidhje specifike për Kosovën, andaj edhe kësaj radhe, sigurisht, jam e prirë të mendoj pozitivisht dhe dua të besoj se e ka bërë zgjidhje të duhur, ka zgjedhur formulën e duhur që do ta kuptoja përafërsisht kështu – “bashkë me dreqin, as në xhenet”. Prandaj, do të presim që tok me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor të futemi në Listën e Bardhë të Shengenit.

Duke dëgjuar disa deputetë, sidomos nga pjesa e koalicionit qeverisës, me qasjen e tyre kritike ndaj Qeverisë, e sjell një retrospektivë qëndrimin e tyre nëpër komisione dhe kontributin e tyre të dhënë në komisione sa i përket përbushjes së këtyre sfidave. Të tillët, së pari, dhe të gjithë ne duhet t'i shtrojmë pyetje vetvetes – çka bëra unë në këtë drejtim kudo që më është dhënë mundësia, sa i kemi ndihmuar arritjes së progresit brenda komisioneve parlamentare, askush nuk e ngriti këtë pyetje? Mendoj që duhet të jemi së pari vetëkritikë, ngase këtu po flitet për punën e Kuvendit, jo të Qeverisë. Do të ishte shumë mirë ta shohim secili atë që kemi bërë dhe çka kemi mund ta bëjmë më mirë? A është rritje e progresit, bie fjalë një vit që të mund ta monitorojmë një ligj, siç është rasti te Komisioni, ku jam pjesë e atij Komisioni për Ekonomi e Tregti që shtyrja e atij monitorimi ka zgjatur thjesht për çështje dhe për shtyrje bërrylash edhe personale? Cili ishte pozicioni i secilit deputet në zvarritjen e këtij procesi? Mos të harrojmë se më 7 maj 2009, Qeveria e Kosovës e ka miratuar udhërrëfyesin për implementimin e kritereve për procesin e liberalizimit të vizave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, në të cilin, bartës i këtij procesi është Ministria e Punëve të Brendshme e Qeverisë së Kosovës, ku e njëjtë është e obliguar të hartojë planin e veprimit për implementimin e udhërrëfyesit. Kjo iniciativë e Qeverisë është për t'u çmuar.

Dhe krejt në fund, të nderuar kolegë deputetë, foltorja e Kuvendit nuk është vetëm për kritika ndaj Qeverisë, por do të ishte shumë e shëndetshme edhe ndonjë vetëkritikë nga ana e deputetëve. Ju ftoj që edhe nga foltorja të ndihmojmë në të arriturat e progresit duke i promovuar masat që i ka ndërmarrë dhe është duke i ndërmarrë Kosova për t'i përbushur kriteret e kërkua nga BE-ja dhe Komisioni Evropian. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Gani Buçinca e ka fjalën, le të përgatitet Arsim Rexhepi.

**GANI BUÇINCA:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar qeveritarë dhe ju kolegë deputetë,

Kuvendi i Kosovës është shndërruar tashmë në një arenë ku çdoherë për çdo lloj teme përsëriten të njëjtat akuza ndaj Qeverisë. Për fat të keq, edhe sot temën të cilën po e trajtojmë, tema që e trajtuan shumë deputetë, e shfrytëzuan ekskluzivisht për propagandë politike dhe diskutimet ishin më shumë të motivuara politikisht.

Unë të gjithë kolegëve deputetë, të cilët e linçuan Qeverinë e Kosovës për ngecjen në procesin e integrimeve evropiane, mund t'ju shtroj disa pyetje.

Një, pse iu desh Maqedonisë të presë rreth 20 vjet për t'u fituar, për të hyrë në liberalizimin e vizave?

**KRYETARI:** Gani, ju lutem, tema është- Raporti i Komisionit, andaj mos dil jashtë teme.

**GANI BUÇINCA:** Po dolën jashtë temës edhe të tjerët, i nderuar zoti Kryetar dhe nuk ju ndërhyre, prandaj në atë kontekst unë po vazhdoj.

Pastaj, Kroacisë pse iu deshtë të presë kaq gjatë dhe nga ju erdhi ajo ide se Kosova do të përfitojë nga ky proces kur dihet se në Kosovë kemi një shkallë të madhe të papunësisë. Pra, nuk kemi ligj për sigurime shëndetësore, nuk kemi ligj për sigurimin pensional-

invalidor, kemi kontroll jo të duhur të kufijve të Kosovës. Pra, dihet se kemi gjyqësor jofunksional, që e kanë ndërtuar vetë miqtë tanë, partnerët tanë ndërkombe, jofunksional, kur dihet se në Kosovë kemi çështje të pazgjidhura të pronësisë dhe para se gjithash kur dihet se Kosova ka 1.200.000 euro buxhetin e vet dhe sikur ky buxhet t'i destinohej vetëm një ministrie, nuk do të mjaftonte që ajo ministri në sektorin e vet përkatës t'i zgjidhë hallet dhe problemet e qytetarëve të Kosovës.

Pritjet kanë qenë jo objektive, mirëpo edhe akuzat ishin jo objektive. Në këtë proces nuk është Qeveria partner, jemi edhe ne këtu si deputetë dhe unë padyshim kërkoi që edhe më tutje të na mbështetë Bashkimi Evropian. Vlerësimi i Bashkimit Evropian ka qenë real, se ne nuk i plotësojmë këto kritere dhe unë kërkoi, që sikur se na ka mbështetur deri më tani, të na mbështet edhe në të ardhmen. Ne kemi nevojë si Kuvend për mbështetje teknike dhe profesionale, kemi nevojë për mirëkuptim të institucioneve ndërkombe, se shpesh raporteve të institucioneve evropiane për progresin u kemi kontribuar edhe ne dhe shumë shpesh ato raporte bazohen në disa eksponime të opozitës dhe të Shoqërisë Civile, që e shohin gjendjen në Kosovë vetëm zi.

Qytetarët e Kosovës kanë shumë halle dhe probleme. Një fatkeqësi kolektive nuk do të ishte mirë që ne sot këtu ta përdorim për qëllime dhe përfitime eksklusive, politike, mirëpo, ashtu sikur qysh e kemi pasur fat si kolektivitet- fatkeqësinë, askush të mos mendojë se qytetarët e Kosovës nuk e kanë një të ardhme të ndritur edhe duke i falënderuar mbështetjes së pa rezervë të miqve tanë ndërkombe dhe komunitetit evropian.

Unë pres që në të ardhmen detyrat tona si Kuvend t'i trajtojmë me më shumë përgjegjësi, dhe të jemi të vetëdijshëm sa i kemi kontribuar ne kësaj gjendje. Unë mendoj se ne si Kuvend kemi mjaft nevojë për mbështetje profesionale dhe materiale, në mënyrë që ne të bëhem një partner i Bashkimit Evropian, i Qeverisë dhe institucioneve të tjera demokratike që sa më shpejt t'i arrijmë standartet.

Krejt në fund, kisha lutur shtetet respektive të Bashkimit Evropian, nëse nuk mund juridikisht ta sanksionojnë liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, së paku t'i kenë parasysh vështirësitë e qytetarëve tanë dhe të jenë më duar lirë në dhënien e vizave për qytetarët tanë. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Zef Morina.

**XHEVDET NEZIRAJ:** Faleminderit, i nderuar zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Ne kemi pasur një debat, Komisioni për Komunitete dhe Komisioni për Integrimë Evropiane, në lidhje me të gjitha sfidat për integrime evropiane për çështje të Kosovës dhe unë përkrah disa rekomandime shumë të qëlluara të Komisionit për Integrimë Evropiane, sidomos kur kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve dhe sidomos disa komuniteteve të cilat për një kohë të gjatë janë lënë pas dore dhe rregullisht po shkruhen raporte në disfavor të Kosovës, jo vetëm të Qeverisë, por edhe të gjitha institucioneve të Kosovës, dhe, që nuk është e mirë as për Qeverinë, as për Kuvendin, as për komisionet dhe për asnjë institucion. Arsyja është se ne mund t'i plotësojmë këto kritere dhe mos të shkruhen këto raporte, mirëpo këto raporte që të shkruhen pozitivisht, duhet të veprojmë pozitivisht. Unë veç do t'i marr disa shembuj. Komisioni për Komunitete është duke e monitoruar Ligjin për promovimin e komuniteteve dhe kemi filluar vizitën në ndërmarrjet publike, ku në atë komision janë të pranishëm anëtarët e secilit komunitet. Bile edhe

Sanje Aliaj, si nënkryetare është duke e udhëhequr atë takim dhe në disa ndërmarrje publike kemi hasur në shkelje drastike të drejtave të komuniteteve. Veç dua ta marr një shembull, ku në KEK prej 7.500-600 punëtorëve, punojnë 3 pjesëtarë të komunitetit egjiptian-rom dhe ashkali dhe ata nuk dinë se të cilit komunitet i takojnë, se ashtu i kanë shënimet, ndërsa në PTK as që kanë ofruar që të na presin. Kanë thënë që nuk kemi kohë të merremi me ju si komision se e dinë se nuk kanë plotësuar asnjë kriter, se nuk i plotësojnë këto vende, këto kritere të punës, ndërsa në Doganën e Kosovës, gjithashtu kemi hasur që nga një numër shumë i madh i të punësuarve janë vetëm 3 të punësuar. Dhe, drejtori i Doganës, publikisht ka publikuar që ka pasur shkelje dhe për përmirësim të kësaj ka bërë edhe botimin dhe hapjen e konkursit me qëllim të pranimit të disa pjesëtarëve të komunitetit egjiptas, rom dhe ashkali në Doganën e Kosovës dhe gëzon fakti se në atë konkurs kanë konkurruar mbi 70 persona, të cilët kanë përgatitje superiore dhe të mesme dhe të mund t'i plotësojnë, por ka qenë kërkesë e Komisionit. Unë besoj që komisionet tona duhet t'i kryejnë disa punë, por edhe Qeveria të jetë shumë më aktive në këtë aspekt se shumë institucione janë duke mos respektuar Ligjin për promovimin e komuniteteve. Dhe, ndarja e vendeve të punës, ndarja e të mirave duhet të bahet barabar me të gjitha komunitetet. Nuk bën të jenë 200 pjesëtarë të komunitetit boshnjak ose turk në Doganë të Kosovës dhe të mos jetë asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptas. Nuk bën të jenë 200 ose 300 të punësuar nëpër universitete, nëpër institucione të shtetit të Kosovës, të komunitetit tjeter dhe të shkelen komunitetet që gjithmonë kanë qenë në njëfarë dore të lënë pas dore.

Unë nuk po e akuzoj Qeverinë, as të kaluarën, as të Thaçit për gjendjen e disa komuniteteve që kanë trashëguar si në pikëpamje sociale, si të arsimit një gjendje të rëndë, mirëpo duhet të ekzistojë gatishmëria dhe shtyrja pozitive për këto komunitete me një qëllim të integrimit dhe për këtë ka shumë shembuj pozitiv që mund të bëjë Qeveria, mund të bëjë Kuvendi dhe mund të bëjë institucionet tjera. Ta marrim një shembull, pse Shërbimi Policor i Kosovës duhet të presë pjesëtarë të komunitetit serb me vite të tëra, 300 pjesëtarë kur në Gjakovë ekzistojnë mbi 7.000 pjesëtarë të komunitetit egjiptian dhe nuk është asnjë pjesëtar në atë komunë? Dhe, nëse nuk kemi policë superior ose policë me grada të larta që mund të bëjnë sigurimin e ndërtuesës së sigurisë së lartë, për policë të thjeshtë kemi. Unë jam i sigurt që për policë dhe për njerëz me shkolla të mesme kemi sa të duash, prandaj, duhet të ekzistojë një gatishmëri e të gjitha institucioneve me qëllim të integrimit të komuniteteve dhe të shkruhet ndonjë raport shumë pozitiv dhe raportet pozitive duhet të shkruhen me veprime. Ekziston edhe strategjia e Qeverisë e cila është aprovuar për këto 3 komunitete që personalisht kam qenë kundër, për arsyen se s'jam pyetur dhe nuk është pru edhe në Kuvend të diskutohet, por e ka aprovuar Qeveria strategjinë për komunitetin rom, egjiptian dhe shkali, që e kanë bërë shoqëritë civile, shoqëritë që më vjen keq që nuk janë në gjendje dhe s'kanë ditur se çka kanë vepruar. Dhe, e keqja më e madhe e asaj strategjie është se në atë strategji nuk është ndarë asnjë cent nga buxheti. Dhe, unë dua ta parafrazoj zotin zëvendëskryeministër në një debat kur thotë- strategjitet mund të jenë shumë të mira, por kur s'ka buxhet ato s'kanë për t'u realizuar, për këtë unë po them, ajo strategji është shkruar shumë mirë edhe pse ka gabime....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Zef Morina, le të përgatitet diskutuesi i fundit Driton Tali.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin, ministrin dhe kolegë deputetë,

Mendoj që raporti i Planit të veprimit të Komisionit është vërtet i qëlluar dhe si i tillë mund të konsiderojmë që në përgjithësi institucionet e vendit, duke u nisur në radhë të parë nga Parlamenti, Qeveria dhe të gjitha institucionet tjera, janë duke kryer punën ashtu si duhet, pavarësisht prej vështirësive që mund t'i kenë dhe pavarësisht prej kohës së shkurtër, sepse Kosova ende nuk e ka mbushur një vit e gjysmë që është shtet dhe si i tillë natyrish që mund të ketë edhe pengesa, do të ketë nevojë ende për të arritur ato çfarë nevojitet t'i ketë një shtet për të qenë vërtet pjesë e një Bashkimi Evropian të cilin të gjithë e aderojmë.

Vullneti dhe synimi i popullit të Kosovës është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Për të arritur këtë, ne duhet t'i plotësojmë disa gjëra të cilat vërtet duhet t'i konsiderojmë që janë jo vetëm obligative, por janë të nevojshme për ne nëse dëshirojmë të jemi pjesë e Evropës dhe nëse dëshirojmë që vërtet Kosova të ketë një prosperitet ashtu çfarë e meriton ta ketë. Janë standardet të cilat duhet t'i plotësojmë dhe unë shpresoj që Kosova mund t'i plotësojë në një afat shumë më të shpejtë si i kanë plotësuar shtetet të cilat tani veç aderojnë të jenë pjesë dhe janë bërë pjesë si është Bullgaria dhe disa shtete tjera.

Ajo që më shtyri më tepër të flas është çështja e liberalizimit të vizave, që disa po e fajesojnë Qeverinë ose po i fajesojnë institucionet, gjë që nuk është e drejtë, sepse liberalizimi i vizave nuk mund të bëhet pse ne kemi dëshirë, por janë disa faktorë ose disa kriterë të cilat ne duhet t'i plotësojmë si vend. Ne, në një kohë jo shumë të largët kemi qenë veç të liruar nga vizat, ju e dini, në ish-Jugosllavinë e asaj kohe, tani mendoj që liberalizimi i vizave nuk është dashur t'i bëhej Serbisë, por meqë i është bërë Serbisë, boll mirë është bërë që s'i është bërë Kosovës, sepse i është dhënë për të kuptuar se Kosova është shtet i pavarur dhe si i tillë mund t'i plotësojë kriteret vetë dhe kur t'i plotësojë do të fitojë të drejtën, edhe pse populli ka shumë nevojë, vërtet, të lëvizë i lirë.

Ajo që më shtyri të flas është kolegu Hasani, i cili e përmendi çështjen pse Kosova nuk është futur në sistemin e liberalizimit të vizave? Mendoj që nuk qëndron ajo, sepse, vërtet, ne si popull, si Kosovë, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë këtu, jemi miq më të mëdhenj të Evropës dhe të shteteve të Perëndimit dhe për këtë arsy nuk kemi të drejtë në njëfarë mënyre t'i akuzojmë ose të themi që për këtë arsy nuk na është mundësuar, sepse po të ishte ashtu atëherë ne kurrë nuk do të marrim liberalizim të vizave, sepse s'e kemi ndërmend ta ndërrojmë atë çfarë jemi, a kuptoni. E njëjtë gjë vlen edhe për integrim në BE, por shpresoj që angazhimi i gjithë neve do të jetë i atillë që me hapa shumë më të shpejtë që kanë hyrë shtetet, të cilat i kemi përreth, do të hyjmë edhe ne dhe do të bëhem pjesë e Evropës, gjë që qytetarët, vërtet, duhet ta kuptojnë mirë angazhimin e institacioneve se ne po punojmë dhe do të punojmë që Kosova sa më shpejt të fitojë të drejtën e të jenë shtetas të lirë, të lëvizin lirshëm dhe të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Mos u merrni me diskutime që s'shkruhen kurrkund! Diskutuesi i fundit Driton Tali.

**DRITON TALI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

E kam parasysh që shumë gjëra u thanë në këtë pikë dhe pa dashur që ta zgjas më shumë për shkak të agjendës që e kemi të ngjeshur, por megjithatë do të ndalem te faqja 7, po them gjithmonë duke pasur parasysh natyrën e këtij rapporti. Dhe këtu, te pika 4, mendoj se, domethënë, këtu flitet për të arriturat, pra, në pikën 4 është miratimi i kornizës

afatmesme, mendoj se nuk është dashur të futet aty për shkak se nuk ka qenë KASH-i në standardevropiane. Nuk i përbush kriteret, jo vetëm të shteteve të Unionit Evropian, por edhe atyre që aspirojnë, flas të botës së dytë dhe të tretë. Unë shpresoj se dikush nga Unioni Evropian nuk do ta lexojë atë punim për shkak të shijes së keqe që do t'ia japë lexuesit, sidomos flas për njohësit e materies.

Ndërsa sa i përket sfidave këtu mendoj se janë prekur pikat e rëndësishme, siç është korruzioni, që është pika 4, dhe liria e mediave, pika 6, apo ndikimi i politikës, siç është shkruar këtu – ndaj mediave dhe institucioneve të pavarura, sepse qysh e dimë, fjala e lirë është e shenjtë në Unionin Evropian, sidomos mediat e lira dhe çdo prekje apo çdo përbuzje e kësaj çështjeje, siç është rasti me heqjen e TV Rrokum nga rrathi kabllovik, vetëm se aty u fol lirshëm, apo imponimet financiare në formë të reklamave, domethënë, marketingut të mediave, është pengesë në integrimet e Unionit Evropian. Andaj, unë pajtohem me të gjithë ata që i prekën këto gjëra dhe nuk do ta zgjatja në këtë pikë, por në këtë raport mungon edhe një pikë shumë e rëndësishme për integrimet evropiane, ajo është ruajtja e ambientit, sepse ambienti është kardinal, është primare për integrimet evropiane dhe kjo pikë është një sfidë shumë e madhe për Kosovën, bile tashmë kjo sfidë do të jetë e pakapërcyeshme për integrimet e Kosovës në Unionin Evropian. E them këtë duke pasur parasysh këtë vendimin e fundit që e mori Qeveria për ndërtimin e termocentralit “Kosova C”, apo “Kosova e Re”. Të nderuar kolegë, them sfidë e pakalueshme, sepse edhe pa miratimin e projektit “Kosova C” apo “Kosova e Re”, ishte Kosova apo edhe është më tutje vendi më i ndotur në Evropë, gjersa me ndërtimin edhe të këtij ndotësi me kapacitet prej 2000 megavatesh, vetëm një 2 kilometra larg kryeqytetit ku jetojnë 700.000 banorë, është drejtpërdrejt në kundërshtim me standarde strikte të Unionit Evropian në këtë drejtim, sepse ky vendim do ta përkeqësojë edhe më shumë ambientin, nivelin i cili do t'i kalojë shumëfish normat e përcaktuara për koncentrimet maksimale të lejuara për emisione dhe imisione.

Të nderuar kolegë,

Parimi i Unionit Evropian për prodhimin e energjisë është e famshmja 20-20-20, ky parim do të futet në vitin 2020 tamam kur “Kosova e Re” do të ndërtohet, sepse sipas planit 1.000 megavatët e parë do të ndërtohen në vitin 2015, gjersa 1.000 megavatet tjere do të përfundojnë në vitin 2020, tamam kur strategjia e Unionit Evropian do të jetësohet dhe ajo strategji thotë, nën a) që shteti ta zvogëlojë prodhimtarinë e tyre të energjisë të bazuar në djegien e qymyrit apo të naftës deri në 20% krahasuar me prodhimin e energjisë së tyre në vitin 1995. Nën b) thotë: ta zvogëlojmë emisionin e dioksidit të karbonit për 20%, gjithmonë krahasuar me misionin që kishim në vitin 1995 dhe, nën c) ta prodrojmë të paktën 20% të energjisë së tyre nga burimet alternative, pra nga uji, era e tjera. Pra, me këtë projekt asnjëherë në këto kushte të domosdoshme, të obligueshme për integrimet evropiane nuk respektohen, sepse, jo që nuk ulet përqindja e prodhimit të energjisë nga qymyri për 20%, por ajo katërfishohet. E dyta, sasia e dioksid-karbonit do të pesëfishohet krahasuar me vitin 1995, por ajo që nuk ulet ashtu siç kërkon Unioni Evropian për 20%, por ajo irritet për 500%. Siç dihet, në vitin 1995 Kosova prodhonte 6 milionë ton, kurse me 2.000 megavat do të prodhohen afér 20 milionë më shumë. Po ashtu, nuk do të përbushet as kushti i tretë, sepse prodhimi i energjisë nuk do të zvogëlohet për 700 megavat për 20% ashtu siç parashihet, por do të trefishohet, andaj unë do të kërkoja nga Komisioni për Integrime Evropiane që këtë raport ta rishikojë dhe ta marrin parasysh ambientin sepse, po e përsëris veten edhe një herë, ajo për kah korrupsioni, pra transparencës që në këtë projekt nuk është respektuar dhe demokracisë që po ashtu nuk është respektuar dhe shprehjes së lirshme të mendimit ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Hajt, edhe një minutë Dritonit, pasi e kemi të hasretit.

DRITON TALI: Veç desha ta përfundoj, zoti Kryetar, se disa injorantë atje po qeshin, por kjo është parakusht për t'u integruar në Evropë, domethënë pa këtë ne veç kallëzojmë pallavra e tjera, a dini? Veç këtë desha t'ua rikujtoj do injorantëve atje që po bisedojnë.

KRYETARI: Deputet Tali! Vërtet, realisht është mirë të kërkosh falje për fjalët që po i thua, sepse është një kulturë në komunikim. Kolegë i ke këta deputetë, nuk janë injorantë, nëse janë injorantë edhe ti s'mund të jesh më pak se këta.

(Reagim i Driton Talit – nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Ajo, s'ka lidhje, ti s'ke nevojë ta fyesh askënd.

(Reagim i deputetit Driton Tali)

KRYETARI: E kreve fjalën, tash u bë. E lëmë këtë. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit të parë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Në sallë kemi 77 deputetë.

Atëherë, me 67 vota “për”, 2 vota “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin e parë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Ju faleminderit!

Vazhdojmë:

- **Shqyrtimi i Raportit të audituar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008**

Në pajtim me nenin 6.3 të Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, Bordi i Trustit Pensional të Kosovës Kuvendit i ka paraqitur Raportin e audituar të Trustit.

Komisioni për Buxhet, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe pasqyrat financiare për vitin 2008 dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit reportues për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOçi: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, mirë se erdhe, Kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Ne sot kemi kërkuar që të shqyrtohet Raporti i audituar i Trustit Pensional të Kosovës dhe nga kërkeshat e deputetëve të herëve tjera, në këtë rast, këtu kemi edhe përfaqësuesin ose kryetarin e Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, që është i thirrur që para Kuvendit të paraqesë raportin. Dhe, është mirë që ne këtu në Kuvend, herëve tjera, kemi diskutuar

për Trustin, por kurrë nuk kemi pasur një përfundim të caktuar, gjithmonë me arsyetimin se nuk e kemi pasur të kompletuar Bordin e Trustit.

Komisioni për Buxhet e Financa, në bazë të nenit 20 të Ligjit të Trustit Pensional ose Fondit Pensional të Kosovës, në bazë të nenit 6 të këtij ligji, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin e audituar në mbledhjen e vet të mbajtur më 22.6.2009 dhe i ka rekomanduar Kuvendit këto çështje, ose këto pika.

Raporti i audituar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008 i plotëson kushtet dhe standarde ligjore të kontabilitetit për raportim dhe është i mbështetur edhe në Ligjin e menaxhimit të financave publike për sa i përket formës së raportimeve financiare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancë plenare, që sot jemi këtu, ta miratojë këtë raport të pasqyrave financiare për vitin 2008.

Gjithashtu, Komisioni i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që në seancë plenare me rastin e shqyrtimit të Raportit të audituar të Trustit të Kursimeve dhe pasqyrave financiare për vitin 2008, të ftohet edhe kryesuesi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, që të raportojë në këtë Kuvend dhe më duket kryesuesin e kemi këtu.

Një rekomandim i katërt që për komisionin ka qenë shumë i rëndësishëm dhe besoj që edhe për Kuvendin do të duhej të ishte i rëndësishëm, duke pasur parasysh rrjetëshëm e gjithë veprimtarisë së Trustit Pensional dhe kursimeve në këtë Trust dhe shpesh edhe debatet që janë zhvilluar rrëth këtyre kursimeve në këtë Kuvend, Komisioni, me qëllim të krijimit të mirë të një baze ligjore për shfrytëzimin, investimin dhe menaxhimin e mjeteve të Trustit Pensional të Kosovës, i rekomandon Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria, gjithnjë mbi bazë të Ligjit dhe kompetencave që ka për formimin e një grupei të punës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të kursimeve pensionale në Kosovë. Në Komision është biseduar detajisht rrëth këtij raportimi dhe vërejtjet e shumta kanë qenë sidomos në pjesën që quhet pjesa menaxhuese ose mjetet në pjesën menaxhuese të Fondit, që ka të bëjë me atë tarifën menaxhuese që ne si Kuvend këtu nuk e kemi miratuar mbi bazë të kërkuesës që ka bërë Trusti. Do të thotë, ka qenë kërkesa që të zbritet për shkak të rritjes së numrit të kontributdhënësve në këtë institucion financiar pensional, kanë kërkuar që të zgjedhesh tarifa dhe ajo nuk është zgjedhur dhe ka mbetur në shkallën që ka qenë edhe më herët, prandaj duke pasur parasysh edhe nevojat për menaxhimin e vet këtij fondi nga ajo tarifë janë grumbulluar mjete ndoshta më shumë se sa kanë pasur nevojë dhe në këtë drejtim Kuvendi do të duhej që në afat sa më të shkurtër mbi bazë të propozimit të Trustit Pensional që të ulë tarifën menaxhuese të Trustit dhe njëkohësisht në pasqyrat financiare të jenë më të detajizuara dhe t'i përshtaten formatit të raportimeve që jemi mësuar ne tashmë me raportet e tillë financiare që përcaktohen edhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

**KRYETARI:** Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, Kryeministër!

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Për shkak të përzierjes së agjendës, mund të them, apo të rendit të ditës dhe diskutimeve në një pikë të rendit të ditës të çështjeve të ndryshme, nuk kisha paraparë që të jem në seancë për shkak të agjendës që kisha, por duke parë edhe opinionet dhe diskutimet të cilat u dëgjuan këtu – mazhoranca përcakton agjendat, duke parë diskutimet rrëth çështjeve të caktuara që u ngritën këtu, në veçanti për termocentralin “Kosova e Re”...

(Ndërhyrje)

...dëshiroj që t'u jap sqarimet e nevojshme edhe profesionale, por edhe në të njëjtën kohë mund, nëse dëshironi, por edhe do të kërkoja, nëse nuk jeni të gatshëm t'i dëgjoni tanë këto sqarime profesionale në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës...

(Ndërhyrje nga deputetët)

...unë e kam obligim t'i sqaroj qytetarët e Kosovës në raport me dezinformatat të cilat i ...

KRYETARI: Dhe, ju po dilni prej rendit të ditës, do të thotë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ... dhe kam të drejtë edhe të ushtroj autoritetin tim kushtetues për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për debat për një çështje të caktuar, kësaj radhe për "Kosovën e Re", prandaj dezinformatave tuaja dhe opinionit që dhjetë vjet që e ka mbajtur Kosovën në terr, do t'i përgjigjem sot, këtu përsëri.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka lëvizur përpara me projektin për termocentralin "Kosova e Re", pas një serie të mbledhjeve të Komitetit drejtues të projektit në dy javët e kaluara. Tash veç, nëse ka mirëkuptim për t' u përballur me faktet.

Këto veprime janë pjesë e një strategjie shumë më të gjerë për sektorin e energjisë dhe kanë për qëllim furnizimin e qëndrueshëm dhe kualitativ me energji në Republikën e Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Reformimi i Sektorit të energjisë do të promovojë rritjen e shpejtë ekonomike dhe do ta pëershpejtojë anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Plani i Republikës së Kosovës për energjinë kërkon pjesëmarrje të gjerë. Duhet të sigurojmë pagesën e faturave tona dhe zvogëlimin e energjisë së humbur, duhet të sigurojmë investimet financiare në hapjen e miqjeve të reja, ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rehabilitimin e njësive ekzistuese, gjeneruese dhe zgjerimin e rrjeteve tona të transmisionit dhe shpërndarjes.

Ju e dini se mbi zhurmën tuaj shurdhuese qëndrojnë faktet, prandaj dëgjoni. Qeveria e Kosovës bashkë me Komisionin Evropian, USAID-in, Bankën Botërore, do të organizojnë një takim të partnerëve për energji gjatë këtij viti për t'i harmonizuar modalitetet dhe gjetur rrugën më të mirë për t'i tërhequr investimet private në sektorin e energjisë. Këto veprime janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe kanë përkrahjen e fuqishme të partnerëve ndërkombëtarë. Ne u jemi mirënjohës: Komisionit Evropian, Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID-it dhe Bankës Botërore, të cilët na kanë ndihmuar në modernizimin e sektorit energetik në Kosovë. Duke u bazuar në këtë bashkëpunim, ne bashkërisht kemi formuluar një strategji të bazuar në 5 pika veprimi, ku secila fazë do të shkojë paralelisht me tjetrën për ta zgjidhur problemin, tanimë kronik të energjisë në Kosovë. Faza e parë është termocentrali "Kosova e Re". Termocentrali "Kosova e Re" dhe hapja e miqjes në Sibovc, do të shkojnë përpara, me ndihmën e vazhdueshme të Bankës Botërore. Termocentrali do të sigurojë energji të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për konsumin vendor dhe për eksportin ndërkombëtar. "Kosova e Re" do të zhvillohet me teknologjinë më të re të termocentraleve super-kritike dhe me mundësitë për të pajisur me kapjen dhe ruajtjen e karbonit. Ajo do t'i përmblushë standarde evropiane të ambientit dhe ato sociale, si dhe do të vendosë një standard të ri teknologjik në rajonin tonë.

Ne jemi përcaktuar që madhësia e përgjithshme të jetë 2.000 megavat e ndërtuar në dy faza, faza e parë prej 1.000 megavatesh, që do të fillojë së ndërtuar menjëherë. Lokacioni pranë termocentralit “Kosova B” do t’i afrohet investitorit të ardhshëm për të ndërtuar termocentralin “Kosova e Re”. Depozitat e linjtit të miqjeve të tashme të Bardhit dhe Mirashit, miqja e re e Sibovcit, do t’i ofrohet investitorit të ardhshëm për zhvillim në baza koncesioni. Kosova do të ketë përfitime të konsiderueshme ekonomike nga ky projekt përmjet mekanizmave të ndryshëm të tërheqjes së të ardhurave, për shembull, nëpërmjet taksave, tantiemave, aksioneve e tjera, që do të përfshihen në marrëveshje me investitorin e ardhshëm.

Termocentrali “Kosova B” paraqet pjesën më të rëndësishme të gjenerimit të tashëm vendor të energjisë dhe është një prej shtyllave të sektorit të energjisë në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe partnerët tanë parashohin një partneritet publik-privat për “Kosovën B”, që do të tërheq kapitalin e nevojshëm privat për rehabilitimin dhe privatizimin e saj.

3. Termocentrali “Kosova A”- me përkrahjen e Komisionit Evropian, Qeveria e Kosovës përkushtohet për mbylljen dhe dekompensionimin e “Kosovës A” sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që t’i adresojë brengat serioze për ambientin dhe shëndetin, të lidhura me këtë termocentral.

Ne po synojmë që kjo çështje të kompletohet gjatë periudhës së vitit 2014-2015. Ky pozicion është në pajtim me obligimet që dalin nga Marrëveshja për Komunitetin Energetik që flet për mbylljen e këtij termocentrali më së largu deri në fund të vitit 2017. Zbatimi me kohë i projektit “Kosova e Re” do të kompensonte prodhimin e zvogëluar të energjisë nga “Kosova A”.

Distribuimi i KEK-ut. Në fund të vitit 2008 Qeveria ka marrë vendim për të privatizuar funksionin e distribuimit të KEK-ut. Modalitetet e privatizimit do të shqyrtohen në javët që vijnë, me ndihmën e një këshilltari për transaksion, që do të emërohet së shpejti. Qeveria është e bindur se privatizimi i distribuimit të KEK-ut do të mundësojë investimet e nevojshme për ngritjen e rrjetit të distribucionit dhe uljen e humbjeve teknike. Kjo do të përmirësojë tutje performancën financiare të kompanisë për distribuim, e cila do të shërbente si një partner i besueshëm për investitorët e “Kosovës B” dhe “Kosovës së Re”.

Faza e pestë, Energjia alternative. Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zhvillimin e hidropotencialit të ripërsëritshëm kosovar për gjenerimin e energjisë dhe për hulumtim për energji solare dhe energji të bazuar në erë. Për këtë qëllim, së bashku me Bankën Botërore e kemi përfunduar studimin e fizibilitetit për Hidrocentralin e Zhurit, kapacitet ky rrëth 300 megavat, me një investim që pritet të ndodhë mbi 300 milionë euro.

Në fund, për zbatimin e të gjitha këtyre masave, Qeveria e Republikës së Kosovës do ta ketë partneritetin e vazdueshëm dhe përkrahjen nga Banka Botërore, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komisioni Evropian. Transparenca ka qenë, është dhe do të mbetet element kyç që do ta përcjellë çdo fazë në zbatimin e këtyre projekteve.

Zbatimi i kësaj strategjie do të kërkojë jo vetëm ekspertizën teknike, por edhe mbështetjen e konsiderueshme dhe kontributin e konsiderueshëm financiar, si dhe garancione nga donatorët dhe investitorët privatë. Unë jam plotësisht i bindur se bashkërisht Qeveria e Republikës së Kosovës, partnerët tanë do ta zgjidhin krizën energjetike në Kosovë.

Dhe, të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Kosovës,  
Tanimë në këto nëntë vjet kemi shpenzuar rreth 1.000.000.000 euro në renovimet e termocentraleve të vjetra të kohës së vjetër, të një kohe pak më të vjetër dhe të një mentaliteti pak më të vjetër. Por, me këtë projekt, buxheti i konsoliduar i Kosovës bëhet nga shpenzimet dhe këto mjete që deri më tanë janë dhënë për import apo renovime, do të shkojnë në projekte të tjera, qoftë në arsim, qoftë në shëndetësi, qoftë në fillimin e ndërtimit të autostradës. Prandaj, i nderuari Kryetar, faleminderit për mundësinë. E dyta, i ftoj të gjithë nëse dëshironi të hapni debat, edhe njerëzit e mentalitetit të territ që u larguan nga rreshti i fundit, nga salla, dua të theksoj se termocentrali “Kosova e Re” dhe strategjia energetike e re në Republikën e Kosovës nuk mund të ecë përpara me mentalitetin e vitit 1974 edhe se mund të flasin në ndonjë vend me numër 2015. Koha e autonomisë së Kosovës ka ikur, Kosova është shtet. Jam i gatshëm për debat apo seancë të jashtëzakonshme, siç e dëshironi, edhe për termocentralin “Kosova e Re”, sepse është projekti i drithës, përballë mentalitetit të territ, edhe për autostradën Vërmicë – Prizren – Mendare, gjithçka ka transparencë, urdhëroni, flasim aq sa ju të doni. Jam në dispozicion.

**KRYETARI:** Sabri Hamiti, e ka kërkuar fjalën.

**SABRI HAMITI:** Zoti Kryetar i Kuvendit,  
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra, kolegë,

Një problem që në një formë ose në formë tjetër është diskutuar gjatë pikës pararendëse të rendit të ditës, u rishfaq me intervenimin e Kryeministrat, zotit Hashim Thaçi. Unë edhe para dite, edhe tash po shoh që ekziston një interesim i jashtëzakonshëm që të bisedohet për këtë projekt. Mendoj që është arsyeshme që sot të mos vazhdojmë në këtë pikë të rendit të ditës, por me kërkesë të Kryeministrat, nëse doni, ja edhe me kërkesë të cilitdo grup, unë po e ofroj kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që të bisedojmë për këtë problem në një ditë që e caktoni ju..., kjo është mënyra më e mirë e të biseduarit. Besoj që nuk ka, nuk është mirë ad-hoc të hyjmë dhe të dalim nga bisedat. Ne dëgjuam një informatë, unë do ta quaja inicuese, ne dëgjuam se Kryeministri ka vullnetin që në Kuvend të bisedohet për këtë temë, mendoj që kjo është forma më e mirë që ta përkrahim dhe ta marrim e të vazhdojmë në temën në të cilën jemi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka Kryeministri!

**KRYEMINISTRI HASHIM THACI:** Po! Ju, nëse pajtoheni, unë do të thërras disa seanca të jashtëzakonshme, jo vetëm një. E tash, a i përgjigjeni ju apo jo... Ju, në njëren anë, disa prej juve dëshironi të dezinformoni, ndërsa në anën tjetër nuk dëshironi t'i dëgjoni faktet dhe opinionet e Qeverisë.

Prandaj, nëse pajtoheni, unë, të nderuar deputetë, të respektuar kolegë të mi, që është me interes të transparencës dhe të debatit me opinionin publik dhe në të mirën e institucioneve tona, kur të dëshironi unë e deponoj kërkesën në emër të Qeverisë për... po, po me shkrim.

1. Seancë e jashtëzakonshme për sektorin energetik – “Kosovën e Re”.

2. Mitrovicën, seancë e jashtëzakonshme.

3. Rendi dhe ligji. Ngadalë, ngadalë. E di që s'keni qejf për të biseduar për rend dhe ligj, por duhet biseduar.
4. Lufta kundër korruptionit dhe krimit të organizuar, mos reagoni, edhe këtu keni për t' u ballafaquar.
5. Gjendja në arsim.
6. Perspektiva evropiane e Kosovës, po, po, se ju diskutonit diçka tjetër, ndërsa flisnit për liberalizimin e vizave. Edhe për këtë çështje bisedojmë.
7. Zhvillimin ekonomik.
8. Infrastrukturën rrugore.

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYETARI:** Faleminderit! Me kërkesën e Kryeministrit, me shkrim, ne të martën e radhisim një seancë për çështjen që e kërkoi Kryeministri. Vazhdojmë. Ju lutem, ju lutem, bëni me shkrim ne i përgjigjemi kërkesës. Vazhdojmë seancën. Fjalën e ka kryesuesi i Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, zoti Besim Beqaj. Lexoni Rregullën 28, e ka shfrytëzuar Kryeministri Rregullën 28 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Pra, lexojeni Rregullën 28. Unë po them, lexojeni ju dhe shikojeni!

**BESIM BEQAJ:** I ndeuari Kryetar i Kuvendit,  
I ndeuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,  
Të ndeuar deputetë,  
Më lejoni që në cilësinë e kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pikë të shkurtra, të paraqes Raportin për pasqyrat financiare dhe auditimin për vitin 2008.

Që në fillim dua të theksoj se ky raport reflekton gjetje të cilat kanë qenë në vitin 2008 dhe që bordi aktual nuk është drejtë drejt përgjegjës për këtë auditim.

Si institucion finanziar, Trusti mbikëqyret nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe kjo bankë mbikëqyr të gjitha transanskionet e Trustit si dhe funksionimin e ligjshëm të Trustit në aspektin e investimeve dhe atë operativ.

Me ligj nga Trusti kërkohet që të informojë Kuvendin dhe Bankën Qendrore të Kosovës për çështjet të cilat do t'i specifikojë. Raportet e kontrolluara të llogarive vjetore të aktivit dhe pasivit, të ardhurat dhe shpenzimet e kontrolluara dhe të nënshkruara nga auditori i certifikuar në përputhje me standardet e kontabilitetit ndërkombëtar apo me standarde të tjera, të cilat janë të miratuara nga Banka Qendrore dhe në pajtim me ligjet në fuqi.

Raportet tremujore, duke përfshirë hollësitë për shitjen dhe fitimin e mjeteve pensionale, së bashku me identitetin e mjeteve, datën e transaksionit, çmimin me të cilin është bërë transaksi dhe ndërmjetësi i cili është shfrytëzuar.

Raportet vjetore për vlerën dhe proporcionin e mjeteve pensionale të cilat janë investuar në klasa të veçanta të mjeteve, duke përfshirë hollësitë e dhënësve të letrave të veçanta me vlerë nga data e vlerësimit të fundit, si dhe raportet vjetore për të gjitha pagesat, për shembull pagesat e mbajtjes dhe pagesat e tjera për shërbime dhe transaksione financiare.

Trusti po ashtu raporton tek kontribuesit e vet një herë në vit, duke dërguar te këta pasqyrat e llogarive të tyre individuale.

Trusti auditohet 3 herë në vit, nga Banka Qendrore e Kosovës, nga Auditori i pavarur i jashtëm, që siguron saktësinë e pasqyrave financiare të përgatitura nga menaxhmenti dhe të aprovuara nga Bordi udhëheqës, si dhe Auditori i pavarur i brendshëm, i angazhuar nga Bordi udhëheqës për të siguruar mbarëvajtjen e operacioneve në politikat dhe procedurat e brendshme të Trustit. Auditorët aprovoohen dhe marrin pëlqimin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Për gjashtë vjet operimi, auditorët gjithmonë kanë dhënë vlerësimë të pastra.

Për auditim të jashtëm nga bordi paraprak është përzgjedhur kompania Di Loid and Tusch e cila ka audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Trustit të Kursimeve Pensionale që përfshijnë bilancin e gjendjes me datë 31 dhjetor 2008 dhe pasqyrën e operimeve, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e pjesëmarrësve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë që vitin që ka përfunduar dhe përbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimive tjetra shpjeguese.

Përgjegjësia e auditorit është që të shprehë opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e tyre. Ata kanë bërë auditimin në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet të cilat janë aplikuar tek ne. Auditimi përfshinë: kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshire vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontroll të brendshme relevante dhe përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga entiteti në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit. Nga auditori është vënë theksi në nevojën e bashkërendimit të pagesave dhe kontributeve nga Administrata Tatimore e Kosovës në Trustin, ku si rezultat i kësaj mangësie, më 26 mars 2009 Trusti ka pasur 28.800.000 euro të pashpërndara.

Cilat janë asetet e Trustit? Në përgjithësi Trusti ka filluar vitin 2007 me 282.243.979 euro asete dhe ka përfunduar vitin 2008 me 259.753.000 euro. Kjo rënie e vlerës ka të bëjë me ndikimin e krizës globale në investimet e Trustit si shkak i krizës financiare, rënia e vlerës së investimeve të Trustit për vitin 2008, ka qenë rreth 92 milionë euro. Shumica e kësaj rënie ka ndodhur gjatë pjesës së fundit të vitit 2008, gjegjësish gjatë muajve shtator-nëntor, kur edhe kriza globale mori përmasat e saja më të hovshme.

Duke parë se kriza po rritej, Bordi i Trustit, në mbledhjen e fundit të e tij për vitin 2008, gjegjësish në shtator, kur edhe i ka skaduar mandati, vendosi që të gjitha të ardhurat që do të grumbullohen nga ajo datë, të mos investohen për të plasuar në Bankën Qendrore, derisa nuk ka Bord dhe situata në treg mos të qartësohet. Si rezultat i këtij vendimi, në Bankën Qendrore të Kosovës, në fund të vitit 2008, ishin të grumbulluara 34 milionë euro.

Bordi i mëparshëm i Trustit, ka marrë vendime për të investuar mjetet e Trustit në disa aset-menagjerë, ndër ta është: Wangar Globes, Globes Index Fund, ku me datën 31 dhjetor 2008, ishin 203.879.893 euro. Ky fond përqendrohet në rritjen afatgjate të kapitalit, duke përcjellë përfomancën e Morgan Stanley Capital International World Index

Politika e investimeve të këtij foni, është investimet substanciale në aksionet e zakonshme. Investimet e Trustit në këtë fond, janë përshkruar në valutë ekuivalente me vlerë neto të aseteve për aksion në ditën relevante të afarizmit.

Aset-menaxhri i dytë është Schroders International Selection Funds Strategic Bank Euro Heights, i cili me datën 31 dhjetor 2008, ka mbajtur 49.175.175 euro. Ky fond është i përbashkët dhe ka selinë në Luksemburg, i cili operon përmes investimeve në Bona të thesarit dhe letrat tjerë me vlerë, me kthim fiks ose varirues sipas denominimeve në vlera të ndryshme.

Euro Credit Management, deri me datë 31 dhjetor 2008, ka pasur 248.850 njësi, që njësia është marrë me 1 euro vlerë. Ky fond është aktiv dhe kërkon ujdinë më të mirë në tregun e bonave dhe ka një rrezik më të lartë të përcjella me kthime më të larta.

European Credit Management, me datë 31 dhjetor 2008, ka mbajtur 12.308.961 euro dhe investimet kanë qenë kryesisht në tregun e kredive.

Fortress Global Liquidity, deri me 31 dhjetor 2008, në këtë Fond kanë qenë 4.102.697 aksione.

Effects Concept and Auriel, gjithashtu janë dy tregje te letrave me vlerë në fushën e shitblerjes së devizave, të cilat kanë mbajtur diku rrëth 12.000.000 euro nga mjetet e Trustit.

Nga investimet në Kosovë, Trusti në fund të vitit 2008, kishte 15.550.119 euro, nga të cilat 10.353.810 euro janë në Raifaizen Bank, ndërsa 5.156.000 janë në ProCredit.

Bordi i mëparshëm, ka vendosur që të mbajë shumicën e të hollave në Quittete, pasi ky lloj investimi ka treguar se ka kthim më të mirë historikisht që nga themelimi i bursave, kundrejt të gjitha krizave që bota ka kaluar gjatë shekullit të fundit.

Nga ana operative, Trusti deri në fund të vitit 2008, ka pasur 281.120 llogari individuale të kontribuuesve kosovarë. Nga këto llogari, 5.924 kanë qenë të kontribuuesve të pensionuar, ndërsa numri i llogarive ka shënuar në rritje mbi 9% në krahasim me vitin 2007. Sipas ligjeve në fuqi, Trusti duhet të investojë vetëm në pajtim me ligjin dhe vendimmarjet të cilat duhet të merren me qëllim të rritjes së kthimit të investimit për kontributin në Trust, duke u bazuar në disa parime themelore dhe ato janë: sigurimet e investimeve; shumëllojshmërinë e investimeve, fitimin maksimal në përputhje me sigurimin e Fondit Pensional dhe ruajtjen e likuiditetit adekuat. Ekzistojnë disa restrikcione në atë se ku mund të investohen këto mjete të Trustit. Ato mund të investohen në fonde monetare, duke përfshirë edhe depozitat bankare në OECD në Kosovë.

Letra me vlerë të tregtushme që emetojnë shtetet apo qeveritë e shteteve të OECD-së, apo Kosovës, letrat me vlerë të korporatave që janë të regjistruara dhe të tregtueshme në shtetet e OECD-së apo Kosovës dhe fondet e përbashkëta dhe fondet tjera, investimet e tregtueshme varësisht nga miratimi i shtetit apo rregulatorit të shteteve të OECD-së apo Kosovës.

Në mungesë të tregjeve të mirëfillta financiare, pra letra me vlerë të tregtueshme të emituara nga Qeveria apo korporatat apo aksioneve të tregtushme të korporatave të Kosovës, e vetmja mundësi për plasimin e fondit ka qenë dhe mbetet edhe më tutje depozitat bankare. Për më tepër, sipas Ligjit në fuqi, Trusti duhet të investojë vetëm përmes menaxhuesve të mjeteve. Pra, nuk mund të bëjë investime direke...

## Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI SABRI HAMITI: Zotëri, kohën e kalove, edhe sa kohë të duhet? Një gjysmë minute ia jepni!

BESIM BEQAJ:.... këta menaxhues mjetesh duhet të jenë të lehtësuar në shtetet, të cilat kanë lidhje të bëjnë me OECD. Në fillim të vitit 2008, Trusti fillon me investime 5% të mjeteve në tregun e këmbimit të valutave, i cili nuk ka koracion me asnje treg tjetër dhe ofron kthime të mira në investim me dozë të pranueshme rreziku dhe angazhohet Effects Concept and Auriel si menaxhues mjetesh. Po ashtu, viti 2008 sheh për herë të parë plasimin e një pjese të mjeteve në Kosovë përmes të depozitave bankare, të cilat u thanë edhe më herët pra...

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Dëgjuam paraqitjen e kryesuesit të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, zotit Besim Beqaj. I dëgjoja dy fjalë prej atje rrëth referimit, ju lutem shumë, silluni në mënyrë institucionale.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në rekomandimin e vet për këtë raport, në pikën 3 kërkon që në këtë mbledhje të paraqes një raport drejtuesi i Bordit, raport i cili në mënyrë unanime është aprovuar. Fjalën e merr përfaqësuesi i PDK-së, për këtë temë. Kush flet për këtë temë? Deputetja Safete Hadergjonaj!

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari zoti kryeministër,  
Zëvendëskryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Kolegë deputetë,

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, me ndryshimin e Ligjit për Fondin Pensional, në qershori të vitit të kaluar është i obliguar që t'i paraqes raport për punën dhe për mënyrën e menaxhimit të mjeteve të kursimeve Kuvendit të Kosovës.

Trusti ka përbushur obligimin që i është përcaktuar me ligj dhe ne sot kemi në shqyrtim Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe pasqyrat financiare për vitin 2008.

Kuvendi, në vazhdimësi ka kerkuar që të ketë një raport të detajizuar për punën e Trustit, me informata të mjaftueshme si si janë menaxhuar mjetet e kursimeve të qytetarëve dhe si është menaxhuar buxheti që ka pasur në dispozicion Trusti.

Mungesa e Bordit ka vështirësuar komunikimin e Kuvendit me Trustin e Kursimeve, ku ka ardhur në pyetje transparenca brenda këtij institucionit, gjë që ka qenë e natyrshme, ka qenë pothuaj se i natyrshëm reagimi, por edhe shqetësimi se çfarë po ndodh në këtë institucion, çfarë po ndodh me mjetet e kursyera të qytetarëve tanë, sidomos gjatë vitit 2008, ku për shkak të krizës financiare ndërkombëtare pasoi rënia e vlerës së mjeteve të Trustit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport dhe vlerëson pozitivisht fillimin e komunikimit të Kuvendit me Trustin, duke llogaritur se pas formimit të Bordit të ri, raporte të tillë, por edhe raporte të punës të këtij institucionit, do të jenë me kohë në Kuvend.

Nga Raporti vërejmë se totali i aseteve të Trustit është 259.753.000 euro, ku nga këto mjete vetëm 34.434.702 euro janë në të gatshme në Bankën Qendrore të Kosovës, kurse mjetet tjera, siç e tha edhe kryetari i Bordit, janë të investuara jashtë Kosovës.

Kuvendi është në pritje të informatave nga Bordi i ri, se si po i qaset menaxhimit të mjeteve të kontributdhënësve krahasuar me gjendjen e vështirë që e ka gjetur në këtë institucion.

Në faqen 23, vërehet se një nga problemet një nga problemet që e ka përcjellë Trustin, është çështja se disa kontribute janë paguar, por nuk kanë shkuar në llogari të personave, sepse janë pa adresë. Problemet janë shfaqur për shkak të mungesës së të dhënavë nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila i verifikon 4 deri në 6 muaj me vonesë. Si rezultat, në vitin e kaluar, pra si rezultat i kësaj, për shkak të mos dorëzimit të raporteve tremujore, nga disa punëdhënës, si dhe për shkak të mospërputhjes së pagesave të disa punëdhënësve, deri në fund të vitit nuk është alokuar në llogaritë individuale shuma prej 44.500.000 euro, kështu që mbetet në të ardhmen të bëhet më shumë në këtë drejtim, që mjetet me kohë të alokohen në llogaritë individuale të kontributdhënësve.

Shpenzimet e Trustit në vitin 2008, kanë qenë 2.2 milion euro, për dallim nga viti 2007, që kanë qenë 2.1 milionë euro. Të dhënat për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve janë shumë të kufizuara.

Te shpenzimet operative shohim se në pozicionin - taksa e menaxhuesve të mjeteve, nuk ka kurrfarë të dhëna se si është bërë ky shpenzim. Kemi këtu edhe një shpenzim tjetër, kostoja e stafit, një shumë prej 431.661 euro. Ne nuk kemi të dhëna se për çfarë janë shpenzuar këto mjete.

Kuvendi nuk ka kurrfarë shënimesh rreth planifikimit të shpenzimeve të këtij institucioni, atëherë është vështirë të nxjerrësh edhe përfundime për arsyeshmërinë e shpenzimeve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i përkrah rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008. Ju faleminderit përvëmendje!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Lidhjes Demokratike, do të flasë deputeti Fatmir Rexhepi.

**FATMIR REXHEPI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë, në emër të Grupit Parlamentar do t'i nxjerr vlerësimet lidhur me reportin në fjalë, ku Raporti i auditimit për Trustin e Kursimeve Pensionale mundëson pra debatin përfondin, e rikthen edhe një herë në aktualitet këtë temë shumë të rëndësishme dhe vetë historikun e debateve në Parlamentin tonë lidhur me këtë Trust, që ka të bëjë me menaxhimin e këtij fondi, transparencën, por edhe që tregon për autoritetin e Parlamentit, i cili shpeshherë ka nxjerrë rekomandime por, si duket, çështjet e debatuara nuk kanë marrë zgjidhje dhe kanë mbetur pa përgjigje adekuante.

Fillimisht, dua të përshëndes sot po ashtu pjesëmarrjen e drejtorit, zotit Beqaj, nga i cili po ashtu dëgjuam një raport të përbledhur për Fondin, për ecurinë, zhvillimet, për

investimet, por edhe për pasojat dhe politikat, gjegjësisht qëllimet që i ka vu Bordi para veti, të cilat ne i përkrahim në parim, se mendojmë që ecuria e mëtutjeshme nuk do të përsëritet nëse varet nga këto politika që i adresoi drejtori, që unë kam besim të plotë se ai do të menaxhojë mirë me Fondin e Trustit Pensional.

Autoriteti i Auditimit, po ashtu në raport konfirmon brengat dhe shqetësimet e ngritura këtu në Parlament, si dhe lëshimet në punën e menaxhimit me këtë fond, si dhe të investimeve për vitet e kaluara. Kështu, vlerësimet e këtij raporti të auditimit, pra, pasqyrohen më së miri apo tregohen përmes tabelave, përmes figurave lidhur me shpenzimet, tarifat, në mënyrë të veçantë mund të nxirret përfundimi, po ashtu, nëse lexohet mirë, pra faqe 6 e këtij raporti, ku thuhet që për vitin 2008, pra, Fondi i kontribuuesve më 1 janar 2008, ishte 349.490.000 euro, ndërsa fondet e kontribuuesve deri më 31 dhjetor ishin 255.746.000 euro, çka tregon pra atë që e tha edhe drejtori i Bordit, një rënie të vlerës së Trustit mbi 92.000.000 euro. Temë debati kjo ka qenë në Parlament. Prandaj, edhe sot, në emër të Grupit Parlamentar do të kërkoja për sa i takon Parlamentit, të ngritë përgjegjësinë e tij, të mendojë, do të thotë, më drejt e më arsyeshëm për masat e mundshme lidhur me Bordin e kaluar, që të kërkohet pra nga ky Parlament përgjegjësi e plotë, ajo që i takon me ligj, sepse ne jemi ata që e kemi themeluar Bordin, ne duhet të kërkojmë përgjegjësinë, nuk duhet lënë pra anash këto 100 milionë, të cilat janë pra kursimet e 380.000 punonjësve të vendit tonë. Nëse kjo mbetet pa përgjigje dhe pa dhënë llogari dikush, unë kujtoj që bashkë me të edhe Parlamenti do të jetë fajtori një, bartës i kësaj përgjegjësie për mos ta quar edhe deri te Qeveria e vendit.

Në emër të Grupit Parlamentar, ne i pranojmë rekandimet e Komisionit për Buxhet, po ashtu edhe parimisht e përkrahim raportin e drejtorit, orientimet strategjike që i tha këtu për fondin, për masat dhe politikat që duhet të dalin nga kjo situatë, sidomos lidhur me dy çështje, lidhur me pasimin e këtyre mjeteve në pajtim me ligjin, i cili e autorizon Bordin që të respektojë dhe zbatojë për fondin, si një fond që duhet të vihet apo të plasohet në vendet e sigurta, qoftë në bankat vendore apo në trajtat tjera këtu brenda, në mënyrë që vërtet edhe ky fond të vihet në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm të vendit tonë. Duke i përkrahur këto orientime, ne e mbështesim Raportin e auditivit, njëherësh edhe raportimin e drejtorit, zotit Beqaj. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti deputet Rexhepi! Në emër të AAK-së, deputeti Haki Shatri.

**HAKI SHATRI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,  
Grupi Parlamentar i Aleancës, Raportin e sheh si një moment kur duhet të bisedohet për periudhën për të cilën po raportohet para Kuvendit dhe e sheh si një shans që të diskutojë dhe të ndikojë që të merren masat e nevojshme lidhur me ngjarjet për vitin ose për periudhën përkatëse për të cilën raportohet.

Raporti nuk është kurrgjë tjetër pos një dëshmi që rapporti i organit përkatës të Trustit ka qenë një raport i besueshëm dhe të gjitha shifrat që kanë qenë në Raportin e Trustit të Pensioneve janë verifikuar edhe një herë nga një institucion i pavarrur për auditim, në këtë rast Di Lloyde.

Pra, na nuk kemi çka e përkrahim rapportin, sepse rapporti është bërë nga një organizatë profesioniste dhe tregon që disa ngjarje të pakëndshme kanë ndodhur në vitin 2008 në Trustin e Pensioneve.

Për Grupin Parlamentar të Aleancës është tepër me rëndësi që të thirremi në diskutimet që janë bërë në Kuvend, në kohën kur është diskutuar për raportin e Trustin e Pensioneve dhe shqetësimet që kanë ngritur këtu deputetët e të gjitha grupeve parlamentare lidhur me fatin e mjeteve të Trustit të Pensioneve. Për ne nuk është shumë me rëndësi a përkrahen rekomandimet e Komisionit për Buxhet, por është me rëndësi që ky Kuvend dëshiron apo nuk dëshiron që të merret me personat, strukturën adekuate të njerëzve që kanë pasur obligim të ndërpresin rrjedhën e humbjeve të mjeteve të Trustit të Pensioneve. Në këtë rast, nuk po mendoj në strukturën adekuate të Bordit të Trustit, sepse këta janë zgjedhur në këtë vit dhe nuk kanë asgjë, as përgjegjësi, as obligim para askujt, as para Kuvendit, por sipas Ligjit për Trustin e Pensioneve, përgjegjës ka qenë pjesërisht, në periudhën sa ka qenë në mandat Bordi i kaluar i Trustit dhe pasa asaj, sipas ligjit, përgjegjësi të plotë materiale dhe politike kanë pasur përgjegjësit e Bankës Qendrore të Kosovës, përmuajin e parë të veprimeve jo të mira në Trust dhe menjëherë, posa tejkalon masën prej 30 ditësh, pra një muaj, siç e parasheh ligji, përgjegjësia për mosveprim ka kaluar te Qeveria e Kosovës. Për ne është me rëndësi që ky Kuvend të përcaktojë përgjegjësinë edhe të udhëheqësve të Bankës, edhe të Qeverisë të Kosovës për mosveprim dhe përmundësuarat e afër 93 milionë eurove.

Ne sot po diskutojmë këtë, po aprovojmë rekomandime të Komisionit për Buxhet pa materie, sepse Raporti i Delloyd është raport profesionist dhe Kuvendi nuk ka pse ta vlerësojë pozitivisht Raportin e Trustit të Pensioneve, pra atë Agjencionit që merret me auditim, që është profesionist, por duhet të merret me çështjen e përcaktimit të përgjegjësisë të atyre që kanë pasur përgjegjësi në vitin 2008, dhe që nuk e ndiejnë veten aspak faktor as para nesh, as para atyre që kanë paguar në Trustin e Pensioneve. Ju faleminderit, shumë!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Shatri!

Në emër të Aleancës Kosova e Re, flet Kryetari i Grupit, Ibrahim Makolli.

**IBRAHIM MAKOLLI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministra që keni mbetur tashmë këtu, sepse shumica prej kolegëve tuaj nuk po e shohin të arsyeshme kur po debatojmë për çështje shumë të ndjeshme, e në veçanti ministri i Ekonomisë, nën resorin e të cilit bie kjo.

Zoti kryesues,

Kolegë,

Unë po paraqes fillimisht shqetësimin e grupit parlamentar dhe shqetësimin tim përkitazi me prezantimin e kryetarit të Bordit, të Trustit Pensional të Kosovës para Kuvendit të Kosovës, sepse ky Kuvend ka zgjedhur me dhjetëra kryetarë bordesh dhe borde dhe nuk është praktikë që kryetarët e bordeve t'i drejtohen Kuvendit, me gjithë respektin, sepse ne kemi komisionin dhe kemi Ministrinë e cila do të duhej të jepë përgjegjësi dhe unë besoj se në të ardhmen nuk do të duhej të vazhdojë në praktikë e tillë. Ky Kuvend nuk është vendi ku mund të bëhen fushata edhe deklarime të kujtdo qoftë.

Sa i përket raportit, ne po flasim për një raport të punuar nga një organ kompetent, nga Auditori Gjeneral dhe unë do të shfrytëzoja rastin tashmë që të shtoj vetëm disa pyetje, që do të duhej të jepeshin përgjigje. Te çështja, kostoja e stafit, që kemi në dy vende, në një vend 391.948, se sa janë të punësuar dhe sa është paga e këtyre të punësuarave, se sa është paga për anëtarët, honorarët e anëtarëve të Bordit, do të duhej të jepej përgjegjësi, do duhej të jepë përgjegjësi dikush, të tregojë se sa janë.

Sigurimi shëndetësor, kolegë! Nëse në një vend ku menaxhohet me para të një qytetari të Kosovës, dikush i jep vetes të drejtë që të bëjë sigurimin shëndetësor nga ato mjete, atëherë kjo është shkelje flagrante e ligjit dhe është absolutisht e palejueshme. Po ashtu, ne kemi thënë disa herë këtu se ky trup kërkon njerëz profesionalë, anëtarë profesionalë të Bordit dhe ne po shohim këtu që janë shpenzuar mjete për konsulencë të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës në kohën kur të gjithë këtu janë deklaruar se këta janë njerëz më të mirë të cilët i njohin këto çështje. Të gjitha këto shpenzime, vetëm shikoni në një vend, kolegë, edukimi publik dhe shpalljet. Çka ka nevojë për edukim publik për Trustin Pensional të Kosovës, kur ne të gjithë e dimë që të gjithë tē punësuarit në Kosovë detyrohen që të paguajnë në Trustin Pensional pa pasur nevojë që të bëhen shpalljet, pa pasur nevojë që të ketë reklamim sa i përket kësaj dhe kjo është absolutisht keqpërdorim i parasë së qytetarit, Dhe, në një vend tjetër, kolegë, në një pjesë këtu ku thuhet -i është dhënë Bankës 20 milionë depozita dhe merreni me mend, shikoni në faqen 19, depoziti paguan kamatë vjetore prej 5.10% tē përbërë për çdo muaj, do të thotë qytetarët e Kosovës, të cilët janë mbledhës së këtyre, janë paratë e tyre, kur marrin kredi nga bankat, paguajnë 15% tē kamates së tyre, ndërsa bankat me paratë, me mjetet e tak sapaguesve në Kosovë, paguajnë vetëm 5% tē depozitave. Kjo flet më së miri për gjendjen që është krijuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Makolli!  
Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, flet deputetja Besa Gaxherri.

**BESA GAXHERRI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj se para se ta marrë fjalën për pikën e rendit të ditës, pasi që në këtë pikë tē rendi tē ditës u ndërhy brutalisht nga Kryeministri i Kosovës, mendoj se kjo çështje nuk mund tē kalojë kështu. Ky skandal nuk mund tē kalojë kështu pa u theksuar. Megjithatë, pasi që nuk është prezent Kryeministri, sepse e kreua ai tē veten, erdhi e deshi sakon si kauboj, e tha çka deshi dhe shkoi dhe nuk është Kryetari i Kuvendit këtu, nuk e kam ndërmend tē reagoj, por thjeshtë do tē reagojmë, ndërsa sot po e ftoj publikisht opozitën që tē rishqyrtojë pozicionin e vet dhe tē mendojë për bojkotimin e seancës, përndryshe ose duhet tē respektohet ky Kuvend dhe Rregullorja e Kuvendit, ose unë mendoj se ne opozita vërtet duhet tē ulemi dhe tē bisedojmë dhe tē mos marrim pjesë fare më në seanca plenare.

Kështu nuk ka ndodhur, zoti kryesues. Unë jam deputete qe 3 mandate, por kështu vërtet nuk ka ndodhur ende. Megjithatë, këtë çështje do ta ngreh si çështje të jashtëzakonshme një ditë tjetër.

Kalojmë tek pika e rendit të ditës, sepse këtu është bërë Hajt pak, kush do, kur tē do mund tē flas çfarë tē dojë. Është e vërtetë, dhe ju lutem, zoti kryesues, mos më ndërhyni, asnjë reagim. Mund tē thuhet, sa i përket këtij raporti, Kuvendi i Kosovës, realisht, për herë tē parë po se shqyrton një raport tē auditorëve të pavarrur tē Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe, natyrisht, ky raport është i vonuar. Vonesën e këtij raporti e arsyeton Trusti Pensional, se kompania audituese e ka vonuar dorëzimin e këtij raporti, e kështu me radhë.

Mund tē thuhet se vërtet raporti i plotëson standardet teknike tē një raporti tē auditimit, por nda ky raport nuk nxjerrim asgjë më shumë ose më pak se ato që vërtet i dimë, që e kanë përcjellë këtë trust, ato probleme, keqmenaxhime, keqpërdorime deri sot që i kemi diskutuar edhe në disa seanca tjera.

Siç e dimë tashmë, si pasojë e krizës globale financiare dhe papërgjegjësisë së Qeverisë, Bankës Qendrore të Kosovës dhe Bordit të pakompletuar të Trustit Pensional, si pasojë Trusti ka pasur humbje afér 100 milionë euro ose saktësisht 92.5 milionë euro. Nga ky raport shihet se në vitin 2007 dhe 2008, janë investuar në sasi e lartë e mjeteve në letra financiare me një fitim të ulët dhe natyrisht se ky Kuvend dhe kontribuuesit e këtij Trusti duhet ta dinë se kush e ka marrë këtë vendim dhe pse.

Duke pasur parasysh se Ligji për Trustin Pensional nuk lejon deponimin në bankat vendore më shumë se 5% të këtij trusti, ne e shohim këto mjetë qarkullojnë në dy banka, pra në këto vendore që veprojnë në Kosovë, në RaifaizenBank dhe në ProCredit Bank, por jo që të dy këto banka ofrojnë kamatat e njëjta, andaj Bordi duhet të intervenojë urgjentisht që kamata të rritet ose mjetet nga banka tjetër të tërhiqen sa më shpejt dhe të barten në bankën e cila ofron kamatë më të lartë. Lidhja Demokratike e Dardanisë kërkon urgjentisht nga Qeveria që Ligji i Trustit Pensional të sillet në Kuvend, për ndryshim.

Këtij reporti i mungon specifikimi apo sqarimi rrith blerjeve apo investimeve gjatë vitit 2008. Nga ky rapport shohim se numri i punëtorëve është 24 dhe në bazë të këtij reporti ne shohim se paga mesatare është 1500 euro. Natyrisht, duhet dhe është dashur të pasqyrohet në raport nivelizimi i pagave, diferenca dhe ta dimë se kush sa paguhet.

Tjetër, shohim shpenzime të larta për kontraktorë dhe konsulentë, kur e dimë se menaxhmenti paguhet në paga të larta dhe, natyrisht, këta njerëz janë zgjedhur si ekspertë dhe duhet të janë ekspertë me qëllim që shumë pakë apo të ketë arsyet e fortë që të bëhen shpenzime për konsulentë.

Nga ky rapport shohim se kontribuesi që ka mbi 2000 euro, nuk ka të drejtë të bëjë tërheqjen e të gjitha mjeteteve, por vetëm 100 euro në muaj dhe unë mendoj se është e padrejtë, kjo çështje duhet të rregullohet në mes të kontribusit dhe Trustit Pensional sipas dëshirës individuale të kontribuuesve.

Nga ky rapport shohim se edhe një problem që ka përcjellë Trustin, është çështja e disa kontribuuesve që paguajnë dhe këto mjetë nuk shkojnë në llogari personale sepse mungon adresa, si rezultat i neglizhencës dhe të mos koordinimit të mirë me ATK-në, 26 milionë euro janë të pashpérndara, pra janë pa adresë.

Në rapport, ndër të tjera shihet se nga taksa menaxhuese janë grumbulluar mbi 2.5 milionë euro, ndërsa shpenzimet operative totale janë 2.204 milionë euro. Nga kjo shihet se ka mundësi dhe duhet menjëherë të ketë zbritje të taksës menaxhuese. Ju faleminderit për vëmendje, zoti kryesues!

**KRYESUESI:** Faleminderit edhe ty zonja, Besa Gaxherri!  
Fjalën e merr Enis Kervan, a është këtu? Nuk është. Myfera flet për grupin “7+”.

**MÜFERA ŞİNİK:** Faleminderit!  
Sayın Başkan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Kosova Emeklilik Trustu tasarrufunun 2008 yılına ait otorite raporunun ve Finansi durumunun görüşülmesi yapılmaktadır.

Kosova Meclisinin Bütçe ve Finansi Komisyonunda görüşüldüğüne göre, raporun görüşülmesi Yasa standartlarını doldurmaktadır.

7+ Parlamente grubu raporu incelemiştir ve bu raporun yatırım ve maddi araçların kullanımı ve harcamaların daha uygun bir şekilde yapılabilmesi için Yasada değişikliklerin ve eklemelerin yapılmasıyla bu raporu kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin SLS, a ka të paraqitur? Nuk ka. Mursel Halili e ka fjalën, për Grupin SLS.

MURSEL HALJILJI: Gospodine predsedavajući,

Gospodine ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlementarna Grupa SLS je razradila ovaj izveštaj Penzionog trusta Kosova i moramo da kažemo da se pridružujemo svima onima koji su dali primedbe što se tiče nekih nejasnoća, odnosno propusta u menadžiranju sredstima Trusta. Postoje pitanja koja su vezana za radna mesta, za visisne plate, za odnose sa stedišama. Tu su i operativni troškovi, koji smatramo da su nerealni. Medjutim, naravno postoje i konstatacije koji su prethodni govornici govorili o bankama koje su ovlašćene da koriste novac štediša kojima menadžira Trust Kosova. Medjutim, stojimo i na stanovištu da čemo prihvati preporuke funksionalne komisije i stoga čemo i ovaj finansijski izveštaj prihvati u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Mbaruan paraqitjet në emër të grupeve. Unë ju lus edhe një herë, ne kemi edhe pika të tjera. Bëhuni të kujdeshëm, paraqitni emrin e njeriut që flet në emër të grupit, për shkak se këtu janë emrat, por nuk po dihet cili është. Tash vazhdojmë me diskutime. Fjalën e merr deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Do të mundohemi ta racionalizojmë kohën.

Raporti i audituar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe paqyra financiare për vitin 2008, jo duke dyshuar në kompaninë e cila ka bërë auditimin, por është me disa mangësi se si paraqitet këtu, duke marrë parasysh mos specifikimin e të të dhënavë, sidomos te ato që kanë të bëjnë për blerjet apo investimet e mjeteve në letra me vlerë me fitim të ulët. Humbja e shkaktuar gjatë vitit 2008, siç thuhet, për shkak të krizës në tregjet financiare në vlerë prej 92.5 milionë euro, tregon se mjetet janë investuar në bankat e jashtme që paraqiten me rejting të lartë, por në anën tjetër janë shkaktuar humbje që kanë prekur drejtpërsëdrejti Fondin Pensional të Kosovës. Prandaj, duke ju bashkëngjitur edhe parafolësve, ndoshta Kuvendi duhet këtu të përqendrohet dhe në njëfarë forme ta gjejmë mënyrën të kërkojë përgjegjësi se në njëren anë është paraqitur që mjetet janë investuar në bankë me rejting të lartë me tri A, ndërsa humbja është shkaktuar në vlerë prej 100 milionë euro.

Cështja e dytë, që është shumë problematike edhe që do të jetë edhe në të ardhmen, është raporti i Trustit me Administratën Tatimore të Kosovës, duke marrë parasysh se disa kontribute që paguhën, nuk shkojnë në llogari personale dhe rezultat i kësaj janë grumbulluar më shumë se 26 milionë. Vetëm në vitin e kaluar 44.500 euro, ndërsa çdo vit barten pothuaj se nga 26.000 euro, sidomos nga ato nga viti 2007, dhe kjo duhet të jetë zgjedhur, sepse kjo... prapë kontributdhënësit dha ata që direkt, do me thënë, në fondin pensional të personave në fjalë.

Dhe, për fund, ajo që ne e kërkojmë gjithnjë, transparenca është dhe që duhet të jetë këtu në Kuvend, para qytetarëve të vendit për pagat e punëtorëve të Trustit Pensional, ku e them se në bazë të llogaritjes paga minimale apo mesatare aty është hiq më pak se 1500 euro dhe këtë ndoshta do ta dijë edhe opinioni, edhe mediat se, nëse bëhet fjalë për paga të deputetëve, do të vërsulen të gjithë, edhe agjencionet e huaja, ndërsa 24 punëtorë, çdonjëri mesatarisht paguhet 1500 euro në Trustin Pensional të Kosovës dhe asnje zhurmë apo asnje kërkim transparency, edhe pse këtu nuk është e paraqitur fare. Prandaj, në këto çështje ndoshta duhet të fokusohet edhe debati, edhe përgjegjësia dhe të orientohen edhe rekomandimet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Ministër,

Deputet të nderuar,

Trusti i Kursimeve Pensionale është i rëndësisë së veçantë për qytetarët e Kosovës dhe kjo nënkuption se për suksesin e Trustit shumë me rëndësi është besimi i qytetarëve në profesionalitetin e Trustit, por edhe në vetë qeverinë, si garant përfundimtar.

Në raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2008, janë paraqitur pasqyrat e audituara vjetore për vitin 2008. Duhet cekur disa vërejtje lidhur me këtë raport. Informatat rrith mjeteve në trust janë shumë teknike dhe përpilimi i tyre do të duhej të modifikohet në mënyrë që Kuvendit të mund të debatojë rrith informatave të ofruara.

Kështu, për shembull, informatat rrith shpërndarjes së mjeteve të Trustit tek kompanitë që investojnë ato jashtë, nuk tregojnë se sa janë humbjet reale te secila prej tyre, kështu që mendoj se do të ishte më e preferuar të bëhet një audit i performancës që do të shprehte opinionin në efikasitetin e kontrollit të Trustit. Humbjet e Fondit gjatë viteve të kaluara janë shumë të larta, atë e kemi të gjithë të qartë. Këto humbje janë rrith 3% GDP-së. Për ta kuptuar seriozitetin e kësaj humbjeje, do të duhej të paramendojmë situatën në Amerikë. Sikur një institucion shtetëror, si Fondi i Pensioneve të humbte diku 400 miliardë dollarë, 400 miliardë dollarë janë afersisht 3% e GDP-së së Amerikës. Atje kishte për të rënë krejt qeveria. Andaj, do të bashkëngjitesha në kërkesën shumë parafolësve që duhet të shtrohet seriozisht edhe çështja e përgjegjësisë. Kush është fajtor për mosreagimin për disa muaj me radhë, a mjafton arsyetimi se Trusti nuk ka patur Bord në atë kohë, kush duhet të marrë përgjegjësinë në mungesë të bordit - Banka Qendrore apo Ministria e Financave.

Një pyetje tjetër me rëndësi është se sa e zbaton Trusti legjislacionin në fuqi. Nëse legjislacioni parasheh 4 opsione për zgjedhjen e formës së pensionit, a iu ofron pensionistëve të gjitha këto opsione. Vendimi i parë i Bordit ishte që sapo të pensionuarve t'u kompensohet një pjesë e mjeteve të kursyera të humbura gjatë krizës financiare dhe është fjala vetëm për humbjen nga kontributet e paguara, por jo edhe nga interesat.

Në cilën rregullore është mbështetur ky vendim, nëse nuk është politik. Sa është i ligjshëm ky diskriminim në mes personave që pensionohen sot dhe atyre që pensionohen vitin e ardhshëm apo vitet tjera, meqë atyre nuk do t'u kompensohen këto humbje.

Nga raporti shihet se te kostoja e stafit bëhen pagesat për sigurimet shëndetësore. Sa është në rregull që brenda institucioneve publike aplikohen standarde të ndryshme. Si arsyetohet që për nëpunësit Trustit paguhën sigurimet shëndetësore nga kontributet e të siguruarve, edhe pse vetë kontribuuesit nuk kanë sigurime shëndetësore. Pagimi i sigurimeve shëndetësore është çështje edhe e institucioneve tjera publike në Kosovë, që funksionojnë në mënyrën e paparë të ndonjë shteti. Ne, me këto veprime, me të vërtetë çdo ditë po e dëshmojmë se jemi shtet sui generis. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja deputete!  
Fjalën e merr deputetja Myrvete Pantina

**MYRVETE PANTINA:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2008, të cilin po e shqyrtojmë sot, është hartuar nga ana e auditorit të pavarur, një kompani e quajtur Delloyd, e cila kompani, si thuhet në raport, ka bërë auditimin në përputhshmëri me standarde ndërkombëtare të auditimit. Ky raport përfshinë: bilancin e gjendjes, pasqyrat e operacioneve, pasqyrat e ndryshimeve në fondet e kontribuesve dhe përmban shënimë për pasqyrat financiare të Trustit.

Opioni i Kompanisë së auditimit është se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë reale, shikuar pra nga të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, deri më 31 dhjetor të vitit 2008.

Për vlerën e investimeve që bëhen nga ana e Trustit, kemi pasur rast të debatojmë në këtë Kuvend para një kohe, por për pasqyrat e operacioneve të trustit, është hera e parë që kemi mundësi të debatojmë meqenëse ato, është hera e parë që na parashtron tani. Andaj, unë do të përqendrohem vetëm në pasqyrat e operacioneve të Trustit, por para se të fillojmë me analizimin e këtyre pasqyrave të operacioneve të Trustit, dua të cek se prej shtatorit të vitit 2008, mjetet e kursyera të kontribuuesve nuk janë plasuar jashtë Kosovës dhe kjo paraqet, pra, një element pozitiv. 5% të mjeteve pensionale, Bordi udhëheqës i Trustit gjatë vitit 2008 ka vendosur që të plasojë në depozita bankare në bankat e Kosovës, por duhet të shikohen mundësitat ligjore që të rritet plasmani i mjeteve të kursyera në Trust në bankat e Kosovës, në mënyrë që ato mjete të shfrytëzohen për nevojat e vendit. Por, edhe unë e kam një vërejtje sa i përket mandatit të bordit dhe faktikisht uljes së vlerës së investimeve të bëra nga ana e Trustit.

Dihet se mandati i Bordit të Trustit ka përfunduar në shtator të vitit 2009, mirëpo është e paqartë se pse Bordi nuk ka reaguar deri në shtator, kur dihet se vlera e investimeve apo rënia e vlerës së investimeve ka filluar edhe më herët edhe gjatë vitit 2007 dhe me intensitet më të madh prej fillimit të vitit 2008.

Nga të dhënat e paraqitura në raport shihet se shpenzimet operative totale të Trustit në vitin 2008, kanë qenë 2.205.000, ndërsa taksa totale menaxhuese e grumbulluar për vitin 2008 ishte 2.486.000, do me thënë shuma e mjeteve të grumbulluara në emër të taksës menaxhuese ishte më e lartë për 282.000, më shumë pra se sa shpenzimet operative. Meqë taksa menaxhuese prej 0.9% u ngarkohet llogarive të kontribuuesve të Trustit në bazë mujore dhe përdoret për financimin e operacioneve të Trustit, atëherë suficit i paraqitur tregon qartë se ka hapësirë për ulje të mëtejme të taksës menaxhuese, gjë që do të ndikonte edhe në shkarkimin e kontribuuesve të Trustit.

Nga raporti po ashtu shihet se kostoja e stafit e përbën konponentën me pjesëmarrje më të madhe në shpenzimet totale të Trustit. Dihet, numri i punëtorëve është 24, por nuk

është paraqitur kategorizimi i pagave të të punësuarve në raport në bazë të koeficienteve. Nga një llogaritje që kam bërë në bazë të dhënave të paraqitura në raport, del se paga mesatare mujore për një punëtor është 1.500 euro, por nuk dihet se sa është diferenca në mes të pagës më të lartë dhe asaj më të ulët. Prandaj, në raportet e ardhshme duhet të paraqitet kategorizimi i pagave në bazë...

#### Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja e fundit për sot, Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit!

Rregullorja e UNMIK-ut për formimin e Trustit ka qenë e aprovuar në Kuvend në vitin 2001, më 2005 është bërë ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut për Fondin Pensional të Kosovës dhe unë mendoj se kemi obligim, si Kuvend, ta rishqyrtojmë Rregulloren e UNMIK-ut, se prej 17.02. jemi shtet dhe duhet ta bëjmë ligjin, ta aprovojmë ligjin për sigurimin pensional dhe me te ta krijojmë sistemin pensional. Ai është një argument i parë, për të cilin po them që obligim është i yni ta rishqyrtojmë Rregulloren për Trustin.

Nën dy, mendoj se Trusti, me mënyrën e veprimit, këtë e kemi nga reporti, gjithashtu edhe prej Rregullores, me përgjegjësinë që e ka, ose papërgjegjësinë, po dëshmon se Trusti funksionon në baza të një shoqërie të sigurimeve komerciale. Parandej, ne vetëm mund ta konstatojmë sot në Kuvend, a ka qenë menaxhimi i mirë, apo jo, dhe diskutimet këtu kanë qenë edhe mund të vazhdojë se kush e formon Bordin, Bordi kujt i ka përgjegjësinë. Banka Qendrore këtu po kontrollon, prandaj ky sistem nuk është, kjo është vetëm një shoqëri e sigurimeve komerciale në bazë.

Nën tre, mendoj se kur është aprovuar Rregullorja këtu në Kuvend, nuk është bërë një diskutim më i gjerë dhe unë e konsideroj se Trusti me mënyrën në të cilën punon, është sidomos vërejtje që ka në opinion, u është imponuar punonjësve kosovarë. As Sindikata këtu nuk po pajtohet, as shumë vetë, as unë nuk pajtohem prej shoqërisë nga unë vijë. Prandaj, unë mendoj se Qeveria ka obligim t'ia propozojë Ligjin për sigurimin pensional Kuvendit dhe të diskutojmë për sistemin pensional.

Unë, me 8 deputetë, para 6 muajve kemi kërkuar, e kemi paraqitur mocionin dhe me Rregulloren e Kuvendit, Qeveria ka qenë e obliguar për 3 muaj ta na japë përgjigen. Prandaj, pasi është këtu zëvendëskryeministri prezent, unë edhe një herë mendoj se Qeveria duhet ta bien ligjin, ta diskutojmë dhe të shohim se a ka apo nuk ka implikime buxhetore, do ta paraqesim edhe një shtesë të cilën e ka Ministria e Financave, që nuk është punë e implikimit buxhetor, por duhet të mendojë se Qeveria, nuk po them nuk ka vullnet politik, por duhet të marrë parasysh krijimin e një sistemi pensional. Prandaj, po e përfundoj, Trusti nuk mundet më tutje të jetë Fondi i sistemit pensional. Trusti mund të jetë vetëm një shoqëri i sigurimeve komerciale jo obligative, kush do të kursejë, mund të kursejë, e kush jo, nuk do, e ka fondin tjetër. Prandaj, mos të luajmë më me sistemin pensional edhe mos ta konsiderojmë Trustin si sistem pensional. Për mua nuk është. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk mund t'i ndryshojmë disa gjëra bash lehtë, mendoj që e dini edhe ju, veç po keni qejf t'i thoni disa gjëra. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet, i fundit, Driton Tali.

GANI KOçi: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë në këtë radhë po flas si deputet, jo në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

U thanë shumë çështje nga diskutuesit dhe unë do të përqendrohem vetëm në katër çështje, që për mua janë shumë esenciale, që është thënë edhe herëve tjera, që është më se e nevojshme që të bëhet ndryshmi në politikat investive të Trustit, sepse nga këto që i kemi pasur deri me tash, i dimë edhe passojat çfarë i kemi, por natyrisht me këto pasoja nuk duhet të lidhen krejt edhe me politikat investive, por duhet të lidhen me atmosferën e përgjithshme në tregun global financier.

Çështja e dytë, që dua ta shtroj, duhet të rregullohet sa më shpejt dhe sa më shpejt që të jetë e mundshme, raporti ndërmjet Trustit dhe Administratës Tatimore të Kosovës në bartjen dhe përcjelljen e të dhënave konkrete dhe të dhënave të sakta, në mënyrë që vërtet mjetet që grumbullohen nga Administrata Tatimore, në emër të Trustit, të adresohen dhe të shkojnë aty ku duhet. Kërkosë tjetër që ishte edhe kërkosë e Komisionit dhe e shumë tjerëve, është çështja e ndryshimit të ligjit. Ligji ka nevojë të ndryshohet dhe, ju e dini, edhe në një ekspoze të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, këtu por edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, që kemi pasur kontakte të formave të ndryshme me drejtoret menaxhues të këtij Trusti, është shtruar kjo nevojë e ndryshimit, prandaj akterët që janë përgjegjës dhe kanë për detyrë, kjo çështje është mirë që të fillojnë sa më shpejt. Një çështje që dua, sa për sqarim të ne deputetëve këtu, dhe që ka të bëjë me ligjin, po përmenden shumë pagat e Trustit. Ju lutem, mirë ose keq, Ligji përcakton edhe formën e financimit të Trustit dhe të pagave të Trustit dhe këto paga nuk mund të krahasohen me pagat e shërbyesve civilë, por të tregut financier dhe ka një dispozitë në ligj, ku thuhet se pagat e atyre që menaxhojnë këtë Trust duhet të jenë të ngjashme ose përafërsisht të ngjashme me fonde të ngjashme që janë diku në botë dhe që veprojnë në botë dhe merren modelet e atyre që menaxhojnë fonde 50 milionëshe, 100 milionëshe ose 200 milionëshe. Kjo është zgjidhje ligjore, e mirë e keqe, ne mund ta ndryshojmë, prandaj mendoj që nuk duhet adresuar këtë se po do dikush nga vetë Bordi, por kështu është e përcaktuar me ligj dhe në këtë drejtim, nëse duhet ndryshuar, duhet ndryshuar kjo çështje, absolutisht dushet ndryshuar kjo çështje. Këto ishin ato që desha t'i them dhe t'i potencoju këtu.

**KRYETARI:** Ju faleminderit, shumë. Dhe, i fundit, Driton Tali.

**DRITON TALI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kam parasysh se jam i fundit dhe kam parasysh se janë edhe disa pika tjera që kanë për t'u shqyrtuar, por megjithatë do të ndalem në atë që parathënësit e mi e folën, dhe diçka që është shumë kah na intereson të gjithë neve, gjithmonë duke pasur parasysh edhe Ligjin, do me thënë për pagat. Unë nuk pajtohem me parafolësin se këto paga e pasqyrojnë nivelin e Trustit, nga fakti se stafi operacional i Trustit, ama nuk bën kurrgjë hiq se çka duhet të punojë një ekspert në një fond. Gjithë atë çka e bëjnë ata, është se i mbledhin kontributet dhe, jo ata, por është njëfarë procesi, është njëfarë sistemi i instaluar, ku stafi i Trustit fare nuk bën asgjë. E gjithë ate që e bën stafi i Trustit, është prodhimi i disa pasqyrave individuale financiare, të cilat përsëri i bën njëfarë softueri, për të cilin vjet janë paguar për mirëmbajtje 30 mijë euro, andaj rroga mesatare 1.500 euro e një punëtori, të një stafit në Trust, mendoj se nuk ka kuptim fare, ama bash fare. Po e them edhe një herë, për shkak se Trusti nuk merret me analizimin e tregjeve, atë punë e bën tjetër kush krejt. Do me thënë, atë që e bën Trusti është se i mbledh, jo ai por tjetër kush, pra procesi, sistemi dhe ato para ua dërgon aset-menaxhuesve tjerë, do me thënë, në këtë rast është Vanguard dhe Schroder, të cilët merren me analizat.

Unë pajtohem se analizues të investimeve në Vanguard paguhen shumë për shkak se tërë ditën merren me analiza dhe me llogaritje të industrisë financiare, ndërsa Trusti nuk bën kurrgjë hiq.

Tash kthehem, aq më shumë më la përshtypje këtu, po flas te faqja 22, ku thotë se ka shpenzime për bonuse dhe punë jashtë orarit. Singershit, nuk e kam të qartë çka punojnë jashtë orarit, gjithmonë po flas për stafin operacional. Më duket se janë 23 apo 24, tash varësish se cilën informatë të fundit e kemi. Pastaj, unë e kam edhe një hall tjetër, merremi me Bordin. Shihni, Bordi që nga viti 2002, që nga gushti i vitit 2002, kur është krijuar Trusti, vetëm se dy vendime strategjike i ka marrë dhe atë në vitin 2003, kur kanë vendosur që, në fakt më 5 mars, e kam edhe datën kur kanë vendosur që mjetet t'i jepen ABN AMRO-s dhe Legal and General për menaxhim dhe, disa vite më vonë, kur marrin vendim që të merren mjetet nga ABN AMRO e Holandës, dhe Legal and General britanike dhe t'i jepen Vanguard-it. Do me thënë, për 7 vite vetëm dy vendime strategjike i kanë marrë dhe për çdo muaj ata paguhen. Shikoni, nëse e bëjmë një llogari 6 vet, sa janë paguar vitin e kaluar, gjithmonë flas deri në shtator, del se një anëtar i Bordit ka kushtuar mesatarisht 1318 euro e 50 centë për muaj. Unë nuk e kam të qartë për çka. Do me thënë, pa marrë parasysh se anëtarët e Bordit janë fajtor, për mendimin tim, apo kanë qenë impotent për të bërë diçka, për t'ua ndërruar kahan investimeve të Kosovës, dhe janë paguar rrrogat marramendëse. Për çka - për kurrgjë hiq! Unë nuk e kam të qartë.

Mos të harrojmë se dy anëtarë të Bordit aktual, dy ndërkombëtarët Kember dhe ky farë Bates, kanë qenë në Bordin e kaluar, do me thënë atij Bordi që na ka kushtuar mbi 100 e sa milionë euro humbje. Singershit, unë pajtohem me atë se ligji duhet të ndryshohet, duhet Trusti thellësish të ndryshohet, si në aspektin operacional edhe në atë strategjik. Shikoni se çfarë demagogje është aty. Në Bord thuhet se, ne e dimë që Trusti është pronë e kontribuuesve, do me thënë u takon kontribuuesve, do me thënë punëdhënësve dhe punëtorëve, sepse këta janë kontribuuesit. Këto dy grupe të interesit apo pronarët e Trustit, përfaqësohen me dy anëtarë atje, do me thënë logjikisht shtrohet pyetja se anëtarët tjerë të Bordit interesin e kujt e përfaqësojnë.

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit. Falënderoj kryetarin e Bordit, zotin Besim Beqaj. Në sallë janë 66 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 43 vota “për”, 8 “kundër”, 7 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe të pasqyrave financiare për vitin 2008 me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

A e dëshironi një pauzë prej 15 minutash, apo po vazhdojmë? Vazhdojmë.

**- Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008 dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009 dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare. Rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, zoti Bahri Hyseni, nëse e do fjalën.

**BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!**

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në pajtim me Ligjin e përgjithshëm për zgjedhjet, për herë të parë Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka afruar raportin me shkrim për punën për vitin 2008.

Komisioni në dy seanca të veçanta, edhe të datës 29 qershor, edhe të datës 6 korrik, ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe ka përshëndetur raportin e ofruar nga Komisioni Qendror Zgjedhor duke marrë parasysh që është hera e parë që Komisioni Qendror Zgjedhor po raporton para Kuvendit të Kosovës me raport me shkrim.

Vlen të përmendet se me rastin e raportit, komisioni ka konstatuar se raporti në fjalë, meqë është për herë të parë, i plotëson kriteret për t'u diskutuar dhe shqyrtuar në seancë plenare.

Vlen të përmendet se raporti flet për funksionimin e Komisionit Qendror Zgjedhor për përbërjen, për infrastrukturën ligjore, flet për mënyrën e organizimit dhe për aktet nënligjore që i ka nxjerrë Komisioni Qendror Zgjedhor, për sfidat, problemet, objektivat.

E rëndësishme është që në raport po thuaj me këtë përmbajtje që e ka, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, por edhe komisione të tjera kanë kuptuar që raporti në përmbajtje flet për një numër të caktuar të ligjeve me të cilat funksionon, për numrin e infrastrukturës ligjore, aktet nënligjore që i ka nxjerrë gjatë periudhës për vitin 2008 dhe, natyrisht, për objektivat që i ka Komisioni Qendror për zgjedhjet për vitin 2009 apo për zgjedhjet e ardhshme.

Vlen të përmendet një fakt se në raport nuk ka përfshirë periudhën apo raportin përfundimtar për zgjedhjet e vitit 2007, që ne kuptojmë, sepse periudha është për vitin 2008.

Në raport janë përfshirë edhe shumë çështje teknike, për të cilat ne kemi kërkuar nga kryetaria e komisionit që ka raportua në Kuvend, që në të ardhmen nuk ka nevojë për mbajtjen e shumë takimeve, që kanë qenë takime të përditshme, prandaj konsiderojmë që kjo është shtesë për raportin, të gjitha takimet që i kanë mbajt.

Unë do të ndalesha vetëm te disa probleme për të cilat ne i kemi rekomanduar edhe kryetares së komisionit, edhe kryeshefit ekzekutiv të komisionit për problemet të cilat ne nuk kemi dash të bëjmë rekomandime, sepse janë rekomandime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këto rekomandime janë rrëth ndërhyrjeve politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, po flasim për periudhën 2007, dhe rasti ka të bëjë me implementimin e zgjedhjeve në gjithë territorin e Kosovës. Do të thotë, edhe pse sovranit ka zgjedhur shumë kryetarë komunash, ka zgjedhur deputetë të asambleve komunale, këto në praktikë nuk janë implementuar për shkak të ndërhyrjeve, qoftë ka zyrat e huaja, nuk janë certifikuar

zgjedhjet, prandaj, mbetet problem serioz dhe kemi rekomanduar që Komisioni Qendror Zgjedhor për zgjedhjet që po vinë apo për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ta ketë parasysh që pavarësish se a do të dalin në zgjedhje, qoftë edhe minoritetet, njerëzit të cilët e fitojnë votën e sovranit duhet të certifikohen, sepse është e drejtë demokratike dhe është e drejtë ligjore që të certifikohen njerëzit të cilët i kanë fituar votat.

Problem tjetër ka qenë lista e votuesve. Ne e dimë se edhe në vitin e kaluar, por edhe në këtë vit ende nuk janë bërë të gjitha parapërgatitjet që spastrohet lista e votuesve. Dhe, vlen të përmendet që shumë njerëz të cilët kanë votuar në shumë zgjedhje, në zgjedhjet e fundit nuk kanë qenë fare në listë dhe kjo është problem që e kemi diskutuar edhe me kryetarin e komisionit dhe kemi rekomanduar që këtu të kihet një kujdes i veçantë, sidomos të bashkëpunohet me Ministrinë e Punëve të Brendshme apo me ofiqarit komunale që të mos ndodhë që njerëzit të cilët kanë votuar në tri palë zgjedhje, të mos jenë në zgjedhjet e fundit.

Ne e kemi kuptuar që është e drejtë ajo koha e kundërshtimit të listave, mirëpo ne duhet të kuptojmë se qytetarët e Kosovës nuk e kanë mundësinë që të gjithë t'i kundërshtojnë listat për arsy, për shkak të kushteve të vështira materiale që i kanë, për arsy që nuk janë të informuar, shumicës së komunave të Kosovës ju mungon edhe informimi publik, prandaj në të ardhmen është mirë që Komisioni Qendror Zgjedhor ta ketë parasysh që t'i informojë qytetarët dhe të pastrojë listat qoftë nga njerëzit të cilët tani kanë ndërruar jetë, qoftë nga njerëzit që fare nuk duhet të jenë në listat e votimit.

Gjithashtu, një vërejtje e cila ka qenë në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për Komisionin Qendror Zgjedhor është edhe çështja e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa. Ne e dimë që shumë parti politike kanë marrë dëname shumë të mëdha dhe pa u argumentuar nga faktet juridike që duhet të argumentohen nga partitë të cilat kanë bërë, po them, padi apo kundërshti për vendosjen e pllakateve të ndryshme, e kështu me radhë. Duke marrë parasysh që ligji aktual ka dhënë mundësinë që edhe kandidatët e pavarur, por edhe partitë politike të vendosin pamflete të ndryshme nëpër rrugë të ndryshme të Kosovës dhe ka mjaftuar që një kundërshtim i një partie politike dhe një parti dënohet pa u argumentua me fakte se kush e ka vendosur atë poster apo diçka tjetër.

Dhe, në fund, komisioni e ka pasur edhe një shqetësim, Komisioni për Legjislacion, të cilin e kemi diskutuar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe çështjen e ngritjes apo të aftësimit, të kapaciteteve që i ka Komisioni Qendror Zgjedhor për parapërgatitjen që duhet të bëhet me rastin e zgjedhjeve komunale që i kemi për vitin 2009, por edhe zgjedhjet tjera.

Vlen të përmendet se ligji aktual, ligji aktual që është për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet komunale ndoshta në të ardhmen është mirë që të plotësohet dhe të ndryshohet, sepse është konstatuar që disa dispozita ligjore, të cilat janë në fuqi, nganjëherë bien në kundërshtim me ligjet e tjera dhe bie në kundërshtim me zbatimin praktik.

Prandaj, kemi sugjerua që sa më parë Komisioni Qendror Zgjedhor, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, t'i identifikojnë këto dispozita ligjore dhe të fillojnë procedurën edhe për ndryshim dhe plotësim, atje ku është e nevojshme.

Me këto rekomandime që janë edhe në raport, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi rekomandon që të aprovohet Raporti i Komisionit Qendror Zgjedhor. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Do të falas edhe në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Kryetar.

Në bazë të Rregullës 51.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve për periudhën 2008 – 2009 dhe sipas raportit të paraqitur për periudhën 2008 – 2009 i plotëson standardet ligjore të kontabilitetit për raportim.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe informatat e ofruara, ndërsa ne marrim parasysh edhe vërejtjet nga Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe i rekomandojmë edhe Kuvendit që të aprovohet si i tillë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

**GJYLNAZE SYLA:** Faleminderit!

Zoti Kryetar, ju jeni treguar sot i pafuqishëm për të mos lejuar Kryeministrin ta shkelë Kuvendin. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës refuzon të marrë pjesë më tej në debat, në shenjë proteste për atë se çka ka bërë Kryeministri i Kosovës sot, duke fyer me arrogancën e tij institucionin më të lartë të vendit, Kuvendin e Kosovës, i cili e përfaqëson popullin e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar Ibrahim makolli:

**IBRAHIM MAKOLLI:** Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Raportin në fjalë e kemi shqyrtuar si grup parlamentar, por në veçanti në Komisionin në Legjislacion dhe unë do të shpreh vetëm disa prej shqetësimave të Grupit tonë Parlamentar sa i përket këtij institucioni.

Sikurse e dimë të gjithë ne, një kohë të gjatë është kërkuar nga shoqëria kosovare kosovarizimi i këtij institucionit dhe, për fat të mirë, më në fund ky institucion është kosovarizuar dhe tash më nuk mund të hedhim fajin te të tjerët për shkak të pengesave në të cilat po hasë dhe mund të hasë ky institucion në të ardhmen.

Në zgjedhjet e fundit, për fat të keq, ky institucion nuk ka dhënë prova që garanton zgjedhje të lira, të drejta dhe fer që plotësojnë standardet ndërkombëtare. Po përmend, që ky institucion, ky organizëm ka lejuar që të abuzohet me vullnetin e votuesit dhe për këtë do të japë dëshmi. Rreth 40 vendvotime në gjithë Kosovën janë shpall të pavlefshme, në të cilat kanë qenë mijëra vota të qytetarëve, të votuesve të Kosovës, që gjithsesi ka edhe do të ketë reflektim të përgjithshme edhe në skenën politike.

Ajo që vërehet te ky institucion, është trajnimi adekuat i anëtarëve të këshillave të vend votimeve, në të kaluarën po flas gjithnjë. Problemi me lista zgjedhore dhe ne të gjithë e dimë që në listat zgjedhore ka me qindra e qindra njerëz të cilët ose nuk janë më në mesin e gjallëve, ose lista në të cilat figurojnë qytetarët e Kosovës me vendbanim jashtë, e që

edhe për kundër faktit që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje, pranë emrave të tyre figurojnë nënshkrimet që kanë marrë pjesë në votime.

Për fat të mirë, po them, ky institucion është kosovarizuar dhe në fund të vitit të kaluar kem pasur kompletimin e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve dhe gjithnjë patëm shpresuar dhe patëm besuar që, më në fund, ky institucion do të arrijë të kryejë punën e vet, por me veprimin e dy anëtarëve të Partisë Demokratike të Kosovës ky organizëm është bllokuar për disa muaj dhe pastaj ka pësuar edhe dorëheqja e kryetarit të komisionit.

KQZ duhet të jetë i gatshëm në çdo moment që të organizojë zgjedhje të lira, e për fat të keq, ne e ndajmë shqetësimin se ky organizëm nuk do të jetë i aftë, nuk do të jetë i gatshëm me këtë potencial që ka, që të garantojë mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të drejta edhe në nëntor të këtij viti.

Ajo që është më shqetësuese, që është pranuar edhe nga vetë udhëheqësit e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve, është ndërhyrja e politikës në institucion të pavarur, siç është KQZ-ja. Ky institucion as sot e kësaj dite nuk po mund të largohet nga ndikimi politik dhe ju e dini që kryesisht ndikimin politik në këtë institucion e kanë dy subjektit më të mëdha në Kosovës, ato që sot janë koalicion qeverisës, të cilat kanë nga dy anëtarë në Komisionin Qendorr të Zgjedhjeve.

Raporti i takon vitit 2008. Unë nuk do të hyja këtu në çështjet te financat, por vetëm do të tërheq vëmendjen në një çështje. E keni që në disa prej takimeve që Komisioni ka organizuar jashtë ose takime të punës me mjete të buxhetit të Kosovës, këto aktivitete janë zhvilluar jashtë Kosovës, që është në kundërshtim me Ligjin për financat në Kosovë.

Gjithsesi, duke qenë një njohës relativisht i mirë i çështjeve të brendshme të Komisionit Qendorr Zgjedhor, edhe një herë e shfaq shqetësimin edhe të Grupit Parlamentar dhe të subjektit politik të cilit i takoj, në aftësinë e këtij organi për të organizuar zgjedhje të drejta, të lira dhe fer në Kosovë, edhe pse të gjithë ne e kemi gojën plotë që nuk ka nevojë ky institucion ose nuk ka nevojë që në Kosovë të kemi bashkë hisenikë të tjera në organizimin e zgjedhjeve.

Uroj që ky organizëm, ky institucion i pavarur në Kosovë, të kryejë detyrimet e veta kushtetuese, ashtu çfarë i ka me Kushtetutë dhe me ligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të LDD-së, deputeti Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën.

**ADEM SALIHAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke marrë parasysh se po ndodhin shumë çrregullime këtu në Kuvend dhe ne nuk po mund ta themi me kohën fjalën tonë, unë e paraqes edhe kundërshtimin e LDD-së për mënyrën si udhëhiqet Kuvendi dhe për mënyrën se si Qeveria...

**KRYETARI:** Po, ju lutem, ju po keni të drejtë të dilni jashtë rendit të ditës, prandaj edhe Kryeministri ka dalë jashtë rendit të ditës.

**ADEM SALIHAJ:** Kryetar, s'ka qenë ajo pikë në rend të ditës, s'ka qenë, ne e kemi kaluar atë pikë.

KRYETARI: Jo, ju lutem, unë po kërkoj vazhdimisht, mos dilni prej rendit të ditës. Kur dikush po del, po kritikoni, tani po dilni vetë. Qe dy deputetë po dalin jashtë rendit të ditës, rendin e ditës e kemi - Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

ADEM SALIHAJ: Kryetar t'i ia dhe atij fjalën, ne nuk mundëm të flasim.

KRYETARI: Po mirë, edhe ty po ta lë fjalën edhe e keni marrë fjalën 500 herë pa rendite të debatoni.

ADEM SALIHAJ: Të lutem, Kryetar, nuk është në rregull jashtë pikës së rendit të ditës të kthehemë edhe njëherë tash në pikën e parë. Po, ti s'na dhe fjalën atëherë, qysh të mos kthehemë tash.

Të lutem Kryetar,  
Unë paraqes kundërshtimin e LDD-së, tash do të flas për Raportin e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Ne e dimë se edhe këtë komision e kanë përcjellë probleme të mëdha, e kanë përcjellë mungesa e kompletimit të komisionit nga anëtari PDK-së, mungesa e kryeshefit për një kohë të gjatë dhe për një kohë edhe mungesa e kryetarit të KQZ-së. Megjithatë, në Komision kemi vërejtur se kanë kryer punë me rëndësi, që janë të rëndësishme për procesin zgjedhor që na pret, por vërejmë edhe disa çështje që na shqetësojnë.

Po e zëmë, KQZ në vend që të mbajë mbledhje, ka objektin e vet, në të cilin punon, shkon dhe mban mbledhje pune në Ohër ose Strugë dhe krijon shpenzime krejt të panevojshme, krijon mëditje e tjera e tjera për udhëtime jashtë, të cilat kapin një vlerë prej 31.804 euro, që na duken krejt të palogjikshme dhe mendojmë që s'janë në rregull këtu në aspektin financiar.

Po ashtu, ka shpenzime, përveç mëditjeve 31.804, ka shpenzime të udhëtimit, 11.110 euro, ka shpenzime të udhëtimit brenda dhe ka edhe mëditje brenda Kosovës, që është krejt e çuditshme, sepse ne udhëtojmë përditë, vizitojmë institucionë të ndryshme dhe s'ka asnjë lloj mëditjesh, ne e kryejmë punën tonë brenda orarit të punës, kurse këtu shohim që ka institucionë tjera që marrin mëditje edhe brenda Kosovës.

Pastaj, te shpenzimet komunale vërehet diçka e çuditshme, janë paraqitur 14.278 euro shpenzime komunale, që është krejt e pabesueshme një shumë kaq e madhe të jetë aty.

Po ashtu, edhe shpenzimet e PTK-së, pra jashtë fushatave mediale që bën KQZ-ja, jashtë reklamave tjera, e tjera, janë 7.722 euro shpenzime të PTK-së.

Përveç kësaj, shihet që për objektin që e shfrytëzon KQZ-ja paguan edhe një qira mjaft të madhe, pra 31.804 euro i ka paguar për vitin 2008.

Ajo që ne na ka interesuar më së shumti, ka qenë çështja e përgatitjeve që po bën KQZ-ja për zgjedhjet që i kemi para nesh dhe në këtë kuptim i kemi bërë shumë pyetje. Gjatë këtij viti ende nuk kanë qenë përgatitjet në atë nivel për arsyen se nuk kanë qenë të shpallura zgjedhjet dhe ne kemi kërkuar që KQZ t'i bëjë një raport tjetër të veçantë Komisionit dhe Parlamentit për përgatitjet që po i bën për zgjedhjet që i kemi në nëntor dhe të shohim se vërtet a është KQZ-ja e përgatitur që t'i organizojë me sukses këto zgjedhje.

Ne e dimë që në zgjedhjet e kaluara kishte shumë probleme me lista zgjedhore, shumë njerëz nuk e kanë gjetur veten aty dhe lista zgjedhore janë të papastruara për arsyen e thjeshtë se shumë njerëz që kanë vdekur, nuk janë hequr prej listave dhe emrat e tyre përdoren shpeshherë për t'i manipuluar votat në vendvotime të caktuara.

Po ashtu, ne kemi kërkuar që të sigurohet një transparencë e mirë për procesin zgjedhor, kemi një kërkësë se a ka mundësi të instalohen kamerat në vendvotime dhe përgjigja ka qenë që deri më sot askush nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Si duket, KQZ-ja nuk është shumë në rrjedhë as të debateve, të diskutimeve që bëhen dhe ndoshta do të ishte mirë që edhe Parlamenti ose një institucion kompetent të bëjë një kërkësë që ta bëjmë edhe ne atë që e bëjnë në shumë vende të zhvilluara, që të kemi një siguri më të madhe në procesin zgjedhor.

Ne e dimë se në zgjedhjet e kaluara janë filmuar me kamera vjedhjet e votave, manipulimet e votave në vendvotime e tjera, ka qenë një proces mjaft i komprometuar dhe shpresojmë që ky komision do t'i bëjë të gjitha përgatitjet e duhura që kjo të mos përsëritet në procesin zgjedhor që është para nesh. Ju faleminderit!

KRYETARI: në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka kërkuar fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala gospodine predsedničë!

Hvala i pozdrav zameniku premijera i ministrima,  
Kolegama,

Mislim da raspravljamo jedan izveštaj koji je dosta osteljiv, ali čiju važnost ne možemo da pretpostavimo ako uzmemos iskustva nekih zemalja, recimo u okruženju, evo najnoviji slučaj izbora u Albaniji, kada i evo koliko vremena nakon izbora, nisu revidirani rezultati. Da se ne bi desile neke stvari po nas neželjene, mi moramo ranije da ih pripremamo, razgovaramo, dogovaramo i tako dalje, tako da je rad Centralne izborne Komisije jedno veoma, ja bih rekao jedan proces veoma značajan, veoma važan, gde se polaže ispit, gde se daje objektivnost i tako dalje, i tako dalje.

Mi do sada nismo imali mnogo problema u izborima. Organizovali su ih OESC, šta ja znam, međunarodni predstavnici, naše domaći, dakle organi, poput naše Centralne izborne komisije, i tako dalje. No, da bismo predupredili neke stvari, da se ne bi ponovile neke greške koje se dešavaju, prvo članovi Centralne izborne komisije naše, dakle kosovske, obilazili su izbore u Bosni i Hercegovini, Makedoniji, Albaniji i imaju još neka druga iskustva i možda bi trebali upravo rukovodjeni tim iskustvima, više da odrade neke stvari kako se ne bi ponovile, mislim kako se ne bi desile neke greške.

Drugo, vrlo je važan proces revidiranja biračkih spiskova, kako god jedan deo stanovnika starih, nestaje, na isti način jedan deo stanovnika stiče punoletstvo, tako da to ne bude, mislim to je vrlo važan proces, treba na vreme da obaveštavamo, da pomognemo. Ako to ostaje samo na savest gradjana, sigurno će ići sporo, pa će broj birača biti mnogi manje nego što je predvidjen i biračko pravo nekima zakinuto.

Ja bih se takodje zadržao na problem glasanja u inostranstvo. Kosovo kao država ima ogroman broj stanovnika koji se privremeno nalaze na prostorima bivše Jugoslacije, ali mnogo više u zemljama Zapadne, Srednje, Severne Evrope i tako dalje i tako dalje. Mislim da je dosadašnji proces procedure glasanja naših gradjana u inostranstvo bio dosta komplikovan i ljudi nisu mogli da se odazovu. Ako uzmete samo iskustva

prethodnih izbora, videćete da je procenat izlazaka birača naših u inistranstvo vrlo mali i simboličan. Ja ču reći iz ugle moje zajednice da preko 40% predstavnika moje zajednice nalaze se u inostranstvo, a tek 1% ima valjane recimo biračke, odnosno rezultate sa biračkih izbora. Što znači da sada imamo već neka dipolomatska predstavništva u nekim od zemalja, i sada umesto jednog centra koji je bio OESC u Beču, mi treba da koristimo naša diplomatska predstavništva, ambasade i tako dalje, za objašnjavanje, za slanje materijala na vreme i uvjek da bude to više jezično, dakle na našim službenim jezicima i da postoje dežurni telefoni gde će ljudi da prhvate informacije, korekcije neke i tako dalje, i tako dalje.

Ja se slažem sa kolegom Salihajem da je bilo troškova koji su napravljeni malo veći možda na nekim seminarima, koji su mogle da se održe na Kosovu, a održani su negde van i tako dalje i tako dalje, to je neko drugo pitanje. Ali bih rekao da takodje posvetimo dosta pažnje objektivnoj predizbornoj kampanji, gde čemo u medijama imati pravo, mislim na jednako pravo na svim medijama i tako dalje, i tako dalje. Kada je u pitanju lista potvrđenih političkih partija koja nam je priložena, ja imam primedbe tako što su neke partie čiste nacionalne, recimo tamo im je stavljeno kao da imaju rezervisana mjesta iz dveju zajednica. Recimo, postoji tamo Demokratska stranka bošnjaka, stoji lepo b/g, što znači da ona aplicira na pobšnjačko i na goransko mjesto. Kako to može? Ne može jedna partija da aplicira na dva nacionalna mjeseta, molim vas. Tu zabludu moramo da uklonimo, ili imamo Gradjanska inicijativa Gore, bošnjačko odnosno goransko mesto. To ne može, to mora da se pročisti, pogotovo kada su rezervisana mjeseta. Ne mogu rezervisana mjesata neko sa njima da se igra pa da danas na neki način zloupotrebito, time što čemo prijaviti partiju za onu ili za ovu zajedicu. Vrlo je jasan program određenih partija i treba Centralna izborna komisija vlo odgovorno i ozbiljno da se bavi ovim stvarima.

Ja bih imao još toga, ali ovoga puta treba da prepustimo reč i drugima. Hvala, vam!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, a e don dikush fjalën? Sllobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala gospodine predsedniče,  
Ono što želim da kažem da je Samostalna liberalna stranka, odnosno Poslanička grupa Samostalna liberalna strana razradivala izveštaj Centralne izborne komisije i sigurno preporuku skupštinske komisije i Poslenički klub Samostalne liberalne strane u načelu će podržati ovaj izveštaj. Međutim, želim da izrazim svoju zabrinutost pre svega zbog zajedničkog iskustva koje imamo kad je u pitanju Centrana izborna komisija, jer na prošlim parlamentarnim izborima smo imali punu zamerki na organizaciju, čak šta više, imali smo neke predstavnike koji su bili u organizaciji izbora, koji su radili na bojkotu izbora, pre svega unutar... Kad je u pitanju srpska zajednica, ono što želim da izrazim kao svoju zabrinutost, jeste da Centralna izborna komisija možda neće imati kapaciteta da samostalno sproveđe lokalne izbore koje su ispred nas, a to ču pre svega da potkreplim jednom činjinicom koja je najsvežija upravo izjavom portparola Centralne izborne komisije, koji je izneo izformaciju, možda grubo rečeno, ali jednu lažnu informaciju, pre svega o učešću političkih partija iz Srpske zajednice i to je dosta nanelo štete ne samo učesnicima potencijalnim, nego i potencijalnim glasačima iz Srpske zajednice, ono što jeste naša namera, kao i namera ove institucije, mislim presvega na ovaj dom koji se zove Skupština, da smo pre svega zagovornici izbora zbog građana, a ne zbog samog procesa. Iz tog razloga kažem da delim zabrinutost svih onih koji su ovde izneli da će upravo ta Centralna izborna komisija, koju smo ... rečeno mi ovde glasali, neće imati dovoljno kapaciteta za tako nešto. Ono što želim da kažem za ovom govornicom, jeste da mi ispred

svoje Poslaničke grupe ulažemo protest na ime Centralne izborne komisije upravo zbog takvih nekih izjava koje ne idu u prilog niti onima koji se prijavljuju za glasanje, znači političkim subjektima, niti onima koji trebaju da glasaju.

Još jednom želim da kažem da smo mi kao Poslanička grupa uzeli u obzir i izveštaj i preporuku skupštinske komisije i u načelu ćemo podržati ovaj izveštaj, uz ono što sam rekao kao našu zabrinutost. Hvala!

**KRYETARI:** Faleminderit! Diskutuesja e fundit është deputetja Edita Tahiri.

**EDITA TAHIRI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke iu bashkuar vlerësimëve të kolegëve për punën e KQZ-së në periudhën 2008, si dhe duke i dhënë mbështetje këtij raporti, unë desha të them që ky komision në fakt ka lënë disa punë të pakryera dhe një prej tyre është që nuk e ka nxjerrë një raport për rezultatet e zgjedhjeve sipas njësive zgjedhore. Ai ka dhënë një raport të rezultateve globale, mirëpo unë këtë që po e kërkoj është i rëndësishëm për të gjitha subjektet politike, sepse përmes atij raporti do të jenë në gjendje të shohin se si kanë kaluar nëpër njësitë zgjedhore dhe, natyrish, në bazë të tyre të bëjnë analizat e duhura dhe të përgatiten më mirë për zgjedhjet e ardhshme që i kemi.

Po ashtu, dua të them se pavarësimi i KQZ-së sigurisht që e vë KQZ-në autentike para sfidave të reja dhe të shumta dhe mendoj se ky organ duhet të ndihmohet si për kah kapacitetet, por edhe në forma të tjera, në mënyrë që të marrë përvoja nga vendet që kanë përvjetorë në demokracitë në tranzicion, për të ngritur sigurisht edhe aftësitë e veta, edhe përgjegjësinë e vetë përballë këtij procesi. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Si e kemi punën me numrin e deputetëve në sallë.

Deputetët që janë duke pirë kafe, le të kthehen për votim! Me qenë se mund të hymë në procesin e votimit, kemi 64 deputetë. Mursel Halilaj, merre fjalën kësaj herë, por tjera herë kur them deputeti i fundit, ma s'pranoj.

**MURSELJ HALJILJI:** Gospodine predsedniče, ja se izvinjavam! Ali sam mislio da është dobiti reç obzirom da nisam znao redosled javljanja. Moram da se javim obzirom da sam jedno vreme bio i član Centralne izborne komisije pa znam kako funksioniše Centralna izborna komisija. Brzo është, neçu dugo da...

Obzirom da postoji zakonska infrastruktura za organizaciju i funksionisanje Centralne izborne komisije, imam jednu primedbu, recimo, citiram: „Naročito četri člana koji drže rezervisana i garantovana mesta koja predstavljaju najveće veçinske zajednice na Kosovu“. Od 8 do 11, znači članova CIK-a, to su ta četri rezervisana mesta, ali se ovde spomenjuju političke partije, pa se dešava da Vakat ima svog člana i nonstop është ga imati, mi smo rekli da treba da se depolitizuje Centralna izborna komisija obzirom da je to nezavisna institucija. Takav slučaj se dogodio i sa gospodom Nekibe Karahoda, koja je bila predsednik Turske partije, pa se dogodilo da je zamenjena, mislim da je na nezakonit način to urađeno, ako smatramo da je to van politička institucija i nezavisna, mislim da ne bi trebalo učešće političkih partija da se uzme u ovome svemu.

Ne bi da dužim, samo ovo što je gospodin Džezair Murati rekao, ja se slažem kod liste registrovanja političkih partija da treba da budu jasno odvojena mesta i da se ne mešaju rezervisana mesta dveju različitih zajednica, recimo Bošnačke i Goranske, koje nemaju jedna s drugom veze, razumete.

Toliko sam imao, ja se izvinjavam možda je malo oduženo. Još jednom, hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 8 vota “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2008.

Vazhdojmë pikën e radhës.

Po vazhdojmë edhe një pikë, të tjerat i lëmë për nesër.

Deputetët duhet të jenë të gatshëm edhe të shtunën edhe të dielën të puojnë për komb dhe atdhe.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit të Punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitën dhe Rregulloren e Punës ka shqyrtuar raportin e punës së Institut Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të Punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Bahri Hyseni, që ta marrë fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar me vëmendje Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, institut i cili vepron duke u bazuar në Ligjin mbi themelin e Institutit Gjyqësor, të datës 23 shkurt 2006, që është i vetmi autoritet i cili kryen të gjitha trajnimet në organet e sistemit të drejtësisë.

Me rastin e shqyrtimit të Raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës, Komisioni me datën 27 prill ka konstatuar se raporti të cilin e ka afruar Institutit Gjyqësor i Kosovës nuk ishte me përbajtje të plotë dhe ka kërkuar raport shtesë nga Institutit Gjyqësor i Kosovës.

Pas marrjes së raportit shtesë, që ka të bëjë me çështjen e Këshillit Drejtues, Këshillit Programor të Institutit, përbërjes së Këshillit Drejtues, trajnuesve të përkohshëm dhe trajnuesve të përhershëm, komisioni ka shqyrtuar raportin dhe konsideron që raporti në fjalë me disa rekomandime që do të dalin nga Kuvendi sot, të aprovohet.

Vlen të përmendet se në kohën për të cilën po debatojmë sot, Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës nuk funksionon për shkak se disa anëtarëve të Institutit Gjyqësor të Kosovës ju ka kaluar mandati. Edhe pse drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës ka bërë propozim në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi brenda afatit të paraparë ligjor që

të vazhdohet afati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të këtij institucioni, propozimet nuk kanë qenë konform ligjit që sot është në fuqi.

Duke marrë parasysh se institucionet të cilat kanë qenë dashur të rekomandojnë kandidatët për anëtarë të Institutit Gjyqësor të Kosovës nuk kanë rekomanuar asnjë nga radhët e minoriteteve, obligim ligjor i cili është paraparë me ligj, dhe për këtë arsy ne nuk kemi pasur mundësi që të pranojmë rekomandimin për përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Vlen të përmendet se çështje më e diskutueshme në komision për Institutin Gjyqësor të Kosovës ka qenë çështja se kush janë trajnuesit e përkohshëm dhe të përhershëm në Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Nga raporti shohim se në Institutin Gjyqësor të Kosovës sot kemi trajnues të përhershëm, të cilët janë të punësuar dhe punojnë në bazë të pagave që marrin nga Institutit dhe trajnues të përkohshëm, të cilët vinë nga fushat e ndryshme, qoftë nga gjykatat, nga prokuroria, apo edhe nga lëmitë me interes apo me eksperiencë të kandidatëve të ndryshëm në lëmin e çështjeve gjyqësore.

Mirëpo, çështja ka qenë diskutuese, meqë të gjitha trajnimet në Institutin Gjyqësor të Kosovës bëhen gjatë orarit ose ditëve të punës. Ne kemi ngritur si shqetësim, si është e mundur që organet e drejtësisë, me gjithë këtë joefikasitet të punës që ka gjyqësori, kanë kohë që prokurorët dhe gjyqtarët gjatë kohës apo gjatë ditëve të punës mbajnë trajnime në Institutin Gjyqësor të Kosovës. Kjo ka qenë çështja më e diskutueshme për të cilën kemi rekomanuar që në të ardhmen duhet të shikohet mënyra e organizimit të trajnimeve në Institut, sepse edhe kështu organet e drejtësisë janë joefikase, me qindra lëndë presin për zgjidhje, kurse kur është çështja e trajnimeve, në Institut, të gjithë prokurorët, të gjithë gjyqtarët që përcaktohen të shkojnë në trajnim, nuk e humbin asnjë ditë, sepse gjatë kësaj dite marrin mëditje të caktuara nga Institutit, por e lënë punën prioritare që e kanë nëpër prokurori dhe gjykata.

Vlen të përmendet që ligji me të cilën po veprohet, është mjaft i paqartë dhe duhet urgjentisht të fillohet plotësimi dhe ndryshimi i ligjit ekzistues, sepse institucionet të cilat rekomandojnë kandidatët për këshillin drejtues, nuk e kanë të qartë se cili institucion është obligativ të rekomandojë kandidatët nga radhët e minoriteteve dhe kjo arsy është pengesë që sot nuk e kemi aktualisht Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, si organ i cili është përgjegjës për funksionimin e punës së institutit, që është pengesë serioze edhe përfundimtina e punës së institacioneve që i përmenda më parë, të organeve të drejtësisë, por edhe për punë të tjera për shkak të organizimit të trajnimeve të ndryshme, për shkak të provimit pranues për gjyqtarë e kështu me radhë.

Çështje diskutabile ka qenë edhe çështja e buxhetit, cili organ e aprovon, sa marrin mëditje këta njerëz të cilët trajnojnë, sidomos prokurorët dhe gjyqtarët, dhe a është konflikt interesit që këta të lënë punën brenda orarit të punës dhe të marrin mëditje në institucionin ku po flasim? Natyrisht që po.

Vlen të përmendet edhe një punë shumë e mirë që e ka bërë instituti, ju e dini para 3 – 4 ditëve instituti ka shpall rezultatet për provimin pranues për gjyqtarë të rinj dhe prokurorë, të cilin e ka kryer me shumë sukses dhe ju e dini që reforma po thuaj me përfundim të këtij raporti, ka përfunduar dhe është bërë një punë shumë e mirë nga instituti, sepse e dini që me datën 14 janë shpallur rezultatet dhe do të kenë mundësinë që të gjithë njerëzit të cilët e kanë pasur provimin e jurisprudencës, por edhe ata që s'e kanë

pasur, që e kanë kaluar provimin e etikës, e kanë kaluar provimin për gjyqtarë, që në të ardhmen do të kenë mundësi të punojnë për organet e drejtësisë, qoftë për gjykatat, qoftë për prokurorinë.

Duke pasur parasysh disa vërejtje që i kemi bërë në komision dhe vërejtjet që i bëmë edhe tani, konsiderojmë që raporti duhet të aprovohet dhe shpresoj që këtë mendim e kanë edhe deputetët. Mirëpo, kisha për t'i thënë edhe 2 – 3 fjalë vetëm në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, se edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah reportin në fjalë dhe kërkon nga deputetët që ta aprovojmë reportin me rekomandimet e përmendura. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrta Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe duke u bazuar në nenin 1 pika 8 e Ligjit 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, ky si institucion i pavarur vepron në bashkëpunim edhe me Këshillin Gjyqësor Prokurorial të Kosovës ose ... trashëgojnë përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për arsimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës.

Pa i përsëritur vërejtjet që i tha kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, sidomos për trajnuesit e përhershëm dhe të përkohshëm, të cilat kryekëput kanë konflikt interes i ajo është ngritur edhe në komisionin funksional, por edhe në grupin parlamentar. Ne mendojmë që ligji është më se i nevojshëm të ndryshohet dhe të plotësohet.

Unë do ta marrë vetëm një shembull, ku një anëtar i Këshillit Drejtues, për shembull, duhet të propozohet nga UNMIK-u dhe kjo bie direkt ndesh edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj kjo ka qenë ndoshta edhe një ndër arsyet pse propozimet janë kthyer nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, jo vetëm me faktin që kanë munguar nga një anëtar i komuniteteve, por edhe me faktin se neve na kanë ardhur aty propozime edhe me moshën 68 vjeçare.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrahë reportin me këto plotësime të kërkua dëshira ne kërkohjmë edhe njëherë nga Institutit Gjyqësor i Kosovës që të marrë iniciativën për ndryshimin dhe plotësim e këtij ligji dhe t'i përbahet konform ligjeve dhe dispozitave tjera të aplikueshme në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të AAK-së, nuk ka.

Në emër të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

**IBRAHIM MAKOLLI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrta Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor. Nuk do të doja që të them ndoshta më tepër se ato që u paraqitën nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, megjithatë dua të përmend vetëm dy çështje që do të duhej të jenë në vëmendjen e këtij organi, pra të Kuvendit.

Këshilli drejtues i këtij institucioni është jofunksional tash e një muaj për shkak se 6 anëtarëve të këshillit drejtues iu ka skaduar mandati dhe tash aktualisht instituti nuk ka

këshill drejtues, do të thotë, vepron në kundërshtim me ligjin dhe kjo praktikë vazhdon edhe në disa prej institucioneve shumë të rëndësishme të tjera të vendit.

Pajtohem plotësisht, sepse këtë e kemi diskutuar edhe në Komisionin për Legjislacion për nevojën e ngutshme që Kuvendi i Kosovës të bëjë ndryshimin ose edhe institucionet e tjera që mund të bëjnë inicim të ndryshimit të ligjit...

**KRYETARI:** Të nderuar deputetë, gjatë kohës së seancës mos lëvizni nga vendi në vend. Vazhdo!

**IBRAHIM MAKOLLI:** ...që në afatin sa më të shpejtë kohor të miratohet ose të nxirret Ligji për Institutin Gjyqësor të Kosovës. Natyrisht, raportet janë të kaluara tashmë, ne e përkrahim këtë raport me të gjitha vërejtjet që u dhanë dhe sugjerimi ynë është që institucionet e tillë, që janë shumë të nevojshme, shumë të domosdoshme përfunksionimin e drejtë dhe të mirë të institucioneve të drejtësisë, të përkrahen nga të gjitha institucionet, e në veçanti nga Kuvendi i Kosovës. faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, edhe prej teje!  
Në emër të LDD-së, Adem Salihaj e ka fjalën.

**ADEM SALIHAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë raport. Vërejtjet tona kryesisht i tha kryetari i Komisionit për Legjislacion. Ne kemi marrë pjesë aktive në debat në komision. Çështjet që u shtruan këtu janë reale dhe mendojmë që kanë vend të diskutohen në organet kompetente, veçanërisht çështja e trajnimit të gjykatësve dhe të prokurorëve, të cilët nga 2 – 3 ditë pune në javë nuk janë në vendet e tyre të punës, janë në trajnime, në trajnime paguhën, kurse paguhën e marrin edhe pagën e plotë edhe në vendin e punës, e në anën tjetër nuk kanë qenë aty që ta kryejnë punën e tyre si gjykatës dhe prokurorë.

Kemi vërejtur edhe një dukuri që këshilli drejtues ka caktuar trajnues nga radhët e këshillit drejtues, që nuk ishte në rregull, sepse ata në një farë mënyre kanë shfrytëzuar ose keqpërdorur pozitën e tyre përfituar edhe në aspektin material si trajnues e tjera, dhe përkrahim këtë ia kemi tërhequr vërejtjen edhe personit përgjegjës që ishte rapportues në komision.

U tha që ka probleme në çështjen e emërimit të anëtarëve të këshillit drejtues, ka ardhur një propozim, e propozimet që komisioni i ka vlerësuar si joadekuatë dhe i ka kthyer me rekomandim që të vinë propozimet që do të ishin adekuatë dhe që do ta krijonin një mundësi që Institutit Gjyqësor i Kosovës të jetë i aftë, ta japë kontributin e tij në çështjen e reformimit të sistemin gjyqësor të Kosovës, i cili, siç e dimë, nuk është në nivelin e duhur dhe nuk mund ta kryejë me sukses punën e tij.

Me disa vërejtje që i dhamë dhe me rekomandimet e komisionit, ne do ta përkrahim këtë raport. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!  
Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati, e ka fjalën.

**DŽEZAIR MURATI:** Hvala vam predsedničë!

I mi se predružujemo šefovima parlamentarnih grupa oko iznošenja primedaba koje su ovde iznete, propusta koji su napravljeni, sumnji da oni pripadaju ovom i onom subjektu i

tako dalje, ali je činjenica da smo dobili obečanje od predstavnika institucija da će predstavnici manjinskih zajednica koji ne dostaju u ovom institut, biti popunjeni u međuvremenu. Mi, normalno tražimo da se ove naše primedbe uvaže, što smo i u Komisiji primetili i ovde danas iznosimo i mi takođe u principu prihvatom ovaj izveštaj, ali samo uz uslov kako bi se propusti koji postoje u međuvremenu ispravili i dopunili. Hvala vam, faleminderit!

KRYETARI: në emër të Grupit Parlamentar SLS, Murselj Haljilji e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala!

Gospodine predsedniče, i Parlamentarna grupa SLS će podržati primedbe i preporuke Komisije za zakonodavstvo i u načelu čemo podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti që e merr fjalën, i fundit është Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, Kryetar!

Unë pajtohem me atë që tha shefi i grupit për legjislacion, por unë kisha dashur që një institucion i rëndësishëm, siç është Këshilli Gjyqësor, të paktën që disa kohë kemi pasur punën e tyre, angazhimet e tyre, le të jenë jo të mjaftueshme ose që u përmendën këtu me ato vërejtjet. Unë kisha kërkuar që të paktën të miratohet ligji dhe të bëhet një reformë në Këshillin Gjyqësor, që disave iu ka kaluar afati, mandati, mosha, të paktën ta kemi një gjeneratë më të re që do të jetë më e angazhuar, pikërisht për iniciativa dhe punë më të mirë të institutit.

Unë nuk dua t'ju marrë kohë më shumë, se edhe janë lodhur, po e shoh, por megjithatë reforma në Këshillin e Institutit është e nevojshme. Nëse e bëjmë këtë, kemi bë dhe pastrimin e gjithë atyre që e kanë tejkaluar kohën, sepse reformat janë të nevojshme pikërisht në këtë institut, që të kemi një gjyqësi dhe një ligjësi të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Në vazhdim, do të thotë, kemi deklarimin me votë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

73 deputetë janë në sallë.

Konstatoj se me 58 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e Punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008.

Të nderuar deputetë,

Para se ta marrim vendimin se kur po e mbajmë pjesën tjetër të seancës, kisha kërkuar edhe një herë nga gjithë deputetët që angazhohen në debat kur është një pikë e rendit të ditës mos të flasin për pika tjera të rendit të ditës dhe nëse e respektojnë deputetët do të respektojnë të gjithë, mendoj kjo duhet të jetë një vërejtje.

Megjithatë unë dua të them se Kryeministri e ka shfrytëzuar rregullën 28 të Rregullores së Punës që ministrat, natyrisht edhe Kryeministri kanë të drejtë të ngrisin çështje në çdo kohë në seancë. Lexoni rregullën 28 të Rregullores së Punës së Kuvendit, edhe pse unë s'kam qenë dakord me zhvillimin e sotshme, por vërtetë nga rendi i ditës kanë dalë edhe deputetët.

Do të thotë, vazhdimi i seancës është të hënën, në ora 10,00, a jeni dakord, a ka kundër? Faleminderit!

\*\*\*

Vazhdimi i seancës, e hënë, 20. 07.2009., ora 10:00  
Seancën drejton zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Në sallë janë 43 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë debatit.

Pika e shtatë e seancës, në vazhdim:

- **Debat lidhur me gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës, sipas kërkesës së një grupi të deputetëve**

Grupi prej shtatë deputetësh, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, që në seancë plenare të debatohet për gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës.

Kryesia e Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, e ka proceduar kërkesën e grupit të deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e grupit të deputetëve, Arsim Rexhepin, si propozues për të debatuar për çështjen e Radiotelevizionit të Kosovës.

Deputet, Arsim, e ke fjalën.

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,  
Në bazë të Rregullës 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ne i kemi propozuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që në këtë seancë të radhisë këtë debat për gjendjen aktuale në Radiotelevizionin e Kosovës.

Radiotelevizioni i Kosovës është themeluar mbi bazën e nevojës së patjetërsueshme të popullit të Kosovës për një televizion publik. Ai është ngritur me shumë vështirësi duke u rritur dita-ditës, nga donacionet e jashtme, nga buxheti vendor dhe nga taksat e detyrueshme për çdo amvisëri. Është ngritur me qëllim që t'i shërbejë informimit të popullit dhe ngritjes së jetës kulturore dhe arsimore të tij.

Por, të dhënat dhe diskutimet konkrete të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Media të Kuvendit të Kosovës, të mbështetura në dy raportet e fundit financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, raportit për vitin 2007 dhe atij për vitin 2008, kanë konstatuar shkelje të shumta dhe flagrante të Ligjit për prokurimin dhe të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Në këto përfundime të komisioneve të lartpërmendura del se Radiotelevizioni i Kosovës posedon me gjashtë llogari bankare, duke shkelur kështu të tèrin Ligjin për financat publike. Kjo shumësi llogarish bankare të Radiotelevizionit të Kosovës, siç pasqyrohet edhe nga diskutimet në Parlament, është bërë me një dhe të vetmin qëllim, ikjen e transaksioneve bankare nga mënyra e rregullt përmes Thesarit dhe fshehjen dhe manipulimin e tyre.

Po ashtu, mbi bazën e raporteve të ofruara nga Radiotelevizioni i Kosovës, që zuri vend në Kuvend dhe në komisionet përkatëse, rezultoi një konstatim empirik se Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës është bord që vepron jashtë Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, të cilit i ka skaduar mandati tash e tre vjet.

Po ashtu, duhet ripërmendur me këtë rast edhe faktin se edhe mandati i drejtorit të tashëm menaxhues ka skaduar tash e tre vjet. Kjo do të thotë se të dy këto instanca të Radiotelevizionit, bordi dhe drejtori i përgjithshëm, janë të kundërligjshme në vendet ku veprojnë. Në Radiotelevizionin e Kosovës, përkundër Ligjit për RTK-në janë të punësuar në marrëdhënie pune ose të angazhuar më se 240 individë me të ashtuquajturën kontratë mbi vepër, të cilëve u zgjatet kontrata më shumë se një vit, përkundër përkufizimit ligjor që lejon maksimumin tre muaj për një kontratë të tillë.

Njëkohësisht, RTK ka një kontratë me Universitetin privat AAB për shkollimin dhe aftësimin e stafit të Radiotelevizionit të Kosovës. Kjo kontratë, përveç që është e pavend dhe antiligjore, sepse është bërë pa tender dhe pa respektuar asnjë normë ligjore, ka dëmtuar rënd edhe interesat shoqërore, sepse një marrëveshje e tillë ka pasur mundësi të bëhej me Universitetin Publik dhe, vetëkuptohet, të kushtojë më pak për këtë institucion.

Me këtë rast në AAB janë dërguar të aftësohen, madje edhe individë të punësuar në Radiotelevizionin e Kosovës, me të ashtuquajturën kontratë në vepër. Edhe me këtë rast s'do mend që është shkelur ligji dhe përdhosur ai.

Duke u bazuar në Ligjin për RTK-në, ku parashihet që Radiotelevizioni i Kosovës çdo vit duhet të shpallë tender për angazhimin e produksioneve private në vlerën 20% të buxhetit që ka në posedim, menaxhmenti i Radiotelevizionit të Kosovës ka shkelur Ligjin për RTK-në, duke mos shpallur tender dhe duke ia besuar vetëm produksionit SIEMPI dhe K1 përbushjen e këtij obligimi ligjor.

Ngjashëm, drejtori i produksionit të RTK-së Ergyn Dobërqani kontrakton me emër të RTK-së produksionin privat K1, pronë e vëllait të tij, Ekrem Dobërqani, gjë që paraqet shkelje flagrante të Ligjit për konflikt interesit. Për të mos u mjaftuar me kaq, në këto projekte të kontraktuara detyrohen të angazhohen punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës.

Duke përmendur edhe rastin e angazhimit të zotit Adi Krasta, moderator nga Tirana, të cilit për 6 emisione të realizuara, të moderuara në Radiotelevizionin e Kosovës, i janë paguar honorare marramendëse në shumën prej 26 mijë eurosh, pa hapur tender dhe, vetëkuptohet, duke shkelur Ligjin për prokurim dhe Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Të gjitha këto që u thanë dhe të tjerat që sigurisht do të thuhen nga debatet për këtë institucion, tregojnë katërçipërisht se Radiotelevizioni i Kosovës ka kompromentuar, ka degraduar misionin publik mbi bazë të cilit është themeluar, si dhe ka degjeneruar mandatin e dhënë përmes Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës nga ky Kuvend.

Si i tillë, ky institucion është shndërruar në një Radiotelevizion klientelist- të njëanshëm, korruptiv dhe i pabesuar, kështu që në gjendjen e tanishme, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ky institucion paraqet rrezik për shtetin dhe për demokracinë.

Tendencat e drejtorit të përgjithshëm të këtij institucioni për të minimizuar përmes storjesh të porositura problemet e mëdha në Radiotelevizionin e Kosovës, duke u përpjekur që me këtë rast të përdhosë punën e ndershme që bëhet në këtë Kuvend, se gjoja ky Kuvend paska punë më të rëndësishme se sa të debatojë për Radiotelevizionin e

Kosovës, doemos që tregojnë qartë mungesën e sensit, të përgjegjësisë dhe të llogaridhënieς.

Në kontekst të gjitha këtyre, mund të dyshojmë se lista e shkurtër e kandidatëve për anëtarë të Bordit të ri të RTK-së, e që është përpiluar në kohën e një menaxhmenti dhe bordi çfarë u tha më lartë, pra të jashtëligjshëm, është e influencuar, e diktuar dhe e klienteliste. Po ashtu, në këtë listë ka individë të involvuar në afera korruptive dhe me padi të hapura në gjyqe.

Andaj, ne deputetët e poshtëshënuar, kemi kërkuar këtë debat urgjent dhe i rekomandojmë këtij Kuvendi, sa vijon:

1. Shkarkimin urgjent të Bordit të menaxhmentit aktual, në krye me zotin Agim Zatriqi,
2. Krijimin urgjent të Komisionit Ad-Hoc Hetimor që do të hulumtonte dhe konstatonte gjendjen aktuale financiare dhe ligjore e profesionale në këtë institucion publik,
3. Emërimin e një menaxhmenti të përkohshëm që do të udhëhiqte këtë medium deri në përfundimin e hetimit për të,
4. Shpalljen e konkursit të ri për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe
5. Restaurimin e interesit publik dhe kthimin në misionin që kishte Radiotelevizioni i Kosovës, në shërbimin interesave të qytetarëve.

Personalisht falënderoj deputetët që kanë mbështetur këtë nismë, ndërsa dua të njoftoj këtë Kuvend, se ndërkohë, 44 deputetë të nderuar të këtij Kuvendi, kanë nënshkruar kërkesën për themelin e Komisionit Ad-Hoc Hetimor për Radiotelevizionin e Kosovës, gjë që në këtë rast janë përbushur të gjitha kushtet që kërkon Kushtetuta. Ju faleminderit!

#### KRYETARI: Faleminderit!

Para se t'ua jap fjalën shefave të grupeve parlamentare, dëshiroj t'ju përkujtoj që kërkesa e parë për shkarkimin emergjent të Bordit të menaxhimit aktual, në krye me Agim Zatriqin, nuk është kompetencë e Kuvendit. Pra, Kuvendi ka përgjegjësi ta zgjedhë Bordin për RTK-në dhe bordi pastaj bën zgjedhjen e drejtorit të ri.

Kërkesa për debat e grupit është e arsyeshme, kërkesa për krijimin e një komisioni ad-hoc për të hetuar gjendjen atje, është e arsyeshme. Të gjitha kërkesat e tjera nuk janë në përgjegjësinë dhe kompetencat e Kuvendit të Kosovës, prandaj i kisha lutar shefat e grupeve parlamentare që mos pajtohen me këto kërkesa. Pra, të pajtohen me debatin, të pajtohen me krijimin e Komisionit ad-hoc dhe të mos merret Kuvendi me përgjegjësitë që nuk na takojnë, as me ligj dhe as me Kushtetutë. Sepse, ne një mënyrë, po të veprohet kështu siç është bërë kjo kërkesë, ne ndërhyjmë drejtpërdrejti në mediat dhe e drejta e Kuvendit nuk është për të ndërhyrë në politikën dhe zgjedhjen e menaxhmentit ekzekutiv të Radiotelevizionit të Kosovës.

Fjalën ia jap shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetit Ramë Buja.

**RAMË BUJA:** I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar Kabinet qeveritar, aq sa jeni,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit, më gjerësish do të flas dhe do të jap më shumë sqarime, Lumë Haxhiu, por unë dua të them veç atë që, në fakt, e tha edhe Kryetari i Kuvendit, se cila

është detyra jonë si Kuvend. Ne mund të kërkojmë llogari vetëm nga ai institucion që e kemi zgjedhur dhe jo më tutje, andaj gjithsesi si Grup Parlamentar ne e mbështesim themelimin e Komisionit ad-hoc për të hetuar gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës, qoftë të mirat, qoftë këqijat, sepse jemi i ftuar të pasqyrimi të realitetit, ndërsa të tjerat vërtet janë të paqëndrueshme dhe, natyrisht, debati është i mbështetur dhe do të marrim pjesë, por jo më shumë se sa të themelohet Komision ad-hoc, që të konstatojë gjendjen dhe pastaj të merren hapa më tutje, por jo duke i tejkaluar kompetencat tona që i kemi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Lufti Haziri.

**LUTFI HAZIRI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Tënderuar deputetë,

Dëshiroj edhe unë të konfirmoj të njëjtën logjikë të punës. Ky Parlament është i obliguar të merret me Bordin e RTK-së, organ të cilin e emëron Parlamenti. Vetë faktin që jemi vonuar në emërimin e bordit apo krijimin e procedurave urgjente për zgjedhjen e Bordit të RTK-së, tregon qartë që ne jemi vonuar dhe ne kemi problemet tona që duhet të merremi në mënyrë urgjente. Pjesa tjeterë është kompetencë e bordit apo organit që ne me ligj e qojmë atje. Ndërhyrja në menaxhment, ndërhyrja në politika redaktuese nga ana e Parlamentit do të shtrembëronte rolin tonë atje dhe do të keqinterpretonte apo do të siguronte atë që Komisioni Evropian në raportin e fundit e ka paraqitur si problem serioz në Kosovë dhe do ta përmend edhe Parlamentin, që nuk është përmendur deri tash.

Andaj, kredibiliteti ynë dhe autoriteti jonë institucional ligjor është nëse ne merremi me themelimin sa më të shpejtë apo zgjedhjen sa më të shpejtë të Bordit të RTK-së. Pjesa tjeterë e punës i takon bordit apo njerëzve që ky Parlament i emëron, që përfshinë edhe menaxhimin, që përfshinë edhe detyrimin e zbatimit të politikave sipas ligjit atje dhe po ashtu Bordin duhet ta sigurojmë që nuk do të ketë ndërhyrje politike në këtë organ.

Andaj, konfirmoj angazhimin tonë dhe besoj që duhet t'i kthehem i vetëm kësaj kërkese. Ky Parlament kërkon sa më shpejtë që të zgjidhet Bordi i RTK-së. Ai është autoriteti i vetëm ligjor, i cili duhet të merret me zbatimin e ligjit, me zbatimin e politikave në Televizionin Publik. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj – Bujupi, e ka fjalën.

**DONIKA KADAJ – BUJUPI:** Faleminderit, Kryetar!

Tënderuar kolegë deputetë,

Kur po flasim, do të thotë, për Radiotelevizionin e Kosovës, mua medoemos po më shkon mendja te 5 korriku i vitit 1999, sado që kjo datë ka qenë e dhimbshme për Televizionin e atëhershëm dhe vazhdon të mbetet një ngjarje e dhimbshme për të gjithë ne, një tendencë e politikës së sotme dhe e Qeverisë që të kontrollojë Radiotelevizionin e Kosovës në mënyrën siç po e bën, duke e sjellë në këtë formë edhe në pyetje, do të thotë, pavarësinë e tij, na bën që të na mungojë, fatkeqësisht, i vetëm edhe ndërhyrja policore në Radiotelevizionin e Kosovës dhe të kthehem i vetëm ditë famëkeqe. Pse ndodh kjo? Ndodh, sepse qeveritarët thërrasin në telefon, diktojnë politikat redaktuese, ndërhyjnë, kërcënojnë dhe shantazhojnë gazetarët e Radiotelevizionit të Kosovës, shantazhojnë menaxhmentin, bëjnë presione të ndryshme, ndërhyjnë në kronikat, në lajmet qendrore, ndërhyjnë, do të thotë, në të gjitha politikat redaktuese të RTK-së. Prandaj, në RTK është

krijuar një anarki e përgjithshme, ku fajin kryesor për këtë gjendje kaq të vështirë të Televizionit Publik, në të cilën është investuar kaq shumë që 10 vjet edhe nga partnerët tanë ndërkombe tarë, por edhe nga vetë tatimpaguesit e Kosovës, ka bërë të kemi, do të thotë, një ndenje të pasigurisë, të kemi ndërhyrje, të kemi raporte që flasim për shkeljet e lirisë së mediave në Kosovë.

KRETARI: Deputete, je jashtë rendit të ditës.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Kemi, do të thotë, kërcënime, shantazhime dhe tendencia që ata gazetarë që janë të dëgjueshëm, të shpërblehen edhe në Radiotelevizionin e Kosovës dhe kjo në një formë bën që Qeveria, e cila në anën tjetër kërkon që të kemi kontroll të përgjithshëm, realisht stimulon në Radiotelevizionin e Kosovës korruptionin dhe bëhet pjesë e këtij korruptioni, duke shpërblyer ata njerëz që janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Prandaj, këtu më së tepërm i pësojnë njerëzit dhe gazetarët profesionistë të Radiotelevizionit të Kosovës, që nuk janë të paktë. Pra, e pëson Kosova, e pësojnë teleshikuesit, e pësojnë qytetarët e Kosovës dhe e pëson imazhi i Kosovës.

Nga një Televizion publik, i cili duhet të jetë i tillë, Radiotelevizioni i Kosovës, me ndërhyrjet kaq të shumta të politikës po kalon në një televizion shtetëror dhe kjo nuk guxon t'i ndodh Kosovës, ose më mirë të thuhet, po kalon në një televizion privat të Kryeministrit Thaçi.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës fton të gjitha palët e interesuara, fton Kuvendin që të themelojë Bordin me shpejtësinë sa më të madhe, duke bërë që ndërhyrjet politike, siç kanë ndodhur me të gjitha bordet, siç ka ndodhur edhe me UP, së fundi, t'i japim fund të gjithë bashkë, pozitë dhe opozitë. Unë besoj që ky Kuvend duhet të ketë përnder t'i thotë - jo shkeljes së lirisë së fjalës, që po bëhet në Kosovë, shkeljes së lirisë së medieve, që po bëhet nga Qeveria, të themelojmë sa më parë bordin, një bord profesional, i cili do të merret me çështjet menaxhuese. Për ndryshe, .... dhe mënyra, do të thotë, kontrolli që po i bëhet këtij mediumi publik, nuk i bënnder Kosovës, nuk i bënnder as Qeverisë, e aq më pak i bënnder Kuvendit.

Prandaj, unë kërkoj sot nga të gjithë ne që të deklarohemi për një bord profesional, të themeluar shumë shpejt dhe pa ndërhyrje politike, mundësish pa ndërhyrje të cilat i kemi parë edhe ditën e premte në këtë Kuvend, një sjellje brutale e të parit të Qeverisë ka bërë që të gjithë deputetët e këtij Kuvendi të fyhen, të ndihen keq dhe të ndërpritet seanca. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë po kërkoj jo nga deputetja, por nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ta respektojnë fjalën e lirë, ta respektojnë rendin e ditës dhe mos të dalin nga rendi i ditës.

(Reagim nga salla)

Ju lutem, jo, jo, replikën po e bëj unë, t'i s'ke nevojë ta bësh. E merr fjalën. Kërkoj, edhe një herë po them, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ta respektojë rendin e ditës. Nëse ata vazhdimisht e shkelin rendin e ditës, të mos ia mohojnë pozitës ta shkelë rendin e ditës.

(Reagim nga salla)

Jo, Ardian, nuk e ke fjalën, se është dashur ta marrësh fjalën në emër të grupit parlamentar. Jo, ju lutem, unë nuk po e mohoj faktin se politika është e përzier në RTK, po në RTK nuk është më pak e përzier Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës se partitë e tjera politike. Prandaj, ju lutem, a! Jo, po ua tërheq vërejtjen juve si grup, ju lutem, është rendi i ditës dhe ndiqeni rendin e ditës. Po përmendi se ju, po përmendi të tjerët, po ju them, respektoni rendin e ditës!

Reagim nga salla)

Edhe ju e keni krijuar gjendjen në RTK, nëse e ka krijuar dikush tjetër. Hiq më pak fajtorë se të tjerët s'jeni as ju. Edhe ju keni qenë në pushtet, i keni bërë të gjitha të zezat, i keni mësuar edhe këta të tjerët t'i bëjnë.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Debati për Radiotelevizionin e Kosovës vjen në një kohë kur realisht duhet parë ky Kuvend kompetencat e veta ligjore që i ka karshi këtij institucioni. Juve të gjithëve u është i njobur qëndrimi i Grupit Parlamentar të AKR-së në lidhje me gjendjen në RTK, që atëherë kur kemi debatuar për shqyrtimin e raportit të RTK-së për vitin 2007. Dhe, në këtë drejtim unë do ta përsëritja atë që e kemi deklaruar që atëherë, janë të njobura pra qëndrimet e Grupit Parlamentar të AKR-së.

Unë do të ndalesha në një segment tjetër. Do të ndalesha në atë se cilat janë përgjegjësitë dhe çfarë ka bërë Kuvendi i Kosovës si themelues i RTK-së karshi Radiotelevizionit të Kosovës. Unë mendoj se Radiotelevizioni i Kosovës është kështu siç është edhe në saje të angazhimeve të Kuvendit të Kosovës që t'i kryejë obligimet e veta ligjore karshi këtij mediumi.

E para, problem është themelimi i Komisionit ad-hoc, i cili do të bënte përgjedhjen e Bordit të RTK-së. Kjo çështje është kthyer në një odise të pafundme. Unë nuk do t'ju mërzis tani me data që nga viti 2006, saktësisht në korrik të vitit 2006, kur i ka skaduar mandati këtij bordi të tanishëm, dhe tani jemi në vitin 2009, asnjë hap nuk është bërë përveç tentativave, përpjekjeve që të krijohet një komision ad-hoc parlamentar për të kryer detyrat e veta ligjore dhe për të përgjedhur Bordin e RTK-së.

Mendoj se aq sa është gjendja dhe kështu siç është gjendja në RTK, një pjesë të përgjegjësive i ka edhe ky Kuvend.

Së fundi, ne kemi miratuar një listë të një komisioni ad-hoc në këtë Kuvend, i cili do të bënte përgjedhjen e Bordit të RTK-së, listë e cila ka ardhur në Kuvend nga KPM-ja që në tetor të vitit të kaluar dhe imagjinojeni, tanë dhjetë muaj nuk është punë që ky komision ad-hoc të funksionalizohet. Heqja nga lista e zotit Hajdin Abazi, si kryesues i këtij komisioni ad-hoc dhe ardhja e zëvendëskryeministrit Kuçi në kryesi të këtij komisioni ad-hoc, që atëherë për ne ka dhënë sinjale se nuk do të krijohet ky komision ad-hoc, me faktin se politika ka ndërhyrë që të kalojnë edhe zgjedhjet e nëntorit dhe të mos bëhet konstituimi i këtij komisioni ad-hoc, që ka marrë votën në këtë Kuvend para një muaj e gjysmë dhe ende Komisioni ad-hoc nuk është formuar. Kjo është detyrë ligjore e Kuvendit të Kosovës.

E dyta, Kuvendi i Kosovës duhet të merret me një fakt tjetër shumë të rëndësishëm. RTK-ja nuk shikohet në 30% të territorit të Kosovës, pra shkallë vendi dhe duhet të marrë masa bashkë me KPM-në në këtë drejtim që kjo çështje, kjo gjendje të evitohet.

Tjetër çështje me të cilën duhet të merret Kuvendi i Kosovës, është përgatitja për digjitalizim, që është një projekt madhor dhe është i kushtëzuar që deri në vitin 2015 do të kalohet në sistemin digjital të transmetimeve, e që Kuvendi i Kosovës nuk ka marrë asnje hap parapërgatitor në këtë drejtim.

Dhe, e katërtë, që është përgjegjësi prapë e Kuvendit të Kosovës, është pronësia ose titullari i këtij mediumi publik, e cila çështje ka ngelur ende pa u zgjidhur. Në të njëjtën kohë, unë mbështes fjalën e Kryetarit të Kuvendit në lidhje me atë se çka mund në këtë debat të debatohet në lidhje me RTK-në, këtë e përcakton ligji. Ne, si Kuvend, nuk kem të drejtë të ndërhyjmë sa i përket drejtorit gjeneral dhe të tjera, është Bordi që duhet të krijohet dhe ta kryejë këtë punë, por unë angazhohem edhe një herë që Komisioni ad-hoc parlamentar ta kryejë obligimin e vetë ligjor. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit, deputet!

Komisionin ad-hoc Kuvendi e ka zgjedhur dhe nëse ky Komision nuk takohet deri të enjten, nëse Kuvendi ma lejon dhe Rregullorja ma lejon, unë mund ta thërras Komisionin ad-hoc të premten dhe të premten le ta kryejë detyrën e vet Komisioni ad-hoc. Do të thotë, nëse deri të enjten nuk konstituohet Komisioni, e keni ftesën time për të premten të mblidhet Komisioni ad-hoc i zgjedhur në Kuvend. Komisioni nuk është e thënë që të jetë qind për qind çdo anëtar i tij dhe me shumicë le të punojë, le t'i rekomandojë Kuvendit anëtarët që mund të janë në Bordin e ardhshëm të RTK-së. Pra, mos ta zgasim këtë çështje tepër, por sot jemi për debatin, sot jemi, nëse jeni në fund, ta votojmë Komisionin ad-hoc. Kjo mendoj është detyra e Kuvendit sot.

Ju lutem, unë dua t'ju them se, ju e dëgjuat anëtarin e Grupit të deputetëve për kërkesat e tij dhe realisht debati le të zhvillohet në kuadër të kërkesës së Grupit të deputetëve. Grupi është i përbërë nga: Arsim Rexhepi, Naim Rustemi, Driton Tali, Riza Smaka, Gani Geci, Shkumbin Demaliaj dhe Naser Rugova. Këta janë nënshkrues të këtij debati dhe respektoni këtë që e kanë bërë deputetët e grupeve politike në Kuvend.

Vazhdojmë me debatin. Në emër të LDD-së, kush e do fjalën? Deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

**LULZIM ZENELI:** Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Shprehim shqetësimin e Grupit Parlamentar të LDD-së dhe besoj të një pjese të madhe të deputetëve të këtij Kuvendi për këtë kulturë të komunikimit që po instalohet në Kuvendin e Kosovës dhe për këtë sistem që po e instalojmë, që nuk përkon me angazhimet tona të cilat kanë qenë nga viti 2000 e këndej. Dhe, ajo çka mund të themi këtu, po instalohen skenarë, të cilët jo vetëm që po e dëmtojnë punën e Kuvendit, por edhe po e rrënojnë sistemin demokratik, bazat e të cilat ende nuk i kemi vendosur ashtu siç dëshiron një shtet serioz. Prandaj, shpreh reagimin e Grupit Parlamentar për këtë kulturë të ulët të komunikimit që po instalohet në Kuvendin e Kosovës dhe një papërgjegjësi totale e Kuvendit të Kosovës, për ta respektuar fjalën e lirë dhe për t'i respektuar normat demokratike.

Sa i përket fjalës të cilën do ta theksojmë këtu lidhur me debatin apo gjendjen e krijuar në Radiotelevizionin e Kosovës, ky Kuvend ka debatuar një herë për raportin e RTK-së.

Dhe, ishte vlerësim thuajse i përgjithshëm, se ky medium publik është shumë larg konceptit dhe vizionit të të qenit një institucion me performanca të tillë çfarë i përket një mediumi publik, në një shoqëri demokratike dhe të lirë, por ky Kuvend i ka vlerësuar gjithashtu të gjitha përpjekjet që qojnë në ngritjen dhe avancimin e këtij institucioni, në avancimin e politikave programore dhe në krijimin e qëndrueshmërisë financiare.

Mirëpo, ne si Grup Parlamentar vlerësojmë se adresa e fajt është pikërisht te institucionet e vendit, pikërisht te Kuvendi i Kosovës, që nuk këmbëngulë të implementohet ligji. Mos implementimi i ligjit paraqet vështirësi në vete dhe këtë duhet ta themi ne. Nëse dikush pretendon se Kuvendi i Kosovës nuk mund të involvohet në një institucion ku nuk implementohen ligjet të cilat i ka nxjerr vetë, atëherë çfarë komoditeti krijon Kuvendi i Kosovës ndaj një mediumi publik? Dhe, si është e mundur që të gjitha raportet ndërkombëtare flasin për ndërhyrje të politikës në një medium publik! E kemi raportin e fundit të OSBE-së, raportin e Komisionit Evropian, ku thotë - ka ndërhyrje të drejtpërdrejt në këtë medium publik nga ana e Qeverisë, nga ana e politikës dhe ne rrjmë karshi këtij fenomeni. Prandaj, me aq komoditet po trajtohet kjo çështje, sa që është për injorancë se si ia kemi shtruar vetes këtë papërgjegjësi të trajtojmë një element të tillë.

Unë kujtoj se Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësinë e plotë dhe obligimet dhe detyrat, të cilat rrjedhin me ligj, që ta mbrojë autonominë e këtij institucionit dhe të garantojë pavarësinë editoriale. Nëse këtë nuk e bën Kuvendi i Kosovës, kush do ta bëjë? U fol me tone aq të ulëta dhe në detaje për gjendjen e krijuar në RTK, mirëpo ta kemi vetëm një fjalë - nëse merremi me çështjet të cilat janë terciare, janë në periferi të problemit, ne nuk e kemi prekur zgjidhjen e problemit. Problemi ekziston te Kuvendi i Kosovës që ende nuk e ka marrë përgjegjësinë që adresohet me ligj.

Ju lutem, kush na pengon, kush e pengon Kuvendin e Kosovës të mos i implementoje detyrat që rrjedhin prej Ligjit të RTK-së? Nëse flasim për Bordin e RTK-së... unë e di shumë mirë, zoti Kryetar, çka flas, mirëpo ajo çka po instalohet këtu në Kuvendin e Kosovës, nuk është që sjell debat serioz, nuk është që zgjon në përqendrimin, se shqetësimet të mia personale dhe të Grupit Parlamentar janë të tillë që tërheqin vëmendjen, nuk ka këtu peshë debati, nuk çon në Kuvendin e Kosovës. Për çka debatojmë për RTK-në dhe në çfarë gjendje ka ardhur Kuvendi i Kosovës, që në fillim të seancës plenare rrezikohet fjala, rrezikohet ajo që themi fjalë e lirë. Fjala e lirë në Kuvendin e Kosovës nuk çon peshë, debati nuk ka kuptim dhe këtë duhet ta themi.

Për çka debatojmë për RTK-në, kur Kuvendi i Kosovës me aq komoditetet, është treguar ndaj fenomeneve që po ngjajnë, qoftë në RTK, qoftë në institucionet e tjera, që e kanë të garantuar me ligj pavarësinë e veprimit. Këtu nuk ia vlen të bisedosh as për RTK-në, fundi i fundit, për arsy se këtu nuk çon peshë, fjala publike nuk çon peshë, atë duhet ta themi dhe seriozitet në Kuvendin e Kosovës nuk ka. Prandaj, si Grup Parlamentar, edhe pse jemi përgatitur në detaje t'i shtrojmë problematikat brenda këtij institucionit, që po rrezikohet ky institucion dhe po rrezikohet nga Qeveria e Kosovës, po rrezikohet nga politika, nëse thuhet se ajo parti apo kjo parti, unë po ju them me përgjegjësi të madhe, të gjithë ata të cilët tentojnë ta monopolizojnë RTK-në, të vendosin kontroll, ata po e monopolizojnë fjalën e lirë.

Raportet ndërkombëtare çka thonë për këtë? Prandaj, çka të debatosh më tutje për RTK-në? Si Grup Parlamentar shprehim shqetësimin tonë se debati për RTK- në dhe debatet tjera nuk janë në nivelin e përgjegjësisë që i takojnë një institucion serioz dhe shtetëror. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju lutem, unë po i lexoj emrat e grupit të deputetëve që e kanë bërë kërkesën për debat.

- Arsim Rexhepi, LDK,
- Naim Rrustemi, PDK,
- Driton Tali, i pavarur,
- Riza Smaka, AKR,
- Gani Geci, LDD,
- Shkumbin Demaliaj, AKR,
- Naser Rugova, LDD,

Do të thotë, janë deputetë të partive të ndryshme që e kanë kërkuar. Tjetër, unë ju them, të nderuar deputetë, nga fillimi deri më tanë asnjëherë nuk jam ulur në këtë karrige që jam me bindje se kam për t'i ndalur këtij anëtarin të Partisë Demokratike mikrofonin, të partive politike desha të them. Do të thotë, ju e dini se këtu kanë ardhur me skenarë të përgatitur se kujt duhet dhënë e kujt jo. Një.

E dyta, sa i përket ligjit, Kuvendi i Kosovës i miraton ligjet. Kuvendi i Kosovës duhet t'i respektojë ligjet, por Ligjin për RTK-në e respekton tjetër kush dhe ka për obligim për ta respektuar tjetërkush. Është çështje tjetër, duhet të bëhet monitorimi se a po e respekton a s'po e respekton? Përsëri nuk është çështje e Kuvendit, si tërsi, është përgjegjësi e një grupei, e komisionit që duhet ta miratojë respektimin e ligjit.

(Reagim nga salla)

Jo, unë po dua të them që nuk po dua ta akuzoj Parlamentin për çështje që nuk janë të tij, çështjet që janë të Parlamentit janë të Parlamentit dhe Parlamentin e përbëjmë të gjithë.

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", kush e ka kërkuar fjalën? Shpresa Murati.

**ŠPRESA MURATI:** Hvala! Pozdrav svima prisutnima!

Svima je poznato koliki je značaj medija u razvoju demokratskog društva, potreba transparentnog realnog informisanja gradjana s obzirom da je osnovno pravo svih gradjana pravo na informisanje. Ne možemo ne istaći da još uvek postoje gradjani kojima je ovo pravo uskraćeno, kada je u pitanju javni servis Radiotelevizije Kosova. Uz to, više od pet godina, uz račun za struju naplačuje im se i 3,5 eura za praćenje programa RTK-a, programa koji u opšte ne mogu pratiti. To je dugogodišnji problem koji nema opravdanja kao i nepoštovanje Zakona o Radioteleviziji Kosova.

Izveštaj RTK-a za 2007. i 2008. godinu dovoljno govori o tome i o stanju u Radioteleviziji Kosova. Zbog toga, kao i zbog mnogobrojnih primedbi, kada je u pitanju sprovodjenje Zakona o RTK-a, Komisija za javne službe, lokalnu upravu i medije odlučila je da pokrene iniciativu za izmenu i dopunu ovog zakona i trenutno se zakon nalazi u fazi amendamentiranja.

Htela bih da se zadržim na redakciji na jezicima zajednica. Te redakcije na bosanskom, turškom i romskom jeziku suočavaju se sa mnogobrojnim problemima. To su redakcije od nekoliko zaposlenih koji trebaju da zabeleže aktualna dešavanja u zajednicama koje pretežno žive u ruralnim sredinama a imaju na raspolaganju opremu i kamere samo jednom nedeljno. Kako u takvim uslovima mogu da prate dešavanja u zajednicama i da

blagovremeno urade priloge i pruže informacije gradjanima. Da ne govorimo o kvalitetu i sadržajima, o prostoru u programskoj šemi, koji nije dovoljan za potrebe zajednica, pa čak i ne ispunjava uslove koji su predviđeni zakonom. Jedina ohrabrujuća činjenica kada je u pitanju izveštavanje na jezicima zajednica i podrška za te medije je fond osnovan pri uredi premijera za podršku manjinskim i multietničkim medijama i uskoro će biti dodeljena sredstva manjinskim medijima iz tog fonda. Smatramo da je i vreme za otvaranje drugog kanala za zajednice, na kojima bi zajednice imale više prostora za promovisanje svojih kultura, običaja, tradicija i time bi i sadržaj programa RTK-a bio bogatiji i kvalitetniji. Takodje, podržavamo i formiranje ad-hoc komisije, istražne komisije koja bi preispitala stanje u Radioteleviziji Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanoviq e do fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvažene kolege poslanici, članovi Vladinog kabineta,

Naravno, mi smo puno pričali ovde u Skupštini i u Parlamentarnoj grupi vezano za RTK-a i samo bi mi možda dva dana da vodimo raspravu vezano za RTK-a i o svim segmentima nerada te institucije, ali naravno postoje i jako dobri mehanizmi koje mi izgleda ne upotrebljavamo, jer to se mora raditi i na osnovu komisija koje će imati stručni kadar u njima i da daju jednu reprospektivu svega toga što se tamo dešava. Što se tiće Srpske zajednice, pa vam slobodno mogu reći i Goranske ovde, pošto su kod nas u Parlamentarnoj grupi, i Aškalijske, ja ne znam gde su to zastupljeni oni na RTK-a, možda u nekom programu koji šušti posle 12 pa nemamo dobru sliku i šta to funkcioniše, na šta bi mi trebali da budemo ponosni kao zajednice na jednu takvu instituciju, a znamo šta ona treba da predstavlja.

Naravno, problema je puno i ja ne bih da kritikujem i ne slažem toliko sa činjenicama da je samo Vlada kriva i kako Vlada sama kontroliše sve to, naravno to nije tačno. Više mislim da se radi o samovolji nekih ljudi tamo koji rade i koji odlučuju o svemu tome, a na nama je da im to jednostavno jako i snažno prenesemo poruku i da im ne omogućimo da rade sve to što rade, jer ja sam ovde dosta slušao u Parlamentu zato što ljudi iz većinske zajednice uglavnom prate taj RTK-a i prate dešavanja tamo zato što po prirodi stvari njih treba da interesuje, nas manje više zato što ni mi kao poslanici nismo zastupljeni na toj televiziji RTK-a a koje, ako nije tačno, neka me demantuje neko, znači mi kao da ne postojimo što se njih tiće. Vidim da tamo postoji puno mahinacija, malverzacija, naplata od reklama i čega, sklapanja štetnih ugovora, nerada i čime se sve bave, ali ne bih puno da dužim, ja smatram da je stvarno krajnije vreme da se komisija jednostavno usredsredi na taj problem i da ako treba, da se ojača još novim članovima i da napravi jedan ozbiljan izveštaj koji će prvo u konsultacijama sa parlamentarnim grupama, sa šefovima parlamentarnih grupa, onda i sa Komisijom za prava i interesa zajednica, možda i sa konsultacijom većinske zajednice i da ovde komisija da neke zaključke, konkretne mere i predloge kako da se ta situacija sa RTK-a napokon jednom razreši. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Koci. Po, para se ta marr fjalën, ju e dini që në fillim të seancës të premtën kemi vendosur që nga 5 minuta t'i kenë deputetët. Keni vendosur, keni votuar, ky është vazhdim i seancës.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Do të përpinqem të jem shumë i shkurtër. Çështjen ose gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës së pari e ka ngritur Komisioni për Buxhet e Financa, pikërisht vetëm në atë linjë

që është edhe kompetencë e këtij Kuvendi, në linjën e buxhetit të këtij radiotelevizioni ose, më mirë të thuhet, në formën dhe mënyrën e raportimit, që nuk ka qenë e formatit që përcakton Ligji i menaxhimit të financave publike. Dhe, për hir të krijimit të një transparency sa më të mirë, duke u mbështetur edhe në raportimet që i ka bërë Zyra e Auditorit Gjeneral, është kërkuar që në këtë drejtim edhe Kuvendi ndoshta të ndërmarrë diçka në përmirësimin e gjendjes. Dua t'ju përkujtoj se Kuvendi i Kosovës është përgjegjës siç e thanë edhe disa parafolës këtu vetëm për sa i përket zgjedhjes së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, që është përgjegjësi e Kuvendit dhe asnjë përgjegjësi tjeter në këtë drejtim rrëth politikave menaxheriale, rrëth politikave programore as Kuvendi dhe as Qeveria nuk e kanë këtë të drejtë dhe nuk duhet t'ia atribuojnë vvetvetes këtë të drejtë. Në anën tjeter, po ashtu Kuvendi është i detyruar që të krijojë një bazë të mirëfilltë të buxhetit për funksionimin e këtij mediumi publik dhe që ky buxhet të jetë i mjaftueshëm dhe në këtë drejtim të jetë edhe i sigurt, gjë të cilën Kuvendi ndoshta me miratimin e ligjit dhe me caktimin e një takse e ka bërë, por duhet të rishikohen edhe format e tjera, sepse ajo formë nuk krijon një stabilitet dhe një qëndrueshmëri financiare të Radiotelevizionit të Kosovës.

Sa i përket një kërkese tjeter që e ka bërë Kuvendi, pas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Media, që raporti nuk ka qenë i plotë dhe do të duhej të plotësohej, një gjë e tillë e ka kërkuar Kuvendi nga Radiotelevizioni i Kosovës dhe besoj që Radiotelevizioni i Kosovës duhet ta sjellë, se është detyrë dhe përgjegjësi që t'i përgjigjet kërkeseve të Kuvendit. Dhe, disa tone që u dëgjuan këtu, me ty do të flas zonja Donika Kadaj, që thoni për zotin Kryeministër, zotin Hashim Thaçi që ai po kontrollon Radiotelevizionin e Kosovës, zoti Thaçi nuk e ka vendosur as Agim Zatriqin, nuk e ka vendosur as familjen shumë të madhe Muçaj, që e bën dhe mban Redaksinë e Lajmeve dhe kjo familje, bashkë me linjën e vet zinxhirore dihet se kujt i takon dhe si i takon. Dhe, e dini fort mirë se ka folës në atë Radiotelevizion të Kosovës që e kanë për zët, e kanë për iri të përmenden emrin e Kryeministrit dhe ata hulumtojnë vërtet pika të zeza dhe informojnë gabimisht se gjëja po do Kryeministri ose Qeveria ta mbikëqyrë dhe ta vë nën kontroll këtë medium publik, ndërsa është krejt e kundërtë se është kjo qeveri që po përpinqet vërtet ta nxjerrë këtë medium nga kontrolllet politike dhe nga kontrolllet klanore që sot janë aty. Prandaj, në këtë drejtim është mirë që Kuvendi ta ndihmojë secilin, ta ndihmojë edhe Qeverinë, ta ndihmojë edhe Radiotelevizionin e Kosovës dhe ky Kuvend vërtet të kërkojë nga Radiotelevizioni i Kosovës vetëm bërjen transparente të shpenzimeve buxhetore që i ka. Përpjekja këtu për të atakuar Kryeministrin Thaçi është përpjekje shumë e dështuar e juaja. Ju lutem, shkonni dhe shihni, unë do t'ju përmend juve me emra. Kush është Mustafë Muçaj dhe i kujt është? Kush është Festim Muçaj-Kabashi dhe i kujt është ai? Kush është Blerta Foniqi dhe e kujt është ajo? Kush është Shaqir Foniqi dhe i kujt është ai? Kush është Anita Muçaj dhe e kujt është ajo? Edhe grimerët, ata që fytyrën ta rregullojnë janë tuajt, ju i keni vendosur dhe ju i kontrolloni dhe ata juve ju përgjigjen, jo Kryeministrin Thaçi, as Kuvendit. Prandaj, ne duhet të bëjmë përpjekje që vërtet nepotizmin e kriuar në Radiotelevizionin e Kosovës ta shkatërrojmë.

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYETARI:** Faleminderit, e kreve fjalën! Urdhëro, dy minuta i ke, merre fjalën. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** E kam veç një pyetje për kryeparlamentarin: A ishte zoti Koci në rend dite, sepse nuk pati ndërryrje, përderisa në fjalimin tim, me vendimin e dikujt, për të cilin do të marrim shumë shpejt informatë dhe do të japë llogari, vendim i

kujt ishte, është ndërprerë transmetimi publik. Është ndërprerë transmetimi publik i fjalimit të opozitës.

KRYETARI: Ti e kërkove replikën me deputetin Gani Koci, ai ua dha përgjigjen. Unë ju thashë, rrini në rend dite, se nëse rrini në rend dite, rrinë të gjithë, po nëse ju s'rrini në rend dite, as këta s'rринë në rend dite dhe s'mund të ndërhhyjë më. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet Driton Tali.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Debati i ngritur nga një grup deputetësh ka të vetmin qëllim që të depolitizojë RTK-në dhe nuk janë këto të gjetura të një qeverie, por edhe të qeverive të tjera. Me fjalë të tjera, dua të them se nuk është e nevojshme që të atribuohen konkretisht me emra se kujt i takojnë, por po shihet qartë nga diskutimet e deputetëve se me të vërtet Radiotelevizioni i Kosovës gjithmonë ka qenë i politizuar dhe është i politizuar veçse e ka ndërruar patronin.

Të dhënët nga diskutimet që kemi pasur në një seancë tjeter, kanë treguar saktë se në Radiotelevizionin e Kosovës ka pasur shkelje të rënda ligjore. Ka pasur shkelje të rënda të Ligjit për prokurimin publik, kur me vite të tëra nuk është respektuar Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, ku RTK-ja ka qenë e obliguar që të hapë konkurs publik për produksionet e jashtme, me fjalë të tjera produksionet private. Po, nuk besoj se është temë e diskutimit në këtë Kuvend kjo, sepse tash është bërë publike, kjo është temë e diskutimit të sistemit të drejtësisë, e Prokurorisë dhe Gjyqësorit. Kështu që i bëj ftesë edhe Prokurorissë të merret më saktësisht me të gjeturat që kanë dalë, të merret dhe të hetojë, sepse ne deputetët nuk mund të bëjmë shumë hetime, por e kemi ngritur si fakt, fakt që nuk është kundërshtuar nga askush, sepse dihet, është e pashme.

Pika e dytë, në debat që unë do ta ngreh, është çështja se në Radiotelevizionin e Kosovës kemi shumë të punësuar me vite me të ashtuquajturën kontratë mbi vepër. Të nderuar, duhet të cekim se kontrata mbi vepër nuk ka kurrfarë baze juridike. Nuk ka ligj që e përcakton kontratën mbi vepër. Secili shërbim i nënshtrohet, blerja e shërbimit i nënshtrohet ligjit për prokurim publik. Edhe kjo është një shkelje shumë e rëndë ligjore dhe më duhet të them se këto kontrata mbi vepër kryesisht bëhen për të blerë dëgjueshmëri, për të blerë pozicion, për të blerë situatën e vet e të tjera. Dhe, këtu kemi të bëjmë me 240 veta, ashtu siç është përfolur, 240 veta me kontratë mbi vepër është një shkelje shumë-shumë e rëndë ligjore dhe këtu ka punë Prokuroria.

Dhe, në pikën e tretë, që unë do të ndërlidhem, është gjithashtu edhe dimensioni programor i RTK-së. Sipas të gjeturave të RTK-së dhe sipas bisedave të brendshme nga Radiotelevizioni i Kosovës, dihet se RTK-ja ka bashkëpunuar shumë ngushtë me Universitetin AAB. Ka bashkëpunuar kryesisht me njerëz që kanë punuar edhe në Universitetin AAB. Edhe drejtor i programit, edhe blerje të shërbimeve nga Universiteti AAB, është konflikt i interesit, konflikt i drejtpërdrejtë i interesit. Për shembull, këshilltari tash, atëherë drejtor i programit Liridon Cahani edhe ka punuar në AAB, edhe ka blerë shërbimin prej AAB-së. Kjo është një shkelje shumë e madhe, nuk po flas me vite, a është e 2007, 2006 a 2005, por është fakt.

Kurse, nga dimensioni i organizimit programor të RTK-së, mund të them lirisht dhe të gjithë e shohim se RTK-ja nuk e luan rolin e vet si një medie e pavarur. Nuk e luan rolin e vet as në transmetim, nuk e ka luajtur rolin e vet dhe nuk është duke e luajtur për hapjen e debatit publik. Për shembull, po e përshkruaj me një shembull shumë konkret. Kohëve

të fundit, ditëve të fundit është përfolur shumë për “Kosovën e Re”. Asnjë debat të hapur. Për shembull, manipulohen fjalët “Banka Botërore”, “Banka Botërore”, pse mos të shohim ne ndonjëherë edhe çka ka për të thënë, të mos jetë qasje shumë nihiliste që ekspertët e brendshëm të Kosovës nuk kanë çka të thonë, veç vjen si e servuar në fund dhe RTK-ja asnjë debat s’ë ka organizuar. Nuk organizon debate për çështje shumë madhore, s’organizon debate së paku të mësohet prej vendeve në regjion. Me gjithë këto mjete, për shembull, që u përfol për RTK-në se nuk ka mjete, po e shohim radio televizionet në Shqipëri organizojnë debate të hapura publike. Nuk ka nevojë të jetë një raportim që i përngjet raportimit nga Kuvendi i Kosovës, raportimit në kohën e Rrahman Morinës, një raportim shumë i zbehtë me disa emisione që nuk ngjallin as kërshërinë e shikuesve.

Po, unë do të ndalem edhe pak te hapja e debatit. Ne kemi pasur, për shembull, raste të tjera ku emisionet porositen, ndërhyhet në Radiotelevizionin e Kosovës. Kjo për mua, ky debat i sotëm, do të ishte një prej hapave të parë për ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit shumë, Naim, për debatin konstruktiv. Një pauzë dhe pastaj vazhdon Driton Tali. Pauza zgjatë 20 minuta, sa për një kafe, do të thotë.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KYESUES SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar, vazhdojmë seancën. Në sallë janë 62 deputetë. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për shkak se këtu i kemi disa delegatë të lajmëruar te cilët pres që të flasin për gjëra të ndryshme, unë do të flas për një çështje që goxha ka kohë që është instaluar në RTK, nga fakti se Bordit dhe ekzekutivit të RTK-sës i ka skaduar afati që 3 vite. Nuk duhet të jesh gjeni për ta kuptuar pse ky institucion lejohet të punojë kështu. Sigurisht se kjo bëhet me qëllim që njerëzit të lihen vjerrë, ashtu që ata gjithmonë të janë të pasigurt dhe gjithmonë nën presion dhe shantazh. U mor vesh, me qëllim që të janë sa më të dëgjueshëm dhe servilë dhe kjo atmosferë domosdø është futur në çdo skutë të RTK-sës, atmosferë ku të punësuarit janë të kujdeshëm ndaj të mëdhenjve e jo ndaj punës, të ndjejnë përgjegjësi ndaj të mëdhenjve e jo ndaj punës, kreativitetit dhe efikasitetit. Asnjë fushë nuk ka përgjegjësi dhe konkurrencë të mirëfilltë në performancë, pos konkurrencës në servilitet dhe mediokri. Andaj, na servohet ky program steril, përkundër dhjetëra milionë eurove që u futën në RTK. Shembull konkret, marrim lajmet qendrore të së premtes, pra më 17 korrik të vitit 2009, se si u raportua për debatin “Kosova e re” nga gazetari Fisnik Dërguti. Ngjashëm raportohej edhe më 2005, kur privatizohej “Ferronikeli”. Edhe atëherë propagandohej nga RTK, si bie fjala gazetari Behxhet Begu ishte shumë aktivë atëherë, se si me privatizimin e “Ferronikelit” nga Alferoni, siç thuhej, nga një kompani e fuqishme, Drenasi dhe Drenica do të lulëzojnë. Tashti, RTK-ja, Redaksia e lajmeve, siç po shihet, ka marrë një detyrë të re të bëjë fushatë për “Kosovën e re” duke propaganduar se sa shumë do të përfitojë Kosova financiarisht, se si Kosova do ta zgjedhë problemin e territ, e tjera. Madje, korrespondenti i RTK-sës nga Nju-Jorku, zoti Sylejman Gashi, ishte edhe më patetik, reportazhi i tij filloi me një demagogji të tejkaluar, të stilit, siç thuhet “më as thitë s’ë hanë”. Raportimi i tij filloi me atë se si, po citoj: “kjo vendimmarrje”, pra për vendimin e ‘Kosovës së re’, “nga Uashingtoni konsiderohet të ketë edhe peshë politike dhe shtetërore, sepse për herë të parë i zoti i vërtetë i tokës dhe i pasurisë së

Kosovës vendos për kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të saj”. Harron me qëllim apo nuk po e ditka zoti Sylejman Gashi dhe redaktorët e lajmeve qendrore të RTK-së se pikërisht zoti i kësaj toke, pra sovrali - qytetari i Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesve të vetë në tetor të vitit 2005 pati marrë vendim konkret se si të shfrytëzohen pasuritë nëntokësore të energjisë. Këtë vendim të fundit e ka marrë Qeveria, pra agjenti i të zotit, e jo i zoti, krye në vete në kundërshtim me vendimin e të zotit, pra të sovranit, pa pyetur fare të zotin. Unë nuk e kam të qartë se si të paktën zoti Sylejman Gashi, që jeton në SHBA, në djepin e lirisë dhe demokracisë, në shtetin që na inspiron jo vetëm neve, por tërë botën paqedashëse dhe demokratike se si duhet zhvilluar liria dhe demokracia, si Sylejman Gashi nuk po e ditka të dallojnë të zotin dhe agjentin.

Pastaj, për ta kupuar se ai raport ishte i porositur nga bosat e tij, zoti Sylejman Gashi, pa fije turpi keqpërdori një thënie të Presidentit Obama, në mënyrën më demagogjike dhe manipuluese të mundshme “duke filluar me zhvillimin e teknologjisë së thëngjillit të pastër është një diçka që do ta bëjë vendin tonë të mos jetë i varur nga energjia e importuar”, citat, duke vazhduar me patetizëm, përsëri po e citoj “Kjo fjali nuk është një premtim elektoral i ndonjë politikani të Kosovës, qoftë ai në pozitë apo opozitë. Ky ishte një prej nga premtimet mbi planin e rritjes së burimeve energetike në Amerikë, të thëna vitin e kaluar nga kandidati i atëhershëm për president të Amerikës Barak Obama, si një plan i zhvillimit të teknologjisë së pastër të energjisë së thëngjillit”. Pra, ky raportim ta çon mallin e viteve ‘80 dhe ‘90 të televizioneve të diktaturës, atëherë pra kur diktatorët sa herë që donin që ndonjë politikë të tyre personale ta lansojnë, gazetarët e tij fillonin fushatën duke manipuluar me informata. Moti kohë kjo mënyrë e raportimit RTK-në e ka shndërruar në Televizion shtetëror, ku vetëm manipulohet me sloganin 100% publike. Me rastin e emisionit në fjalë, zoti Sylejman Gashi dhe redaktorët e lajmeve qendrore të RTK-së qëllimisht ngatërhojnë diçka që në Kosovë ende nuk është në rend të ditës. Pra, edhe nuk flasin për teknologjinë e thëngjillit të pastër, por për linjin e Kosovës, cilësia e të cilit është shumë e njohur për përqendrimin e lartë të hirit. KEK-u tashti hedh rrëth 25 tonelata pluhur dhe hi në ajër çdo orë ose 74 herë apo 7.400 herë më shumë sesa norma e lejuar me standardet evropiane. Sa i pa informuar apo sa i pa përgjegjshëm dhe manipulativ duhet të jesh për të krahasuar hulumtimet për prodhimin e energjisë nga thëngjilli i pastër, një teknologji që veç sa ka filluar të hulumtohet nëpër laboratoret e shteteve të shquara në SHBA, në vende tjera perëndimore e që edhe më tutje është më shumë teorike dhe teknologji shumë e shtrenjtë për ta jetësuar me një projekt ...

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYESUESI:** Faleminderit! E ka fjalën deputeti Gani Geci!

**GANI GECI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,

Radiotelevizioni i Kosovës është një medium publik, të gjithë e dimë këtë, dhe mediumet publike, por edhe institucionet publike do të duhej të menaxhoheshin nga të zgjedhurit, nga institucionet e zgjedhur apo nga bordet që i zgjedhin institucionet. Dhe kjo nuk po ndodh në Radiotelevizionin e Kosovës. Tash tri vjet, Radiotelevizioni i Kosovës është pa bordin e saj, është edhe pa drejtorin. Dhe, ju e dini, nëse një medium ose një institucion publik që nuk e ka të pagzgjedhur drejtorin dhe drejtori pa mandat është sahanlëpirës, ai ua lëpin sahanin tanëve, kush të vjen në pushtet dhe kjo po ndodh edhe në këtë medium. Do të thotë, ata që kanë qenë në pushtet, ai drejtori e ka lëpi sahanin e tyre sa kanë qenë ata dhe tash këta të tjerët që kanë ardhur në pushtet, po e lëpinë këtë sahanin e këtyre. RTK

qe shtatë vjet e ka kontraktuar një firmë private apo një agjencion marketingu që e ka emrin CMB dhe ky agjencion i menaxhon mbi 5 milionë euro.

Ju lutem, ju e dii që institucionet publike dhe të gjitha institucionet publike do të duheshin që marketingjet dhe të hyrat e tyre t'i udhëheqnin përmes Thesarit dhe të hyrat e Radiotelevizionit nuk udhëhiqen përmes Thesarit të Kosovës. Ju lutem, shkoni këqyreni Thesarin dhe a ka udhëheqje të menaxhimeve publike apo të parave që hynë në këtë medium përmes Thesarit. Kjo nuk ndodh. Dhe, çka ndodh? Unë e kam nënshkruar për këtë debat, kam qenë një prej atyre që e kam nënshkruar, por po ju them sinqerisht, më vonë e kam kupuar që s'është dashur ta nënshkruaj. Ja se pse? Sepse, unë qysh shëtitit këtu nëpër Prishtinë dhe pi kafe nëpër kafene të Prishtinës dhe ai ministri i krejt ministrave të PDK-së dhe të LDK-së kishte qenë një ditë duke pirë kafe me drejtorin. Dhe, me atë drejtorin kishte qenë edhe Kryeministri, edhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese, edhe ai menaxheri që i bën këto menaxhimet – drejtori i Televizionit Klan, do të thotë, të gjitha këto janë të kota. Ne po mundohemi të diskutojmë kot për një diçka që s'mund ta lëvizim sepse ministri i ministrave e thërrret në telefon atë drejtorin dhe i thotë - ndërprisja filan deputetit, nuk bën më të dalë dhe ia ndërpres. Unë s'e di tash a ma kanë ndërprerë mua, po edhe mua mund të ma ndërpresin, sepse i thërrret ai dhe ata janë të detyruar të bëjnë atë që e thotë ai.

Të tjerat. Unë më herët e kam pas marrë një çmimore të Radiotelevizionit të Kosovës dhe kjo çmimore e Radiotelevizionit që e kam prapë, nëse i shumëzojmë, kush di të shumëzojë, 12 x 1 sekondë sa bëjnë, 12 euro kushton një sekondë përpëra lajmeve, por edhe pas lajmeve, jep për të kupuar se të hyrat nga marketingu në vjetor janë mbi 2.500.000 euro, pa i llogaritur të hyrat tjera që bëhen para lajmeve të para, para orës 17:00 dhe pas orës 23:00 Do të thotë, pajtohem plotësisht me kërkësën e grupit të deputetëve që ne të bëjmë një komision ad-hoc për hetimin e Radiotelevizionin e Kosovës për të gjeturat në këtë Radiotelevizion, sepse këtu është shkelur ligji dhe deputetët janë për ta mbrojtur ligjin. Ne duhet ta mbrojmë ligjin, duhet të hetojmë se kush e ka shkel ligjin, a e ka shkel ligjin drejtori a bordi, a ai ministri i ministrave. Prandaj, ne duhet të jemi të qartë, sepse Radiotelevizioni i Kosovës është televizion publik, por nuk është televizion publik për opozitën, tani për tani për këtë opozitën që është pak më e butë, jo për atë opozitën pak më të vështirë që janë. Dhe, nëse neve nuk na lejohet asnjëherë të kemi qasje në Radiotelevizionin publik, po siguroj që edhe një pjese të LDK-së nuk i lejohet, sepse nuk e kanë fuqinë as të atyre, as të këtyre, vetë Kryetari i Kuvendit e pranoi haptas që aty ka hajna, po problemi është cili është më hajn, të gjendet. Do të thotë, ka këtu shkelje, po kush e ka shkel ligjin ma shumë, a ma shumë e kanë shkel ligjin ata që kanë qenë në pushtet më herët, a më shumë po e shkelin ligjin këta, këtu është problemi. Do të thotë, ne duhet të kemi një qasje tjetër. Ne duhet të kemi një qasje tjetër para votuesve, sepse ne nuk jemi zgjedhur këtu që të zgjedhim cili është më hajn, por që ne ta zbatojmë ligjin dhe të shohim e të hetojmë kush e ka shkelur Ligjin mbi Radiotelevizionin dhe pse, ta zëmë, Kuvendi i Kosovës apo me urdhrin e Qeverisë është emëruar zëvendëskryeministri si udhëheqës, që më vonë të dalë që Kushtetuta nuk e lejon dhe kjo duhet të shtyhet deri të përfundojnë zgjedhjet lokale. Ose edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Jepjani dhjetë sekonda, le ta kryejë, apo gjysmë minute.

GANI GECI: Po, më duket, ai ministri i ministrave ma ka ndal! Megjithatë, në bazë të Kushtetutës nuk ka pas të drejtë që zëvendëskryeministri të jetë në Komisionin ad-hoc dhe kjo është bërë me qëllim të shtyrjes në pa afat deri pas zgjedhjeve dhe këtë ne të

gjithë po e kuptojmë, ne jemi duke u marrë nga pak me politikë. Po, kjo çka po ndodh, do të duhej të ndryshohej. Ky komision që do të formohet dhe ne do ta votojmë, do të duhej ta hetonte gjendjen e Radiotelevizionit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Me nder qofsh! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e diskutojmë sot një çështje shumë të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë dhe për zhvillimin e mediave dhe të fjalës së lirë në një shtet me një demokraci dhe institucionë të brishta, në një shtet kur gati dy dekada këto çështje mbasë kanë qenë nganjëherë edhe tema të ndaluara. Por, qe 17 muaj të ekzistimit si shtet i pavarur dhe sovran dhe me kompetencë të plota, si organi më i lartë legjislativ i shtetit të Kosovës, a e kemi dhënë provimin, a kemi qenë në nivel të detyrës dhe a është vënë në pikëpyetje serioziteti i institucionit më të lartë të shtetit tonë.

Unë nuk do të ndalem në aspektet financiare për RTK-në, as në aspektet organizative, as në respektimin e ligjeve që kanë të bëjnë edhe me shërbyesit civilë, me punësimin e të tjera. Do të ndalem në rolin që e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës me kompetencat kushtetuese dhe konform legjislacionit në fuqi, me qasjen e këtij Kuvendi ndaj të vetmit transmetues publik në vend. Unë konsideroj që debatet e nxehtha, debatet me emocione dhe në mungesë të alternativave, të propozimeve dhe materies substanciale se si të përkrahet RTK-ja, si të zhvillohet ajo dhe si të jetë vërtet një transmetues publik i pavarur, se si RTK-ja vërtet të jetë në shërbim të informimit të drejtë dhe të zhvillimit të demokracisë, që ka edhe misione tjera si transmetues i vetëm publik, unë para Kuvendit të Republikës së Kosovës do të parashtroj disa çështje, në të cilat, sot, në seancën e sotme ky Kuvend duhet të japë përgjigje:

1. Prolongimi i zgjedhjes së Bordit të RTK-së, pse po ndodh, kujt po i konvenon dhe a jemi Kuvend i Republikës së Kosovës dhe RTK-ja na përgjigjet neve. Atëherë, të marrim vendim dhe të caktojmë limite kohore që kjo temë njëherë e përgjithmonë dhe me këto debate nganjëherë emocionale dhe me akuza të ndërsjella, mos t'i ngarkojmë qytetarët e lodhur të Republikës së Kosovës me këtë çështje, por të marrim vendime ashtu si na takon si ligjvënës dhe si njerëz të zgjedhur.

2. Kryesuesi i Komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së është zëvendëskryeministri. Sipas të gjitha raporteve që monitorojnë fjalën e lirë dhe lirinë e medieve, është edhe shkelje flagrante e ligjit. Zotëri kryesues dhe partnerë të koalicionit qeverisës, nuk ju bën nder ajo. Do të vazhdojnë edhe me raportet e tjera të Komisionit Evropian, të Bashkimit Evropian, vendimet që po i merr BE-ja ditëve të fundit, po edhe të institucioneve tjera serioze relevante ndërkombëtare të na akuzojnë për ndërhyrje politike në mediat, sidomos në transmetuesin publik. Nuk ju bën nder ajo. Edhe ashtu e keni shumicën. Pse edhe njëherë në raportet e ardhshme të këtyre institucioneve që vendosin për ecjen e shtetit tonë në ato procese aspak të lehta, të hyjmë si shtet që po prodhojmë momentume politike që reflektojnë me ndikime të vrazhdëta në politikat editoriale të transmetuesit publik.

3. As më shumë dhe as më pak, Kuvendi i Republikës së Kosovës vetëm duhet ta kryejë punën e vet që nënkupton, nën 4. sot të formohet një komision hetimor, të formohet sot, secili grup parlamentar t'i propozojë emrat e vet dhe që ky komision hetimor pas gjetjeve të tij, analizave të tij, të vijë dhe të informojë Kuvendin. Por, ndërkohë duhet të përzgjidhet bordi i ri i RTK-së në mënyrë që ta zgjedh një menaxhment kredibil, të

respektueshëm dhe profesional që gjendja e papranueshme, që është konstatim i të gjithë kolegëve të çmuar të këtij Kuvendi sot, në RTK të sanohet dhe vërtet ta ndihmojmë RTK-në dhe njëherë e përgjithmonë të krijojmë një kulturë politike shtetformuese që është në trendet që po i kérkon edhe Bashkimi Evropian, por që është nevojë, tek e fundit, edhe për qytetarin edhe për zhvillimin institucional dhe demokratik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti!

XHAVIT HALITI: Zoti kryesues, faleminderit!

Të nderuar kolegë, kolege,

Më vjen keq që sot po debatojmë për një çështje për të cilën të gjithë kemi vërejtje, por fatkeqësisht nuk kemi njerëzit kryesorë të cilët do të duhej të na informonin dhe të na sqaronin këtu për të gjitha këto kritika që po ngrihen, qoftë në drejtim të qeverisë, qoftë në drejtim të Televizioniit të Kosovës, në këtë rast ndoshta është bërë pak më shumë e është orientuar kah drejtori aktual.

Ne kemi një ligj i cili përcakton qartë funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe po më vjen keq që askush deri më tani nuk e përmendi se ku është shkel ligji përfunksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës. Mendoj se në këtë rast më së paku ka faj Radiotelevizioni i Kosovës për arsyen se ata nuk kanë mundur ta zgjedhin Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës, por bordin kemi qenë të obliguar ta zgjedhim ne. Më vjen mirë që Kryetari i Parlamentit u prononcua dhe tha se do ta zgjedhim së shpejti, do të thotë, gjatë javës së ardhshme edhe këtë çështje dhe është mirë.

Ndoshta do të duhej më shumë të koncentrohemë tek ligji dhe kontrolli i emisioneve ose monitorimi i emisioneve të Radiotelevizionit të Kosovës, të cilat do të duhej të monitoroheshin jo nga Parlamenti, por nga një grup specialistësh – njerëzish të paguar, kuptohet, tek të cilët do të kishim mundësi edhe ne të ankohemi edhe si subjekte politike, edhe si deputetë, edhe si shoqëri civile dhe të gjithë tjerët.

Unë e di që secili nga ne këtu, që jemi në sallë, e kemi nga një drejtor të konstruktuar në kokën tonë kush do të ishte më i mirë. Veçanërisht partitë politike e kanë nga një drejtor të vetin të konstruktuar, sepse është interes i tyre se ne s'po kërkojmë që të zbatohet ligji në televizion, ligji mbi transmetimet, ligji mbi respektimin e hierarkisë politike, në këtë rast të Televizonit të Kosovës, ligji mbi ndjekjen ose transmetimin ose jo kujt s'ia ka transmetuar kur i është kërkuar që të bëhet transmetimi, por po kërkojmë keqpërdorimet financiare dhe për këto keqpërdorime financiare ne e kemi një formulë shumë të lehtë sepse dokumentacionin zyrtar publik në Kosovë secili qytetar është i lirë që të shkojë ta kërkojë kontrollin e këtij dokumentacioni dhe është i lirë që të bëjë padi në Prokurorinë e përgjithshme. Ne nuk mund ta luajmë rolin e prokurorit si Parlament për çështjet e keqpërdorimeve financiare. Aq më pak, mendoj që është përgjegjësi e jona që të kërkojmë komision hetimor parlamentar për ta kontrolluar Televizionin e Kosovës.

Unë nuk e di se si, në cilësinë e kujt do të vijë drejtori i Televizonit para këtij komisioni, nuk e di se në cilësinë e kujt do të vijë kolektivi i Radiotelevizionit të Kosovës, kur akoma s'e ka bordin e tij. Ta krijojmë bordin dhe pastaj bordi le të menaxhojë me këto çështje të cilat po përmenden.

Unë nuk kam vërejtur në transmetimet e deritashme anim politik të Televizonit të Kosovës, përvèç se kam vërejtur ndonjë shkelje të rangimit të hierarkisë politike në transmetimin e lajmeve, që nuk do të duhej të bëhej në atë formë. Dhe, në veçanti, kur transmeton angazhimet publike të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit të Qeverisë

së Kosovës, të Parlamentit të Kosovës dhe të kryeparlamentarit, mendoj që nuk i hyn në hak askujt sepse ata janë persona me të cilët identifikohemi ne të gjithë dhe identifikohet Kosova.

Prandaj, unë mendoj që çështja e formimit të këtij komisioni hetimor mendoj që është ...

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYESUESI:** Ia vazhdoni, se e ka kohën e vet ky, është anëtar i Kryesisë!

**XHAVIT HALITI:** ... mendoj që nuk është e arsyeshme që të krijohet komisioni hetimor për Televizionin. Komision hetimor mund të krijojmë për disa çështje tjera, të cilat janë kompetencë e jona, e jo që të hetojmë se si i kanë zgjidhur problemet e tyre financiare. Le të merren, thashë, institucionet e specializuara dhe ndonjëri që ka kohë të shkojë të kërkojë dokumentacionin dhe secili subjekt politik që është i interesuar që ta vë para përgjegjësisë Televizionin, t'i gjejë dokumentet dhe t'i çojë në vendin e duhur, që është Prokuroria e përgjithshme dhe kjo mendoj që është rruga më e drejtë dhe më e lehtë.

Mbi të gjitha, për t'i eliminuar këto keqkuptime ose akuza dhe kundër akuzave kundër njëri-tjetrit, ndoshta do të duhej më shumë të mendonim që të krijojmë një komision mbi partizan të përbashkët nga të gjitha subjektet politike dhe në veçanti, kuptohet, nga pozita dhe opozita mbi bazën e fuqisë politike dhe ndoshta edhe të favorizuar, për ta favorizuar opozitën, i cili do të përcaktojë rregullat e lojës së Televizionit publik. Në qoftë se për neve është më me rëndësi që ta zgjedhim drejtorin dhe pastaj ta lëmë atë të bëjë çka të dojë për qejf tonin ose për qejf të vetin, mendoj se është e gabueshme. Secili drejtor që mund të vijë në televizion, në qoftë se nuk i ka rregullat e përcaktuara, në qoftë se nuk e ka një komision mbikëqyrës që monitoron transmetimet, marketingun që po thuhet, x-kompani ka marrë kaq... Ai dikujt duhet t'ia japë marketingun të monitorojë, duhet t'ia jap dikujt këtë lloj biznesi, si janë bërë ato kontrata tona, nuk kam shkua që ta monitoroj Televizionin e Kosovës, por mendoj që një komision mbi partizan i krijuar në këtë parlament që përcakton rregullat e qarta dhe ato t'i inkorporojë në ligj, do ta zgjidh këtë problem.

Prandaj, unë jam në veçanti dhe po kërkoj nga kolegët që të mos kërkojnë komision hetimor për televizionin, sepse mendoj që nuk është çështje e jona, nuk është kompetencë e jona. Që të krijojmë një komision hetimor për çështje të tjera të cilat janë kompetencë e jona, nuk jam që të mos krijohen dhe nuk kam qenë kurrë, por kam përshtypjen që në vend që të merremi duke u përpjekur, që thotë ai, të bëjmë diçka tjetër, bëjmë krejt diçka tjetër dhe absolutisht nuk do të kemi ndonjë rezultat konkret nga ky komision, përvèç se do të konstatojmë pastaj edhe sa kamera janë dëmtuar në televizionin e Kosovës që i ka sjellë falas dikush tjetër.

Të gjitha problemet e krijuara në Televizionin e Kosovës mendoj janë mënyra se si është konceptuar udhëheqja e saj, që në krijimin e Televizionit të Kosovës në periudhën kur e ka bërë OSBE-ja, në mungesë të njerëzve, në mungesë të ligjeve, në mungesë të Parlamentit të Kosovës, në mungesë të Qeverisë së Kosovës i ka vendosur formulat dhe ato janë zbatuar në mënyrën e tyre. Prandaj, urdhëroni ta rregullojmë Ligjin përfunkcionimin e Televizionit dhe të fillojmë me diçka më mirë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

**BAJRAM KOSUMI:** Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që sot do të kisha dashur të flasim thelbësishët për problemet e mëdha me të cilat ballafaqohet RTK-ja, si i vetmi televizion publik në Kosovë, dhe do të debatojmë, sepse edhe pika e rendit të ditës për të cilën është thirrur seanca plenare, është e tillë – debat lidhur me gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës. Kjo është tema të cilën ne jemi duke e trajtuar tash.

Mirëpo, para se të kaloj në çështjet kyçë, nuk mund të mos hetohet fillimi i tensionuar i diskutimit sot për këtë pikë, që jemi të gjithë të pakënaqur me mënyrën se si e ruan apo s'e ruan pavarësinë editoriale RTK-ja, është një çështje pak a shumë e pritur, por se u tregua një frustrim i madh posa filloj debati për RTK-në, kjo ishte diçka e papritur. Nuk mendoj se tensionimi i qëllimshëm i situatave politike apo të lidhura me politikën e ndihmon demokracinë në Kosovë. Ndoshta ka dikush që mashtrohet se mund të përfitojë nga ky tensionim i situatës, por unë besoj se tensionimet e qëllimshme të tilla i kushtojnë Kosovës, do të na kushtojnë të gjithë neve. Por, ky frustrim për debatin për RTK-në nxjerr në sipërfaqe edhe diçka tjeter. Nuk është fjala për një x, ose një y person, për një qendër, por është fjala për shumë qendra, për shumë x dhe shumë y që kanë interesa të drejtpërdrejta në RTK, në transmetuesin publik. Dhe, do të thotë, kjo është ajo që doli sot në fillim të debatit në sipërfaqe dhe që me të vërtetë e çorenton publikun, opinionin, e çorenton Kuvendin e Kosovës nga thelbi i temës për të cilin duhet të debatohet. Kuvendi i Kosovës është mbikëqyrësi legjitim i vetmi i RTK-së përmes mekanizmave që ia përcakton ligji dhe ne duhet të debatojmë për këtë.

Janë tri çështje thelbësore që Kuvendi duhet t'i diskutojë për RTK-në, janë tri probleme kryesore të identikuara pothuaj se në çdo diskutim për RTK-në. Nën një, është ai që po u dhemb më së shumti tash grupeve politike, është pavarësia editoriale e RTK-së, apo po të shprehemi pak ndryshe - demonopolizimi i politikave të RTK-së. Problemi i dytë është cilësia dhe ligjësia e funksionimit të RTK-së, është temë thelbësore për të cilën duhet Kuvendi të interesohet.

Dhe, çështja e tretë, është mbulimi i territorit të Kosovës me RTK-në, që është e përkufizuar me ligj, po ashtu, e që në praktikë nuk mbulohet, është në kundërshtim me ligjin.

Këto janë tri çështje thelbësore që duhet të debatohen. Grupi që ka kërkuar debatin, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj që e kanë bërë këtë punë, e kanë bërë shumë mirë, kanë elaboruar disa prej kërkësave të tyre dhe unë shpreh përkrahjen time edhe për rekomandimin e dytë, edhe për rekomandimin e katërt, do të thotë edhe për formimin e një komisioni hetimor dhe për konkursin e ri për anëtarë të bordit të RTK-së, edhe pse do të thotë, duhet të them edhe këtu, pajtohem pjesërisht te komisioni hetimor me atë që tha kolegu Haliti. Por, pyetja dhe dilema ime tash është, me formimin e një komisionit hetimor dhe me shpalljen e një konkursi, a po e ç'pështjellojmë lëmshin e RTK-së apo, fatkeqësisht, mos po e pështjellojmë ende. Pse e kam këtë dilemë. Nuk dyshoj në vullnetin tonë të mirë, në mendimin e mirë të Kuvendit për ta filluar këtë çështje. Problemi qëndron këtu: formimi i Bordit të RTK-së është përgjegjësi e Kuvendit. Qe sa vjet është zvarritur kjo përgjegjësi, do të thotë, ne kemi përgjegjësinë, një pjesë të përgjegjësisë për gjendjen e krijuar në RTK. Ne e kemi lejuar që RTK-ja të funksionojë pa bord, ne kemi lejuar që në RTK të ndodhin devijime të tilla programore, të politikave editoriale e tjera, e tjera. Është pikëpyetje edhe tash, a mund të formohet...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kosumi! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryesues,  
Ministra të nderuar,  
Deputetë të respektuar,  
Macioni shkrimor i dhënë nga grupi i deputetëve në këtë Kuvend, nuk është dhënë ad-hoc, që iu ka tekur dikujt apo kushdo qoftë që ka apo e ka pasur ndonjë tendencë, ose nga këto shqetësimë edhe të tjera, por këto, Menaxhmenti ilegal, për shkak se iu ka skaduar mandati. Bordi apo Këshilli, që ishte dashur të quhej Këshill, po e zëmë, asi soji, është fjala për një institucion shumë të rëndësishëm për informimin publik, po asi soji, me afat të skaduar, do të thotë inegzistent edhe më pastaj çfarëdo pune që do të bënte, do ishte apriori e paligjshme.

Sistemi i pagave, nuk ka sistem të pagash, por po e quaj asi soji, pagat ad-hoc, kush kaq, kush aq, edhe ato janë top sekret, madje, madje edhe për Komisionin për Buxhet, ju lutem, është fjala për paranë publike. Po ky është nonsens, që është totalisht i pranishëm. Sistemi i financimit, absolutisht i papranueshëm, i palogjikshëm, i imponuar që e favorizon dikë që pa kurrfarë merite të grumbullojë para, të distributojë para dhe mos të jep përgjegjësi, duke u thirrur në njëfarë premise, se qenka i pavarur e tjera, e tjera.

Pranimi në bazat nepotiste të individëve të pashkolluar e më pastaj shkollimi me paranë publike. Po, ju lutem, po kjo është totalisht e papranueshme. Reporteri, raportohet, dikush thotë raportuari. Ju lutem, ai është i stërvngarkuar me disa figura që vetë quhen analistë dhe ata janë ata që japid analiza edhe më pastaj, natyrisht që indoktrinojnë masën, sepse nuk është dhe nuk mund të jetë aq në nivel, apo jo.

Më pastaj, numri i madh i punëtorëve të Radiotelevizionit të Prishtinës që kanë mbetur pa punë, në gjendje sociale të mjeruar, ndërsa numri i konsideruar në këtë institucion me paga jashtëzakonisht të larta, jashtë kritereve, nuk është fjala, askush nuk është xheloz, në qoftë se meriton, le ta ketë, ama nuk e meritojnë për të pasur paga aq të larta edhe intransparente. Unë angazhohem, ju lutem, me plotë bindje se Kuvendi i Kosovës është institucioni suprem, sidomos kur është në pyetje ligji, më pastaj raporti për punën, nuk është fjala për interferencë në programin editorial, ani pse aty ka shumë parregullsi e pa hijeshi, e tjera, e tjera. Por, Kuvendi duhet të jetë në raport, cilido institucion, pra edhe Radiotelevizioni i Kosovës.

Duhet ta formojmë një komision parlamentar, hetimor, me një përbërje, jo po më teket mua, po e propozoj këtë, por le të jetë me të vërtetë serioze. T'ju caktojmë detyra dhe ato detyra janë të qarta, shihen nga këto, edhe nga macioni, por edhe nga këto thekse që u dhanë deri me tash. Shumica e tyre ishin me vend dhe afat për ta dhënë një raport, ju lutem. Por, vetëm po të ishte përfillë konkluzioni i Komisionit për Buxhet, që është një ndër, jo por i vetmi komision më kompetent, më meritor për çështjet e financave, atëherë do të ishte dashur të formohej komisioni hetimor. Por, si mund të tolerohet që një institucion me një rëndësi shoqërore të veçantë, të mbajë shumë konto, po e zëmë, Komisioni për Buxhet e di që janë 6 konto, por atëherë me bazë mund të dyshohet se ka edhe konto të tjera, e tjera. Po, kjo është totalisht e papranueshme, po edhe aty ka vend për të interferuar menjëherë Prokuroria Publike, por pse nuk interferon ajo prokurori? Këtu ka shumë gjëra. Prandaj, nga këto thekse dalin shumë detyra për shumë institucione tona. Nuk duhet të ngurojmë, jo kjo është çështje e këtij apo nuk është e jona. Këtu duhet që një numër i konsideruar i institucioneve. në bazë të këtyre theksimeve me përgjegjësinë e plotë t'i merrnin detyrat e veta, të vepronin dhe të raportonin.

KRYESUESI : Ju faleminderit, zoti Smaka!

Fjalën e ka, deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ.** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është debatuar edhe më parë për veprimtarinë e Radiotelevizionit të Kosovës, por edhe sot është akoma për t'u çuditur se si lejohet edhe më tej që të mashtrohen së pari ata që parapaguajnë, do me thënë, në këtë rast qytetarët dhe ata të cilët dëshirojnë që ky medium publik ta ketë misionin e vet në shërbim të interesave të qytetarëve të shoqërisë së Kosovës.

Për të ditur se ky televizion publik, a është i pavarur dhe si sillet politika redaktuese, do të ndalem vetëm te programi informativ dhe se sa është shkelur ligji apo nuk është shkelur ligji, jo vetëm tani, por që nga formimi i saj dhe sidomos që nga formimi edhe i institucioneve në nivelin lokal dhe atë qendror. Unë mendoj se që nga formimi i këtij mediumi, të quajtur publik, politika redaktuese ka qenë shumë larg së qeni i pavarur nga partitë politike dhe nga grupe të ndryshme të të fortëve në Kosovë dhe disa të interesit të njohur si shoqëri civile. Nganjëherë, është mendimi im personal, se Radiotelevizioni i Kosovës, me këtë politikë redaktuese, të ndalem aty ku është shkelur ligji, së pari neni 6, te standartet programore, ku thuhet: "RTK do të respektojë veçoritë dhe dinjitetin e njeriut, parimin e paanshmërisë dhe vetësinë e informacionit, pluralizmin e mendimeve, pluralizmin fetar dhe politik".

Të nderuar kolegë deputetë,

Që nga pas lufta, mua personalisht më është dukur se RTK-ja ka pasur mision më shumë të rrënojë politikisht Presidentin historik Dr. Ibrahim Rugova, e bashkë me të edhe Lidhjen Demokratike të Kosovës. Këtu kemi shumë fakte. Nuk do të ndalem, por ato i dinë edhe opinioni i gjerë dhe shumë njerëz anembanë botës edhe diasporës, ku shikohet edhe Radiotelevizioni i Kosovës.

Ajo, çka unë mendoj që është shkelur ligji, është edhe te neni 3. Do të siguroj që lajmet të mos jenë të njëanshme, të jenë të pavarura dhe të sakta, që komentet të jenë qartë të ndara nga lajmet dhe të identifikohen si të tilla dhe që materialet informative të jenë të kontrolluara me një kujdes të arsyeshëm, bazuar në rrethanat si në përmbajtjen e tyre, ... dhe faktet, para përhapjes së tyre për të siguruar se a janë më të sakta dhe sa më të famshme që është e mundur.

Kolegë deputetë,

RTK shumë herë i ka kushtuar më shumë rëndësi vizitës së ndonjë drejtuesi partiak në ndonjë katund apo ndonjë lagje të Kosovës, se sa aktivitetit të Presidentit të Kosovës dhe informata për aktivitetin e Presidenti të Kosovës, si në të kaluarën, si në të tashmen, shpeshherë ndodhë që të jepet vetëm si lajm i dytë, por edhe si i tretë, i katërt, nganjëherë edhe i pestë, bile, bile edhe në pjesën e fundit të lajmeve informative.

Ne nuk mund t'i myllim sytë dhe e dimë shumë mirë që bordit, jo vetëm që i ka kaluar mandati, por edhe drejtorit i ka kaluar mandati, duke u thirrur edhe në ligj, që mandati i drejtorit të përgjithshëm është 3 vjeçar dhe ne këtu e themi sot me plotë gojën, para këtij Kuvendi që, në bazë të ligjit, që 3 vjet nuk funksionon bordi. Bordi gjithmonë ka qenë bord politik, nuk ka qenë bord i pavarur, gjithmonë kanë qenë njerëzit politik, të njohur, pa i përmendor me emra, dhe kur kanë dashur njerëz të caktuar, si në bahë të babës, thënë më shkurt, kanë pasur hapësirë programore. Vetëm ata që kanë menduar ndryshe, në këtë rast, që nuk iu kanë përshtatur politikës redaktues, nganjëherë që kanë

pasur drejtim ndoshta edhe në një luftë vëllavrasëse, mendoj që ata nuk kanë pasur hapësirë në Radiotelevizionin e Kosovës. Kështu edhe mund të vazhdojë, nëse Kuvendi i Kosovës, apo ne deputetët nuk marrim hapa të ngutshëm për ndërrimin e gjendjes aty. Prandaj, Ligji është shkelur edhe në këto pika, është shkelur edhe te nenit 28 dhe në shumë, shumë pika, pa hyrë në anën financiare. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

**ARDIAN GJINI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Realisht, sot kam pasur në plan të flas krejt diçka tjetër, por duhet të kthehem në dy ose tri pika në temë, flasim për temën, nuk do të dal prej temës për shkak se po flasim për Radiotelevizionin e Kosovës, nuk po flasim vetëm për një medium publik, flasim edhe për mediumin më të fuqishëm në Kosovë, që do të thotë flasim për fjalën e lirë, kjo thotë flasim për demokracinë, në fund të fundit, për një hallkë esenciale të demokracisë.

Duhet të protestoj edhe njëherë të them se ne kemi përgjegjësi si Kuvend, mos të lejojmë që gjenjeshtra në Kosovë të shndërrohet në normë. Në Kosovë gjenjeshtra po shndërrohet në normë dhe duke dëgjuar, i paramendoj njerëzit të cilët e shohin televizorin, sidomos njerëzit e RTK-së, që e dinë se çka ndodhë aty dhe i dëgjojnë fjalët prej këtu dhe qeshin. Qeshin se edhe ata e kanë pranuar që është mirë të gjenjehet për interes të tyre. Qesh një grimere atje, që e di mbiemrin e vet qysh e ka, edhe ajo qesh dhe pajtohet me atë gjenjeshtë që po ndodhë këtu.

Thashë që Televizioni i Kosovës është një hallkë tepër e rëndësishme e demokracisë në Kosovë dhe me qenë se filluam të krahasojmë, do t'ju tregoj shkurt për një minutë një bisedë timen të vitit 2006 me shumë njerëz dhe me komisionarë për atë se si është sjellë Radiotelevizioni i Kosovës, kur ne kemi qenë në pushtet. Në një natë të vetme, të mërkurën, në lajmet qendrore, jo vetëm një natë, po një natë është specifike për shkak se kemi shkruar ankesë. Lajmi i parë ka qenë takimi i Kabinetit të qeverisjes të mirë në hije, 7 minuta zoti Thaçi, ndërsa takimi i Qeverisë së Kosovës, që merr vendime përvendin, ka qenë lajm i katërt dhe ka filluar me fyerje ndaj ish ministres Tërmkollit, ndaj meje, ndaj të gjithë njerëzve tjerë dhe dikush këtu më thotë mua se ju keni bërë njëjtë. Po ju them - jo, nuk kemi bërë njëjtë, pika e parë pse nuk kemi bërë njëjtë. Pika e dytë, pse nuk kemi bërë njëjtë, është se sot, të nderuar kolegë deputetë, ministra, i nderuar zoti kryesues i seancës, është ndërprerë transmetimi i drejtpërdrejtë kur deputetja e opozitës e ka mbajtur fjalën. Shikoni, pa dhënë kualifikime, pa dhënë kualifikime, secili prej jush, secili njeri në Kosovë, duhet të vë gishtin në kokë dhe të mendojë kur ka ndodhur kështu? Ku ndodhë kështu, ku ndodhë të ndërpitet transmetimi në minutën kur e merr fjalën përfaqësuesi i opozitës dhe të rifillojë kur e përfundon fjalën. Cilat janë ato vende ku ndodhë kështu. Edhe kjo është pikërisht në temë, po flasim pikërisht për Radiotelevizionin e Kosovës. Së fundi, ne jemi deputetë, ne jemi deputet dhe mendoj se nuk do koment, ajo që e thashë më përparrë nuk do koment. Mendoni shumë mirë ju dhe kushdo qoftë që e dinë këtë fakt të sodit, mendoni shumë çka jemi duke i bërë vendit. Ku e çon vendin logjika e tillë. Kush është ai njeri që e ka prekur sustën dhe a e di ai njeri që e ka prekur sustën se është duke e sakatuar vendin, është duke e sakatuar një luftë 20 vjeçare për të mbërrí ku jemi këtu. E fundit është kjo. Ne jemi deputetë, kemi të drejtë të shprehemi lirë. Thashë edhe njëherë, fjalë e lirë është hallka kryesore e demokracisë. Ne nuk kemi nevojë fjalën tonë t'ia sjellim Kryetarit të Kuvendit të na e redaktojë. Edhe ne ndërtojmë kontekst dhe kur ndërtojmë kontestin kemi të drejtë të shërbehem me informata, kemi të drejtë edhe të mendojmë gabueshëm, nëse është gabueshëm eventualisht diçka. Por, kemi të drejtë të themi çka mendojmë dhe për kënd

mendojmë. Kushdo që mendon që ne nuk duhet të kemi të drejtë, se e kemi gabim, prapë është duke e sakatuar një luftë 20 vjeçare. Nuk po them vetëm luftën me pushkë, por një luftë 20 vjeçare të secilit njeri në Kosovë. Ne nuk e kemi ulur kryet edhe kur na kanë shti në burg pse i kemi quar dy gishta. Qysh guxojmë sot me të vijmë në pozitë të na ndalet fjala se dikujt nuk i pëlqen çka po themi, edhe kjo është fjala e lirë, edhe kjo është Radiotelevizioni i Kosovës.

Mendoj se Kosova sot duhet të mbajë në mend ditën, duhet mësuar shumë prej kësaj dite dhe është momenti i fundit, secili njeri të ulet vetëm njëherë dhe të reflektojë, të mendojë se çka jemi duke i bërë vendit. A është kjo rruga që po e duam, dhe nëse guxojmë të themi, a duhet dikush ta mbrojë me këmbëngulje të drejtën e opozitës për të folur. Lidershipi, Qeveria demokratike është ekzakt ajo e cila me këmbëngulje e mbron të drejtën e opozitës për të folur, edhe nëse i duket që e ka gabim. Nëse ndodhë ndryshe, nuk kemi leadership demokratik, kemi leadership totalitar, që do ta mbysë fjalën e opozitës, qoftë gabim, qoftë e drejtë, edhe njëherë po ju them.

E fundit, është fjalia e fundit, mbajeni mend këtë ditë të sodit, kur iu është ndalur fjala një deputeteje të opozitës prej Radiotelevizionit të Kosovës...

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Gjini!  
Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

**LUTFI HAZIRI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Jam i obliguar që të sqaroj pjesë të angazhimit. Natyrisht që kemi mbështetur debatin, natyrisht që jemi pjesë e një debati konstruktiv, por ajo që dëshiroj të potencoja edhe një herë, në kapacitetet e mia, si deputet dhe si përfaqësues i një partie politike që mban përgjegjësinë për këto institucione, është që ky Kuvend i madh e ka për obligim ligjor dhe kushtetues të zgjedhë Bordin e RTK-së. Gjithçka më poshtë, është ndërhyrje e institucionit, i cili duhet të garantojë ligjshmërinë, ndërhyrja e institucionit në politika tjera. As politika redaktuese, as politika kadrovike, as politikat tjera, ne nuk guxojmë të rrëshqasim, si Kuvend nuk guxojmë të rrëshqasim, si deputetë, dhe duhet garantuar institucionin publik për qëndrueshmëri financiare, si detyrë e dytë, që e tha deputeti Koci më herët.

Funksionimi i bordit dhe funksionalizimin e atij bordi është obligim gati qe tri vjet i këtij Kuvendi. Drejtorin gjeneral të Televizionit dhe drejtorët nëpër institucion brenda RTK-së, është një ligj tjetër i cili e rregullon dhe për të cilin ne duhet të garantojmë.

Konkursi publik, intervistimi dhe politikat e regrutimit në Kosovës janë të rregulluara me ligj. Ato i bën dikush tjetër, nuk i bëjmë ne. Edhe njëherë i bëj thirrje Kuvendit, kryetarit të Kuvendit edhe Kryesisë së Kuvendit, që është e detyruar ta zbatojë vendimin e këtij Kuvendi, që të ftohet Komisioni ad-hoc, i zgjedhur nga ky Kuvend, të fillojë punimet për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, të sillen sa më shpejt në Kuvend për votim dhe t'i jepet detyra e madhe atij bordi që të fillojë zbatimin e politikave që ia njeh Ligji në televizionin publik. Rrugë tjetër nuk ka. Ky Kuvend nuk bënë hetime, ky Kuvend po krijon përshtypje që ne jemi të interesuar ta dimë cilin tender, cilën detyrë kush ia ka dhënë televizionit publik. Mua nuk më intereson ajo punë, janë organet tjera që merren me ato. Unë e kuqtoj vullnetin e mirë të vendoset ligji dhe të vendoset rregull gjithkund, ku kemi autoritet kushtetues, por nuk guxojmë të rrëshqasim ne, të marrim rolin e Prokurorisë apo të Auditorit Gjeneral, as të lëmë përshtypje të tillë, sepse po del në pah që ne po i mbrojmë interesat e një grupi tjetër të interesit atje, që do

të marrë punë. Këto janë probleme menaxheriale, nëse ka bërë gabime, nëse janë bërë lëshime, le të konstatohet dhe ai që konkuron mandej për t'u bërë drejtor aty, i thuhet dhe i tregohet qartë ku ka shkelje ligjore, apo nëse kemi probleme më të mëdha, kemi probleme që duhet të merren institucionet e pavarura me të, e jo Kuvendi i Republikës.

Nëse e përbledh krejt diskutimin tim, ka të bëjë ky Kuvend, zoti kryesues, të lutem, detyroje ta luajë rolin e vet kushtetues që e ka. Ai rol është që, konstatimi ynë i përbashkët të dalë që përzgjedhja e bordit nga ana e Komisionit ad-hoc është detyra e vetme dhe kryesore e këtij organi, pjesa tjeter i jepet detyrë e shkruar, ditën që votojmë ne për anëtarët e bordit. Të gjitha detyrat, të gjitha problemet e notuara, të gjitha kërkesat që i kemi, bordi që zgjidhet nga ky Kuvend i merr dhe shkon atje për t'i realizuar. Ai televizion është pa bord, ai televizion është me ushtrues detyre. Njerëzit e lëshojnë, njerëzit ikin. Ai televizion ka mbetur pa qëndrueshmëri financiare. Nuk mundemi ne të themi që RTK-ja ka problem se nuk e mbulon territorin e Kosovës. Këto janë probleme që duhet garantuar qëndrueshmëri financiare, të investojmë si institucion atje dhe mandej të kërkojmë diçka më shumë.

Këto janë probleme që unë i shoh kështu dhe kërkesa ime ka të bëjë ndaj këtij institucioni që ne ta marrim detyrën tonë ta realizojmë: Nëse ne e zgjedhim Bordin shpejt, e komisioni ekziston, grapi ad-hoc ekziston. Nëse ne e zgjedhim bordin, ne e kemi zgjedhur problemin në Televizion publik. Ju faleminderit!

#### Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Hajdin Abazi e ka fjalën, le të përgatitet Gjylnaze Syla.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Qëndrimin tim në lidhje me problemet në kuadër të RTK-së dhe zgjidhjen së tyre i kam shprehur edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Komisionin për Media, madje i kam shprehur edhe këtu, por atëherë kur ka qenë momenti dhe kur kemi diskutuar konkretisht. Sot, ky debat është iniciuar pa vend dhe para kohe, pse? Sepse në Kuvend këtu kemi një lloj demokracie, që quhet demokraci procedurale dhe ne e kemi dhënë procedurën që Komisioni ad-hoc të punojë dhe limitet e Komisionit ad-hoc janë deri sa kalon ai mandati kur, nëse ata vetë nuk mblidhen, Kryetari i Kuvendit i thërrret dhe e organizon punën e tyre. Do të thotë, është dashur të pritet. Nëse kjo nuk funksionon, atëherë ky debat do të kishte qenë me vend. Pavarësisht kësaj, unë nuk pajtohem absolutisht me kërkesat të cilat janë parashtruar, se rekomandimet që janë bërë, le të shkojnë kështu. Rekomandimi i parë është një masë, që thotë: Shkarkimi emergjent i bordit dhe i menaxhmentit, kjo është masë që na kujton masat e dhunshme, kur ne duhet ta bëjmë. Dhe, ne kur kemi iniciuar një procedurë të rregullt.

Kemi rekomandimin e tretë, emërimin e një menaxhmenti të përkohshëm, do të thotë, që këtyre herë i kanë thënë drejtori e dhunshme, nëse duam ta kujtojmë më saktë dhe kemi shumë interesant rekomandimin e tretë që të shpallet një konkurs i ri. Kolegë, konkursi është shpallë, është në procedurë dhe ne jemi ata që kemi krijuar një komision ad-hoc, i cili do të merret me atë konkurs dhe kompetent për ta shpallur konkursin është KPM-ja, nuk është Kuvendi i Kosovës. Mund të bëhet kërkesë për një konkurs të ri vetëm nëse dështon në afat të rregullt që Komisioni ad-hoc të bëjë një përzgjedhje dhe ne nuk arrijmë të votojmë një bord të RTK-së.

Dhe, e dyta, debati këtu u nis keq, u nis me atë ritmin me filozofinë e kaosit që për gjithçka të niset me insinuata dhe të stigmatizohen edhe ata që më së paku kanë përgjegjësi, kur ky bord dhe ky menaxher i RTK-së është vendosur aty. Edhe sot, ata që për tri vjet e kanë heshtur gjatë pushtetit të tyre këtë çështje, sot tash e akuzojnë dikë tjetër. Kjo nuk është e ndershme. Unë jam dakord që duhet të gjejmë zgjidhje, po së pari do të duhej të thoshim që ne kemi heshtur në kohën tonë dhe tash, urdhëroni ju, zgjidheni problemin.

Dhe së fundi, kur flasim për RTK-në, duhet ta kemi parasysh që flasim për lirinë e fjalës, për lirinë e mediave dhe ne duhet të jemi shumë të kujdeshëm këtu, sepse çdo cениm i kësaj lirie do të na kushtojë tek Unioni Evropian, te Këshilli Evropian, që na përcjell se sa ne po jemi tolerantë. Këtu, si shumicë, jemi treguar jashtëzakonisht tolerant ndaj opozitës, duke lejuar të flasë rend e pa rend, duke tejkaluar e duke dalë gjithnjë jashtë rendit. Pse, sepse pikërisht me këtë tregojmë se këtu ekziston një demokraci. Mirëpo, ne nëse e cenojmë lirinë e medieve, e kemi cenuar lirinë e Kosovës, e kemi cenuar imazhin tonë para Bashkimit Evropian dhe para gjithë vendeve demokratike të botës. Kjo nuk na lejohet ne ta bëjmë, ne na lejohet që në procedura të rregullta, sikurse që kemi nis me Komisionin ad-hoc, që gjatë mandatit është i caktuar ta zgjedh problemin dhe vetëm nëse atëherë dështon, ne mund të ndërmarrim diçka. Dhe, për fat të keq, këtu u tha se nuk ka kulturë debati. Kulturë debati në Kuvendin tonë ka, por është një kulturë destruktive, një kulturë që për dalë jashtë rendit të ditës, për një pikë për të cilën flasim t'i ngatërojmë 100 pika të tjera dhe është një kulturë e cila ka për qëllim të satanizon gjithçka të mirë dhe gjithçka të mbarë që është bërë dhe po bëhet në Kosovë. Uroj që këto të mos përsëriten. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla, le të përgatitet Bahri Hyseni.

**GJYLNAZE SYLA:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, dy janë,

Të nderuar deputetë,

Unë po filloj se çka është tema, meqë Kryetari i Kuvendit e bëri çështje, pra po e lexoj.

Në bazë të rregullës 23.2 të Rregullores së Kuvendit, i propozojmë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që ta radhisë në rendin e ditës të seancës së ardhshme plenare të Kuvendit gjendjen e krijuar në Radiotelevizionin e Kosovës. Zoti Kryetar, tema është gjendja e krijuar në Radiotelevizionin e Kosovës dhe aty do të përqendrohem. Cila është e vërteta, cila është gjendja.

Mendoj që nuk duhet fakt më të madh se sa dita e sotme. Cilat janë të drejtat tona ligjore të përcaktuara sipas Ligjit për RTK-në. Po e lexoj prapë nenin 1 pikë 2. Themelues i institucionit publik të RTK-së është Kuvendi i Kosovës, pra ne jemi themelues të RTK-së. Do të jetë detyrë e themeluesit të mbrojë autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së.

Zoti Kryetar,

Sot Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës pikërisht e kërkoi këtë, që të mbrohet dhe të ruhet autonomia dhe pavarësia e RTK-së dhe në këtë kontekst ishte edhe fjalimi ynë.

Cili është fakti se kjo s'po ngjanë, nuk duhet më shumë se sa përvoja e sodit. Derisa deputetja Donika Kadaj foli në emër të Aleancës, u ndërpren transmetimi. Pse? Pse u ndërpren transmetimi pikërisht kur folëm ne? Do të thotë, është kontrolluar. Nëse e di dikush, mund të tregoj se kush e bëre këtë. Ky është fakt i kontrollit dhe atë sigurisht jam e bindur, i kontrollit qeveritare.

Të nderuar deputetë,

Po vazhdojë me një çështje tjeter. Është koha të thuhet e vërteta, nuk duhet të frikësohem nga e vërteta. E vërteta është se transmetuesi publik po kontrollohet dhe se ka presion publik, politik dhe se ky Kuvend e ka obligim ligjor që ta ruajë dhe ta mbrojë nga këto ndikime politike. Leni gazetarët le ta kryejnë punën e vetë, leni RTK-në të jetë transmetues publik i përgjegjshëm dhe në interes të publikut. Debat duhet të zhvillohet edhe këtu dhe ky debat duhet të transmetohet, është pjesë e demokracisë dhe ne jemi ata që duhet ta mbrojmë pikërisht këtë demokraci.

Fakti tjeter është se nuk është përzgjedhur bordi dhe, natyrisht, kjo ka ndikuar në punën e RTK-së. Por, është gjithashtu fakt dhe e vërtetë se kryetari i Komisionit ad-hoc parlamentar është zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Sa mund të mos ketë ndikim të politikës në qoftë se kemi zëvendëskryeministrin në krye të këtij komisioni.

Të nderuar deputetë,

Në fund të fundit, nuk është vetëm Aleanca që e thotë këtë. Merrni raportet, lexoni raportet e Komisionit Evropian, lexoni raportet e Freedom house dhe e shihni se sa ka liri të mediave, sa ka mendim të lirë. Çfarë mendimi të lirë ne po krijojmë në qoftë se fjalimet e Kuvendi nuk transmetohen ose në qoftë kryetari i Kuvendit e merr fjalën duke mos e respektuar Rregulloren dhe, për më tepër nuk, lejon të replikojë në fjalët që i thotë.

Tash, dëshiroj t'ju kujtoj se cili është veprimi i dytë urgjent që duhet të bëjmë ne. Është financimi i RTK-së. A është i qëndrueshëm financimi i RTK-së, dëshiroj që secili nga ju të mendoni për këtë.

Në fund, fjalën time dua ta përmbyll se nuk do të lejojmë diktat në Kuvend dhe as diktaturë në Kuvend.

Zoti Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kryesisë,

Ju kujtoj se asnijëherë nuk e keni zbatuar Rregullën 5.4, sipas të cilës Kryesia angazhohet që së paku një orë e seancës i vihet në dispozicion opozitës për çështjet të cilat dëshiron t'i shtrojë. Nëse ndonjëri nga deputetët e pozitës ka menduar se iu ka falë diçka opozitës, jo, nuk është respektuar rregulla sipas të cilës një orë për çdo seancë i lihet opozitës për çështje që dëshiron t'i shtrojë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Me kërkësë. Nuk keni pasur asnijë kërkësë opozita për diçka të tillë. Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet Adem Salihaj.

**BAHRI HYSENI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Konsideroj se po debatojmë për një çështje shumë me rëndësi, mirëpo ndoshta vullnet i Kuvendit të Kosovës është që çështjet që po i debatojmë, t'i bëjmë institucionale. Nuk e konsideroj që është mirë të debatojmë për çështjet dhe për rekomandimet, të cilat po kërkojnë një logjikë dhe një rrugë tjeter për të lënë rrugën institucionale dhe për të kaluar në një rrugë të anarkisë, një rrugë për të formuar komisione dhe borde, të cilat më së tepërmë i kanë kushtuar Kosovës. Kosova ka derdhur gjak, kemi bërë punë të madhe për t'i krijuar institucionet dhe duhet ta ruajmë besimin në institucionet që i kemi krijuar vetë.

Unë do të ndalesha pikërisht te rekomandimet që i ka kërkuar ky grup i deputetëve. Kam respekt shumë, por a thua a jemi të vetëdijshëm që ne si organ përfaqësues, si organ më i lartë i Kuvendit të Kosovës, çka po kërkojmë. Po thirremi në ligj dhe po kërkojmë diçka komplet kundër ligjit. Ku shkruan që kemi të drejtë ne ta shkarkojmë drejtorin e Radiotelevizionit të Kosovës, ku shkruan që kemi të drejtë ne të auditojmë, sepse ne kemi një auditor të cilin e paguajmë shumë dhe shumë i kushton Kosovës, është auditori i pavarur dhe ku e kemi këtë të drejtë ne të krijojmë aditor. Fundi i fundit, ku kemi të drejtë ne, si deputetë dhe si Kuvendi i Kosovës, të krijojmë një situatë për të bërë diktat qoftë ndaj agjencioneve të pavarura, qoftë ndaj televizioneve apo mediave publike. Ne kemi të drejtën të krijojmë një bord, bord të cilin e kemi krijuar dhe i cili së shpejti ndoshta do të mblidhet. Ne kemi të drejtë të kërkojmë raport, por nuk kemi të drejtë të kërkojmë rrugë jo institucionale dhe rrugë të cilat nuk na sjellin në situatë.

Ajo çka më bëri të diskutoj, është edhe çështja e deputetëve që vinë nga opozita. Është shumë e vërtetë dhe të gjithë jemi që ne t'i depolitizojmë, t'i familjarizojmë të gjitha institucionet, por të lutem, e nderuara deputete, sot kur po flasim, unë kisha dash ta di si deputet i Parlamentit të Kosovës, kush nga anëtarët e familjes së Qeverisë punën në Radiotelevizion, kisha dashur ta di, unë nuk e di. Unë e di që punojnë edhe nga familja e ish kryeministrat, lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, edhe nga familja Foniqi, edhe nga familja Muçaj, edhe familje të tjera. Është mirë ta kuptojmë kush nga familjet e Qeverisë punon në këtë medium.

Çështja tjetër. Po kërkojmë Komision Hetimorë Parlamentar. Ku është e drejta jonë? Po, është me Kushtetutë, po nuk është që të krijojmë Komision Hetimor Parlamentar kur ty ta merr mendja, se ti nuk je ekspert. Ne kemi dhanë mund të krijojmë televizione publike të lira, jo vetëm televizione, por edhe agjencione publike, prandaj nuk është e drejtë e jotja ta humbësh besimin. Nëse e ke humbur besimin në vetvete, nuk duhet humbur besimin në auditor, në institucione e tjera. Prandaj, kjo logjikë për të krijuar institucion mbi institucion, për të krijuar sisteme paralele, kemi boll sisteme paralele dhe institucion paralele. Bëni luftë për t'i eliminuar sistemet paralele, bëni luftë për t'i eliminuar të gjitha komisionet të cilat vendosen për të kontrolluar institucionin, janë të pabaza, janë jokushtetuese, janë jodemokratike dhe, fundi i fundit, ne këtë institucion e kemi krijuar me ndjerës dhe nuk duhet sot që Kuvendi të shfaqet në atë formën e diktaturës dhe hajde të shkatërrojmë, hajde të krijojmë, ne jemi mësuar vetëm para viteve '99 me ato borde që i kanë krijuar dhe kanë pastruar me mijëra shqiptarë prej punës. Nuk ka nevojë, dëgjo, e kemi krijuar një bord, ky bord do të mblidhet së shpejti.

Dhe, krejt në fund, është mirë edhe ligjin ta lexojmë, ligji nuk i ndalon as zëvendëskryeministrat të Kosovës, nuk kam dalë për ta mbrojtur zëvendëskryeministrin, por ligji kërkon të dërgohet nga një përfaqësues të partive politike dhe përfaqësuesi i partive politike në këtë rast mund të jetë edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, është pikërisht me ligj. Por, derisa kanë të drejtë të gjitha partitë politike me ta çojnë, atëherë kush, cili ligj ia imponon Partisë Demokratike të Kosovës ta çojë një anëtar të vetin cilind, pavarësisht a është Kryeministër, a deputet, apo edhe ndonjë referent kudo që punon.

Zoti Kryetar,  
Falënderoj, dhe kisha kërkua që...

KRYETARI: Faleminderit, shumë!  
Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, pas Ademit do ta marrë unë pak fjalën.

ADEM SALIHAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pas meje mund ta marrësh fjalën, po të lutem mos i komento ato që them, se kam të drejtë në replikë dhe duhet të ma japësh fjalën përsëri.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj që tema është shumë e qëlluar, ne kemi debatuar për Raportin e RTK-së, kemi pasur po thuaj të njëjtat vërejtje dhe situata atje vazhdon të jetë e njëjtë. Pra, i kemi tri vite që e kemi këtë situatë. Të gjitha këto që u përmend këtu, gjashtë llogari, 240 punëtorë me kontratë, që është krejt joligjore, mungesa e këshillit drejtues, mungesa e menagjmentit, kontrata që bënë dikush aty me vëllain e tij, që është fakt, mund të jetë ai vetë, por e ka një firmë në emër të vëllait, ose tjetra kontratë me ABB-në, që është i njëjtë person këtu dhe i njëjtë person atje. Shumica prej këtyre çështjeve këtu janë, në fakt, edhe vepra penale dhe askush s'merret me këtë, që tregon se jo RTK-ja, por edhe prokuroria, edhe gjyqësia mund të jenë krejt të ndikuara politikisht dhe i mbyllin sytë para gjërave që shihen prej aeroplanit. Mos të flasim edhe për Agjencionin e Antikorrupsionit, e cila i përcjell të gjitha këtu dhe nuk ndërmerr asnjë hapë në këtë drejtim.

Të flasim tash për përgjegjësitë e Kuvendit. Kuvendi ka përgjegjësi ta emërojë Bordin. Ne e kemi krijuar një komision ad-hoc, të cilin e udhëheq zëvendëskryeministri, po e udhëheq, shihet qartë vizuelisht që e udhëheq Qeveria, jo Parlamenti. Kjo është përshtypja vizuele dhe përmbajtja është e njëjta gjë. Dhe, nëse Qeveria e udhëheq një komision ad-hoc për ta zgjedhur Bordin e RTK-së, do të dihet çfarë bordi do të kemi në RTK, i cili, në fakt, do të jetë i ndikuar plotësisht politikisht nga Qeveria. Tash këtu është një luftë se kush ka ndikim më të madh. Po, thotë Kryetari, kemi ne, po keni edhe ju. Do të thotë, janë përzier këtu, është një luftë e ndikimit politik në RTK dhe shihet që RTK-ja në asnjë situatë nuk do të ketë një paanësi në aspektin e informimit publik. Nëse s'është nën ndikimin e njërit, do të jetë nën ndikimin e tjetrit, por jashtë ndikimit nuk do të jetë në asnjë situatë dhe ne duhet ta presim këtë edhe në të ardhmen dhe, për mua, nuk është aspak me rëndësi kush jep lajme, cili spiker, cili e fshin korridorin e RTK-së, cili rri te porta. Politikën redaktuese të RTK-së e bën dikush tjetër dhe e lexon një spiker ose e fshin korridorin një tjetër. Pra, është me rëndësi kush e bën atë politikë dhe atë politikë në mënyrë joligjore e bën qe tri vjet një bord dhe një menaxher, i cili nuk ka kompetenca ta bëjë këtë.

Ne e dimë fare mirë se gjashtë llogari nuk mund t'i ketë asnjë lloj institucioni publik. Kjo është krejt kundër ligjore, është vepër penale, është mënyra për t'i fshehur dhe për t'i keqpërdorur financat publike. Ne e dimë këtë, e kemi pasur edhe në raport dhe vazhdon kjo gjendje që është.

Pastaj, fakti që dikush bën kontratë me mjetet publike të RTK-së me vëllain e tij ose me vetveten, sepse ne dimë plot firma që regjistrohen në emër të vëllait, por ky është vetë ai që e menaxhon atë, është përsëri konflikt interesit dhe ndoshta ka elemente të veprës penale.

Është një shembull tjetër që shihet prej aeroplanit, një personi që e udhëheq një emision në RTK i jep 4500 euro vetëm për një emision që zgjat një orë ose dy orë. Krahasoni me çfarëdo të ardhurash në Kosovë, krahasoni me cilindo efekt që mund të ketë dikush në aspektin ekonomik, sa është e arsyeshme edhe e kuptueshme t'i marrë dikush 4500 euro për një emision dhe kjo ka ndodhur në RTK. Të gjitha këto janë mënyra për t'i keqpërdorur maksimalisht paratë e qytetarëve të Kosovës, të cilat merren në mënyrë të detyrueshme përmes takstsës, që është tri euro e gjysmë në muaj, edhe prej personave që janë të varfër, edhe prej njerëzve që janë në pension, edhe prej njerëzve që nuk e shohin

asnijëherë RTK-në sepse nuk ka rrjet në atë pjesë, edhe prej atyre që nuk duan ta shikojnë, se ka tash televizione satelitorë sa të doni dhe nuk janë të interesuar ta shikojnë RTK-në. Pra, merren në mënyrë të detyrueshme dhe përdoren, siç po shihet, për interesa thjeshtë personale, klanore, grupore, ndoshta edhe partiake. Është një situatë që na kompromiton ne si institucion. Ne kemi mundësi të ndikojmë në këtë, kemi mundësi në format ligjore në kuadër të përgjegjësive të Kuvendit, jo në politikën programore të RTK-së. Nuk jemi

...

KRYETARI: Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Tani do ta marrë fjalën Kryetari, Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Dua të flas si deputet dhe fillimisht dua të them që vërtetë mendoj se shpesh herë po keqpërdoret fjala për shkak të rendit të ditës, ka diçka tjetër në rend të ditës dhe pastaj flitet krejt diçka tjetër. Është në rend të ditës çështja ose gjendja në RTK, pastaj sulmohet Kuvendi, sulmohet Kryetari i Kuvendit, sulmohet Qeveria, do të thotë dilet në gjithë hapësirën vetëm sa të kritikohen njerëzit dhe mendoj që kjo praktikë nuk është mirë dhe nuk e nderon as deputetin, nuk e nderon as Kuvendin dhe s'e nderon askënd në Kosovë. Kisha dëshiruar që vërtet kur të kemi një çështje në rend të ditës, të përqendrohemti te rendi i ditës dhe të bëjmë çka mund të bëjmë në atë rend të ditës, se prandaj vërtetë po akuzohet Kryetari dhe Kryesia pse një çështje e kanë vënë në rend dite.

Ju lutem, 6 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë mocion edhe për Kryeministrin edhe për çdo ministër. Sa mocione i keni bërë të tilla? Kur i keni bërë, kanë ardhur, do të thotë, kërkuesat nuk kanë qenë me shkrim dhe ne, si Parlament, s'kemi mund t'i adresojmë çështjet që vetë si keni kërkuar ju.

Tash, të hyj në rend të ditës. Çka ka Kuvendi përgjegjësi në raport me Radiotelevizionin e Kosovës. Pealisht, çështja e parë është që Kuvendi e ka miratuar Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës, çështja e parë.

Çështja tjetër është zgjedhja e Bordit. Ju lutem, edhe në mandatin e kaluar ka qenë, kah fundi i mandatit çështja e zgjedhjes së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe nuk është zgjedhur. Në titor apo nëntor të vitit të kaluar e kemi formuar një bord dhe nuk ka funksionuar. Para një muaji është zgjedhur edhe një komision tjetër ad-hoc dhe përsëri komisioni nuk është mbledhur për t'u funksionalizuar. Partia Demokratike e ka një anëtar në atë komision, e kryeson. Nëse anëtari që është zgjedhur për ta kryesuar, nuk e kryen deri të enjten, të enjten Kryetari po e merr përgjegjësi ta thërrasë për të premten komisionin dhe komisioni ta kryej këtë detyrë ligjore që e ka. Do të thotë, kjo është detyra e Kuvendit të Kosovës në raport me Radiotelevizionin e Kosovës.

Sigurimi i mjeteve financiare është përgjegjësi e jona, të nderuar deputetë. Dhe, ne kemi bërë një zgjidhje të përkohshme, mendoj që Radiotelevizioni i Kosovës duhet ta ketë një zgjidhje të përhershme financiare, qoftë edhe obligimi i Qeverisë për t'i dhënë mjetet buxhetore, në fund të fundit, ai është televizion publik dhe ashtu-kështu qytetarët e Kosovës po i japin mjetet për ta funksionalizuar, për të punuar ky televizion publik.

Tjetër, është sigurimi i pavarësisë editoriale. Vërtet, nëse është obligim i Kuvendit sigurimi i pavarësisë editoriale, kërkuesat që vinë nga grapi i deputetëve e humb këtë pavarësi dhe ne s'mund të pajtohemti me ketë kërkësë, se mendoj që është kërkësë e jashtëligjshme dhe një kërkësë që nuk kemi të drejtë ta bëjmë ne, si Kuvend.

Dhe, një obligim tjetër i Kuvendit është mbikëqyrja financiare. Po, me këto mendoj që mbarojnë të drejtat dhe obligimet e Kuvendit të Kosovës, si institucion ligjvënës, në raport me Radiotelevizionin e Kosovës. Prandaj, mendoj që ne duhet ta bëjmë përzgjedhjen e bordit, bordi pastaj le të merret me bordin menaxhues ose udhëheqjen menaxhuese të Radiotelevizionit të Kosovës, ajo e drejtë nuk është e jona. Kërkesa që ne ta ndërojmë Bordin Ekzekutiv të Radiotelevizionit të Kosovës është e jashtëligjshme dhe ne, si deputetë, nuk duhet t'ia lëmë vetit një diçka që nuk na takon neve.

Prandaj, ju kisha lutar që ne, si Parlament, në rend të parë ta kryejmë obligimin tonë që e kemi në raport me Radiotelevizionin e Kosovës dhe që, si Parlament, së paku nëse të tjerët paskan ndërhyrë në politikat redaktuese të Radiotelevizionit të Kosovës, ne si Kuvend mos ta bëjmë një gjë të tillë. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Krasniqi!

Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu:

**EQREM KRYEZIU:** Faleminderit, zoti kryesues, edhe zoti Kryetar, që sa po uleni në karrigen e udhëheqësit, dhe do t'ju kërkoja leje të përshëndes edhe një ministër, dy janë këtu, dhe zonjat e zotërinjtë deputetë.

Unë e përcolla me vëmendje të madhe ndërhyrjen e Kryetarit të Parlamentit për këtë çështje dhe me fjalën time po e siguroj si Kryetarin, si juve, si opinionin tjetër, se nuk e kam ndërmend të shfrytëzoj, thjesht, politikisht çështjen e RTK-së. Me një fjalë, do të përpinqem, nuk jam i sigurt a do t'ia dalë, por do të përpinqem që të jem përtej pozitës dhe opozitës.

Dhe, ajo që besoj, unë po i shpreh shqetësimet e mia, nuk ka lidhje me partinë time kjo, edhe pse unë mund të vajtoj, si viktimi, por nuk e kam ndërmend të vajtoj.

Dhe, çka është ajo përtej pozitës dhe opozitës, neve nuk na intereson degjenerimi i RTK-së. Është investim shumë i madh, shumë i gjatë, si kohë, duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të jetës së sotme, shumë i gjatë si kohë, që të shikojmë degjenerimin e tij. Shikoni çka po ndodh? Dikush ankohet se politika redaktuese, që e përmendi Kryetari, dhe kjo është ajo që mua më shqetëson. Për financa nuk jam ekspert, dolën se ka vërejtje shumë financa, por sa vërejtje mund të ketë në politikën redaktuese, kjo është shqetësuese. Në qoftë se janë, si të them, në përpjesët tē drejtë shpërdorimet financiare me shpërdorime në politikën redaktuese, me të vërtetë është për t'u brengosur se po degjenerohet një institucion shumë i rëndësishëm, jo pse unë ia kam inati ose pse po kam dëshirë ta luftoj. Çka do të thotë kjo? Në qoftë se vazhdon kështu, kam frikë se do t'i vijë turp dikujt, secilit, në daç të pozitës, në daç të qeveritarëve, në daç opozitës të dalë me penxhere të caktuara, televizione të caktuara, që kjo do të ishte humbje për Kosovën, jo vetëm për politikën redaktuese të RTK-së.

Natyrisht, zoti Kryetar, edhe zonja e zotërinj, të paktën botëkuptimet e partisë sonë, po besoj edhe të secilit njeri normal, janë definitivisht një qëndrim i vendosur se askënd nuk do të guxojmë ta privojmë nga ëndrrat që ai do të duhej të kishte për lirinë edhe demokracinë, pa marrë parasysh sistemet në të cilat ka jetuar.

Mirëpo, zoti Kryetar, në qoftë se lihet përshtypja se shkëlqimi i salloneve të totalitarizmit, ku unë kam marrë pjesë ose dikush ka marrë pjesë, më verbon tash për të parë ligjet e reja të Kosovës së pavarrur, kjo është një pikëpyetje, kjo është një pikëpyetje, unë po paralajmëroj se është edhe e mundshme një gjë e tillë. Dhe, çka ndodh me RTK-në, që do

të duhej jo vetëm të paraqite fytyrën e Kosovës, identitetin e saj, po do të duhej të merrte pjesë në krijimin e identitetit të Kosovës. Në qoftë se nuk ka një politikë redaktuese që nuk e këqyrë me përbuzje përpjekjen e shqiptarëve dhe të tjerëve për të bërë një shtet të pavarur ose nuk është servil ndaj pushtetarëve aktualë, se përbuzja dhe servilizmi janë pjesë të një medaljeje dhe unë po ju besoj se asnijërit, po ju siguroj, më falni, se nga një herë po frymëzohem po lidhje. Unë po ju siguroj se nuk i bën shërbim asnjë ministri një paraqitje të tillë në televizion. Ju e keni parë, zakonisht përfaqësuesit e institucioneve kryesore, edhe kohën kur LDK-ja ka pasur 60%, kanë dalë të sheqerosur, kanë dalë statik, prodhim i një mentaliteti krahasues. Shikoni, nuk është shërbim as për Qeverinë, as për Kryetarin e Kosovës, as për Kryeministrin, sepse reminishencat...

KRYETARI: Anëtarët e Kryesisë i kanë 10 minuta.

EQREM KRYEZIU:.. sepse kam frikë, të jemi të qartë, kam frikë se riminishencat e tilla duhet verifikuar, atëherë, në qoftë se përsëriten minishencat e shkelqimeve, të pallateve të totalitarizmit në rajon. Shpeshherë ma ka quar mallin, ne e kemi përjetuar të gjithë, shumica prej këtyre, ma ka quar mallin një shikim përbuzës, shqiptarët e gjorë që po lypin ta kritikojnë totalitarizmin e shokut Tito. Shiko, nuk më vjen mirë mua të shoh këso shikime edhe sot edhe këto trajtime. Nuk e ndiej veten komod as nuk di pse ta ndij veten të persekutuar, këtu është problemi. Nuk më intereson mua a e përkrah, a favorizohet zoti Hashim Thaçi më shumë, a zoti Sejdiu, a më pak pozita ose opozita. Jo, problemi është te esenca e kësaj çështjeje për të cilën po flasim.

Shikoni, ju lutem, ne po flasim për pavarësinë e RTK-së, por deri ku duhet të shkojë ajo pavarësi? Pavarësi prej politikës, shumë e qartë, por jo edhe pavarësi ndaj procese shoqërore, historike, demokratike të Kosovës. Në qoftë se RTK-ja bën propagandë fenomenale, sugestionuese kundër daljes në zgjedhje, në votime, zonja e zotërinj, kjo është varësi ndaj një politike të kaluar totalitare. Nuk mund të pranohet, le ta shaj Kryeministrin sa herë të donë, Kryetarin sa herë të donë, Eqrem Kryeziun sa herë të dojë, por të bëjë të këtilla veprime, propagandë sugestive, jashtëzakonisht të fuqishme për të mos dalë njerëzit në zgjedhje, kjo nuk shkon. Unë, për fat të keq, detyrohem të kthehem, edhe pse nuk jam ithëtar i mendjes së ligë, por ka pasur emisione të gjata që kanë favorizuar konfliktin civil në Kosovë. E qysh, a kjo është pavarësia e një institucioni... Të mos të flas për cikërrimat e pashije që më së pari jepet një storie primitive e mjerimit faktik real, para se zhvillimet më të rëndësishme politike të asaj dite, qoftë të Kryetarit, qoftë të Kryeministrit. Eksplorativ, instrumentalizim primitiv i mjerimit të njerëzve. Në emër të cilës politikë, dhe mos të flasim, si tha zoti Salihaj, po më vjen mirë që po detyrohem të pajtohem me të, të mos flasim për linçin që bëhet mbi zyrtarët politikë, mbi Parlamentin, këqyri këta, thotë, çka donë, në emër të kushteve donë të marrin para. Ndërkëq, po del, që tha Salihaj, se .... Kështu që, sinqerisht, unë ndoshta kam një ndjenjë të paranojës, ndoshta ka mundësi, mirëpo veç kjo kope qitu prej 120 vetëve është në vëzhgimin e antikorrupsionit dhe unë jam për të, po le ti shikojnë edhe segmentet e tjera që tallen me neve. Ndërkëq, nuk lënë gjë pa bërë. Në qoftë se kjo është e vërtetë, më falni, unë nuk mund të pajtohem me këtë gjendje.

Boll po kam dëshirë të jem konformist, t'i ndihmoj shoqërisë kosovare, veç me të vërtetë në këtë rast, më falni se unë nuk mund të pajtohem. Ju faleminderit për mirëkuptim, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet deputetja Edita Tahiri.

**IBRAHIM MAKOLLI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Është shumë e vërtetë që sot po debatojmë për një çështje jo pak të rëndësishme dhe do të dua të them që forma se si po rrjedh ky debat, nuk është sinjal i mirë për demokracinë më këtë vend, nuk është sinjal i mirë për medien e lirë që garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të gjitha normat ndërkontrolluese.

E përkrah në tërsi fjalën e deputetit të mëhershëm, i cili deklaroi se këtu ka filluar të vendoset një mentalitet monist, që të përkujton vitet '90, kur Radiotelevizioni i Prishtinës atëherë, po në të njëjtën formë është ndikuar dhe është ndërhyrë nga ana e institucioneve.

Unë do të doja që të paraqes vetëm dy çështje se çka dhe cilat janë obligimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që parashihen edhe me Ligjin e Radiotelevizionin të Kosovës.

Neni 1.2 dhe 1.3 përcakton qartazi detyrat dhe obligimet, si dhe përgjegjësitë e kuvendit të Kosovës, e që është mbrojtja e autonomisë institucionale dhe e pavarësisë editoriale të RTK-së, si dhe sigurimi i financave adekuate për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së dhe garantimi i objekteve të përshtatshme për transmetuesin publik. Këtu u tha, te politika redaktoriale e RTK-së. Kolegë të nderuar, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është autoritet i cili bën vlerësimin e politikave redaktuese, sepse për këtë çështje është Bordi i RTK-së i zgjedhur nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Këtu po flitet kush e ka shkel Ligjin dhe unë do të doja, jo vetëm në këtë rast, të tjerheq vëmendjen edhe në çështje të tjera. Pikërisht Kuvendi i Republikës së Kosovës është shkelësi më i madh i ligjit, në këtë rast, sepse po të veprohej ndryshe dhe po ta zbatonte ligjin Kuvendi i Kosovës, nuk e besoj se do të vinte deri në këtë gjendje Radiotelevizioni i Kosovës.

Tash qe tri vite, Televizioni i Kosovës nuk e ka bordin, edhe pse ky ligj përcakton qartazi që deri në zgjedhjen e bordit të ri, ky bord i shtron kompetencat. Prandaj, fajtor për një gjendje të tillë është pikërisht Kuvendi i Kosovës dhe jo Bordi i RTK-së. Nuk e besoj që në një vend normal, në një vend demokratik, krijohen komisione të cilat hetojnë mediet, sepse sinjali për to nuk është i mirë dhe i drejtë.

A janë këto përpjekje, për më tepër i shoh si përpjekje për të disiplinuar mediat nga ana e politikës dhe pikërisht Kuvendi i Kosovës do të duhej të jetë institucioni i cili i mbron mediet nga ndërhyrja politike dhe jo të bëjë të njëjtin gabim sikurse që po përpinqet në këtë rast. Ne nuk mund të bëjmë, po ritheksoj edhe një herë vlerësimin e politikave të RTK-së, por ajo që i takon këtij Kuvendi, është që ngutshëm të krijojë bordin, të zgjedhë Bordin e RTK-së, i cili pastaj do të përcaktojë politikat. Dhe, së fundi, edhe një çështje do të duhej ta vë në pah këtu. Monitorimin e punës së Radiotelevizionit të Kosovës e bën Këshilli i përkohshëm, Këshilli i Pavarur për Media dhe nuk mund ta marrim dhe ta zëvendësojmë rolin që e ka Këshilli i Përkohshëm për Media. Andaj, sugjeroj që ky debat të jetë, në radhë të parë në mbrojtje të institucionit publik medial, të cilit do t'i dërgohej një sinjal i qartë se ky Kuvend do të jetë në mbrojtje gjithherë të fjalës së lirë dhe nuk do të lejojë ndërhyrjen e politikave në redaktuarën e këtyre emisioneve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Edita Tahiri dhe po e marrim pauzën për drekë. Pas Editës janë edhe 5 deputetë, tash u bë edhe një - 6, po shtohen vazhdimesht.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë të nderuar,

Ministra të nderuar,

Debati për gjendjen në RTK është një debat legitim përfaktin se Kuvendi i Kosovës ka rolin e mbikëqyrësit të organizatave publike dhe besoj dhe kam dëshirë që të vazhdojnë debatet edhe përf organizatat e tjera publike, në mënyrë që të shohim si është gjendja, por edhe të japim rekomandimet e duhura.

Në kuadër të diskutimit tim nuk do të përsëris ato që u thanë, mirëpo do të përpinqem të fokusohem në atë se çka është puna jonë, si Kuvend i Kosovës, në raport me RTK-në, çka është puna e vetë RTK-së dhe e cilat do të ishin edhe masat që duhet të ndërmerren. E para, u tha qartë këtu, që Bordi i RTK-së nuk është formuar përmë shumë se 3 vjet dhe kjo tregon, sigurisht, një dështim të Kuvendit të Kosovës, por jo vetëm të këtij mandati, sepse puna ka filluar më herët, pra edhe të mandatit të kaluar, dhe unë mendoj që bordi që është formuar, më falni, Komisioni ad-hoc që është formuar, duhet ta kryej punën e vet. E përshëndes gatishmérinë tuaj, si Kryetar, që në këtë të premte, pra, nëse nuk ndodhë më herët nga ana e kryesuesit të zgjedhur, që ta thërras mbledhjen, e përshëndes me të vërtetë gatishmérinë tuaj që të premten ta thirrni mbledhjen dhe do t'ju kisha lutar që ta mbani fjalën, sepse kryesuesi i tashëm, duket mbas informacionit që kam nga kolegët, kishte qenë kryesues edhe i Komisionit ad-hoc të përparshëm, po asnjëherë nuk e kishe thirr mbledhjen.

Prandaj, kjo që e thatë ju sot, mendoj se i jep një zgjidhje kësaj çështjeje dhe ngrit Kuvendin e Kosovës në shkallën e përgjegjësisë, sepse përf të kërkuar një punë më të mirë të RTK-së, së pari ne si institucion duhet t'i krijojmë kushtet. Pra, mos të lëmë njerëzit me kompetenca të pasqaruara apo me mandate të skaduara, si dhe të punojmë në qëndrueshmérinë e tyre, veçmas në aspektin financiar. Mirëpo, nga ana tjetër, RTK edhe njerëzit që po punojnë aty, kanë obligimet e tyre së pari jetike dhe profesionale. RTK, si një institucion publik, duhet t'i shërbet qytetarëve dhe në anën tjetër duhet ta ruaj integritetin gazetaresk, përkundër ndërhyrjeve politike që kanë ndodhur, po ndodhin dhe mendoj se edhe do të ndodhin, por nuk ishte një lajm i mirë që as Raporti i progresit, as Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan përf të Drejtat e Njeriut e të tjerë faktorë nuk e lanë pa përmendur se ka ndërhyrje politike në media.

Nëse synojmë një shtet demokratik, mendoj se ai fillon prej institucioneve, në mënyrë që pastaj, si një mentalitet demokratik të reflektohet në të gjitha segmentet e jetës. Prandaj, në këtë drejtim sa thërras RTK-në që të rrisë etikën gazetareske, të rrisë profesionalizmin, aq ftoj edhe institucionet e Kosovës dhe veçmas Kuvendin e Kosovës që të jetë korrekt në këtë raport.

Sa iu përket masave që u propozuan, po më vjen mirë që ka ide që janë konform obligimeve që i ka Parlamenti, por disa nga propozimet, rekomandimet që dilnin nga kompetenca tona, tregojnë se edhe vetë ky grup që e ka iniciuar këtë çështje, nuk e ka trajtuar mirë këtë problematikë dhe, në anën tjetër, dua të përkujtoj se formimi i komision hetimor përf një bord të cilit i ka kaluar mandati, është një qasje me vonesë, siç ishte qasja me vonesë me rastin e Bordit të Trustit Pensional, kur u humbën milionat, andaj unë dua të propozoj edhe diçka, të bëjmë një komision hetimor përf të gjitha organizatat publike dhe mos të harrojmë që këto ditë Auditori i Gjeneral na tregoi me gisht se në disa ministri ka po ashtu keqmenaxhime financiare, pra të jemi pro aktiv

dhe mos tē shkojmë tē bējmë veprime kur organeve po ju skadojnë mandatet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në orën 15:00 vazhdojmë debatin.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë debatin. Kemi mbi 40 veta në sallë. Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le tē përgatitet Gani Buçinca.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, na datu reč!

Pozdravljam Predsedništvo i kolege poslanike,

Danas imamo pokrenutu jako pozitivnu iniciativu od strane jednog broja poslanika, koju ja pozravljam pozitivno o radu Radiotelevizije Kosova i smatram da su se svi poslanici danas maksimalno potrudili da daju svoj doprinos.

Svi zanamo da smo kao poslanici ovde dobili izveštaje Radiotelevizije Kosova za 2007. i 2008. godinu i na ime obaveze od strane Skupštinskog poslovnika i na ime Zakona o Radioteleviziji Kosova dobijamo ove godišnje izveštaje.

U istim izveštajima se daje doznanja to što je meni privuklo pažnju da Radiotelevizija Kosova proizvodi i emituje programe na pet jezika, to je Albanski, Srpski, Turski, Bošnjački i Romski jezik. Ja ču da dam ovde doznanja da su službeni jezici, znači albanski, srpski, turski, bosanski, romski jezik, bošnjački, goranski jezici su jezici manjina zajednica, te smatram da nisu službeni jezici i da se više ne pravi ovakva tehnička greška. Zajednice su se ovde opredelile kao zvanični jezici, jedan deo zajednice na sprskom, jedan deo na bosanskom jeziku, lingvistika poznaje ove jezike kao službene jezike.

Mislim da kada se daju ovi izveštataji, mora da se pazi i na gramatičke i tehničke greške.

Svi poslanici ovde manjinskih zajednica znamo da nam nije osiguran niti minimum zakonskih potreba za prisustnost na javnom servisu. Kada je u pitanju pokrivenost kanala Radiotelevizije Kosova, on nije dostupan regijama u Gori i Župi, kao regija Opolje, punih 10. godina, od 1999. godine kada je srušen repetitor na Svilenu, koji tehnički nije sposobljen do današnjeg dana.

Gledaoci istih regija plačaju nešto što im tehnički nije dostupno, iako plačaju taksu od 3,5 eura u računu za struju od 2003. godine, i fakturisana sredstva su veća do sada od milion i osamsto, a na izme Zakona o medijama, 5% se izvestira za zajednice, što nije ispoštovano da se jedan repetitor vrati u funkciji.

Tražim kao poslanica da se da preporuka, kada bude imenovana Ad-hoc Komisija, da se retroaktivno oslobole od plačanja TV preplate svi građani kojiima kanal nije dostupan i da se retroaktivno skinu ova sredstva kao zaduženje u računu za struju.

Krajnje je vreme da se krene u namenske investicije od strane Vlade i Radiotelevizije Kosova kada su u pitanju obavezna sredstva za zajednice na ime Zakona o javnim medijama. Ovaka politika bi stigla do svake manjinske zajednice za ciljem bržeg integrisanja u kosovsko društvo.

Vlada i Radiotelevizija Kosova se za sada bave samo tectorikom. Nemaju dobru praksu i mehanizam koji treba da zaživi na terenu.

Citiram stranu br. 4. izveštaja za 2008. godinu. Zašto to radim? Kaže, Radiotelevizija Kosova danas predstavlja društveno, etnički treba, piše entički, mozak Kosova, koji postiće politički plularizam, unapređuje kulturnu raznolikost, međuetničku toleranciju, demokratizaciju i društveno integriranje i uopšte. Moja diskusija predašnja je bila na imo ovog citata. Znači, od ovoga na terenu smo svesni da nema ništa.

Jako važno, kada su u pitanju današnje preporuke od strane nas poslanika, jasno se vidi i zna da postoji kršenje zakona kada je u pitanju imenovanje borda i njegovo prečutno nastavljanje funkcijonisanja i posle pune tri godine isteka mandata.

Kada je u pitanju menadžiranje od strane direktora Radiotelevizije Kosova, kada su u pitanju sredstva i ljudski resurs, potpuno nezakonit pristup javnoj i nabavci, gde se krši Nacrt zakona o javnoj nabavci ...

**KRYETARI:** Faleminderit!  
Fjalën e ka Memli Krasniqi.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Debati i sotëm për gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës, pa dyshim që është i rëndësishëm, sepse po flasim për transmetuesin e vetëm publik, por në një formë është një dejavu edhe debateve të kaluara, sepse po përsëriten shumë gjëra që janë thënë edhe kur kemi diskutuar për raportet e këtij institucioni.

Pa dyshim se në Radiotelevizionin e Kosovës ka mjaft probleme dhe unë mendoj se problemi kryesor dhe ai në të cilën duhet të përqendrohem është mungesa e bordit të ri dhe besoj se këtu ndërlidhen edhe kompetencat e këtij Kuvendi, por normalisht që ka edhe probleme të tjera për të cilat ndoshta edhe mund të bisedojmë e që janë të ndryshme si, ta zëmë, kualifikimi i kuadrit aty, numri i punëtorëve, çështja e kontratave, nivelizimi i pagave e tjerë.

Por, unë do të përqendrohem te rekomandimet që janë nxjerrë nga paraqitësit e mocionit. Pra, mendoj që për problemet e RTK-së, këto rekomandime, absolutisht, jo që nuk ofrojnë zgjidhje, por përkundrazi, tentojnë të shkaktojnë probleme të reja.

Të nderuar deputetë,  
Është mendimi im se kërkesa për të themeluar një komision hetimor, për të bërë suspendime arbitrale e aq më keq instalime arbitrale, nuk është asnjë tjetër, vetëm një kërkesë për të futur masa të dhunshme në Radiotelevizionin e Kosovës. Kjo është një kërkesë për presion edhe për shantazh ndaj këtij transmetuesi publik.

Unë mendoj se një gjë e tillë ndoshta do të pinte ujë në një vend si Rusia, në një vend monist, por jo në një demokraci të re, siç është Republika e Kosovës.

Me këtë mendësi që po mbështetet fuqishëm nga opozita, po më duket se po bëhet e qartë se kush në Kosovë po do të ushtrojë ndikim dhe kontroll politik në mediat e pavarura, dhe veçanërisht në mediumin më të madh dhe më ndikim në vendin tonë.

Ajo që unë e shoh këtu si deputet, është se opozita realisht nuk është duke kërkuar që të respektohet ligji, për shembull Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, por po kërkohet një mundësi për të shkelur pavarësinë mediale dhe për të iniciuar një kontroll shumë jo parimor, një kontroll krejt autoritar ndaj këtij institucioni publik, i cili do të duhej të ishte në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Mendoj se është obligim i Kuvendit të Republikës së Kosovës që të bëjë përshpejtimin e përgjedhjes së anëtarëve të Bordit të ri të Radiotelevizionit të Kosovës, sepse gjendja me bordin e vjetër është shumë e komplikuar. U tha edhe nga parafolësit se nuk është kjo që është duke ndodhur që një muaj, as qe një vit, por është prej mandatit të kaluar dhe për këtë zvarritje nuk mund të ketë vetëm një adresë. Përgjegjësia e të gjithë neve këtu dhe e komisionit të formuar është që ta bëjë këtë përshpejtim dhe besoj se kjo ndoshta është pika konsensuale e të gjitha diskutimeve.

Në anën tjetër, besoj se obligimi ynë, si Kuvend, është edhe amendamentimi i Ligjit për RTK-në, që është një proces që ka filluar dhe ka ngecur diku, pastaj monitorimi i zbatimit edhe të këtij ligji, edhe të ligjeve të tjera përkatëse, qoftë të Ligjit për KPM-në apo të tjerë, dhe nuk është obligim i ynë shndërrimi i një organi kaq të rëndësishëm, si Kuvendi i Kosovës, shndërrimi në një organ përmbytjen e kontabilitetit të Radiotelevizionit të Kosovës. Është Auditori Gjeneral ai që merret me këtë punë dhe jo ne.

Edhe njëherë dua ta ritheksoj se rekomandimet janë absolutisht jodemokratike, nuk na bëjnë nder si Kuvend, sepse ne nuk mund të fusim masa të dhunshme në institucione të pavarura.

Vota ime publikisht është kundër këtyre rekomandimeve. Pra, unë shpresoj se edhe deputetët e tjerë do ta mbështesin këtë, sepse ne nuk mund të sillemi kështu. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet Ibrahim Gashi.

**GANI BUÇINCA:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përhëndes të gjithëve ju, kolegë deputetë, dhe ju ministra që jeni këtu.

Nuk dola të diskutoj dhe të lëshohem shumë në atë problematikë, të cilën ne e kemi trajtuar disa herë në transmetuesin publik, mirëpo nga debatet dhe konsultat që i kam pasur me kolegët e mi të të gjitha partive politike thuaja se, unë kam ardhur në përfundim se ende nuk e kemi të qartë çka është transmetuesi publik, si do të definohet ai me ligj si transmetues i tillë dhe si të definohet me ligj që ai edhe të funksionojë si transmetues publik?

Që të jetë një transmetues publik, para së gjithash duhet të përgatisë program për publikun, e para, kriteri i parë. Kriteri i dytë, të financohet nga publiku, dhe kriteri i tretë, të kontrollohet nga publiku.

Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, i cili është në fuqi, fatkeqësisht, me asnjë dispozitë nuk e sanksionon kontrollin publik që duhet t'i bëhet transmetuesit publik.

Dhe, pikërisht është ky ligj dhe Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, i cili prodhon gjendje të tillë në transmetuesin publik. Mund t'ju them me përgjegjësi se jam njeri i mediave dhe e njoh mirë problematikën e medieve, se këto dy ligje do të prodhojnë në

çdo kohë të njëjtën gjendje që është sot në Radiotelevizionin e Kosovës. Këtu jujeni dëshmitarë që unë e kam ngritur në seanca parlamentare më herët çështjen e procedurave për ndryshimin e këtyre dy ligjeve. Ajo çka e bën Kuvendin e Kosovës të pafuqishëm dhe çka e shfajëson prej përgjegjësisë, janë dy ligjet aktuale. Kuvendi i Kosovës nuk ka asnë të drejtë ligjore që të bëjë kontrollin e transmetuesit publik. Nuk bën kontroll, jo në kuptimin politik, jo në kuptimin e politikave redaktuese, por në kuptimin e zbatimit të Ligjit të Radiotelevizionit nga ana e menaxhmentit për arsyen se po thuaj se të gjitha kompetencat me ligj i ka Komisioni i Pavarur për Media.

Mirëpo, Komisioni Parlamentar për Media dhe vetë Parlamenti nuk ka asnë fuqi ligjore që të kontrollojë Komisionin e Pavarur për Media, i cili është përgjegjës për të kontrolluar zbatimin e Ligjit të Radiotelevizionit Publik nga ana e menaxhmentit. Komisioni i Pavarur për Media ka të drejtë t'ia marrë transmetuesit publik licencën në rast se gjatë monitorimit i vëren shkeljet në këtë institucion.

Dhe, në këtë gjendje çfarë është, unë mund t'i jap disa propozime. Sa më shpejt duhet të amendamentohen dy ligje të cilat i kemi këtu, që sapo unë i përmenda, një, të ekzistojë vullneti politik nga të gjitha forcat politike këtu në këtë Kuvend, që problemi i transmetuesit publik të definohet, të sanksionohet qartë me ligj, duke manifestuar një vullnet politik që shkon përtej interesave të partive politike që janë këtu dhe përtej interesave të pozitës dhe opozitës, konform ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare për informimin e publikut. Një prej dispozitave bazë të Kushtetutës sonë është edhe informimi i publikut, mirëpo jo informimi dosido i publikut, por informim i drejtë, cilësor dhe kualitativ.

Unë e shfrytëzoj rastin ta falënderoj OSBE-në, e cila në muajin dhjetor e ka sponsorizuar një delegacion të këtij Kuvendi që ta vizitojë Kroacinë dhe të njihet më për se afërmimi me mënyrën se si e kanë zgjedhur kroatët problemin e transmetuesit publik. Ne jemi të gjithë këtu, të gjitha partitë kanë qenë të përfaqësuara dhe shteti mik, Parlamenti kroat, shteti mik ynë ka qenë i gatshëm të na afrojë ndihmë teknike dhe profesionale, për të na ndihmuar që, më në fund, edhe ne të kemi ligj të mirë për transmetuesin publik.

Aty janë shtruar disa debate dhe problemi qëndronte edhe në Kroaci se ata i kishin liruar mediat prej politikës, mirëpo për fat të keq, thanë, ne nuk kemi pasur mundësi t'i çlirojmë mediat nga pronarët e mediave dhe nga vetë interesat e gazetarëve, kështu që në këtë kontekst edhe gazetarët i kontribuojnë shumë një gjendje të tillë në informim çfarë është në Radiotelevizionin e Kosovës. Ajo...

**KRYETARI:** Faleminderit shumë, u krye. Nuk ka nevojë të përzihen të tjerët. Fjalën e ka Ibrahim Gashi, le të përgatitet Adem Grabovci.

**IBRAHIM GASHI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Tema që po bisedojmë sot me kërkesën e një grupei deputetësh, mendoj që vjen në një kohë kur ndoshta ata që sot ishin goxha të zëshëm këtu, mund të kenë eventualisht edhe përgjegjësi për gjendjen në këtë medium publik, të vetmin në Kosovë, ndërkëq gjeneralisimi që sot është më kritike opozita nga njëri prej kolegëve deputet, do të them që besoj se ka menduar në një pjesë të opozitës, sepse AKR dhe përfaqësuesi ynë, që foli në emër të AKR-së, e adresoi përgjegjësinë e këtij institucioni, pra Kuvendit të Republikës së Kosovës karshi RTK-së dhe nuk u zgjeruam ne më shumë, pikërisht përfaktin se ne e dimë që konform Ligjit për RTK-në, roli i Kuvendit është shumë i madh,

por në fakt është i kornizuar se si mund të implementohet ai rol. Dhe, ne jemi në një farë mënyrë konsistent që në atë vijë të shkojë angazhimi i Kuvendit dhe të shihet se gjendja në RTK, sa është e mirë apo e keqe, sa është produkt i mos angazhimit të këtij institucioni që i takojmë ne të gjithë, ndoshta jo vetëm të kësaj legjislaturre, por edhe të legjislaturës por edhe legjislaturës pararendëse, që për tre vjet e ka mbajtur peng këtë institucion pa e zgjedhur bordin, mekanizmin e vetëm përmes të cilit Kuvendi mund të ushtrojë në një farë mënyre ndikim pozitiv, po e them në kuptimin e fjalës, në Radiotelevizionin e Kosovës.

Kërkesa me disa rekomandime që doli nga grupei iniciues për të diskutuar sot lidhur me këtë çështje, mendoj se duhet të reduktohet vetëm në atë pjesë që ka të bëjë me, si të them, reagimin tonë për të kompletuar bordin, madje as për të ngritur komision ad-hoc hetimor, për faktin se ne kemi Komisionin e Pavarur për Media, të cilit do t'i dyfishonim tash funksionin nëse do ta bënim edhe një mekanizëm tjetër paralel për të konstatuar gjendjen në RTK.

Madje edhe ajo që ka të bëjë lidhur me politikat redaktuese në RTK, Kuvendi s'mund të adresoj vërejtjet me rrugë tjetër përvëç përmes bordit të cilin e emëron vetë. Bordi është ai i cili në një farë mënyre mund të konstatojë se çfarë janë ato politika redaktuese dhe mund të marrë masa karshi menaxhmentit që po supozojmë që, domethënë, nuk është sa duhet koherent dhe konsistent në zbatimin e ligjit me rastin e hartimit të politikave redaktuese të këtij mediumi.

Rrugët të tjera mendoj që janë një farë mënyre interferencë e drejtpërdrejtë në lirinë e medias dhe ndoshta debatet që sot i dëgjojmë këtu, mund të na përshkruan edhe neve si ndërhyrje në lirinë e këtij mediumi publik, ani pse është në një farë mënyre i ndërvarur dhe është i themeluar nga ne. Po edhe funksioni edhe misioni ynë karshi këtij është në një farë mënyre i kornizuar me një kornizë ligjore të cilën duhet ta respektojmë këtu.

Është pak e tepërt nëse ne paragjykojmë, sepse secilit nga ne nuk i pëlqen diçka në RTK dhe shumë sende vërehen ashiqare. Dhe, ndoshta janë partitë më të vogla, partitë më të reja edhe në opozitë edhe jashtë këtij Parlamenti që kanë vërejtjet me trajtimin që ju bëhen nga ky medium publik. Mirëpo, ne insistojmë që të krijohen mekanizma legal për t'i korrigjuar gjërat që s'janë në rregull atje, dhe në këtë rast dëshirojmë që ta mbajmë përfjale Kryetarin e Kuvendit, që brenda kësaj jave të ulet Komisioni, i cili do ta zgjedhë bordin. Në rast se jo atëherë kritikat mund të adresohen edhe në drejtim tjetër se dikush dëshiron ta zgjatë këtë agoni në këtë medium.

Pra, ideja është që të mos bëhen kualifikime përtej kompetencave që ne i kem, sepse kjo mund të na merret edhe si ndërhyrje në lirinë e fjalës dhe shprehjes së lirë edhe domethënë edhe neve si deputetë, përkatësisht përfaqësues të popullit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Fjalën e ka Adem Grabovci, le të përgatitet Berim Ramosaj.

**ADEM GRABOVCI:** Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Vërtet po debatojmë sot për një institucion tepër të rëndësishëm të vendit tonë. Jam i thitar i debateve publike që vlerësoj se është një mjet demokratik që i eliminon të gjitha dilemat dhe krijon qartësi tek qytetarët dhe tek ne, mirëpo varet se çfarë qëllimi ka debati, a respektohet ai debat, për çka është thirrur? Unë mendoj se këtu në Parlament në tërsi po

devijohet dhe po keqpërdoret, po devalvohet edhe ky mjet tepër demokratik dhe tepër i rëndësishëm që të aplikohet në vendin tonë. Këtu, nga një pjesë e deputetëve shihet qartë se opsesion u është bërë Qeveria. Lirisht marr guximin të them se sukseset që po i tregon kjo Qeveri dhe, thjesht, sukseset e treguara ia largojnë pushtetin apo ëndrrën për të ardhur në pushtet.

Prandaj, është e qartë se prej fillimit e në mbarim, këta, një pjesë nuk shohin bardh në këtë vend, vetëm zi. Megjithatë, për mua nuk është fare shqetësuese, personalisht e ndiej veten shumë mirë kur më kritikon dikush, sepse më distancon nga e keqja dhe një gjë dua të bëjë të qartë këtu në këtë Parlament dhe për të gjithë qytetarët se Kosova në vazhdimësi po i largohet një qeverisje të keqe dhe këtu po instalohet një qeverisje e mirë, e cila do të jetë në shërbim dhe në mbrojtje të interesave të qytetarëve.

Grupi i kolegëve të cilët kanë ngritur një çështje sot këtu, vërtet nëse marrim dhe i kemi parasysh rekomandimet që na jasin, nën një, ku thuhet se kërkojnë shkarkimin emergjent të Bordit dhe të menaxhmentit aktual në krye me filan fistekun. Nën tre, emërimin e një menaxhmenti të përkohshëm, ta përkujton fillimin e viteve '80 apo të viteve '90, ku në shumë ndërmarrje tona politika moniste e atëhershme shkarkonte drejtorë brenda nate, shkarkonte edhe drejtorë të RTK-së brenda nate dhe emëronte ata të cilët donin dhe kërkonin që të përçojnë politikën e tyre.

**KRYETARI:** Të kisha lutar, krahasimet mos i bëni me vitet e kaluara!

**ADEM GRABOVCI:** Në anën tjeter, ne si Parlament mendoj se jemi në kundërshtim me vetveten. Ne kemi krijuar një komision ad-hoc dhe kemi të drejtë të gjithë që të kërkojmë nga ai komision se deri ku e ka quar punën e vet, të na jep një informatë. Kemi të drejtë që të kërkojmë konstituimin dhe funksionalizimin e Bordit të RTK-së. Pra, kemi të drejtë të kërkojmë zbatimin e Ligjit sa po respektohet, ndërsa jo të përzihemi në politikën redaktuese dhe të bëjmë politikën RTK-së, sepse kjo vërtetë është e palejueshme, është antidemokratike dhe kërkesa dhe goja plot që e përdorin disa deputetë se duhet ta instalojmë demokracinë, unë ju kisha lutar që të bëjmë një dallim në mes të demokracisë dhe të anarkisë. Këtu më tepër gjason se tendenca për të shkaktuar një anarki se sa një demokraci. Demokracia i ka rregullat e veta dhe ato duhet të respektohen dhe të aplikohen dhe të vlejnë për të gjithë, pa përjashtim.

Prandaj, kërkesa për formimin e Komisionit Hetimor, mendoj po ashtu se i tejkalon kompetencat tona. Kemi organe të tjera përkatëse të cilat e kryejnë këtë punë. Personalisht jam kundër dhe u bëj thirrje të gjithë deputetëve që të votojnë kundër formimit të këtij komisioni, i cili vlerësoj se do të jetë i dëmshëm dhe do të bjerë në kundërshtim me qëndrimet dhe veprimet tona të mëhershme. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet Etem Arifi.

**BERIM BARMOSAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Me qenë se pjesën kryesore të debatit e përcolla, dëshiroj së pari që të merremi me problemin dhe mos të hedhimakuza ndaj këtij grupi të deputetëve, se sipas asaj deklarate, respektivisht sipas atij rapporti që ka bërë ky grup, qëllimi është shumë i mirë. Nuk është qëllimi që dikush as të qitet para gjyqit, as të akuzohet, por qëllimi është të shqyrtojmë gjendjen në RTK, unë madje kështu e kuptoj.

Me qenë se vërtet ka probleme në RTK dhe ato probleme nuk janë vetëm të RTK-së, por janë probleme që na preokupojnë të gjithëve, fajet kryesore nuk janë tërësisht të Kuvendit. Nuk mund të më bind mua koalicioni qeveritar që faji është i përbashkët në aspektin e neglizhencës në definimin e saktë, qoftë të Komisionit ad-hoc, qoftë të Bordit të RTK-së. Dihet, kush ka të drejtën, ka edhe përgjegjësinë. Ne e dimë që e kemi një pozitë, e dimë që e kem një ekzekutiv, e dimë kush e mban përgjegjësinë dhe e dimë kush e mban të drejtën. Në qoftë se shpërndahet në këtë formë përgjegjësia, si u mundua këtu të shpërndahet në tërë deputetët e këtij Kuvendi, atëherë ajo mbetet në fakt papërgjegjësi. Përgjegjësia qëndron në vendimmarrje. Në qoftë se kemi formuar një Komision ad-hoc dhe ai Komision në përbërje ka

konflikt të interesit, atë që e thanë edhe shumë deputetë të tjera, ne mund t'i tejkalojmë ato probleme, por nuk mund të tejkalojmë ne situatën që të mbajmë RTK-në pa Bord. I vetmi shans i këtij Kuvendi, i këtij legjislativi të mbikëqyrë punën e RTK-së, është vetëm përmes Bordit, atij bordi apo këshilli, qysh të doni po i themi sepse, tek e fundit, ai është supervaizer i Bordit, është Bord mbikëqyrës. Faktikisht, RTK-në në qoftë se e lëmë na të mbikëqyret nga grupe qytetarësh apo nga individë, në fakt ne e kemi lënë në anarki. I vetmi shans që ta fitojë epitetin RTK-ja si Radiotelevizion Publik, është që ai vërtet të jetë publik. Ne që jemi këtu, në fakt reflektojmë interesin e publikut, nuk reflektojmë interesin personal apo individual. E, në qoftë se vërtet dëshiron RTK-ja ta luajë rolin e një mediumi publik, që nuk jam t'i merret pavarësia, atëherë padyshim që duhet të sqarohen saktë të drejtat dhe përgjegjësitë.

Unë kërkoj nga ky moment, jo të themi sintagmën sa më shpejt që është e mundur të bëhet bordi, ose sa më shpejt të merren vendime, por bile nga ky diskutim, nga ky debat të dalin saktë me kohën e saktë, kur do ta kemi Bordin e RTK-së, cilat do të janë detyrat, të cilat në fakt i ka sipas ligjit dhe të ecim më tutje.

Në fakt, në qoftë se ne e bëjmë një agjendë të saktë, në aspektin edhe të zbatimit të ligjit dhe të ligjshmërisë dhe të definimit të saktë të organeve, që në njëfarë forme mbikëqyrin edhe funksionalizojnë RTK-në, ne e kemi tejkaluar problemin dhe nuk kemi kurrgjë në kundërshtim njeri me tjetrin. Unë, me sa e pash këtu, shumica e deputetëve janë vërtet në të mirë funksionimit të RTK-së. Mos të hyjmë në politikën programore, mos të hyjmë në qëndrueshmërinë financiare, që padyshim është sfidë edhe për RTK-në edhe për shumë të tjera, mirépo i vetmi shans i ndikimit të këtij Kuvendi në RTK, si medium publik, është ndërtimi i bordit dhe ai bord të ketë përbërjen e tillë, që është e paraparë me ligj, ashtu që ai të mbikëqyrë punën edhe në aspektin e mirë funksionimit edhe në aspektin e politikës programore, por edhe në aspektin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare.

Roli i Kuvendit nuk është vetëm të bëjë debat, por të nxjerrim konkluzë. Nuk jemi në kuptimin e asaj të nxjerrim definime që nuk kanë adresë, nuk jemi për gjykime të personave, por jemi në fakt shumë të interesuar që RTK-ja të mos ketë probleme dhe raporti i ardhshëm që do të vijë i RTK-së, të jetë një raport i mirë.

Sa i përket keq menaxhimit, keq financimit, keq formave të menaxhimit financiar, ne kemi të drejtë si Kuvend të propozojmë ...

**KRYETARI:** Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Etem Arifi, le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

**ETEM ARIFI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!  
Përvendetje për të gjithë,

Unë mendoj që RTK-ja mban emrin e televizionit publik, e që në të vërtetë nuk është publik, sepse nuk i përgjigjet publikut. Komuniteti ashkali është në terrin e informimit rrith aktiviteteve, qoftë nga subjekti politik i tyre, Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës, ose nga OJQ-të e ndryshme. Edhe pse kemi kërkuar nga RTK-ja edhe nga Drejtoria e RTK-së shumë herë që të na ndajë një minutazh për informimin e ashkalinjëve për punën dhe aktivitetet e ndryshme, që kanë të drejtë të informohen edhe ashkalinjët, ne nuk kemi marrë asnijëherë përgjigje as pozitive, as negative.

Ne mendojmë që formimi i komisionit hetimor do ta ndryshojë gjendjen në RTK dhe mendojmë që Kuvendi ta zgjedhë Bordin e RTK-së, atëherë shpresojmë se edhe ne do të jemi pjesë e informimit, sepse edhe ne kemi të drejtë sikurse edhe serbët, edhe boshnjakët, edhe romët, edhe turqit, edhe pse i kemi ftuar kamerat e RTK-së shumë herë në aktivitet tona politike, kulturore, asnijëherë nuk na janë përgjigjur. Për shembull, i kemi ftuar shumë shpesh nëpër festat tona të flamurit kombëtar të ashkalinjëve, më 15 shkurt, nuk na u kanë përgjigjur asnijëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! I fundit është deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje ministrave!

Unë njëherë nuk desha të flas, por mu kujtua këtu që kërkesa e 44 deputetëve për RTK-në ishte pak interesante dhe, ndoshta, jo e kohës, e momentit, e qasjes. Pra, ajo ma kujton dallimin ndërmjet demokracisë dhe anarkisë. Deputetët kërkojnë ta vendosin demokracinë që është ligji, por në këtë rast dalim te pozicioni i debatit te anarkia, sepse dalim me lloj- lloj diskutimesh që nuk përputhen me këtë. Për mua është një thënie që: "Aty ku nuk jam unë, çdo gjë është keq". Kjo ma kujton mua që tanë ky bord ose kjo që është deri me tash, është prej vitit 2002. Kjo i ka tejkaluar të gjitha qeverisjet deri më sot. Asnjëherë nuk janë kërkuar ndryshime, jo për ta bërë më mirë, por as për ta bërë më keq. E kanë ruajtur gjendjen e njëtrajtshme, secili ka funksionuar në atë shkallën, në atë stadin e vet, por për mua është e paarsyeshme të kërkohet që të krijojmë bord hetimor. Kjo ma kujton që ne do të bëjmë censurë dhe censura do të thotë që ne ta redaktojmë politikën redaktuese të RTK-së dhe t'i japim mundësi që ato çka të duam t'u ofrojmë.

Mund të mos pajtohen shumëkush prej këtyre 44-ve, por do ta kthejmë pak dhe ta kujtojmë të kaluarën, sepse censura, sidomos në RTK, është pjesë shumë e rëndë. Qytetarët kanë nevojë t'i shohin edhe ndryshimet, edhe dallimet, edhe perceptimet.

Për mua, bordi që do të krijohet, i cili kërkoj që të krijohet dhe të pajtohem me kolegët deputetë, që kërkuan që të krijohet ky bord sa më shpejt apo në afatin kohor, siç e përmendët edhe ju, Kryetar, më herët, që deri të premten ta kemi një mundësi, që t'i jepet ajo mundësi që bordi ta krijojë politikën dhe ato politika t'i redaktojë në RTK. Në të kundërtën, nëse do ta instalojmë komisionin hetimor, Kuvendi i Kosovës ka bërë një shkelje procedurale të ligjit dhe të gjithave.

Unë, edhe një herë kërkoj që RTK, derisa është medium publik, të jetë publik, të jetë në shërbim të qytetarëve e jo të interesave të ngushta të individëve. Ju faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

**MYRVETE PANTINA:** RTK është institucion publik i cili ofron shërbime publike në fushën e transmetimit të radios dhe televizionit. Është subjekt juridik i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilin edhe i raporton. Njëra ndër karakteristikat që i japin notë negative këtij institucionin është mungesa e transparencës. Unë do t'i paraqes dy argumente, ku vërehet mos transparenca në këtë institucion publik.

Nëse bazohemi në pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2008, shihet se të hyrat e këtij institucioni kryesisht burojnë nga parapagimi, rrëth 84% të të hyrave të përgjithshme, pjesën tjeter prej 14% e përbëjnë të hyrat nga marketingu dhe një pjesë shumë të vogël e përbëjnë të hyrat nga rimbursimet dhe të hyrat tjera, me nga 1% të të hyrave të përgjithshme. Mënyra e këtillë e paraqitjes së të hyrave, pa asnjë sqarim, posaçërisht, të të hyrat nga marketingu, se nga cilat shërbime janë realizuar ato të hyra, sa është çmimi i atyre shërbimeve, është formë shume e përgjithësuar dhe nuk i përmblush kriteret e parapara me Ligjin mbi financat publike. Nga Raporti i vitit 2008 i RTK-së shihet se shpenzimet në këtë institucion gjatë vitit 2008 kanë qenë më të ulëta se sa të hyrat për 76,848 €, d.m.th. ka pasur bilanc pozitiv. Por, edhe në kategorinë e shpenzimeve nuk është respektuar mënyra e raportimit financierar sipas Ligjit mbi financat publike, sepse nuk janë paraqitur në mënyrë analitike.

Një mangësi tjeter në RTK, që vërehet nga raporti, është ekzistimi i disa llogarive bankare, gjë që është në kundërshtim me kërkuesat e ligjit, që të gjitha paratë publike duhet të deponohen në një llogari të përcaktuar nga MEF. Ndërsa, RTK-ja, sipas të dhënave të Raportit 2007 të këtij institucioni, ka pasur 2 llogari kryesore dhe 5 nënlogari, prandaj ekzistimi i disa llogarive bankare nuk shkon në favor të transparencës në kë institucion. Andaj, mendoj se është e nevojshme të formohet një komision hetimor në nivel të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të konstatuar gjendjen reale në këtë institucion.

**KRYETARI:** Konsideroj se debati ka përfunduar. Ramë Buja, urdhëro, si shef i Grupit Parlamentar.

**RAMË BUJA:** Kryetar, duke dashur t'i respektoj të gjithë përgjérat e thëna, sepse u thanë gjëra shumë të mençura, por unë kisha kërkuar 15 minuta pauzë, kam nevojë për një konsultë me Grupin tim Parlamentar.

**KRYETARI:** Mirë, faleminderit! 15 minuta pauzë, pas 15 minutave në sallë.

(Reagime nga salla)

**KRYETARI:** Pauzë ka kërkuar.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

Të nderuar deputetë, fjala përfundimtare i takon udhëheqësit të Grupit të deputetëve, deputetit Arsim Rexhepi.

**ARSIM REXHEPI:** Ju faleminderit shumë, zoti Kryetar!

I falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre konstruktive dhe gati konstruktive. Po ju jap një reminishencë, kujtim nga viti 2005. Grupi Parlamentar i PDK-së kërkon komision hetimor.

Lënda: Kërkesë për krijimin e një komisioni hetimor, e tjera e tjera, për Radiotelevizionin e Kosovës.

Në vitet 2005 dhe 2009, paraqitet i njëjtë problem- Radiotelevizioni i Kosovës. Sot ju i dhatë antipodin e asaj energjie politike të cilën keni dashur për ta luftuar atëherë, ndërsa sot, për të njëjtat kushte e keni mbrojtur. Le të jetë në moralin tuaj politik.

Po i kthehem mocionit. Me Kushtetutë, neni 77, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kuvendi, me kërkesën e 1/3 së gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore. 44 deputetë e kanë nënshkruar kërkesën për krijimin e komisionit hetimor dhe kjo me automatizëm e obligon çdo grup parlamentar që t'i emërojë, në kuadër të atij komisioni hetimor, anëtarët e vet. Kështu thotë Kushtetuta, të cilën e kam nënshkruar edhe unë bashkë me juve dhe besoj që kurrkush nuk ka disponim që ta luftojë këtë patriotizëm tonë kushtetues.

Edhe një herë i kisha lutar të gjithë ata njerëz, deputetë, kolegët tonë të ndershëm, që në thellësinë e tyre besojnë se në Radiotelevizionin e Kosovës, përmes një komisioni hetimor mund të përmirësohet gjendja dhe unë jam i bindur që mund të përmirësohet, që të mos bëhen pengesë e krijimit të këtij komisioni hetimor. E lus Kryetarin që ta vë në procedurë themelimin e këtij komisioni hetimor. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Të nderuar deputetë!

Është e vërtetë që në vitin 2005, shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës kam qenë unë dhe kam kërkuar disa herë që të formohen komisione hetimore, e jo vetëm për RTK-në, por edhe për ekzekutivin, por asnjëherë në këtë Kuvend nuk është votuar ajo. Sa i përket 1/3 të deputetëve që kanë të drejtë ta ngrenë një çështje për formimin e një komisioni hetimor, mund të them me përgjegjësi që personi që gjatë hartimit të Kushtetutës, me këmbëngulësi e ka kërkuar që një 1/3 e deputetëve ta kenë të drejtën për ta formuar komisionin hetimor, kam qenë unë. Do të thotë, unë jam autor i asaj kërkese. Por, ne kemi një material përpëra dhe materiali i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, megjithatë, janë të nënshkruar fillimisht 45 deputetë por, ndërkohë, 4 deputetë që janë të nënshkruar nga Grupi “7+”, kanë tërhequr nënshkrimet dhe 5 deputetë nga SLS-ja, që bëjnë gjithsej 9, 45 hiq 9, janë 36 nënshkrime dhe kështu nuk i kemi 40 nënshkrime për ta formuar komisionin hetimor. Kjo është gjendja.

(Reagime nga salla)

Kështu, unë e kam të nënshkruar. Po, Haxhi Merxha, Xhezair Murati, Myfera Shinik, Shpresa Murati, pastaj kanë tërhequr nënshkrimet nga SLS-ja Dragisha Miriq, Dimiq Dragan, Sllobodan Petroviq, Mursel Halili dhe Kosara Nikoliq, që janë gjithsej 9 (nëntë) dhe me këtë e përfundojmë këtë pikë dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

(Reagime nga salla)

Tjetër, unë e kam një material që i është dërguar Kryesisë.

(Reagime nga salla)

Pauzën e ka kërkuar, ka pasur të drejtë ta kërkojë shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, prandaj edhe u krye. Ne jemi në rregull. Dëgjoni, kërkesat fillestare të grüpit prej 7 deputetëve kanë qenë: shkarkimi emergjent i Bordit të menaxhimit, kjo

nuk është me ligj dhe nuk mund ta bëjmë, krijimi i Komisionit ad-hoc, i patën 45 nënshkrimë, u tërheqën 9. Nën 3, emërimin e një menaxhmentit të përkohshëm që do të udhëheqë këtë medium ... edhe kjo është e jashtëligjshme dhe, nën 4, shpallja e konkursit, edhe kjo, se je në procedurë të zgjedhjes së Bordit dhe, në fund, restaurimi i interesit publik dhe kthimi i misionit që i është besuar RTK-së, besoj që RTK-ja ka misionin e vet.

(Reagime nga salla)

Janë tërhequr nënshkrimet, të nderuar. Vazhdojmë me rendin e ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit të Komisionit parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb**

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Materiali i është dërguar Kryesisë sot, nesër e kemi mbledhjen e Kryesisë dhe e shqyrtojmë materialin.

(Reagime nga salla)

Jo, materiali i është dërguar Kryesisë dhe ne e patëm një tërheqje, tash kemi të tjera, le ta shqyrtojë Kryesia dhe le të marrë vendim.

(Reagime nga salla)

Sabri Hamiti e kërkon fjalën.

SABRI HAMITI: Kolegë shumë të nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit, Zotërinj ministra,

Ne kemi biseduar sot për një çështje tepër të rëndësishme për RTK-në. Dëgjova fjalë që s'do të duhej Kuvendi, nuk ka vend, nuk ka sallë, nuk ka përbërje më kompetente dhe më të detyruar ligjërisht që të bisedojë për këto probleme.

Ne biseduam disa orë dhe arritëm në përfundimin kur do të duhej të votoheshin kërkosat e një grupei deputetësh, të cilat dalëngadalë morën formën e krijimit të një komisioni hetimor. Meqë, siç e patë edhe vet, u vërtetua që ka deputetë që s'e dinë fort peshën e nënshkrimit të vet dhe unë ju kam thënë, është hera e njëmbëdhjetë që ndodh kjo formë në Kuvendin e Kosovës. Në këtë tip sjelljesh janë përzier deputetët herë-herë të gjitha grupeve, kështu që s' dua t'i them askujt që është i veçantë. Meqë ne e pamë që, ndërkohë, menjëherë pati kërkesa që këta numra të plotësohen, ju lutem shumë, edhe për shkak të procedurave të Kuvendit, kërkosat i dini, Rregulloren e dini, le të verifikohen me shkrim kërkosat e reja, sot kjo pikë pushon, kalojmë në pikën tjetër dhe vazhdohet herën tjetër. Ju faleminderit!

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Komisioni parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 2008/2 për ndryshimin e Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil ka intervistuar kandidatët për

anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin, iu është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc, zoti Hydajet Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit, ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

**HYDAJET HYSENI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Është moment jo fort i përshtatshëm për ta shtruar këtë çështje, por besoj se ky Kuvend është në nivelin e përgjegjësisë dhe ndjeshmërisë së çështjes që do të shqyrtojmë, prandaj edhe do t' ju lusja që t'i kushton vëmendjen e duhur.

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni parlamentar ad-hoc, në përputhje me mandatin e marrë nga ky Kuvend, në bazë të konkursit të publikuar për emërimin e një anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga komuniteti serb dhe pas procedurës së selektimit në bazë të kushteve formale, në pajtim me Rregulloren 2008/12, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në bazë të kritereve unike për të gjithë kandidatët, ka intervistuar kandidatët, pas konkursit të përsëritur dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës, këta dy kandidatë: Irena Svetiq -Ahmedi, e cila ka marrë 91.7 pikë dhe Nebojsha Zdejkoviq 87.7 pikë. Për njoftimin tuaj, vetëm çështja e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është adresuar edhe në raportin e progresit, kurse me këtë zgjedhje, ne plotësojmë edhe vendin e 6 nga 7 sa janë, kurse pas ndonjë muaji, i skadon mandati edhe anëtarit të 7-të dhe me këtë përbushjet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, përbushjet edhe një obligim institucional i Kosovës.

Ju ftoj prandaj, zonja e zotërinj deputetë, që të votojmë sipas procedurave të parapara. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Pra, s'ka pauzë, presim edhe 5 minuta që deputetët të kthehen, përndryshe kërkoj nga regjia, pas 5 minutave, që ta bëjë identifikimin e deputetëve që janë në sallë dhe të atyre që kanë dal jashtë.

Pika e 9 e rendit të ditës, që është një njoftim.

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar “7+” ka vendosur që anëtare në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi të emërohet deputetja Myferra Shinik, në vend të deputetit Xhezair Murati.

Atëherë, mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**